



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në Avokaturën e Shtetit

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË”
NË
AVOKATURËN E SHTETIT

Tiranë 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-11
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-9
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	9-11
II.	HYRJA	12-14
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	12
2.	Identifikimi i çështjes	12-13
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13
4.	Përgjegjësitë e audituesve	13
5.	Kriteret e vlerësimit	13
6.	Standardet e auditimit	13-14
7.	Metodat e auditimit	14
8.	Dokumentimi i auditimit	14
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-107
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	14-15
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejttimeve të auditimit:	15
2.1.	Mbi organizimin, funksionimin dhe përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ për: -përputhshmërinë e procedurave të ndjekura për përfaqësimin juridik të shtetit në gjykata apo procese të tjera ligjore, -analizimin e efekteve financiare të ndjekjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në buxhetin e shtetit, -koordinimi dhe mbikëqyrja e punës së avokatëve të shtetit në të gjitha nivelet e administratës publike.	15-63
2.2.	Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit -Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit. -Realizimi i planit të buxhetit.	64-72
2.3.	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. -Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës. -Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit. -Inventarizimi i pronës shtetërore.	72-90
2.4.	Prokurimet me fonde publike -Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik, lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/ punëve dhe shërbimeve.	90-93
2.5.	Mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, funksionimi i strukturës së Auditit të Brendshëm.	93-107
2.6.	Të tjera çështje që mund të dalin gjatë auditimit.	107-137
IV.	REKOMANDIME	137-152

RMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër për subjektin.

Avokatura e Shtetit (*këtu e më poshtë ASH*) është person juridik publik në varësi të Kryeministrit, është institucion qendror i administratës publike, i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike, i cili përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit për personat juridik shtetëror.

Auditimi i këtij institucioni ka rëndësi pasi, një ndër funksionet bazë të tij është mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit të përputhshmërisë mbi bazën e një vlerësimi objektiv për zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e ASH dhe ecurinë e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2024 si dhe kontabilizimin e detyrimeve, masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim marrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushjen e qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

-Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi. (Stoku i detyrimeve dhe rakordimi i detyrimeve të prapambetura, gjendje në datën 31.12.2024. Detyrimet sipas vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare).

-Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

Metodat për kryerjen e këtij auditimi janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, ASH funksion në zbatim të Ligjit Nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke siguruar informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;

c. *Pyetësorët drejtuar subjektit* - duke marrë informacionet mbi numrin e vendimeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ dhe detyrimet që rrjedhin nga vendimet përkatëse për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2024, këmbimin e informacionit me institucionet përgjegjëse/palë interesi në çështje arbitrazhi;

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

I.1 Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi në terren.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se Avokatura e Shtetit për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2024, paraqet në veprimtarinë e saj specifika trajtuar më poshtë:

Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi në vijim:

1. Për periudhën nën auditim, Zyra e Inspektimit dhe Këshillimit në ASH e cila është përgjegjëse për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit, në të dyja nivelet e

organizimit, për ushtrimin me efektivitet të funksioneve të institucionit, ka kryer vetëm inspektime tematike dhe të fokusuara mbi veprimtarinë e avokatëve të shtetit individualisht dhe jo mbi veprimtarinë e zyrave në tërësi. Nuk ka informacion lidhur me çështjen dhe pasojat të cilat mund ose kanë sjellë dëm në interesat e shtetit shqiptar, nga veprimet apo mos veprimet e avokatëve të shtetit.

2. Fokusi kryesor i Zyrës së Inspektimit ka qenë “Përditësimi i dosjeve në sistemin elektronik”, *në zyrat vendore dhe ato të avokatëve të shtetit pranë Ministrive*, por megjithëse është kryer një numër i konsiderueshëm inspektimesh për këtë problematikë (rreth 92 inspektime vetëm për 2023), nuk ka një konkluzion se sa për qind e dosjeve janë hedhur në sistemin elektronik dhe sa jo e rrjedhimisht asnjë datë fikse se kur ky proces duhet të përfundojë.

3. Regjistrimi i vendimeve të GJEDNJ dhe Gjykatave të Huaja dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe çdo lloj korrespondence tjetër pjesë e procesit deri në publikimin e vendimit përfundimtar kryhet sipas një regjistri fizik dhe elektronik (Excel), por mungon një sistem bartës informatik për digjitalizimin e çdo elementi të dosjes, që sjell mungesë transparence dhe llogaridhënie dhe rrit riskun e mos mbajtjes saktë dhe në kohë të çdo të dhëne të nevojshme për monitorimin e të gjithë korrespondencës shkresore apo e-maileve zyrtare.

4. Në lidhje me vendimet e arbitrazhit të fituara nga RSH, në regjistrat elektronik (Excel) rezulton se janë 7 vendime, nga të cilat 4 vendime janë të fituara gjatë vitit 2024. Sipas këtyre vendimeve, RSH duhet të rimbursohet për *kosto të tribunalit dhe shpenzime të përfaqësimit* në vlerën 8,971,593 Euro, 1,565,791 USD dhe 108,551 GBP ose e thënë në një monedhë të vetme 10,473,572 euro¹ si dhe 6,821,710 euro dëmshpërblim, pra në total 17,295,282 euro të shpenzuara nga buxhetit i shtetit, të ndarë këto ndërmjet institucioneve të ndryshme, përfshirë MF, MIE, APD, A, MBZHR dhe AKUK.

Vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar bëhen të zbatueshëm në Shqipëri pas njohjes së vendimit nga Gjykata Shqiptare e Apelit, çka në vlerësimin tonë paraqet nevojën për një qasje ndryshe të ASH si dhe rrit përgjegjësinë që kanë Institucionet përkatëse në rolin e palëve të paditura dhe detyrimin për të zbatuar dhe ndjekur vendimet e gjykatave të arbitrazhit *për më tepër kur ato janë njohur nga Gjykata e Apelit*.

Nga këto 7 vendime, janë njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë, vetëm 2 vendime:

- Çështja ICC Case No. 20564/EMT/GR, (iniciuar nga viti 2014), me *Vendimin nr. 131 datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë (kërkues MIE)*, ku Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka vendosur që Pala Paditëse H. srl duhet t’i paguajë Penalitete për vonesat, RSH në shumën 6,821,710 euro dhe 325,000 \$.

- *Vendimi i dytë i njohur nga Gjykata e Apelit i përket çështjes ICSID ARB/14/26*, (iniciuar nga viti 2014) “A. A.” sh.p.k., A. N., shoqëria “C..” s.r.l, me nr. 969, datë 25.11.2024, ku Pala Paditëse duhet t’i paguajë Penalitete për vonesat, RSH 3,269,938.71 euro.

- *Vendimi i dytë i njohur nga Gjykata e Apelit i përket çështjes ICSID ARB/14/26*, (iniciuar nga viti 2014) “A. A.” sh.p.k., A. N., shoqëria “C.” s.r.l, me nr. 969, datë 25.11.2024.

Mos rimbursimi i vlerave të vendosura nga Vendimet e Gjykatave të Arbitrazhit në favor të RSH-së, në buxhetin e shtetit, në dy çështjet të cilat janë njohur edhe nga Gjykata e Apelit, konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale 10,091,648.7 euro dhe 325,000 USD, veprime në kundërshtim me me Kodin e Procedurës Civile (K.Pr.C), neni 510. Ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit të njohura nga gjykatat është detyrim ligjor dhe moral ndaj interesit publik.

¹ Monedhat e huaja janë konvertuar me kursin zyrtar të BSH, të datës 24.04.2025.

5. Në lidhje me çështjet në gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar dhe vendimet e tyre ku shteti shqiptar është pala humbëse, deri në dhjetor 2024, rezultojnë 4 çështje, me efekte financiar në një vlerë totale 180,125,882 euro, nga të cilat kosto të tribunalit dhe përfaqësimit janë 11,580,103.86 euro², vlerë e cila gjithashtu do të paguhet nga qeveria shqiptare.

Përsa i përket vendimeve të humbura nga RSH, vetëm një prej tyre është njohur nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, konkretisht: Çështja ICC Case no. 22676/GR me palë paditëse GBC, iniciuar prej 2017. Pala e Paditur (MIE&AKBN, Alb Petrol.)

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit vlerën 12,577,852.1 USD: si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencës së Marrëveshjes së Cakranit, Gorishtit dhe Ballshit.

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit 292,760 USD dhe 14,451.68 Euro, me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

Prej datës së njohjes deri në periudhën e auditimit (prill 2025) nuk është marrë asnjë masë nga MIE&AKBN, për njohjen e këtij detyrimi dhe planifikimin në buxhetin përkatës për shlyerjen e tij duke e vendosur shtetin shqiptar para një risku tjetër në dëm të buxhetit të shtetit atë të interesave për 4 vite, të cilat të përlllogaritura nga grupi i auditimit prej datës së vendimit 06.07.2020 deri në 31.12.2024, vlera e pritshme e interesave është: 65,871 \$ dhe 2,890.4 euro ose e shprehur në një monedhë të vetme 60,776 euro, vlerë që përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit.

6. Në lidhje me çështjet në proces apo të ndërprera, në gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar, 4 (katër) çështje janë të përfunduara, 2 (dy) janë çështje të pezulluara pra pa zhvillime nga ana e palës paditëse, dhe 2 (dy) janë në proces.

Efekt negativ financiar i shpenzimeve gjyqësore, paguar nga buxhetit i shtetit si palë e paditur për këto çështje (të pezulluara, të përfunduara dhe në proces), është 1,949,063 euro.

7. a) Nga përpunimi i të dhënave sipas regjistrave elektronikë, të ASH, rezulton se vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë, të cilat kanë marrë formën përfundimtare gjatë vitit 2023, janë 23, nga të cilët të ekzekutuar brenda vitit 2023, janë 14 me një vlerë dëmshpërblimi 10,416,942 lekë dhe 68,166 lekë interesa për 5 vendime të likuiduara jashtë afatit 3-mujor, në dëm të shtetit shqiptar, veprime në kundërshtim me Nenin 19/4 të Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar, "Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse".

b) Në lidhje me vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë, të cilët kanë marrë formë të prerë në vitin 2023 dhe janë kryer pagesat në vitin 2024, rezultojnë të jenë 9, me një vlerë dëmshpërblimi 21,263,173 lekë nga të cilat 37,396 lekë janë interesa³, për pagesa jashtë afatit 3 mujor.

c) Për vendime të GJEDNJ-së, të cilat kanë marrë formë përfundimtare në periudhën 2019-2021, por të ekzekutuara gjatë vitit 2023, rezultojnë të jenë 2 vendime (datë 26.01.2023) me një vlerë dëmshpërblimi 4,018,746 lekë, nga të cilat 369,741 lekë janë interesa për pagesa të kryera jashtë afateve ligjore, konkretisht Vendimi i datës 21.04.2021/S. k. Shqipërisë dhe Vendimi i GJEDNJ i datës 17.09.2019/P. k. Shqipërisë.

Për vitin 2024, Shteti Shqiptar ka ekzekutuar gjithsej 31 vendime, kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën 30,355,446 lekë dhe në vlerë totale 30,403,545 lekë nga të cilat 48,009 lekë janë interes i paguar ndaj gjyqfituesve, për vonesa në kryerjen e pagesës, veprime në kundërshtim me Neni 19/4 "Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse" të ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar. Nga 31 vendime të ekzekutuara, 9 prej tyre janë të mbartura nga viti 2023 (sqaruar më sipër).

² Në shumën e kostove të përfaqësimit në gjykata, janë përfshirë edhe 2 çështje në të cilat pala shqiptare ka qenë fituese por ka pasur detyrim për të paguar vlerat 5,902,888 euro, paraqitur në tabelen 14, rreshti 5-6.

³ Kjo shumë është pjesë e vlerës prej 48,009 lekë.

Pra në total për periudhën 2023-2024, janë paguar jashtë afatit 3 mujor, 19 vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë në shkellje të nenit 19/4 të Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse”, të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 485,916 lekë.

d) Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve GJEDNJ në ASH, për vitin 2024, rezultoi se: GJEDNJ ka dalë me 49 vendime, për 67 kërkesa. Në këto çështje, kërkuesit gjatë gjykimit, kanë kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerë financiare prej 5,601,036.064 (pesë miliard e gjashtëqind e një milion e tridhjetë e gjashtëmijë e gjashtëdhjetë e katër) Euro⁴, ndërsa Gjykata ka pranuar në total një shpërblim dëmi në vlerën 212,600 Euro⁵.

8. ASH në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse (MD-MF-KM) nuk ka arritur ende të zgjidhë dhe të ekzekutojë vendimet e GJEDNJ në 6 çështje kundër Shqipërisë, të cilat kanë një vlerë dëmshpërblimi 17,968,650 euro, ku vetëm *çështja Sh. përbën 75 %* të këtij detyrimi (rreth 13.3 mln euro) me një vendim të datës 28.05.2018. Ndërkohë renditen edhe çështjet e tjera:

- ✓ Çështja D.k. Shqipërisë me vlerë 15,600 euro (dt. 14.09.2015/Vendimi).
- ✓ Çështja “Dh. dhe N.k. Shqipërisë”, me vlerë 4,417,750 euro (dt 17.03.2016/Vendimi).
- ✓ Çështja I.srl K. Shqipërisë me vlerë 10,800 euro, (dt. 05.03.2024/Vendimi).
- ✓ Çështja Z.k. Shqipërisë me vlerë 60,000 euro (dt. 11.06.2024/Vendimi).
- ✓ Çështja M. & S. F. B.s NV k. Shqipërisë me vlerë 17,200 euro (dt.16.10.2024/Vendimi).

Tre nga këto çështje datojnë me një vendim përfundimtar të GJEDNJ për më shumë se 7 vite, (2015-2018) të paekzekutuara ende, çka sjell një efekt negativ të shtuar në buxhetin e shtetit lidhur me kamatëvonesat që do të aplikohen mbi këto vlera. Moszbatimi i Vendimeve të GJEDNJ, nga shteti shqiptar, bie ndesh me nenin 46 të KEDNJ (detyrimi për zbatim), ku përcaktohet qartë se *palët kontraktuese angazhohen të respektojnë vendimet përfundimtare të gjykatës në çdo çështje në të cilën ato janë palë*.

Në lidhje me 3 vendimet e GJEDNJ, të cilat kanë marrë formë përfundimtare në vitin 2024, dërguar pranë Kryeministrit kërkesat për ekzekutimin e këtyre vendimeve, së bashku me projekt VKM përkatëse, Vendimi i Këshillit të Ministrave nuk është miratuar duke dalë jashtë afateve (përmby 5 muaj) në kundërshtim me nenin 19/2 të Ligjit/10018, i ndryshuar për ASH.

9. Ministria e Financave në deklaratimet e saj si në raportet vjetorë 2023&2024, ashtu edhe në evidencat e borxhit, nuk paraqet dhe nuk ka llogaritur në asnjë moment, *vlerën e interesave mbi shumat e përcaktuara në vendimet e GJEDNJ-së apo të arbitrazhit ndërkombëtar kundër Shqipërisë edhe pse janë në tejkallim të afateve të përcaktuara* e rrjedhimisht as Avokatura e Shtetit nuk e disponon këtë informacion. Grupi i auditimit nuk mund të dalë në një vlerë të saktë mbi vlerën e interesave të pritshëm për t’u paguar dhe që janë dëm në buxhetin e shtetit, veçanërisht për vendimet e GJEDNJ-së, ku afatet janë të mirë përcaktuara dhe ka ende vendime të cilat kanë më shumë se 7 vite jashtë afateve për ekzekutim.

10. Avokatura e Shtetit deri në datën 31.12.2024 është penalizuar me gjoba nga Drejtoria e Tatim Taksave Tiranë në shumën *391,550 lekë* (shkaktuar nga dega e financës). Nëpërmjet bankës janë kryer pagesat e detyrimeve për gjobat në shumën *50, 630 lekë*, ndërsa diferenca prej **340,920 lekë** është në proces gjyqësor me nr. çështje 31155-02028-80-2025, datë 03.03.2025.

11. Nëpërmjet bankës janë kryer pagesa për dieta brenda vendit në *shumën 82,500 lekë*, pa dokumentacionin justifikues dhe vërtetues, pasi nga punonjësit nuk janë paraqitur faturat e hotelit si edhe nuk janë plotësuar urdhër shërbimet, veprime në kundërshtim me udhëzimin e

⁴ Në terma konkretë, janë kërkuar gjithsej nga kërkuesit: 553.339.977 Euro; 260.488.700 Lekë; 5.122.715.430 USD dhe 180.901 Franga Zviceriane, të cilat janë konvertuar në Euro me kursin e datës 03.02.2025.

⁵ Në këtë vlerë janë përfshirë dhe 2 vendimet më të fundit të gjykatës, që nuk janë bërë akoma përfundimtare.

Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 34, 35 dhe 36.

12. Për procedurat e ndjekura nga komisioni i ngritur në kuadër të kontraktimit të studiove ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar, bazuar në VKM nr.893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrate të avokatisë vendase ose të huaja”, rezultoi mungesë e akteve të tjera nënligjore për këtë lloj procedure. Avokatura e Shtetit nuk ka hartuar ndonjë akt si: Udhëzim/rregullore e brendshme që të përcaktojë rregulla të detajuara lidhur me funksionimin e komisionit, detyrat e anëtarëve të komisionit, vendimmarrjen, rregullat mbi dokumentimin e plotë, të saktë dhe në kohën e duhur të procesit që nga nisja e tij deri në arkivimin e praktikës, si edhe rregulla të tjera që lidhen me konfidencialitetin e ruajtjes së të dhënave apo deklarin e konfliktit të interesit. Nisur nga fakti se VKM nr. 890/2020, nuk i ka të përcaktuara qartë rregullat që ndiqen gjatë procesit të pikëzimit e të renditjes së subjekteve ofertuese lidhur me kritere si: “përvoja profesionale e ofertuesit, eksperiencia të ngjashme të stafit kryesor të ofertuesit dhe raste të suksesit të ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit”, komisioni i ngritur në ASH ka aplikuar një formulë të ngjashme me atë të vlerësimit të ofertës ekonomike sipas pikës 4, shkronja a) të kësaj VKM-je. Kjo metodologji e përdorur nga komisioni është e pa miratuar me një akt të brendshëm. Për sa më sipër është e nevojshme që procedura të pasqyrohet në një akt nënligjor me efekt rregullator si Udhëzim apo Urdhër të titullarit të ASH dhe në rast ankimimi të procedurës së vlerësimit nga subjektet ofertuese të kualifikuara, Zyra e Avokaturës së Shtetit do të mund të garantojë ofertuesit me informacion të mjaftueshëm për mënyrën e vlerësimit, bazuar në procedura të miratuara dhe transparente. Mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 16, pikat 2 dhe 3, nenin 22 dhe nenin 23, pika 5, e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Referuar pikës 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin përcaktohet se, njësitë publike duhet të mbështeten në akte ligjore dhe nënligjore specifike për procese dhe procedura përkatëse, duke filluar nga zbatimi i ligjeve, e duke vijuar me miratimin e rregulloreve të tyre të brendshme (udhëzime, direktiva) për të evidentuar më hollësisht procedurat, përcaktimin e autoritetit dhe përgjegjësisë, si dhe procedurat e kontrollit.

2. Anëtarët e komisionit nuk kanë kryer verifikimin e mungesës së konfliktit të interesit në momentin e hapjes së ofertave sipas nenit 4, pika 1, shkronjës “c”, dhe pika 2 shkronjat “b” ,“c”, si dhe neni 7, pika 1 në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

-Në procesverbalin e vlerësimit të subjekteve, lidhur me kriteret si: “përvojë profesionale/eksperiencia të ngjashme të stafit kryesor dhe raste të suksesit”, komisioni nuk ka dhënë shpjegime të hollësishme mbi mënyrën e vlerësimit të numrit të rasteve të ngjashme për secilin kriter; Kontratat e lidhura nga Avokatura e Shtetit parashikojnë hartimin në gjuhën angleze.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si vijon:

1. Avokatura e Shtetit të marrë masat e nevojshme për hartimin e planeve vjetore të inspektimit, programeve të plota të inspektimit, hartimin e raporteve me informacionet përkatëse të çështjeve në të cilat mbrojtja e interesave të shtetit nuk është kryer në përputhje me përcaktimet ligjore, për të vlerësuar përmbushjen e detyrave funksionale nga avokatët e shtetit.

2. Avokatura e Shtetit të marrë masa konkrete për:

-Finalizimin dhe standardizimin e hedhjes së të gjitha dosjeve për çështjet e gjykatave Kombëtare në sistemin elektronik duke vendosur një afat të qartë për përfundimin e këtij procesi.

3. Avokatura e Shtetit të marrë masa konkrete dhe të ngrejë një grup pune me avokatët e shtetit dhe specialistë IT, për digjitalizimin e procesit të dosjeve dhe vendimeve të *GJEDNJ dhe Gjykatave të Huaja dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar* ku të përcaktohen saktë me anë të moduleve çdo e dhënë për to prej inicimit të këtyre çështjeve e deri në daljen e vendimit përfundimtar si dhe në monitorimin e korrespondencës me institucionet palë në këtë proces.

4. Të merren masa nga MIE/Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për ndjekjen e procedurave për njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të vendimeve të arbitrazhit në pasqyrat financiare (*çështjet 1. ICC Case nr. 22676/GR dhe 2. ICC Case No. 20564/EMT/GR*) dhe të iniciohen veprimet për ekzekutimin dhe arkëtimin e vlerave monetare në shumën 6,821,710 euro dhe 325,000 \$ duke bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit për të raportuar të dhënat në kohë reale në Ministrinë e Financave.

5. Të merren masa nga MTM/Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për ndjekjen e procedurave për njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të vendimeve të arbitrazhit (ICSID ARB/14/26, (iniciuar nga viti 2014) “A. A.”sh.p.k., A. N., shoqëria “C.” s.r.l, me nr. 969, datë 25.11.2024.) në pasqyrat financiare dhe të iniciohen veprimet për ekzekutimin dhe arkëtimin e vlerave monetare në shumën 3,269,938.71 euro, duke bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit për të raportuar të dhënat në kohë reale në Ministrinë e Financave.

6. Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me (MIE) dhe A.AKBN të marrë masa për zbatimin e menjehershëm të vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit të njohur nga Gjykata e Apelit me vendim *nr. 49 datë 04.05.2021*, në vlerën 12,577,852.1 USD,

7. Avokatura e Shtetit, të marrë masa duke informuar Këshillin e Ministrave, për të eliminuar kostot me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën *60,776 euro* të krijuara si pasojë e mos ekzekutimit të vendimit të formës prerë *nr. 49, datë 04.05.2021*, dhe në bashkëpunim me MIE të nxjerrë përgjegjësitë ligjore për çdo mosveprim të punonjësve.

8. Avokatura e Shtetit të marrë masat e nevojshme për të njohur dhe reaguuar në kohë në rastet kur gjyqefituesit e vendimeve të gjykatave të huaja apo arbitrazhit ndërkombëtar kërkojnë zbatimin e vendimit në vende ku Shteti Shqiptar gëzon të drejta, duke analizuar në çdo rast përdorimin e mjetit ligjor më efektiv për mbrojtjen sa më të plotë dhe cilësore të interesit të vendit.

9. Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ pranë ASH-së, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të Buxhetit të Shtetit, në vlerën *485,916 lekë*, interesa për pagesa të vendimeve të *GJEDNJ, jashtë afatit 3-mujor, për periudhën 2023-2024*.

10. Avokatura e Shtetit bashkë me Këshillin Konsultativ për Çështjet e *GJEDNJ-së*, për 3 çështjet kryesore “*SH and others v. Albania*”, “*Dh. dhe N*“ dhe “*D. k. Shqipërisë*” (*17,880,650 euro*), me vendime të formës përfundimtare të *GJEDNJ-së* për shumë se 7 vite, të cilat kanë penalizuar taksapaguesit shqiptarë me një barrë mjaft të lartë financiare,(pa përfshirë këtu interesat për vonesa në likuidim) të ri analizojë dosjet gjyqësore dhe vendimet e *GJEDNJ* dhe të informojë Këshillin e Ministrave për të gjitha shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse dhe evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive.

11. Avokatura e Shtetit bashkë me Këshillin Konsultativ për Çështjet e *GJEDNJ-së*, për 3 çështjet “*I srl K. Shqipërisë*”, “*Z.k. Shqipërisë*” dhe “*M. & S. F. Br. NV k. Shqipërisë*” (*88,000 euro*), me vendime të formës përfundimtare të *GJEDNJ-së* të dala gjatë vitit 2024, të marrë masa dhe t'i kërkojë Këshillit të Ministrave miratimin e VKM përkatëse, për ekzekutimin e Vendimeve të *GJEDNJ-së* si dhe shmangien e penalteteve në vonesa për likuidim.

12. Avokatura e Shtetit në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ por dhe të përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për ekzekutimin e këtyre vendimeve, të informojë Këshillin e Ministrave për vendimet ende të paekzekutuar, si dhe vlerën e interesave financiarë të llogaritur për moszbatimin në afat të tyre, të cilat e ekspozojnë në vijimësi buxhetin e shtetit me vlera të konsiderueshme financiare.

13. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për raportimin në afat të deklarimeve periodike në sistemin C@TS, me qëllim shmangien e penalteteve nga Drejtoria e Tatimeve.

14. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masa duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën 82,500 lekë, përfituar pa dokumentacionin justifikues nga punonjësit.

15. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit të marrë masa për hartimin e një akti nënligjor me karakter shpjegues mbi përcaktimin e rregullave të qarta që duhet të ndiqen nga komisionet e ngritura për kontraktimin e studiove ligjore lidhur me: (i) dokumentimin e plotë, të saktë dhe në kohën e duhur të procesit që nga nisja e tij deri në arkivimin e praktikës si dhe përcaktimin e listës së akteve që duhet të përmbajë dosja e procedurës së kontraktimit; (ii) rregulla që lidhen me konfidencialitetin e ruajtjes së të dhënave dhe verifikimin e mungesës së konfliktit të interesit; (iii) detyrat e anëtarëve të komisionit; (iv) procesin e pikëzimit e të renditjes së subjekteve ofertuese lidhur me kritere si: *“përvoja profesionale e ofertuesit, eksperiencia të ngjashme të stafit kryesor të ofertuesit dhe raste të suksesit të ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit”*, si dhe (v) arsyetimin e vendimmarrjes nga ana e komisionit.

I.1. Konkluzioni dhe opinionin i auditimit.

Opinion për auditimin e përputhshmërisë

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit (këtu e më poshtë ASH), me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me ecurinë e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar, kontabilizimin e detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së ASH, me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me ecurinë e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar, kontabilizimin e detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e ASH-së, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një Opinioni të Kualifikuar të përputhshmërisë⁶.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.

⁶ **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.

Ne kemi audituar veprimtarinë e subjektit Avokatura e Shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSA P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga ASH dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa.

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e **opinionit të kualifikuar**.

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, sipas kërkesave të Ligjit Nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” si dhe Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit” me të gjitha aspektet materiale, etj. kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi, të identifikuar si më poshtë vijon:

Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen kryesisht me ndikimin që institucioni ka në përfaqësimin e interesave të vendit në proceset gjyqësore, por edhe sa i përket mirë menaxhimit të veprimtarisë dhe burimeve të tij.

Problematikat e evidentuara i referohen kryesisht; proceseve të ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit, sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, mungesës së mbulimit territorial me proces inspektues, mos përmbushjes së procesit të regjistrimit të dosjeve elektronike për çështjet në gjykatat e RSH, në sistemin elektronik, mungesës së digjitalizimit të dosjeve për vendimet e arbitrazhit dhe vendimeve të GJEDNJ-së që ka sjellë mungesë transparence dhe llogaridhënie duke rritur riskun e mos mbajtjes saktë dhe në kohë të veprimeve të kryera, mos garantimin e zbatimit të plotë të vendimeve të GJEDNJ, moskryerjen e analizave të posaçme lidhur me procedurat e ndjekura nga institucionet publike (MIE, MTM, A, AKBN, APD) për çështjet e humbura të cilat kanë krijuar efekte financiare të konsiderueshme në buxhetin e shtetit dhe mos nxjerrjen e përgjegjësiive individuale.

Nga auditimi mbi ecurinë e ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar deri në dhjetor 2024, rezultuan të ardhura të munguara dhe përdorim pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve të buxhetit të shtetit, si më poshtë:

- Për vendime të arbitrazhit të fituara nga RSH, ku nga 7 vendime, 4 vendime janë të fituara gjatë vitit 2024. Sipas këtyre vendimeve, RSH duhet të rimbursohet për kosto të tribunalit dhe shpenzime të përfaqësimit në vlerën 10,473,572 euro⁷ si dhe 6,821,710 euro dëmshpërblim, pra në total 17,295,282 euro të shpenzuara nga buxheti i shtetit, të ndarë këto ndërmjet institucioneve të ndryshme, përfshirë MF, MIE, APD, A, MBZHR dhe AKUK.

- Nga këto 7 vendime, janë njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë, vetëm 2 vendime:

a. Çështja ICC Case No. 20564/EMT/GR, (iniciuar nga viti 2014), me *Vendimin nr. 131 datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë (kërkes Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)*,

b. *Vendimi i dytë i njohur nga Gjykata e apelit i përket çështjes ICSID ARB/14/26, (iniciuar nga viti 2014) “A. A.” sh.p.k., A. N. shoqëria “C.” s.r.l, me nr. 969, datë 25.11.2024. Mos rimbursimi i të cilëve në favor të RSH-së, konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e*

⁷ Monedhat e huaja janë konvertuar me kursin zyrtar të BSH, të datës 24.04.2025.

shtetit në vlerën totale 10,375,826 euro. Ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit të njohura nga gjykatat është detyrim ligjor dhe moral ndaj interesit publik.

-Përsa i përket vendimeve të arbitrazhit të humbura nga shteti shqiptar deri në dhjetor 2024, që janë 4 çështje, me efekt financiar në një vlerë totale 180,125,882 euro vetëm një prej tyre është njohur nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, konkretisht: Çështja ICC Case no. 22676/GR, iniciuar prej 2017 me palë të Paditur (MIE&AKBN, Alb Petrol), ku MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit vlerën 12,577,852.1 USD si dhe 292,760 USD dhe 14,451.68 Euro, me interes me normë 5%, e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës. Prej datës së njohjes deri në periudhën e auditimit (prill 2025) nuk është marrë asnjë masë nga MIE&AKBN, për njohjen e këtij detyrimi dhe planifikimin në buxhetin përkatës, për shlyerjen e tij duke e vendosur shtetin shqiptar para një risku tjetër në dëm të buxhetit të shtetit atë të interesave për 4 vite, të cilat kanë vlerë 60,776 euro.

- Për 19 vendime të GJEDNJ-së, të cilat kanë marrë formë përfundimtare në periudhën 2023-2024, është kryer nga Ministria e Financave, pagesa jashtë afatit 3-mujor duke gjeneruar interesa në vlerën 485,916 lekë, veprime në kundërshtim me Nenin 19/4 të Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar, "Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse".

- Për mos ekzekutimin e vlerës së dëmshpërblimit prej 17,968,650 euro, nga Ministria e Financës dhe Këshilli i Ministrave për 6 vendimeve të GJEDNJ-së, të mbartura në vite, që do të sjellë edhe një efekt negativ të shtuar në buxhetin e shtetit lidhur me kamatëvonesat që do të aplikohen mbi këto vlera.

-Për penalitete në vlerën 391,550 lekë për mos përmbushje të afateve ligjore në pagesa nga dega e financës, marrë në sistemin tatimor C@TS, i detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe TAP.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se, në llogarinë 468 "Debitor të ndryshëm", vlera prej 11,053,138 lekë, përfaqëson masa zhdëmtimi për dëme ekonomike të konstatuara në vite. Vlera është kontabilizuar, por nuk është arkëtuar ndër vite dhe nuk janë marrë masa për arkëtimin e tyre.

Ministria e Financave në deklaratimet e saj si në raportet vjetore 2023&2024, ashtu edhe në evidencat e borxhit, nuk paraqet dhe nuk ka llogaritur vlerën e interesave mbi shumatat e përcaktuara në vendimet e GJEDNJ-së apo të arbitrazhit ndërkombëtar kundër Shqipërisë edhe pse janë në tejkalim të afateve të përcaktuara, duke mos pasqyruar vlerën reale të borxhit total të Republikës së Shqipërisë si dhe mos planifikim të saktë të PBA-ve për likuidimin e tyre në kohë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit Nr.164/1 Prot, datë 11.02.2025, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 10.02.2025 deri në datë 07.05.2025, në ASH u krye auditimi "Mbi Përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare" për periudhën nga data 01.01.2023 deri në 31.12.2024 nga grupi i auditimit me përbërje:

M. B., përgjegjës grupi;

E. Ll., auditues

L. Ll., auditues

M. M., auditues

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit në: regjistrimin e vendimeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ, korrespondencën me institucionet palë interesi në çështjet e iniciuara për arbitrazh në lidhje me njohjen e vendimeve të arbitrazhit dhe ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, detyrimin për raportimin në MFE të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ, si edhe në aktivitetin e veprimtarisë ekonomike-financiare.

Në përfundim të punës audituese në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur aktkonstatimet si dhe është organizuar takimi përmbyllës në datën 06.05.2025 me Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit dhe përfaqësuesit të zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, synohet dhënia e opinionit të auditimit të përputhshëmrisë mbi një vlerësim objektiv, profesional dhe të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga ASH të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve të vendosura. Qëllimi i tij është përcaktimi i nivelit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e ASH për periudhën nën auditim.

Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga audituesit:

- nëse janë zbatuar detyrimet ligjore të Avokaturës së Shtetit në lidhje me regjistrimin në kohë të çështjeve të iniciuara për arbitrazh dhe vendimeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ, si dhe bashkëpunim me institucionet përgjegjëse (palë interesi në çështje arbitrazhi) për ecurinë e ekzekutimit të vendimeve;
- nëse janë kryer kontabilizimet e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ si dhe masat për likuidimin e tyre;
- nëse janë zbatuar kërkesat ligjore për aktivitetin ekonomiko-financiar;
- dhënien e opinionit të auditimit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së ASH-it.

2. Identifikimi i çështjes.

Projekt Raporti i Auditimit mbi auditimin e përputhshëmrisë së veprimtarisë së ASH Tiranë, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, ka identifikuar sipas kriterëve specifikë të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- përputhshmëria me kriteret ligjore, lidhur me ecurinë e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe arbitrazhit;
- bashkëpunimin me institucionet palë interesi;
- përputhshmëria në lidhje me kontabilizimin e detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të ASH-it, kanë për detyrë që të përgjigjen për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në lidhje me përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë.

Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

4.Përgjegjësitë e audituesve.

Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë/ASH dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-^{së}) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për administrimin dhe përditësimin e regjistrit të posaçëm fizik dhe elektronik të çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatavetë huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar.

-Nëse janë raportuar në në MFE detyrimet që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ.

-Nëse janë kontabilizuar dhe marrë masa për likuidimin e detyrimeve.

5.Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit:

-Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Ligji Nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;

-Rregullore e brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit” miratuar me Urdhërin Nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit i ndryshuar;

-Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

6.Standardet e auditimit.

Standardet e zbatuara nga grupi i auditimit gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit:

-ISSAI 400 (*Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*), që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

-ISSAI 4000 "*Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*";

-Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*”; etj.;

-Praktikat më të mira të fushës.

7.Metodat e auditimit.

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar, ASH, funksion në zbatim të Ligjit Nr. Nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimit e auditimit;

c. *Pyetësorët drejtuar subjektit*-duke marrë informacionet mbi numrin e vendimeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ për vitin 2023, këmbimin e informacionit me institucionet përgjegjëse/palë interesi në çështje arbitrazhi;

d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

8. Dokumentimi i auditimit.

Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuar/a dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me nëpunësit e ASH, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në aktkonstatimet e mbajtura në subjekt dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti Auditimi.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Avokatura e Shtetit (ASH) është person juridik publik në varësi të Kryeministrit, është institucion qendror i administratës publike, *i ngarkuar ekskluzivisht për dhënien e asistencës juridike*, i cili përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit për personat juridik shtetëror. Ajo drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele në nivel qendror dhe vendor. Në nivel qendror përbëhet nga: a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare; b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror; c) *zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar*; ç) zyra e inspektimit; d) Kolegji i Avokaturës së Shtetit. Detyrat dhe funksionet parashikohen në Rregulloren e Brendshme të Institucionit. Ndër funksionet bazë të Institucionit janë mbrojtja e interesave pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, ku Republika e Shqipërisë është palë.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

Në zbatim të programit të auditimit Nr. 164/1, datë 11.02.2025, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në Avokaturën e Shtetit, u ushtrua auditim përputhshmërie për periudhën 01.01.2023-31.12.2024, sipas këtyre drejtimeve:

-Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlerat e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi. (Stoku i detyrimeve dhe rakordimi i detyrimeve të prapambetura, gjendje në datën 31.12.2024. Detyrimet sipas vendimeve të Gjykatave Ndërkombëtare).

-Kontabilizimi i detyrimeve dhe masat e marra për ndjekjen dhe likuidimin e tyre.

-Hartimi dhe zbatimi i buxhetit.

-Dokumentimi dhe lëvizja e vlerave materiale dhe monetare, mbajtja e kontabilitetit, etj.

-Probleme të ndryshme që dolën gjatë auditimit.

Auditimi në Avokaturën e Shtetit, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar.

Në këtë subjekt, u evidentuan disa të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.1. Mbi organizimin, funksionimin dhe përputhshmërinë e veprimitarisë së institucionit me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ për:

-përputhshmërinë e procedurave të ndjekura për përfaqësimin juridik të shtetit në gjykata apo procese të tjera ligjore,

-analizimin e efekteve financiare të ndjekjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në buxhetin e shtetit,

-koordinimin dhe mbikëqyrjen e punës së avokatëve të shtetit në të gjitha nivelet e administratës publike.

U shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- ✓ Raportet vjetorë të ASH për periudhën 2023-2024,
- ✓ Korrespondenca shkresore me Ministrinë e Linjës si dhe me MF për ecurinë dhe likuidimin e vendimeve të formës së prerë të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;
- ✓ Analizat vjetore respektive 2023-2024, të zyrës së Inspektimit në ASH, në lidhje me arritjen e objektivave sipas detyrave funksionale.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- ✓ Ligji Nr.10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar;
- ✓ Rregullore e brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit” miratuar me Urdhrin Nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit i ndryshuar;
- ✓ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj);
- ✓ Kodi i Procedurës Civile (KPrC) RSH.

I. Struktura, detyrat dhe përshkrimi i aktivitetit:

Referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 4 të Ligjit 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Avokatura e Shtetit drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele, në nivel qendror dhe vendor.” “Avokatura e Shtetit në nivel qendror përbëhet nga:

a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare;

b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror;

c) zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;

ç) zyra e inspektimit”.

Sipas pikës 3 dhe 4 të nenit të mësipërm, “Avokatura e Shtetit në nivel vendor përbëhet nga:

a) zyrat vendore, të cilat veprojnë pranë çdo gjykate apeli, ku ushtrojnë dhe kompetencën tokësore

b) avokatët e shtetit ose zyrat e Avokaturës së Shtetit pranë ministrive.

4. Avokatura e Shtetit ka në përbërjen e saj edhe administratën mbështetëse. Marrëdhëniet juridike të punës së punonjësve të administratës mbështetëse, rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e punës.”

Deri në nëntor 2023, marrëdhëniet institucionale dhe ndërinstitucionale rregulloheshin me ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, Rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 68, dt. 28.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e ASH” si dhe Vendimin Nr. 381, datë 12.6.2019 “Për

përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja”.

Me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 495, datë 21.07.2022 “*Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave gjyqësore të gjykatave*” si dhe me Ligjin nr. 91/2023 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar*”, Avokatura e Shtetit ka ndërmarrë iniciativën për propozimin e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore, me qëllim përshtatjen e organizimit dhe shpërndarjes së avokatëve të shtetit dhe Zyrave Vendore të Avokaturës së Shtetit.

Pas miratimit të ndryshimeve ligjore, Avokatura e Shtetit ka propozuar projekt aktin “*Për organizimin territorial dhe kompetencat tokësore të zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit*”. Pas zhvillimit të procesit të dhënies së mendimeve nga institucionet shtetërore, me vendimin nr. 65, datë 14.02.2024 të Këshillit të Ministrave “*Për organizimin e zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit*” janë miratuar parashikimet nënligjore, të autorizuara me ligjin nr. 91/2023 për mënyrën e organizimit dhe shpërndarjes së zyrave vendore. Tashmë kanë të parashikuar kompetencën territoriale sipas gjykatave në mënyrë nominale dhe jo sipas Gjykatave të Apelit, të cilat u bashkuan në një të vetme. Gjithashtu është parashikuar suprimimi i Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Durrës, duke krijuar Zyrën Vendore të Avokaturës së Shtetit Lushnjë, e cila ka në kompetencë territoriale Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat. Ky ndryshim është kryer duke marrë në konsideratë krijimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, e cila do të shqyrtojë një numër të konsiderueshëm çështjesh duke përfshirë të gjitha bashkitë në jug të Shqipërisë.

Avokatura e Shtetit propozoi gjithashtu ndryshime në urdhrin e Kryeministrit nr. 58, datë 25.03.2019 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetit*”, akt i cili pas zhvillimit të procesit të konsultimit me ministrinë e linjës, u ndryshua nëpërmjet urdhrin nr. 88, datë 29.05.2024 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetit*”.

Me urdhrin nr. 88/2024 të Kryeministrit, organizimi i avokatëve të shtetit në nivel vendor ndryshoi në këtë mënyrë:

1. ZVASH Durrës transferohet në Lushnjë dhe nga 7 avokatë shteti reduktohet në 5,
2. ZVASH Korçë nga 3 avokatë shteti reduktohet në 1,
3. ZVASH Vlorë nga 7 avokatë shteti reduktohet në 4,
4. ZVASH Gjirokastrë nga 4 avokatë shteti reduktohet në 2 dhe
5. ZVASH Shkodër nga 3 avokatë shteti reduktohet në 1.

Ndërsa numri i avokatëve të shtetit pranë ministrive u shtua me 7 duke kaluar nga **29 në 36 avokatë shteti** të cilët do të kryejnë përfaqësimin pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit në Tiranë. Ndryshime ndodhën edhe në numrin e avokatëve të shtetit në nivel qendror, ku Zyra e Përfaqësimit Ligjor pranë Gjykatave Kombëtare u shtua me 2 avokatë shteti duke e çuar numrin total në 7, ndërsa Zyra e Këshillimit dhe Koordinimit Ndërminstrior u reduktua numri nga 5 në 3 avokatë shteti.

Koordinimi dhe mbikëqyrja e punës së avokatëve të shtetit në të gjitha nivelet e administratës publike.

Veprimtaria dhe analiza statistikore e zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit, viti 2023.

Në raportin vjetor “Mbi analizën e punës për vitin 2023”, vënë në dispozicion nga subjekti nën auditim, janë analizuar çështjet e ndjekura për vitin 2023, nga 6 zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit dhe avokatët pranë Ministrive. Të dhënat paraqiten si më poshtë:

Tabela 1: Çështjet e Zyrave Vendore për vitin 2023

	Mbartur	Ardhur	Gjithsej	Përfunduar	Në proces	Fituar	Fituar pjesërisht	Humbur	Pushim	Kthim aktesh	Kthim rigjykim	Mos kompetencë	Relatuat	Deleguar
Zyra Tiranë	193	1651	1844	1603	109	51	13	26	11	1	3	4	493	721
Zyra Vlorë	757	1521	2278	228	465	63	40	59	50	10	1	3	110	703
Zyra Gjirokastrë	490	427	917	99	408	24	4	21	32	9	4	5	-	348
Zyra Korçë	178	257	435	64	159	12	8	17	23	1	-	3	61	313
Zyra Durrës	506	621	1127	175	480	51	0	27	72	8	-	8	152	432
Zyra Shkodër	173	398	571	94	149	16	8	20	28	20	-	2	141	185
Totali	2297	4875	7172	2263	1770	217	73	170	216	49	8	25	957	2702

Burimi i të dhënave, ASH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Gjatë vitit 2023 në zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit, numri i çështjeve të mbartura në total është 2297, dhe ai i çështjeve të regjistruara gjatë këtij viti është 4875.

Pra, gjithsej për vitin 2023 zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit kanë shqyrtuar në total 7,172 çështje prej të cilave, 2,263 janë përfunduar brenda këtij viti, 1770 ishin në proces, ndërsa 2702 çështje janë deleguar. Delegimi është kryer mbështetur në urdhrat e brendshëm institucional të cilët rregullojnë delegimin e çështjeve organeve të interesuar. Për këtë vit, referuar të dhënave të paraqitura në raportin vjetor të punës së A.SH, 217 çështje janë fituar, 73 çështje janë fituar pjesërisht, ndërsa 170 janë humbur. Nga të dhënat rezultojnë se, Zyra Vendore e Tiranës dhe Zyra Vendore e Vlorës kanë pasur numrin më të lartë të çështjeve në total, përkatësisht 1844 dhe 2278. Në total çështjet e trajtuara nga Zyrat Vendore dhe Avokatët në ministri, paraqiten si më poshtë⁸:

Tabela 2: Çështje në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit dhe në Avokatët e Shtetit në ministri, për vitin 2023

Zyrat Vendore dhe Avokatët e Shtetit në Ministri	Mbartur	Ardhur	Gjithsej	Përfund	Ne dore	Fituar	Humbur	Pushuar	Juridiksion/komp	Relatuat	Deleguar
Zyrat Vendore	2297	4875	7172	2263	1770	217	170	170	82	957	2702
Av. Ministrive	1257	3287	4544	704	1591	263	184	136	49	248	2008
Totali	355	8162	11716	2967	3361	480	354	216	131	1205	4710

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2023, i Avokaturës së Shtetit.

Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga të dhënat e vëna në dispozicion grupit të auditimit, evidentohet se për vitin 2023 numri total i çështjeve të trajtuara në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit dhe nga Avokatët e Shtetit në ministri, është 11,716, ku më specifikisht, 7172 janë çështje të mbartura dhe të ardhura në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit, ndërsa 4544 ishin çështje të trajtuara nga Avokatët e Shtetit në Ministri. Gjatë vitit 2023 në total janë fituar 480 çështje, 217 prej të cilave në Zyrat Vendore, ndërsa 263 nga avokatët e shtetit në ministri. Çështje të humbura gjatë këtij viti janë 354, prej të cilave 170 janë ndjekur nga zyrat vendore, ndërsa 184 janë ndjekur nga avokatët e shtetit në ministri. Në vitin 2023, në total janë deleguar 4710 çështje.

⁸ Në lidhje me kolonën 11, sqarojmë që çështjet e deleguara janë sipas urdhrat të Avokatit të Përgjithshëm, nr.123, datë 03.03.2023, "Për delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe mbrojtjes", pasi ka një numër të konsiderueshëm çështjesh të institucioneve qendrore apo vendore, që bëjnë pjesë në kategorinë e rasteve që nuk duhet të përfaqësohen nga ASH, për shkak të vlerës dhe rritjes fiktive të ngarkesës në punë të avokatëve të shtetit.

Tabela 3: Dëmi i parandaluar dhe i ardhur në lekë dhe m², për zyrat vendore në vitin 2023.

	Dëmi i parandaluar/ lekë	Dëmi i shkaktuar/ lekë	Dëmi i parandaluar/ m ²	Dëmi shkaktuar/ m ²
Zyra Vendore Tiranë	53,392,940	324,698,033	108,449.50	835,161
Zyra Vëndore Vlorë	776,946,998	1,637,960,312	2,299,260	9,101,949.50
Zyra Vendore Gjirokastër	67,213,970	187,071,437	4,092,110	3,611,288.70
Zyra Vendore Korçë	58,083,488	134,488,362	43,168	152,181
Zyra Vendore Durrës	1,462,269,925	228,409,367	389,088	300,688
Zyra Vendore Shkodër	260,546,179	245,046,813	3,674,801	625,605
Totali	2,678,453,500	2,757,674,324	10,606,877	14,626,873

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2023, i Avokaturës së Shtetit
Përpunoi: Grupi i auditimit

Referuar tabelës 3, së dëmit të parandaluar dhe dëmit të ardhur në lekë dhe m², të paraqitur në Raportin e Analizës së Punës së Avokaturës së Shtetit për vitin 2023 evidentohet se, dëmi total i parandaluar është në vlerë 2,678,453,500 lekë, ose 10,606,877 m², ndërsa dëmi⁹ total i ardhur është në vlerë 2,757,674,324 lekë, ose 14,626,873 m².

Për vitin 2023, nga analizimi i të dhënave sipas zyrave vendore, me tregues negativ paraqiten:

- Në zyrën vendore Vlorë, dëmi i ardhur në vlerën dhe m² është ndjeshëm më i lartë se dëmi i parandaluar. Dëmi i ardhur është në vlerën 1,637,960,312 lekë ose 9,101,949.50 m², ndërsa dëmi i parandaluar është 776,946,998 lekë ose 2,299,260 m². Dëmi i ardhur në zyrën vendore Vlorë është sa 60% e dëmit total të shkaktuar nga të gjithë zyrat vendore për vitin 2023.
- Gjithashtu edhe në zyrën vendore Tiranë, dëmi i ardhur në vlerë tejkalon dëmin e parandaluar në vlerë, më specifikisht dëmi i ardhur është 324,698,033 lekë ose 6 herë më shumë se sa ai i parandaluar që është 53,392,940 lekë.
- në zyrën vendore Gjirokastër dëmi i ardhur është ndjeshëm më i lartë konkretisht 187,071,437 lekë , krahasuar me dëmin e parandaluar i cili është në vlerën 67,213,970 lekë, pra rreth 3 herë më i lartë.
- në zyrën vendore Korçë dëmi i ardhur është ndjeshëm më i lartë konkretisht 134,488,362 lekë , krahasuar me dëmin e parandaluar i cili është në vlerën 58,083,488 lekë, pra rreth 2 herë më i lartë.

Tabela 4: Dëmi i parandaluar dhe i ardhur në lekë dhe m², për zyrat vendore dhe avokatët në ministri, në vitin 2023

Nr.	Zyra Vendore/ Avokatët e Ministrive	Dëmi i parandaluar lekë	Dëmi i ardhur lekë	Dëmi i parandaluar m ²	Dëmi i ardhur në m ²
1	Zyrat Vendore	2,678,453,500	2,757,674,324	10,606,877	14,626,873
2	Avokatët e Ministrive	5,371,440,708	3,757,872,555	4,053,593.92	530,046.92
Totali		8,049,894,208	6,515,546,879	14,660,470	15,156,920

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2023, i Avokaturës së Shtetit
Përpunoi: Grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në Raportin e Analizës së Punës së Avokaturës së Shtetit për vitin 2023, konstatojmë se dëmi i parandaluar për çështjet e trajtuara nga avokatët e shtetit në ministri është 5,371,440,708 lekë (4,053,593.92 m²), ndërsa dëmi i ardhur është në vlerë 3,757,872,555 lekë (530,046.92 m²). Në total për vitin 2023, për çështjet e trajtuara nga zyrat vendore dhe avokatët e shtetit në ministri, dëmi total i parandaluar është raportuar

⁹ Termi **Dëm i ardhur/Dëm i parandaluar**, i referohet terminologjisë së përdorur nga Avokatura e Shtetit në treguesit statistikorë të veprimtarisë vjetore dhe në lidhje me dëmin për m² është bërë mbledhja sipas përmbajtjes të dispozitivit në vendim. Gjithashtu vlerat e vendosura në tabelat e mësipërme në lidhje me dëmin e parandaluar në lekë dhe dëmin e parandaluar në m², nuk kanë lidhje aritmetike me njëra tjetrën, pasi vendimet e gjykatave janë të përcaktuara në lekë ose në m², për zhdëmtimin e pronave dhe sipas kësaj përmbajtjeje vendosen në tabelë për treguesit statistikorë vjetorë.

8,049,894,208 lekë (**14,660,470 m²**), ndërsa dëmi i ardhur është **6,515,546,879** lekë (**15,156,920 m²**).

Tabela 5: Tabela përmbledhëse e dëmit të parandaluar dhe dëmit të shkaktuar sipas zyrave të avokaturës së shtetit¹⁰, për vitin 2023

Zyrat	Dëmi i parandaluar në lekë	Dëmi i shkaktuar në lekë	Dëmi i parandaluar në m ²	Dëmi i shkaktuar në m ²
Zyrat Vendore dhe Avokatët e Shtetit, pranë Ministrive	8,049,894,208	6,515,546,879	14,660,470.42	15,156,920.12
Zyra e Përfaqësimit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut	1,981,109,768	29,089,814	-	-
Zyra e Inspektimit	799,184,216	11,658,725	51.7	216.3
TOTALI	10,830,188,192	6,556,295,418	14,660,522.12	15,157,136.42

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2023, i Avokaturës së Shtetit

Përpunoi: Grupi i auditimit

Për vitin 2024

Në lidhje me strukturën dhe mënyrën e funksionimit të ASH për vitin 2024, ka rezultuar se:

Pas ndryshimeve të miratuara me ligjin nr.91/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” të ndryshuar”, ishte planifikuar nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim, të cilat do të ndryshonin organizimin e Avokaturës së Shtetit në nivel vendor dhe në nivel qendror. Me vendimin nr. 65, datë 14.02.2024 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin e zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit” u miratua organizimi i zyrave vendore sipas autorizimit në ligjin nr. 91/2023.

Me urdhrin nr. 88, datë 29.05.2024 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetit” u miratuan ndryshime në numrin e avokatëve të shtetit pranë zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit, duke u reduktuar, me qëllim rritjen e numrit të avokatëve të shtetit pranë ministrive. Ky organizim i ri është miratuar si rrjedhojë e ndryshimeve në hartën gjyqësore me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, nëpërmjet të cilit përqendrohej ngarkesa e çështjeve administrative në qytetin e Tiranës dhe të Lushnjës (gjykatat administrative përkatëse) si dhe shkrirja e 6 gjykatave të apelit, duke u bashkuar në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Për sa më sipër, organizimi i zyrave vendore është reduktuar në numrin e avokatëve të shtetit, dhe konkretisht:

- Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Gjirokastrë, nga 4 avokatë shteti u reduktua në 2,
- Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Korçë, nga 3 avokatë shteti u reduktua në 1,
- Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Shkodër, nga 3 avokatë shteti u reduktua në 1.
- Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Tiranë ka 6 avokatë.
- Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Vlorë ka 4 avokatë
- Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Lushnjë ka 5 avokatë/plan dhe 3/fakt (2 vende vakant).

Pjesa më e madhe e numrit të avokatëve të shtetit të reduktuar nga zyrat vendore u transferuan në Tiranë, në pozicionin e avokatit të shtetit pranë ministrive, të cilët kanë në kompetencë përfaqësimin e të gjitha çështjeve gjyqësore me palë të paditur organet e administratës shtetërore, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Apelit, ku avokatë të shtetit pranë Ministrive sipas strukturës duhet të jenë 36 dhe numri faktik është 31 (5 vakant).

¹⁰ Dëmi i parandaluar dhe i shkaktuar është llogaritur në lekë, sipas kursit të këmbimit me monedhën euro të Bankës së Shqipërisë të datës 31.12.2023.

Në raportin vjetor “Mbi analizën e punës për vitin 2024”, vënë në dispozicion nga subjekti nën auditim, janë analizuar çështjet e ndjekura për vitin 2024, nga 6 zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit dhe avokatët pranë Ministrive.

Nga auditimi rezultoi se:

Avokatët e Shtetit pranë ministrive dhe Zyra e Përfaqësimit, kanë mbartur 1845 çështje gjyqësore nga viti 2023, ndërkohë të ardhura rezultojnë 3234 çështje gjatë vitit 2024, nga gjykatat e shkallës së parë, 1733 çështje nga gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Lartë, nga të cilat: Fituar në shkallë të parë 215 çështje; Fituar pjesërisht në shkallë të parë 46 çështje; Humbur në shkallë të parë 180 çështje; Pushim gjykimi në shkallë të parë 159 çështje; Kthim aktesh në shkallë të parë 55; Mos kompetencë në shkallë të parë 38 çështje; Fituar në Apel dhe Gjykatë e Lartë 235 çështje; Fituar pjesërisht në Apel dhe Gjykatë e Lartë 41 çështje; Pushim gjykimi në Apel dhe Gjykatë e Lartë 55 çështje;

Kthim rigjykim në Apel dhe Gjykatë e Lartë 106 çështje; Mos kompetencë në Apel 9 çështje; Relatuar në shkallë të parë dhe në Apel 287 çështje; Deleguar në shkallë të parë dhe në Apel 2258 çështje. (paraqitur në tabelën 6).

Tabela 6

Mbartur nga 2023	Ardhur nga Gj. Shkallë e parë(adm.civile)	Ardhur nga Apel (adm.civile) dhe Gj. Lartë	Fituar shkallë e parë.	Fituar pjesë. shkallë e parë.	Humbur shkallë e parë.	Pushim gjykimi shkallë e parë	Kthim Aktesh shkallë e parë.	Mos kompetencë shkallë e parë.	Fituar në Apel & Gjykatë e Lartë.	Fituar pjes. Apel & Gjykatë e Lartë.	Humbur Apel & Gjykatë e Lartë	Pushim gjykimi-Apel.	Kthim për rigjykim Apel & Gjykatë e Lartë	Moskompetencë Apel	Relatuar shkallë e parë +Apel	Deleguar shkallë e parë +Apel.
1845	3234	1733	215	46	180	159	55	38	235	41	211	55	106	9	287	2258

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2024, i Avokaturës së Shtetit

Tabela 7: Dëmi i parandaluar dhe ai i ardhur nga avokatët e shtetit pranë ministrive dhe zyra e Përfaqësimit në Gjykata, 2024

Dëmi i parandaluar në m ² - Shkallë e parë.	Dëmi i parandaluar në LEKE- Shkallë e parë.	Dëmi i shkaktuar në LEKE- Shkallë e parë.	Dëmi i shkaktuar në m ² - Shkallë e parë.
1,103,086.03 m ²	9,246,284,288 lekë	3,961,721,204 lekë	216,476.4 m ²

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2024, i Avokaturës së Shtetit, përpunoi: Grupi i auditimit

Vlera e dëmit të parandaluar dhe të shkaktuar në “lekë” dhe në “m²”, nga çështjet e përfaqësuara nga Avokatët e Shtetit pranë ministrive dhe Zyra e Përfaqësimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë dhe të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (Tiranë, Durrës), rezultojnë e paraqitur në tabelën 7, ku dëmi i parandaluar është 1,103,086.03 m² dhe 9,246,284,288 lekë, ndërsa ai i ardhur është 3,961,721,204 lekë dhe 216,476.4 m². (Tab 7)

Ndërkohë vlera e dëmit të parandaluar dhe të shkaktuar në “lekë” dhe në “m²”, nga çështjet e përfaqësuara nga Avokatët e Shtetit pranë ministrive dhe Zyra e Përfaqësimit në Gjykatën e Apelit Administrativ, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatës së Lartë, i paraqitur në tabelën 8, rezultojnë: dëmi i parandaluar 125,667,384,573 lekë, ndërsa ai i ardhur është 7,027,668,679 lekë.

Tabela 8: Dëmi i parandaluar dhe ai i ardhur nga avokatët e shtetit pranë Ministrive, 2024

Dëmi i parandaluar në m ² - Apel & Gj. Lartë	Dëmi i parandaluar në LEKE- Apel & Gj. Lartë.	Dëmi i shkaktuar në LEKE- Apel & Gj. Lartë	Dëmi i shkaktuar në m ² - Apel & Gj. Lartë
2,645,188.29	125,667,384,573	7,027,668,679	484,277

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2024, i Avokaturës së Shtetit, përpunoi: Grupi i auditimit

Në lidhje me veprimtarinë në zyrat vendore të ASH, për vitin 2024, bazuar në të dhënat e raportit vjetor të ASH, 2024, situata paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 9: Çështje në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit, për vitin 2024

N r.	Zyrat Vendore	Mbartur nga 2023	Ardhur në 2024	Totali	Të fituara	Të fituara pjesërisht	Të humbura	Pushimi gjyqimi	Kthimi i akteve	Kthimi rigjyqimi	Moskompetencia	Delegimi	Relatimi
1	Tiranë	377	3744	4121	127	24	60	65	11	10	13	1671	1425
2	Lushnjë	0	683	683	3	0	1	1	0	0	2	394	21
3	Vlorë	1301	806	2107	38	24	54	32	20	0	7	981	17
4	Gjirokastrë	455	419	874	29	3	20	28	6	0	2	208	37
5	Korçë	155	54	209	12	16	10	17	4	0	1	4	4
6	Shkodër/Lezhë	142	154	296	21	6	18	16	6	0	4	17	17
	Totali	2430	5860	8290	230	73	163	159	47	10	29	3275	1521

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2024, i Avokaturës së Shtetit, përpunoi: Grupi i auditimit.

Gjatë vitit 2024 në zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit, numri i çështjeve të mbartura në total ishte **2430**, dhe ai i çështjeve të regjistruara gjatë këtij viti ishte **5860**. Pra, gjithsej për vitin 2024 zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit kanë pasur në shqyrtim në total 8290, çështje prej të cilave, 701 janë përfunduar brenda këtij viti, ndërsa 2240 ishin në proces. Për këtë vit, referuar të dhënave të paraqitura në raportin vjetor të punës së A.SH, 230 çështje janë fituar, 73 çështje janë fituar pjesërisht, 163 çështje janë humbur, ndërsa 3275 çështje janë deleguar. Nga të dhënat rezulton se, Zyra Vendore e Tiranës dhe Zyra Vendore e Vlorës, kanë pasur numrin më të lartë të çështjeve në total, përkatësisht 4121 dhe 2107. Në total çështjet e trajtuara nga Zyrat Vendore dhe Avokatët në ministri, paraqiten si më poshtë:

Tabela 10: Çështje në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit dhe në Avokatët e Shtetit në ministri, për vitin 2024

Zyrat Vendore dhe Avokatët e Shtetit në Ministri.	Mbartur	Ardhur	Gjithsej	Përfund	Ne dore	Fituar	Pjesërisht	Humbur	Pushuar	Juridiksion/komp	Relatuar	Deleguar
Zyrat Vendore	2430	5860	8290	701	2240	230	73	163	159	34	1521	3275
Av. Ministrive	1845	4967	6812			450	87	391	214	115	287	2258
Totali	4275	10827	15102			680	160	554	373	149	1808	5533

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2024, i Avokaturës së Shtetit, përpunoi: Grupi i auditimit.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion grupit të auditimit, evidentohet se për vitin 2024, numri total i çështjeve të trajtuara në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit dhe nga Avokatët e Shtetit në ministri, ishte 15,102, ku më specifikisht, 8290 ishin çështje të mbartura dhe të ardhura në Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit, ndërsa 6812 ishin çështje të trajtuara nga Avokatët e Shtetit në Ministri. Gjatë këtij viti në total, janë fituar 680 çështje, 230 prej të cilave në Zyrat Vendore, ndërsa 450 nga avokatët e shtetit në ministri. Në 2024-ën janë fituar pjesërisht 160 çështje, Çështje të humbura gjatë këtij viti janë 554, prej të cilave 163 janë ndjekur nga zyrat vendore, ndërsa 391 janë ndjekur nga avokatët e shtetit në ministri. Në vitin 2024, në total janë deleguar 5533 çështje.

Referuar tabelës së dëmit të parandaluar dhe dëmit të ardhur në lekë dhe m², për Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit, të paraqitur në Raportin e Analizës së Punës së Avokaturës së Shtetit për vitin 2024 evidentohet se, dëmi total i parandaluar është në vlerë 1,046,214,662 lekë, ose

9,066,344 m² , ndërsa dëmi total i ardhur është në vlerë 2,207,384,051 lekë, ose 15,102,701 m².

Për vitin 2024, nga analizimi i të dhënave sipas zyrave vendore, dëmi më i madh i ardhur në lekë, paraqitet në Zyrën Vendore Tiranë, Vlorë dhe Shkodër/Lezhë, ku specifikisht, rezultojnë se:

- në zyrën vendore Tiranë, dëmi i ardhur në vlerën 1,001,373,555 lekë është më i lartë se dëmi i parandaluar në vlerën 618,792,627 lekë si dhe përbën 45% të dëmit total të ardhur në zyrat vendore për vitin 2024;
- në zyrën vendore Vlorë, dëmi i ardhur në vlerë tejkalon dëmin e parandaluar në vlerë, më specifikisht dëmi i ardhur është 892,767,167 lekë, ndërsa ai i parandaluar është 44,707,490 lekë.

Tabela 11: Përmbledhëse e dëmit të shkaktuar dhe të parandaluar në “lekë” dhe “m²”, Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit – Viti 2024.

Nr. rendor.	Zyrat Vendore	Dëmi i parandaluar në lekë	Dëmi i shkaktuar në lekë	Dëmi i shkaktuar në m ²	Dëmi i parandaluar m ²
1	Tiranë	618,792,627	1,001,373,555	880262.6	58359.34
2	Lushnjë	9,709,075	1,000,000	0	0
3	Vlorë	44,707,490	892,767,167	6,420,857	5,680,609
4	Gjirokastrë	15,800,000	8,579,393	6,031,308	2,991,509
5	Korçë	68,322,339	70,659,177	240,968	35,838
6	Shkodër/Lezhë	288,883,131	233,004,759	2,409,568	358,388
	Totali	1,046,214,662	2,207,384,051	15,102,701	9,066,344

Burimi: Raporti i Analizës së Punës për vitin 2024, i Avokaturës së Shtetit, përpunoi: Grupi i auditimit

Nëse do ta paraqisnim në mënyrë krahasimore veprimtarinë e Avokatëve të Shtetit pranë Ministrive me atë të zyrave vendore, statistikat paraqitet në tabelën 12:

Tabela 12: Dëmi i parandaluar dhe i ardhur në lekë dhe m², për zyrat vendore dhe avokatët në ministri, në vitin 2024

Nr	Zyra Vendore/ Avokatët e Ministrive	Dëmi i parandaluar lekë	Dëmi i ardhur lekë	Dëmi i parandaluar m ²	Dëmi i ardhur m ²
1	Zyrat Vendore	1,046,214,662	2,207,384,051	9,066,344	15,102,701
2	Av. e Ministrive	134,913,668,861	10,989,389,883	3,748,274.32	700,753.4
	Totali	135,959,883,523	13,196,773,934	12,814,618	15,803,454

Punoi grupi i auditimit

Nga analizimi i të dhënave të paraqitura në Raportin e Analizës së Punës së Avokaturës së Shtetit për vitin 2024, konstatojmë se dëmi i parandaluar për çështjet e trajtuara nga avokatët e shtetit në ministri është 134,913,668,861 lekë (3,748,274.32 m²), ndërsa dëmi i ardhur në vlerë është 10,989,389,883 lekë (700,753.4 m²). Në total për vitin **2024**, në çështjet e trajtuara nga zyrat vendore dhe avokatët e shtetit në ministri, dëmi total i parandaluar është raportuar 135,959,884 mijë lekë (12,814,618 m²), ndërsa dëmi i ardhur është 13,196,774 mijë lekë (15,803,454 m²).

Përputhshmëria e procedurave të ndjekura për përfaqësimin e shtetit në gjykata apo procese të tjera ligjore; Analizimi i efekteve financiare të ndjekjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në buxhetin e shtetit.

Referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 4 të Ligjit 10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Avokatura e Shtetit drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele, në nivel qendror dhe vendor.” “Avokatura e Shtetit në nivel qendror përbëhet nga:

a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare;

b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror;

c) zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;

ç) zyra e inspektimit”.

Sipas shkronjave b dhe ç të pikës 1 të nenit 5 të ligjit 10018, 13.11.2008 të ndryshuar, Avokatura e Shtetit “përfaqëson dhe mbrohet interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë.”.

Evidentimi i çështjeve në regjistrat përkatës të institucionit.

Avokatura e Shtetit i regjistron çështjet e gjykatave kombëtare në regjistrin fizik dhe në sistemin elektronik të çështjeve i cili përdoret nga institucioni, dhe për periudhën në auditim ka qenë në fokusin e inspektimeve nga **Zyra e Inspektimit dhe Këshillimit në ASH**, për 6 zyrat vendore.

- ✓ Përsa i përket sistemit elektronik, nuk ka gjurmë auditimi ku të specifikohet data e implementimit të këtij sistemi përveçse një dokumenti në gjuhën angleze, i cili ka të bëjë me specifikimet teknike të sistemit, të datës 25.02.2019.
- ✓ Nisur nga verifikimet e kryera si dhe bazuar në raportet vjetore të ASH, për periudhën nën auditim, Zyra e Inspektimit dhe Këshillimit në ASH e cila është përgjegjëse për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit, në të dyja nivelet e organizimit, për ushtrimin me efektivitet të funksioneve të institucionit, ka kryer vetëm inspektime tematike dhe të fokusuara mbi veprimtarinë e avokatëve të shtetit individualisht dhe jo mbi veprimtarinë e zyrave në tërësi.
- ✓ Nuk ka informacion lidhur me çështjen dhe pasojat të cilat mund ose kanë sjellë dëm në interesat e shtetit Shqiptar, nga veprimet apo mos veprimet e avokatëve të shtetit.
- ✓ Fokusi kryesor i Zyrës së inspektimit për 2023-2024, ka qenë “Përditësimi i dosjeve në sistemin elektronik”, në zyrat vendore dhe ato të avokatëve të shtetit pranë Ministrive.
- ✓ Por megjithëse është kryer një numër i konsiderueshëm inspektimesh për këtë problematikë (rreth 92 inspektime vetëm për 2023), nuk ka një konkluzion se sa për qind e dosjeve janë hedhur në sistemin elektronik dhe sa jo e rrjedhimisht asnjë datë fikse se kur ky proces duhet të përfundojë.
- ✓ Sistemi aktual nuk përpunon informacione statistikore për çështjet gjyqësore në vite çfarë do të sillte rritje të transparencës e llogaridhënies si dhe saktësim në përpunimin e informacioneve duke lehtësuar punën e Audituesve të brendshëm apo të jashtëm por edhe të institucioneve të tjera shtetërore.

*Për sa i përket regjistrimit të vendimeve të GJEDNJ dhe Gjykatave të Huaja dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe çdo lloj korrespondence tjetër pjesë e procesit deri në publikimin e vendimit përfundimtar, ASH nuk ka një sistem IT ose e thënë ndryshe të dhënat për vendimet e GJEDNJ dhe Gjykatave të Arbitrazhit nuk janë të digjitalizuara, ende sot në 2025.

Avokatura e Shtetit disponon një regjistër fizik (manual) dhe elektronik (Excel), për regjistrimin e çështjeve, sipas formatit të miratuar me Urdhrat e Titullarit të ASH, nr. 375, datë 20.10.2022 dhe 375/1, datë 21.10.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e formatit të regjistrimit elektronik dhe fizik të çështjeve të Arbitrazhit dhe përfaqësimit në gjykatat e huaja” si dhe “Për miratimin e formatit të regjistrimit të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrimit të çështjeve në shqyrtim të GJEDNJ-së”.

Digjitalizimi i të dhënave në Avokaturën e Shtetit do të ketë ndikim pozitiv në menaxhimin e çështjeve ligjore, veçanërisht ato të arbitrazhit ndërkombëtar.

Mungesa e digjitalizimit sjell:

- ✓ mungesë transparence dhe llogaridhënie, pasi rrit riskun e mos mbajtjes saktë dhe në kohë të çdo të dhëne të nevojshme për monitorimin e të gjithë korrespondencës shkresore apo e-maileve zyrtare si me institucionet brenda vendit ashtu dhe me ato ndërkombëtare.
- ✓ Përgatitjen e dosjeve dhe çështjeve të reja apo atyre të mbartura në vite duke u bazuar në të dhëna të plota dhe të verifikuara si dhe kursyer kohë dhe burime njerëzore.
- ✓ Gjurmimin dhe verifikimin e veprimeve, duke ulur mundësinë e ndërhyrjeve apo fshehjes së fakteve si dhe mbrojtjen më të mirë të interesave të shtetit shqiptar.

Në zbatim të Ligjit 84/2022 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2023" si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 19.01.2023, pika 126.5/b, si dhe Udhëzimit nr.1, datë 24.01.2024, pika 136.5, "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2023", Ministria e Financës merr informacion nga ASH mbi detyrimet financiare që rrjedhin nga vendimet e GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar, për qëllime analize, transparence dhe raportimi të detyrimeve kontingjente të qeverisjes së përgjithshme, brenda datës 10 maj dhe 10 shtator të çdo viti buxhetor si dhe sa herë që të jetë e nevojshme.

Sipas kësaj dispozite rezulton që për periudhën në auditim, ASH ka dërguar në mënyrë shkresore dhe elektronike, raportimet mbi gjendjen dhe ecurinë e vendimeve të GJEDNJ dhe arbitrazhit ndërkombëtar, konkretisht:

Shkresa me nr 4831/1, datë 30.10.2023; shkresa me nr. 1795/1, datë 19.04.2024; e-maillet zyrtare në datat 14.04.2023; 16.06.2023; 12.09.2023; 15.04.2024;12.09.2024;

Për sa është trajtuar në projekt raport, nga subjekti është paraqitur observacion me shkresën nr. 508/17 prot, datë 22.08.2025, administruar pranë KLSH me nr.164/5 prot, datë 25.08.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në mënyrë të përmbledhur subjekti parashtron:

a.....Inspektimet e përgjithshme të zyrave vendore, nuk janë kryer për shkaqe objektive të mbështetura në zhvillimet konkrete që kanë pamundësuar planifikimin dhe kryerjen e inspektimeve të përgjithshme. Është me rëndësi të evidentohet fakti se në vitet pararendëse 2022 etj dhe gjatë vitit 2025 janë zhvilluar inspektime të përgjithshme të zyrave vendore. Inspektimet e përgjithshme nuk janë zhvilluar për shkak të faktorëve të sqaruar edhe më parë, dhe jo si zgjedhje apo mos planifikim. Ky fakt provohet nga tërësia e veprimtarisë së kryer nga Zyra e Inspektimit, planet vjetore të inspektimit dhe të gjitha ndryshimet që ka pësuar institucioni i Avokaturës së Shtetit gjatë vitit 2024.

Për arsyet e sqaruara edhe më parë, Zyra e Inspektimit është angazhuar vazhdimisht në monitorimin në kohë reale të veprimtarisë së avokatëve të shtetit (urdhri 387/2023 i APSH), me qëllim menaxhimin e riskut dhe shmangien për aq sa është e mundur të çdo eventualiteti të dëmshëm.

b. Sqarojmë gjithashtu se Inspektimi i Përgjithshëm për periudhën 2023-2024 është një veprimtari që është aktualisht duke u kryer, konkretisht, në datën 05.05.2025 ka përfunduar inspektimi i përgjithshëm i Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Gjirokastër për periudhën 2021-2024 bazuar në urdhrin nr. 64, datë 31.01.2025 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit "Për ushtrimin e inspektimit të përgjithshëm të Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Gjirokastër".

c. Aktualisht, është duke u zhvilluar inspektim i përgjithshëm për Zyrën Vendore të Avokaturës së Shtetit Lezhë (ish-ZVASH Shkodër) për periudhën 2022-2025 në bazë të urdhrin nr. 340, datë 16.6.2025 "Për ushtrimin e inspektimit të përgjithshëm të veprimtarisë së avokatëve të shtetit të ish-Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Shkodër dhe aktualisht ZVASH Lezhë" sipas Planit Vjetor të Zyrës së Inspektimit në Avokaturën e Shtetit, të miratuar me urdhrin nr.

63, datë 31.01.2025 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, si dhe do të vijojë inspektimi i përgjithshëm për zyrat e tjera vendore.

Nisur nga volumi i çështjeve dhe natyra e inspektimit të përgjithshëm, ku verifikohen të gjitha çështjet e përfaqësuara gjatë një periudhe disa vjeçare, Zyra e Inspektimit e ka të pamundur të kryejë të gjitha inspektimet e zyrave vendore brenda një periudhe 12 mujore. Për këtë shkak edhe në ndryshimet që do të kryhen në metodologjinë e inspektimit është parashikuar një metodologji për mënyrën e kryerjes së inspektimit me përzgjedhje.

d. Për vitin 2024 nuk janë planifikuar inspektime të përgjithshme të avokatëve të shtetit në nivel vendor dhe pranë zyrave vendore, për shkak të ndryshimeve në strukturën dhe organikën e Avokaturës së Shtetit, dhe konkretisht: Me urdhrin nr. 88/2024 të Kryeministrit, organizimi i avokatëve të shtetit në nivel vendor ndryshoi në këtë mënyrë: ZVASH Durrës transferohet në Lushnjë dhe nga 7 avokatë shteti reduktohet në 5, ZVASH Korçë nga 3 avokatë shteti reduktohet në 1, ZVASH Vlorë nga 7 avokatë shteti reduktohet në 4, ZVASH Gjirokastrë nga 4 avokatë shteti reduktohet në 2 dhe ZVASH Shkodër nga 3 avokatë shteti reduktohet në 1. Ndërsa numri i avokatëve të shtetit pranë ministrive u shtua me 7 duke kaluar nga 29 në 36 avokatë shteti të cilët do të kryejnë përfaqësimin pranë gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit në Tiranë. Ndryshime ndodhën edhe në numrin e avokatëve të shtetit në nivel qendror, ku Zyra e Përfaqësimit Ligjor pranë Gjykatave Kombëtare u shtua me 2 avokatë shteti duke e çuar numrin total në 7, ndërsa Zyra e Këshillimit dhe Koordinimit Ndërmintor u reduktua numri nga 5 në 3 avokatë shteti. Nga numri total i avokatëve të shtetit pranë Zyrave Vendore u suprimuan 4 vende ndërsa u shtuan funksione në administratën në Zyrën Qendrore të Avokaturës së Shtetit.

e. Lidhur me përcaktimin e një përqindjeje të dosjeve të pasqyruara në regjistrin elektronik të Avokaturës së Shtetit nga Zyra e Inspektimit sqarohet se, numri i lartë i çështjeve, koha e shkurtër në dispozicion dhe mungesa e një stafi mbështetës janë arsyet kryesore e mos kryerjes së një analize të tillë. Ndërsa duhet evidentuar fakti se raportet e inspektimit janë nxjerrë në mënyrë individuale për secilin avokat shteti, dhe se këto raporte nuk ishin përfundimtare pasi do të duhej të përfundonin procesin e shqyrtimit pranë Komisionit të Disiplinës. Siç edhe e pasqyruam më lartë Zyra e Inspektimit ka pasur vetëm 4 avokatë shteti nga 5 që ka organika e saj.

Lidhur me planifikimin e inspektimeve, Zyra e Inspektimit ka kryer analizën e riskut për të dy vitet 2023-2024, ku renditen në fillim për të zhvilluar inspektime të përgjithshme Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit, për shkak të distancës dhe autonomisë sa i përket nxjerrjes së akteve nëpërmjet Kryetarëve të Zyrave, por për shkaqet objektive të parashtruara më sipër nuk është bërë i mundur inspektimi i këtyre zyrave gjatë viteve 2023-2024. Vlen të theksohet se gjatë viteve të mëparshme është kryer inspektim i përgjithshëm i zyrave vendore, si dhe, duke marrë në konsideratë risqet janë nxjerrë edhe urdhrat e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për monitorimin e akteve procedurale, ku gjashtë Zyrat Vendore të Avokaturës së Shtetit monitorohen vazhdimisht nga avokatët e shtetit në Zyrën e Inspektimit.

Zyra e Inspektimit gjatë kësaj periudhe ka pasur në total 4 avokatë shteti, dhe asnjë strukturë tjetër për ti ardhur në ndihmë qoftë juristë apo specialistë statistike. Në funksion të mirëmenaxhimit të burimeve njerëzore është çmuar më e përshtatshme dhënia e fokusit në kryerjen e verifikimeve të veprimtarisë së avokatëve të shtetit, konstatimin e gjetjeve, përgatitjen e projekt-raporteve të inspektimit, trajtimin e observacioneve, dhe në fund përgatitjen e raporteve përfundimtare. Vlen të theksohet fakti se, Zyra e Inspektimit është angazhuar edhe në veprimtari të tjera të institucionit të përshkruara në mënyrë të detajuar në raportet vjetore 2023 dhe 2024, për të cilat është dedikuar një kohë dhe angazhim i konsiderueshëm dhe i vazhdueshëm.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket pretendimeve tuaja, ju dakordësoni me gjetjet tona dhe sikurse jemi shprehur edhe në PRA, ju nuk kundërshtoni që këto konkluzione nuk

qëndrojnë por paraqisni arsyet tuaja për mos kryerjen e tyre si për inspektimet e përgjithshme, ecurinë e hedhjes së dosjeve në sistemin elektronik, por njëkohësisht edhe mangësitë që ky sistem elektronik (IT) ka në mosplotësimin e nevojave të institucionit për të krijuar gjurmën e auditimit, në dhënien në kohë reale të çdo informacioni apo raporti statistikor për të vlerësuar performancën e zyrave vendore të avokatisë. Për rrjedhojë qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm përse i përket konkluzioneve të arritura.

Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlera e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjyqimi”.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit rezultoi se vlerat financiare të vendimeve të arbitrazhit deri me datë 31.12.2024, të raportuar nga ASH, ku përfshihen ato të formës së prerë, ato në proces shqyrtimi, janë shprehur nga grupi i auditimit, të ndara 3 kategori:

Vendimet e formës së prerë të fituara në favor të RSH, vendime të humbura në disfavor të RSH, dhe vendime në proces.

A. Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Arbitrazhit Ndërkombëtar, të fituara në favor të RSH.

Në lidhje me vendimet e fituara në favor të RSH dhe konkretisht subjekteve të cilët citohen në vijim, paraqitet kjo situatë deri më 31.12.2024 (Tab nr. 13)

Tabela 13: Përmbledhëse e vendimeve të Arbitrazhit të fituara nga RSH.

Nr.	Çështja	Paditësi	I padituri	Dëmspërblim/ detyrim/penalite	Kosto të tribunalit dhe përfaqësimit		
				Euro	Euro	USD	GBP
1.	ICSID ARB 14/26	“A. A.”sh.p.k., A. N, shoqëria “C ” s.r.l	RSH/MTM		2,407,000	837,128	106,755
2.	ICC Case No. 20564/EMT/GR	H. srl	RSH /MIE	6,821,710		325,000	
3.	ICC Case 21349/GR	Bp	RSH/MIE, AKBN, A			33,120	
4.	ICC Case no.22919/GR	H. srl	RSH /MIE		731,280		1,796
5.	PCA Case 2018-49	V. srl	RSH /MBZHR		1,700,000		
6.	ICSID Case no.ARB/20/37	M.C. T.Corp, A. D. LP, D.K. Sh. SH.A. Durrës C..T.	RSH /APD		1,583,512	370,543	
7.	SCC 2021/155	IV.. H. GmbH	RSH		2,549,801		
	Totali			6,821,710	8,971,593	1,565,791	108,551

Burimi i të dhënave, ASH, përpunoi grupi i auditimit

1. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim datë 03.03.2020, për çështjen ICSID ARB/14/26, (iniciuar nga viti 2014) ku ka vendosur:

Vendimi i Tribunalit datë 20.03.2020, ka vendosur:

-se ka juridiksion për të marrë në shqyrtim pretendimet e palës paditëse;

-të rrëzojë secilën prej pretendimeve të ngritura nga pala paditëse dhe;

-se pala paditëse duhet t'i paguajë palës së paditur kostot dhe shpenzimet në vlerën totale prej €1,857,000, USD 427,488.72 dhe £106,755 brenda 28 ditëve nga momenti i shpalljes së këtij vendimi.

Në rast vonese në pagesën e këtyre kostove, do të përlllogaritet një interes 2% i përbërë me bazë mujore (compound ëith monthly rests), deri në kryerjen e pagesës për këto kosto.

Vendimi mbi anulimin datë **06.05.2022**, i cili është në favor të Republikës së Shqipërisë, ka vendosur përfundimisht si më poshtë:

- a. Kërkesa për anulimin e Palës Paditëse rrëzohet;
- b. Pala Paditëse do të mbartë të gjitha kostot e procedurave, duke përfshirë tarifën dhe shpenzimet e Tribunalit, në masën e **USD 409,636.99**; dhe
- c. Pala Paditëse, brenda ***njëzet e tetë (28) ditëve*** nga data e dorëzimit të këtij vendimi, do t'i paguajë Palës së paditur, shumën prej EUR 550,000 sa i përket shpenzimeve dhe kostove të kësaj të fundit për përfaqësimin.

Nëse ka vonesa në pagimin e këtyre kostove interesi do të shtohet mbi shumën që mbetet të paguara në normën prej 2% të interesit të përbërë me bazë mujore, derisa të paguhet kostot; d. Hiqet Pezullimi i Ekzekutimit të Vendimit.

Statusi aktual: *Rezulton se pas përcjelljes nga ASH të vendimeve të certifikuara të arbitrazhit (Vendimi mbi themelin e çështjes dhe Vendimi mbi kërkesën për anulim), MTM ka paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkesën për njohjen e vendimeve në Shqipëri.*

Aktualisht vendimi rezulton i njohur nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 969, datë 25.11.2024. Ky vendim është përcjellë nga MTM me shkresën nr. 3294 prot., datë 25.04.2025 (protokolluar në ASH me shkresën nr. 2726 prot., datë 28.04.2025). MTM i është drejtuar Sh. P. Gj.Sh., duke vënë në dijeni ASH.

2. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim datë 07.09.2018, për çështjen **ICC Case No. 20564/EMT/GR, (iniciuar nga viti 2014)** ku ka vendosur:

- Pala Paditëse H. srl duhet t'i paguajë Penalitete për vonesat, RSH në shumën **1,693,157 Euro** me interes të përbërë (interest on a compound basis), duke përdorur Libor 12-mujor në Euro + 2 % nga data 16 Korrik 2011 deri në pagesën e plotë.
- Detyrim i H. që t'i paguajë dëmshpërblim RSH në shumën **5,182,535 Euro** me një interes të përbërë me bazë Libor 12-mujor në Euro +2% nga data 09.01.2018 deri në pagesën e plotë;
- Detyrim i H. që t'i rimbursojë RSH **325,000 USD** sa i përket tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC.
- Detyrim i RSH për t'i rimbursuar Paditësit kostot ligjore për fazën e dytë të procedurave në shumën **142,975.78 Euro**.

Statusi aktual: *Njohur vendimi me Vendimin nr. 131 datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë (kërkues MIE).*

Me shkresën nr. 3666/1 datë 18.07.2023, MIE i ka dërguar një kopje Avokaturës së Shtetit të vendimit të Gjykatës së Apelit të cilës i është dhënë fuqi juridike.

Nga MIE deri në 31.12.2023 nuk është janë marrë masa për ekzekutimin e këtij vendimi.

3. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim datë **07.06.2024**,

për çështjen **ICC Case 21349/GR (iniciuar nga viti 2015)** ku ka vendosur:

-Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që burojnë nga dy Marrëveshje (Licencë Marrëveshje dhe Marrëveshje Hidrokarbure) lidhur me operimin e vendburimit të Patos Marinzës, që kanë të bëjnë me rikuperimin e disa kategorive të kostove të kryera nga operatori. Tribunali ka përcaktuar kriteret për rikuperimin e Kostove Hidrokarbure duke identifikuar përfundimisht se cilat janë kostot që B.P.A. mund të rikuperojë ose jo (duke vlerësuar se mbi 200 milion USD të deklaruar nga B. si të rikuperueshme nuk janë të tilla).

Tribunali gjithashtu ka urdhëruar B. që të rregullojë deklaratat e kostove (cost statements) për vitet fiskale në fjalë sipas përcaktimeve të bëra nga Tribunali, duke mbuluar çdo periudhë relevante 3-mujore, duke amenduar në këtë mënyrë "Kostot e Refuzuara nga AKBN" për periudhën 2012 -2017, "Totalin e Kostove Hidrokarbure" dhe balancat e mbartura, si dhe t'i përfshijë këto rregullime në raport progresin e parë 3-mujor pas daljes së vendimit.

Ekzekutimi i këtij vendimi, pas nxjerrjes së raporteve përfundimtare të auditit nga AKBN do të ketë ndikim të mëpasshëm në përllogaritjet eventuale të Tatimit mbi Fitimin të mbledhura nga organet tatimore si dhe ndikim në auditet e AKBN edhe për vitet vijuese 2018 e në vijim. Tribunali ka vendosur gjithashtu që të Paditurit (MIE, AKBN dhe Alb.) duhet të paguajnë kostot dhe shpenzimet lidhur me këtë arbitrazh në vlerën USD 5,759,912.31 (brenda 30 ditësh nga dalja e vendimit).

Pala Paditëse paraqiti më 20.07.2024 një kërkesë për Korrigjim dhe Interpretim pranë Gjykatës së Lartë në Zvicër. Me vendimin e datës **14.11.2024**, Tribunali vendosi se:

- rrëzon kërkesën e depozituar nga pala paditëse,
- urdhëron palën paditëse t'i paguajë palës së paditur nr.2 (Al.Sh.a), 50% të kostove ligjore (d.m.th. 27,120,62 \$US) dhe shpenzimeve paraprake të kësaj të fundit (d.m.th. 6,000\$),
- refuzon të gjitha kërkesat dhe pretendimet e tjera të palëve.
- Si përfundim sipas vendimit: *Të Paditurit (MIE+ AKBN +Alb.) duhet t'i paguajnë B. USD 5,759,912.31 (s qarim, me nxjerrjen e raport auditeve përfundimtare nga AKBN sipas gjetjeve të Tribunalit, DPT do të vijojë procedurat, për përllogaritjet e tatimit mbi fitimin).*
Sipas vendimit mbi kërkesën për korrigjim dhe interpretim, B. duhet t'i paguajë Al.: 27,120.62 \$ dhe 6,000 \$.

Statusi aktual: Në datën 21.02.2025, AKBN ka paraqitur kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ndërkohë shpenzime gjyqësore të paguara nga Shteti Shqiptar (MIE/AKBN) për këtë çështje janë:

Shpenzime gjyqësore **-210,000 USD** (AKBN);

Shpenzimet e përfaqësimit ligjor (MIE/AKBN)-**EUR 1,750,000;**

Tarifat për ekspertët (MIE/AKBN)- **EUR 880,000,**

Shpenzimet e pjesëmarrjes në seancë gjyqësore nga pjesëmarrësit (MIE, AKBN, Avokaturë) **23,597 Euro,**

Kostot e sallës së seancave dëgjimore, **40,195 Euro,**

Kostot e transkriptimit- **14,585 USD,**

Kostot e përkthimit- **3,648.68 GBP.**

Pra në total, kosto e shtetit shqiptar për shpenzimet gjyqësore është: 224,585 USD, 2,693,792 euro; 3,648.68 GBP.

4. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim sipas *Procesit të arbitrazhit, datë 04.06.2019 dhe Procesit të anulimit, datë 31.05.2022*, për çështjen **ICC Case no.22919/GR (iniciuar nga viti 2017)**, konkretisht:

Subjekti H. detyrohet t'i paguajë RSH: 731,280 Euro + 1,795.60 GBP, kosto ligjore dhe kosto të tjera të kryera në kuadër të arbitrazhit.

Statusi aktual: Në proces njohjeje në Gjykatën e Apelit Tiranë (kërkues MIE).

5. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim datë **03.10.2024**, për çështjen **PCA Case 2018-49**, (iniciuar nga viti 2018), ku ka vendosur:

- Deklaron të pranueshme pretendimet e Valerias, siç përcaktohet në fazën e dytë të arbitrazhit;
- Me shumicë votash, deklaroi se Shqipëria nuk ka shkelur detyrimet e saj sipas BIT Itali-Shqipëri; - Me shumicë, hedh poshtë pretendimet e V. për kompensim monetar për dëme materiale dhe jo materiale;

- Urdhëron V. t'i paguajë Shqipërisë, brenda tre muajve nga njoftimi i këtij Vendimi, shumën prej **1,700,000 euro**, si rimbursim i pjeshëm i shpenzimeve të Shqipërisë;

- Rrëzon të gjitha pretendimet e tjera të Palëve.

Statusi aktual:

Me shkresën nr. 3837/2 Prot., datë 24.10.2024, ASH ka njoftuar MBZHR, KM dhe MF për vendimin e arbitrazhit. Me shkresën e datës 29 tetor 2024 i është kërkuar zyrtarisht V.I.srl ekzekutimi i vendimit dhe bërja e pagesës. Me letrën e datës 2 dhjetor 2024 i është kërkuar V. srl ekzekutimi i vendimit sipas dispozitivit të vendimit të arbitrazhit. Nga ana e shoqërisë nuk është kthyer përgjigje.

- Vendimi Final i Arbitrazhit, origjinal me nr.1015/1Prot., është protokolluar pranë Avokaturës së Shtetit më datë 14 shkurt 2025. Me shkresën zyrtare të Avokaturës së Shtetit me nr.1051/2 Prot., datë 14 .02.20-25 drejtuar MBZHT është përcjellë dokumentacioni për vijimin e procesit të njohjes dhe dhënie fuqi ligjore në Republikën e Shqipërisë të Vendimit Final të Arbitrazhit të datës 3 tetor 2024 për çështjen e arbitrazhit PCA Case No. 2018-49 V. I. S.r.l. në likuidim për Republikën e Shqipërisë.

Shpenzimet paguar nga MBZHR:

- Shpenzimet e PCA (arbitrat, sekretaria, transkriptimi, etj): **494,500 EUR;**

- Shpenzimet e përfaqësimit ligjor: **1,000,000 EUR;**

- Shpenzimet për ekspertë: **385,000 GBP;**

- Shpenzimet e bëra nga dëshmitarë dhe përfaqësuesit e RSH: **10,222.70 EUR**

Në total, kosto e shpenzimeve gjyqësore të RSH (MBZHR), është: 1,504,722.7 euro dhe 385,000 GBP.

6. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim datë 26.07.2024, për çështjen ICSID Case no.ARB/20/37, (iniciuar nga viti 2020), ku ka vendosur:

- Tribunali nuk ka juridiksion mbi pretendimet e ngritura nga MCTC.

- Tribunali ka juridiksion mbi pretendimet e ngritura nga DKS, DCT dhe A.DLP;

- Tribunali rrëzon pretendimet e ngritura nga DKS, DCT dhe AI;

- Paditësit do të mbulojnë 70% të kostove të të Paditurit: 370,542.55 USD dhe 1,583,512.00 EUR;

- Të gjitha pretendimet dhe kërkesat e tjera rrëzohen.

Shpenzimet paguar nga APD:

Shpenzime të arbitrazhit (arbitrat, etj.): USD 434,646.50.

(kthyer Shpenzime për përfaqësimin ligjor: 1,900,000 EUR Shpenzime për ekspertë: 94,700 USD & 360,000 EUR; Shpenzime udhëtimi transporti 2,160 EUR).

Statusi Aktual: Vendimi i arbitrazhit është dërguar MIE, APD, KM dhe MF me shkresën e ASH, nr. 123/29 Prot., datë 12.09.2024.

Me shkresën nr. 23/33 Prot., datë 21.10.2024, Avokatura e Shtetit i ka kërkuar Palës Paditëse kryerjen e pagesës sipas dispozitivit të vendimit. Ndaj kësaj kërkesë nuk është marrë përgjigje. Pas komunikimeve me ICSID, MEPJ dhe MD, për dërgimin e kopjes së certifikuar të vendimit, i është dërguar vendimi i certifikuar MIE, APD, MF me shkresën e ASH me nr. 124/66 Prot., datë 07.10.2024.

Nga komunikimet e ASH me MIE-n, sipas shkresave zyrtare dhe emaileve, rezulton se kjo e fundit ka paraqitur kërkesën për njohje dhe ekzekutim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

7. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim datë 26.06.2024, për çështjen SCC Arbitration 2021/155, (iniciuar nga viti 2021), ku ka vendosur:

-Tribunali deklaron se ka juridiksion për të dëgjuar pretendimet e palë paditëse dhe në këtë mënyrë hedh poshtë kundërshtimin e Shqipërisë ndaj juridiksionit.

-Sa i përket themelit, pretendimet e I. për një gjetje të shkeljes nga Shqipëria të Traktatit të Kartës së Energjisë/ ECT dhe për kompensim të dëmit në shumën prej 37, 224,810.82 Euro plus interesat e akumuluar, Rëzohen.

- Sa i përket kostove procedurale, I-i kërkon kompensim në vlerën prej 3,544,859.81 Euro plus vlerën 1,300.09 GBP ndërsa Shqipëria kërkon kompensim në vlerën prej 2,580,540.69 Euro.

- Gjykata përcakton se secila nga Palët do të përballojë kostot e veta pa akorduar ndonjë vendim mbi kostot kundrejt palës tjetër.

Statusi aktual: Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 370/49 Prot., datë 15.07.2024 ka njoftuar për vendimin KM, MF, MIE dhe MTM.

Shpenzimet paguar nga MF:

- Shpenzimet e tribunalit, SCC: 241,810.04 EUR;

- shpenzimet e përfaqësimit ligjor: 1,650,000 EUR

- Shpenzimet e eksperteve: 242,928 EUR; 367, 100 EUR

- Shpenzimet e sallës dhe udhëtimit, përkthimit, suportit teknik, etj.- 47 962.69 EUR

Totali i shpenzimeve gjyqësore 2,549,800.69 Euro.

Konkluzion: Sipas vendimeve të arbitrazhit, rezulton se RSH ka fituar ndaj 7 çështjeve për të cilat ka qenë palë e paditur, 4 prej të cilave janë fituar gjatë vitit 2024. Vendimet e Arbitrazhit janë shprehur për rimbursim të kostove të tribunalit dhe shpenzimeve të përfaqësimit në shumën totale 8,971,593 Euro; 1,565,791 USD dhe 108,551 GBP si dhe 6,821,710 euro dëmshpërblim (Tabela nr.13).

Nga këto 7 vendime, janë njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë, vetëm dy vendime:

-Çështja ICC Case No. 20564/EMT/GR, (iniciuar nga viti 2014), me *Vendimin nr. 131 datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë (kërkesë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë)*, ku Gjykata Ndërkombëtare e arbitrazhit ka vendosur që Pala Paditëse H. srl duhet t'i paguajë penaltete për vonesat RSH-së në shumën **1,693,157 Euro** me interes të përbërë (interest on a compound basis), duke përdorur Libor 12-mujor në Euro + 2 % nga data 16 Korrik 2011 deri në pagesën e plotë.

- Detyrim i H që t'i paguajë dëmshpërblim RSH në shumën **5,182,535 Euro** me një interes të përbërë me bazë Libor 12-mujor në Euro +2% nga data 09.01.2018 deri në pagesën e plotë;

- Detyrim i H. që t'i rimbursojë RSH, **325,000 USD** sa i përket tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC.

Me shkresën nr. 3666/1 datë 18.07.2023, MIE i ka dërguar një kopje të vendimit të Gjykatës së Apelit Avokaturës së Shtetit të cilit i është dhënë fuqi juridike.

Nga MIE deri në 31.12.2023 nuk janë marrë masa për ekzekutimin e këtij vendimi, duke sjellë një paraqitje jo të drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që kanë palët e treta ndaj institucionit dhe anasjelltas. Mosnjohja në pasqyrat financiare e të drejtave dhe detyrimeve sjell për pasojë mos arkëtimin e të drejtave të fituara dhe mospagimin e detyrimeve.

-Çështja ICSID ARB/14/26, (iniciuar nga viti 2014) "A.A" sh.p.k., A. N., shoqëria "C." s.r.l, vendimi rezulton i njohur nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me *vendimin nr. 969, datë 25.11.2024*. Ky vendim është përcjellë nga MTM me shkresën nr. 3294 prot., datë 25.04.2025 (protokolluar në ASH me shkresën nr. 2726 prot., datë 28.04.2025). MTM i është drejtuar Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, duke vënë në dijeni ASH. Vendimi i Tribunalit, ka vendosur:

-se ka juridiksion për të marrë në shqyrtim pretendimet e palës paditëse;

-të rrëzojë secilën prej pretendimeve të ngritura nga pala paditëse dhe;

-se pala paditëse duhet t'i paguajë palës së paditur kostot dhe shpenzimet në vlerën totale prej €2,407,000 , USD 837,128.71 dhe £106,755 brenda 28 ditëve nga momenti i shpalljes së këtij vendimi ose e thënë ndryshe në total.

5 (pesë) vendimet e tjera po në favor të RSH, ende nuk janë njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë, pra e thënë ndryshe nuk kanë marrë fuqi ligjore për tu ekzekutuar, vonesa të cilat nuk mund të parashikohen se sa mund të zgjasin në afate kohore, si rezultat i ngarkesës së madhe të dosjeve që kjo gjykatë ka.

Gjithashtu në këtë kontekst, vlerat për të cilat shteti shqiptar pret të rimburohet nga këto vendime, janë shpenzime paraprakisht të kryera nga buxheti i shtetit (respektivisht sipas institucioneve përgjegjëse që janë palë të paditura në këto çështje gjyqësore).¹¹

Pra vetëm për periudhën 2014-2024, qeveria shqiptare ka shpenzuar rreth 6,421,792 Euro; 1,565,791 USD dhe 108,551 GBP, ose e thënë në një monedhë të vetme **7,923,771.29 euro**¹², për përfaqësimin ligjor në këto çështje, edhe pse ka qenë palë fituese si palë e paditur. Këto shpenzime janë ndarë ndërmjet institucioneve të ndryshme, përfshirë MF, MIE, APD, A., MBZHR dhe AKUK.

Vlera e “dëmit të parandaluar” për 7 vendime të arbitrazhit në favor të RSH, është: **499,759 900 Euro**.

B. Ecuria e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Arbitrazhit Ndërkombëtar, të humbura si çështje nga RSH.

Në lidhje me vendimet e fituara në gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar, kundër RSH dhe konkretisht subjekteve të cilët citohen në vijim, paraqitet kjo situatë deri më 31.12.2024 (Tab nr. 14).¹³

Tabela 14: Përmbledhëse e vendimeve të Arbitrazhit të humbura nga RSH.

N r	Iniciu ar	Çështja	Paditësi	I padituri	Dëmshpërblim/detyrim/penalite te			Kosto të tribunalit dhe përfaqësimit		
					Euro	USD	G B P	Euro	USD	G B P
1	2015	ICSID ARB/15/28	H. C. srl, F.B., M.R., S..G..n, L. C.	RSH	99,487,000			8,222,238	\$2,346,442.13	
2	2017	ICC Case no. 22676/GR	G. .C. LTD	MIE, AKBN, AI.		12,577,852		14,451.68	292,760	
3	2018	ICC Case no.23998/MH M (C-24011/MHM)	“JV C.C. E. & A. T. S. A.”, shoqëria “C.C. E.” dhe “A. T. S. A.”	MPPT/ARRSH		44,262,682.40		573,081.13		
4	2018	ICC Case 24140/MHM	Shoqëria s.p.a,	C.D. MIE, AKUK	13,338,920.9				350,000	
5	2014	ICC Case No. 20564/EMT/GR	H.srl	MIE				142,976		

¹¹ Neni 9/pika 5.1. e Ligjit 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

¹² Monedhat e huaja janë konvertuar me kursin zyrtar të BSH, të datës 24.04.2025.

¹³ Sqarojmë që në tabelën nr. 14, përveç 4 çështjeve gjyqësore për të cilat, Gjykata e Arbitrazhit ka dalë me vendimet përkatëse kundër Shqipërisë, janë edhe dy çështje të fituara nga RSH, por në tabelë janë shprehur detyrimet që RSH ka ndaj palës paditëse, kjo për të dalë në një vlerë totale të efekteve financiare të

6	2015	ICC Case 21349/GR	B.P	MIE, AKBN, A	5,759,912					
		Totali			118,585,832	56,840,534	0	8,952,747	2,989,202	0

1. Për çështjen ICSID ARB/15/28, e palës paditëse H.srl, C.srl, F.B., M.R, S. G., L. C, (inicuar nga viti 2015), Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë tre vendime: Procesi i arbitrazhit i datës 24.04.2019, Procesi i Anulimit, datë 02.04.2021 si dhe Procesi i Rishikimit, datë 29.03.2023, ku ka vendosur:

-Detyrim i RSH të paguajë:

- dëmshpërblim ndaj M.R në shumën 46,751,000 Euro për shpronësimin e interesit të tij në A;
- dëmshpërblim ndaj S. G.në shumën 11,688,000 Euro për shpronësimin e interesit të saj në A.;

- dëmshpërblim ndaj F. B në shumën 41,048,000 Euro për shpronësimin e interesit të tij në A;
- 75 % të kostove ligjore, ekspertëve dhe kostot e lidhura me të në shumën 8,222,238.53 Euro;
- 100 % të kostove të arbitrazhit të Paditësve në shumën 645.183,42 USD + interesa mbi shumat e paragrafëve (3) deri në (8) të dispozitivit të vendimit Libor+3% tremujor prej 31.03.2018 deri në pagesën e plotë.

Procesi i Anulimit: - detyrim i RSH të paguajë të gjitha kostot e procedurave duke përfshirë tarifatat dhe shpenzimet e anëtarëve të Tribunalit, kostot administrative dhe shpenzimet direkte si dhe kostot ligjore të Paditësve në shumën e 1,701,258.71 USD + interes LIBOR (ose SOFR nëse LIBOR nuk ekziston më derisa të bëhet pagesa e plotë) + 3% (compunded quaterly) i përbërë tremujor nga data 31 mars 2021.

Procesi i Rishikimit: Tribunali vendosi rrëzimin e kërkesës për rishikim. Palët do të mbulojnë shpenzimet e tyre ligjore dhe i Padituri do të mbulojë kostot e procedurave.

Statusi aktual: Pala Paditëse H.srl, F. B, M.R, etj më 08.08.2019 (me datë regjistrimi në Gjykatë 30.08.2019) ka paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkesën për njohjen e vendimit të arbitrazhit. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 182 akti, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për njohjen dhe ekzekutimin në RSH të vendimit të arbitrazhit ICSID Nr. ARB/15/28 duke qenë se Gjykata e Apelit ka konsideruar se vendimi nuk kishte marrë ende formë të prerë (Nga ana e RSH ishte regjistruar tashmë kërkesa për anulimin e vendimit të arbitrazhit).

Në vijim Pala Paditëse ka regjistruar në Gjykatën e Apelit Tiranë kërkesën vijuese të njohjes së vendimit të arbitrazhit ICSID Nr. ARB/15/28 me nr. Akti 218 dhe datë Regjistrimi 23.11.2020. *Çështja vijon të jetë me statusin: Përpunim (pra ende nuk ka ndonjë njoftim nga Gjykata e Apelit Tiranë për fillimin e procesit lidhur me njohjen e vendimit të arbitrazhit).*

2. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim datë 06.07.2020, për çështjen ICC Case no. 22676/GR (inicuara nga viti 2017), me palë paditëse G.C. LTD, ku ka vendosur:

-MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit vlerën 12,577,852.1 USD:

si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencës Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit.

-Paditësi duhet të paguajë 60 % të Kostove Administrative dhe të Paditurit duhet të paguajnë 40 % të këtyre kostove.

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit 292,760 USD dhe 14,451.68 Euro, me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

Statusi aktual: Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, me kërkesë të shoqërisë "G.C Ltd" përfaqësuar nga dega e shoqërisë së huaj T. A Ltd ka vendosur: Njohjen dhe dhënien fuqi ligjore për zbatim në Republikën e Shqipërisë të vendimit nr. 22676/GR.

Avokatura e Shtetit ka ushtruar të drejtën e rekursit duke kërkuar: Prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes si dhe pezullimin e ekzekutimit. Pezullimi i ekzekutimit nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë. Aktualisht çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe akoma nuk ka një datë të planifikuar për zhvillimin e seancës. Shoqëria G.C Ltd është regjistruar në proces likuidimi në Ishujt Kajman. Më 8 Maj 2023 G C Ltd i kalon të gjitha të drejtat shoqërisë O.B. Limited. Personi juridik O.B. si pasues i se drejtës se G.C ka inicuar procedura ekzekutimi ne juridiksione te tjera si: SHBA (Kolumbi), Belgjike, Holandë.

3. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim ka marrë vendim sipas Procesit të arbitrazhit: 01.09.2020 si dhe Procesit të anulimit: 31.05.2022, për çështjen ICC Case no.23998/MHM (C-24011/MHM) (inicuar nga viti 2018), me palë paditëse: Bashkimi i shoqërive “JV C.C. E. WL & A. T. S.A.”, shoqëria “C. C. E.” dhe “A.T.S.A, ku ka vendosur: Vendimi i arbitrazhit 01.09.2020:

Detyrime për RSH: USD 25,220,016.3 sic përcaktohet në Vendimin për Segmentin 1 të 9 Tetor 2017 të shtuar me USD 5,044,003.27 për 20 % TVSH, domethënë një shumë në total prej **USD 30,264,019.64**; USD 11,665,552 sic përcaktohet në Vendimin për Segmentin 3 të 7 Shtator 2017 të shtuar me USD 2,333,110.46 për 20 % TVSH, domethënë një shumë në total prej **USD 13,998,662.77**);

261,556.75 Euro kosto administrative të paditësit dhe tarifat dhe shpenzimet e Tribunalit; **161,524.38** Euro - rimbursim të kostove ligjore të paditësit.

Procesi i Anulimit: Vendimi i Gjykatës së Apelit Paris 31.05.2022.

Detyrime për RSH: 150,000 Euro shpenzime gjyqësore të paditësit.

Statusi aktual dhe korrespondenca e ASH: Me shkresën nr. 119/1 Prot., datë 20.01.2023, ASH i ka kthyer përgjigje shkresës nr. 10379/6 Prot., datë 30.12.2022 të ARSSH (për dijeni edhe MIE) mbi një propozim të JV Copri Aktor për zgjidhjen me mirëkuptim të çështjeve që lidhen me vendimin e arbitrazhit.

Nga ASH është theksuar se në zbatim dhe interpretim të Konventës së New York-ut “Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit”, vendimi i arbitrazhit mund të ekzekutohet vetëm pas njohjes së tij nga Gjykata e Apelit, sipas kuadrit ligjor në fjalë.

4. Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim të datës 14.03.2024, për çështjen ICC Case 24140/MHM (inicuar nga viti 2018), me palë paditëse: Shoqëria C.D s.p.a, dhe palë të paditur MIE & AKUK, ku ka vendosur:

Vendimi i arbitrazhit ndërkombëtar të lëshuar nga Tribunali më datë **14 Mars 2024**:

I padituri urdhërohet të paguajë:

- Shumën prej JPY 1,613,393,481 sipas Kreut të Kërkesës 1. Kjo shumë do të përlllogaritet me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës Qendrore të Japonisë, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të paguhet në këtë monedhë), e llogaritur nga 1 tetori 2018 deri në datën e pagesës efektive të tij nga Pala e Paditur.

- Shumën prej 277,619,188 JPY sipas Kreut të Pretendimit 2. Kjo shumë do të përlllogaritet me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës Qendrore të Japonisë, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të paguhet në këtë monedhë), e llogaritur nga 1 tetori 2018 deri në datën e pagesës efektive të tij nga Pala e Paditur.

- Shumën prej 9,534,185.42 JPY dhe 90,902.38 Euro sipas Kreut të Kërkesës 3. Këto shuma do të përlllogariten me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës Qendrore të Japonisë dhe Bankës Qendrore Evropiane, përkatësisht, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të paguhet në këtë monedhë) . llogaritur nga 1 tetori 2018 deri në datën e pagesës efektive të tij nga Pala e Paditur.

- Shumën prej 270,000 Euro sipas Kreut të Pretendimit 4. Kjo shumë do të përlllogaritet me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës së Përgjithshme Evropiane, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të paguhet në këtë monedhë), e llogaritur nga 1 maji 2019 deri në datën e pagesës së tij efektive nga Pala e Paditur.
- Shumën prej 46,964,317.99 LEK sipas Kreut të Pretendimit 5. Kjo shumë do të përlllogaritet me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës Qendrore të Shqipërisë, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të paguhet në këtë monedhë), e llogaritur nga data 14 dhjetor 2020 deri në datën e pagesës efektive të tij nga Pala e Paditur.
- Shumat prej 5,083,345 JPY dhe 43,418,264.97 LEK sipas Kreut të Pretendimit 6. Këto shuma do të përlllogariten me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës Qendrore të Japonisë dhe Bankës Qendrore të Shqipërisë, përkatësisht, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të paguhet në këtë monedhë), llogaritur nga 14 dhjetor 2020 deri në datën e pagesës efektive të tyre nga Pala e Paditur.
- Shuma prej 710,009,469 JPY sipas Kreut të Pretendimit 7. Kjo shumë do të përlllogaritet me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës Qendrore të Japonisë, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të paguhet në këtë monedhë), e llogaritur nga 14 dhjetor 2020 deri në datën e pagesës efektive të tij nga Pala e Paditur.
- Shumat prej 16,408,971 LEK dhe 2,463,286.25 Euro sipas Kreut të Pretendimit 8. Këto shuma do të përlllogariten me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës Qendrore të Shqipërisë dhe Bankës Qendrore Evropiane, përkatësisht, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të paguhet në këtë monedhë), llogaritur nga 14 dhjetor 2020, deri në datën e pagesës efektive të tyre nga Pala e Paditur.
- Shumën prej 262,060,458 JPY sipas Kreut të Pretendimit 9. Kjo shumë do të përlllogaritet me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës Qendrore të Japonisë, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të depozitohet në këtë monedhë), e llogaritur nga 14 dhjetor 2020 deri në datën e pagesës efektive të tij nga Pala e Paditur.
- Padiësi detyrohet t'i paguajë të Paditurit shumën prej 1,357,755,462 JPY si kthim (return) të balancës së Pagesës Paradhënie (Advance Payment). Kjo shumë do të përlllogaritet me interes me një normë vjetore prej 3% mbi normën e skontimit të Bankës Qendrore të Japonisë, ose nëse nuk disponohet, norma e ofruar ndër bankare (dhe do të paguhet në këtë monedhë), e llogaritur nga 20 Korrik 2018 deri në datën e pagesës efektive të tij nga Pala Padiëse.
- Shuma prej 1,357,755,462 JPY plus interesi i përlllogaritur nga 20 Korrik 2018, që Padiësi i detyrohet të Paditurit, do të zbritet (set-off) nga i Padituri nga shuma finale (principali plus interesi) që do të paguhet në JPY nga I Padituri tek Padiësi.
- I padituri do të mbulojë kostot e Arbitrazhit, siç janë fiksuar nga Gjykata e ICC dhe do t'i shlyejë Padiësit 350,000 USD që i ka paguar ICC si pagesa paraprake dhe secila Palë do të mbulojë kostot e veta ligjore apo kostot e tjera të kryera në lidhje me këtë arbitrazh. Pra si përfundim, sipas vendimit të Arbitrazhit, *Pala e Paditur (MIE, AKUK)* duhet t'i paguajë Padiësit shumat 21,764,250 Euro, ndërsa Padiësi duhet t'i paguajë MIE/AKUK vlerën 8,425,329.10 Euro.

Në total, Pala e Paditur (MIE/AKUK) pas zbritjes së vlerës që i detyrohet Padiësi, duhet t'i paguajë këtij të fundit vlerën prej **13,338,920.9 Euro + 350,000 USD.**

V.O: Në këto shuma nuk janë të llogaritura interesat, të cilat në momentin që ky vendim do të jetë i ekzekutueshëm do të llogariten në vlera.

Statusi aktual: Vendimi i është përcjellë MIE/AKUK me shkresën e ASH, nr. 56/11 Prot., datë 12.04.2024, dhe nuk është njohur ende nga Gjykata e Apelit.

Shpenzimet paguar nga AKUK:

- ✓ Shpenzimet për ICC: **350,000 Euro**
- ✓ Shpenzimet për përfaqësimin ligjor: **€ 1,099,000**

- ✓ Shpenzimet për ekspertin: **757,500 USD;**
- ✓ Shpenzimet për ekspertin e pavarur: **€ 76,750**
- ✓ Kostot për seancat: **£ 2,647; £ 7,612.50**

Në total nga AKUK, janë paguar shpenzime përfaqësimi në vlerën 1,525,750 euro, 757,000 USD dhe 10,259.5 GPG.

Përsa i përket vendimeve të humbura nga RSH, vetëm një prej tyre është njohur nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, konkretisht: Çështja ICC Case no. 22676/GR me palë paditëse GBC, iniciuar prej 2017. Pala e Paditur (MIE&AKBN, Alb.)

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit vlerën **12,577,852.1 USD:** si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencës Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit. -Paditësi duhet të paguajë 60 % të Kostove Administrative dhe të Paditurit duhet të paguajnë 40 % të këtyre kostove.

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit **292,760 USD dhe 14,451.68 Euro,** me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

Prej datës së njohjes deri në periudhën e auditimit (prill 2025) nuk është marrë asnjë masë nga MIE&AKBN, për njohjen e këtij detyrimi dhe planifikimin në buxhetin përkatës për shlyerjen e tij duke e vendosur shtetin shqiptar para një risku tjetër në dëm të buxhetit të shtetit atë të interesave për 4 vite, të cilat të përllogaritura nga grupi i auditimit prej datës së vendimit 06.07.2020 deri në 31.12.2024, vlera e prishme e interesave është:

Tabela 15

Vlera e detyrimit Norma e interesit 5%	06.07.2020- 31.12.2024	2021	2022	2023	2024	Totali
292,760	7,319	14,638	14,638	14,638	14,638	65,871 \$
14,452	361,3	722.6	722.6	722.6	722.6	2,890 Euro

Përpunoi, grupi i auditimit.

Pra vlera prej **65,871 \$ dhe 2,890 euro,** përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit, pasi MIE rezulton të mos ketë njohur ende këtë detyrim në pasqyrat financiare të institucionit e si rrjedhojë nuk janë marrë masa për likuidimin e çështjeve të sipër përmendura, veprime në kundërshtim me *UMF nr 8 datë 09.03.2018 i ndryshuar me nr UMF nr 5, datë 21.2.2022.*

Konkluzion: Në lidhje me çështjet e humbura nga RSH, në gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar, deri në dhjetor 2024, rezultojnë 4 çështje, ku efektet financiare të marra progresive, pra në një periudhë kohe prej 10 vitesh, (2014-2024) janë në total 180,125,882 euro, nga të cilat kosto të tribunalit dhe përfaqësimit janë 11,580,103.86 euro,¹⁴ detyrim për t'u paguar nga qeveria shqiptare sipas vendimit të Tribunalit.

Çështjet e humbura janë:

1. H. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, ku shteti shqiptar është i detyruar të paguajë shumën prej 108 mln euro ose sa 57% e detyrimit total që shtetit shqiptar ka në çështjet e arbitrazhit.
2. C. A., çështje që lidhet me ndërtimin e autostradës Tiranë-Elbasan, me një faturë 39,462,217.43 euro.
3. C. D., çështje e humbur me një detyrim 21,764,250 euro.
4. G.C-. LTD, çështje e humbur me një faturë 11,317,183.7 euro.

¹⁴ Në shumën e kostove të përfaqësimit në gjykata, janë përfshirë edhe 2 çështje në të cilat pala shqiptare ka qenë fituese por ka pasur detyrim për të paguar vlerat 5,902,888 euro, paraqitur në tabelen 14, rreshti 5-6.

Përsa i përket vendimeve të humbura nga RSH, vetëm një prej tyre është njohur nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, konkretisht: Çështja ICC Case no. 22676/GR me palë paditëse G.C, iniciuar prej 2017. Pala e Paditur (MIE&AKBN, Alb)

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit vlerën **12,577,852.1 USD**: si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencës Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit. -Paditësi duhet të paguajë 60 % të Kostove Administrative dhe të Paditurit duhet të paguajnë 40 % të këtyre kostove.

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit **292,760 USD dhe 14,451.68 Euro**, me interes me normë **5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës**.

Prej datës së njohjes deri në periudhën e auditimit (prill 2025) nuk është marrë asnjë masë nga MIE&AKBN, për njohjen e këtij detyrimi dhe planifikimin në buxhetin përkatës për shlyerjen e tij duke e vendosur shtetin shqiptar para një risku tjetër në dëm të buxhetit të shtetit atë të interesave për 4 vite, të cilat të përlllogaritura nga grupi i auditimit prej datës së vendimit 06.07.2020 deri në 31.12.2024, vlera e pritshme e interesave është: **65,871 \$ dhe 2,890.4 euro**, ose e shprehur në një monedhë të vetme **60,776.15 euro**, vlerë që përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit, pasi MIE rezulton të mos ketë njohur ende këtë detyrim në pasqyrat financiare të institucionit e si rrjedhojë nuk janë marrë masa për likuidimin e çështjeve të sipër përmendura, veprime në kundërshtim me *UMF nr. 8 datë 09.03.2018 i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.2.2022*.

C. Në lidhje me çështjet në proces apo të ndërprera, të dhënat jepen në tabelën 3, në vijim:

Tabela 16: Përmbledhje e çështjeve të përfunduara dhe atyre në proces.

Nr.	Iniciuar çështja	Titulli	Pala Paditëse	Palë e Paditur	Data e vendimit përfundimtar	Shpenzimet gjyqësore	Statusi aktual
1	2016	ICSID Case no.CONC/16/1	X.K.	RSH	Arbitrazhi nuk ka filluar ende. Kërkesë për Pajtim më 16 Maj 2016. Pezulluar që në vitin 2016 për shkak të procedurës së pajtimit.		Nuk ka asnjë zhvillim të mëtejshëm
	2020	ICSID Case no.ARB/20/54	A.E.B.V	RSH	Përfunduar në Korrik 2022. Procesi është ndërprerë (Discontinued) për shkak se palët nuk kanë paguar shpenzimet administrative fillestare të Tribunalit.		Përfunduar
3	2021	çështje vendase	D.G./D. E.	MIE	Ne proces	Shpenzimet per arbitrazh: 45 000 mije Euro	Në pritje të vendimit
4	2022	M. N v. Republic of Albania	M. N.	RSH	Ne proces	Shpenzimet paguar nga MF. Shpenzime për PCA, Tribunalin: 100,000 Euro (deri tani) Shpenzimet për përfaqësim ligjor: 130,000 Euro (deri tani). Shpenzimet për ekspertin: 14 000 Euro	Në proces

5	2023	UNCITRAL Case PCA Case No. 2023-43	P/ kundër A Sh.a (Amonica)	A	Përfunduar më 11.12.2023	Shpenzimet për përfaqësim ligjor paguar nga Alb petrol: 100 000 Euro. 56,867.52 Euro	Përfunduar
6	2023		PP Sha kundër AI	A	Përfunduar më 14.11.2023	Nuk ka shpenzime	Përfunduar
7	2023	ICSID Case No. ARB/23/9	EMS	RSH	Përfunduar më 13.08.2024	Shpenzimet paguar nga APD. Shpenzimet administrative dhe të arbitrave: 123,195.48 EUR. Shpenzimet për përfaqësimin ligjor: 1,050,000 EUR. Shpenzimet per ekspertin: 330,000 EUR	Përfunduar procedura sipas Urdhrit të Tribunalit. Me shkresën tonë nr. 124/62 Prot., datë 12.09.24 i është njoftuar Urdhri i Tribunalit MIE, APD, KM dhe MF.
8	2024		F.B , M. D. Renzis, S.G, L C, C	RSH	Nuk ka asnjë zhvillim të mëtejshëm që nga paraqitja e kërkesës për arbitrazh.		Nuk ka ende zhvillime të mëtejshme

Punoi grupi i auditimit.

Sipas tabelës 16, (8 çështje në total) rezulton se 4 çështje janë përfunduar, konkretisht: Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit ka marrë vendim sipas Procesit të arbitrazhit për 4 çështje të paraqitura në tabelën 3, përkatësisht:

-Çështja ICSID Case no.ARB/20/54, përfunduar në Korrik 2022. Procesi është ndërprerë (Discontinued) për shkak se palët nuk kanë paguar shpenzimet administrative fillestare të Tribunalit.

-Çështja UNCITRAL Case PCA Case No. 2023-43, përfunduar më 11.12.2023, shpenzimet për përfaqësim ligjor paguar nga A: **100 000 Euro & 56,867.52 Euro.**

-Çështja P. P. Sha kundër A. Sh. a, përfunduar më 14.11.2023, nuk ka shpenzime.

-Çështja ICSID Case No. ARB/23/9, përfunduar më **13.08.2024**, ku pala padiëse është tërhequr nga padia, shpenzimet paguar nga APD. Shpenzimet administrative dhe të arbitrave: 123,195.48 EUR. Shpenzimet për përfaqësimin ligjor: 1,050,000 EUR. Shpenzimet per ekspertin: 330,000 EUR përfunduar procedura sipas Urdhrit të Tribunalit. Me shkresën e ASH, nr. 124/62 Prot., datë 12.09.24 i është njoftuar Urdhri i Tribunalit MIE, APD, KM dhe MF.

Në total për këto 4 çështje, shpenzimet gjyqësore të paguara nga pala e paditur, pra nga buxheti i shtetit shqiptar, janë:

A: **156,867.52 euro;**

APD: **1,503,195.48, euro**

-Janë dy çështje të pezulluara pra pa zhvillime nga ana e palës paditëse:

- Çështja ICSID Case no. CONC/16/1, iniciuar në 2016, Arbitrazhi nuk ka filluar ende. Kërkesë për Pajtim më 16 Maj 2016. *Pezulluar që në vitin 2016* për shkak të procedurës së pajtimit.
- Çështja F. B., M. . R., S.G, L. C, Nuk ka asnjë zhvillim të mëtejshëm që nga paraqitja e kërkesës për arbitrazh.

-2 çështje janë në proces:

- ✓ Çështja D.G./D. E., iniciuar në 2021, Shpenzimet për arbitrat: **45,000 mijë Euro**, e cila është në pritje të vendimit.
- ✓ Çështja M. N., shpenzimet gjyqësore paguar nga MF, të specifikuara:
 - Shpenzime për PCA, Tribunalin: 100,000 Euro (deri tani)
 - Shpenzimet për përfaqësim ligjor: 130,000 Euro (deri tani)
 - Shpenzimet për ekspertin: 14 000 Euro

Totali i shpenzimeve paguar nga buxheti i shtetit është **244,000 euro**

Statusi: ***në proces.***

Efeki financiar i shpenzimeve gjyqësore, paguar nga buxheti i shtetit si palë e paditur për këto çështje (të pezulluara, të përfunduara dhe në proces), është 1,949,063 euro.

Konkluzion:

1. Nga auditimi i veprimtarisë statistikore në zyrat vendore të ASH si dhe regjistrimi i çështjeve në regjistrat përkatës të institucionit, u konstatua se:

- ✓ Avokatura e Shtetit i regjistron çështjet e gjykatave kombëtare në regjistrin fizik dhe në sistemin elektronik të çështjeve i cili përdoret nga institucioni, dhe për periudhën në auditim ka qenë në fokusin e inspektimeve nga Zyra e Inspektimit dhe Këshillimit në ASH, për 6 zyrat vendore.
- ✓ Përsa i përket sistemit elektronik (IT) të çështjeve¹⁵ vendore, nuk ka gjurmë auditimi ku të specifikohet data e implementimit të këtij sistemi përveçse një dokumenti në gjuhën angleze, i cili ka të bëjë me specifikimet teknike të sistemit, të datës 25.02.2019.
- ✓ Nisur nga verifikimet e kryera si dhe bazuar në raportet vjetore të ASH, për periudhën nën auditim, Zyra e Inspektimit dhe Këshillimit në ASH e cila është përgjegjëse për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit, në të dyja nivelet e organizimit, për ushtrimin me efektivitet të funksioneve të institucionit, ka kryer vetëm inspektime tematike dhe të fokusuara mbi veprimtarinë e avokatëve të shtetit individualisht dhe jo mbi veprimtarinë e zyrave në tërësi.
- ✓ Nuk ka informacion lidhur me çështjen dhe pasojat të cilat mund ose kanë sjellë dëm në interesat e shtetit Shqiptar, nga veprimet apo mos veprimet e avokatëve të shtetit.
- ✓ Fokusi kryesor i Zyrës së inspektimit për 2023-2024, ka qenë “Përditësimi i dosjeve në sistemin elektronik”, në zyrat vendore dhe ato të avokatëve të shtetit pranë Ministrive, por megjithëse është kryer një numër i konsiderueshëm inspektimesh për këtë problematikë (rreth 92 inspektime vetëm për 2023), nuk ka një konkluzion se sa për qind e dosjeve janë hedhur në sistemin elektronik dhe sa jo e rrjedhimisht asnjë datë fikse se kur ky proces duhet të përfundojë.
- ✓ Sistemi aktual nuk përpunon informacione statistikore për çështjet gjyqësore në vite çfarë do të sillte rritje të transparencës e llogaridhënies si dhe saktësim në përpunimin e informacioneve duke lehtësuar punën e Audituesve të brendshëm apo të jashtëm por edhe të institucioneve të tjera shtetërore.

Për sa i përket regjistrimit të vendimeve të GJEDNJ dhe Gjykatave të Huaja dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe çdo lloj korrespondence tjetër pjesë e procesit deri në publikimin e vendimit përfundimtar, ASH nuk ka një sistem elektronik ose e thënë ndryshe të dhënat për vendimet e GJEDNJ dhe Gjykatave të Arbitrazhit nuk janë të digjitalizuara, ende sot në 2025. Avokatura e Shtetit disponon një regjistër fizik (manual) dhe elektronik (Excel), për regjistrimin e çështjeve, sipas formatit të miratuar me Urdhrat e Titullarit të ASH, nr. 375, datë 20.10.2022 dhe 375/1, datë 21.10.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e formatit të regjistrimit elektronik dhe fizik të çështjeve të Arbitrazhit dhe përfaqësimit në gjykatat e huaja”

¹⁵ Sqarojmë që në ASH, aktualisht ka një sistem elektronik (IT), për regjistrimin e të gjitha dosjeve për çështjet vendore dhe një regjistër elektronik për vendimet e Arbitrazhit dhe të GJEDNJ-së, ku grupi i auditimit ka konstatuar gjetjet për secilin.

si dhe “Për miratimin e formatit të regjistrimit të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrimit të çështjeve në shqyrtim të GJEDNJ-së”.

Digjitalizimi i të dhënave në Avokaturën e Shtetit do të sigurojë saktësinë në menaxhimin e çështjeve ligjore, veçanërisht ato të arbitrazhit ndërkombëtar.

Mungesa e digjitalizimit ka sjellë:

- ✓ mungesë transparence dhe llogaridhënie, pasi rrit riskun e mos mbajtjes saktë dhe në kohë të çdo të dhëne të nevojshme për monitorimin e të gjithë korrespondencës shkresore apo e-maileve zyrtare si me institucionet brenda vendit ashtu dhe me ato ndërkombëtare.
- ✓ Përgatitjen e dosjeve dhe çështjeve të reja apo atyre të mbartura në vite duke u bazuar në të dhëna të plota dhe të verifikuara si dhe kursyer kohë dhe burime njerëzore.
- ✓ Gjurmimin dhe verifikimin e veprimeve, duke ulur mundësinë e ndërhyrjeve apo fshehjes së fakteve si dhe mbrojtjen më të mirë të interesave të shtetit shqiptar.

2. Në lidhje me ecurinë e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlera e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykimi, u konstatuan:

Çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar kanë sjellë një barrë të konsiderueshme financiare për Shqipërinë, me detyrime që arrijnë në miliona euro. Kjo nënvizon nevojën për menaxhim më të kujdesshëm të kontratave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe përfaqësim të fortë ligjor në përballje ndërkombëtare.

A. Në lidhje me vendimet e arbitrazhit të fituara nga RSH, rezulton se janë 7, ku 4 prej tyre të fituara gjatë vitit 2024. Sipas këtyre vendimeve, RSH duhet të rimbursohet për kosto të tribunalit dhe shpenzime të përfaqësimit në shumën totale 8,971,593 Euro, 1,565,791 USD dhe 108,551 GBP si dhe 6,821,710 euro dëmshpërblim. (Tab nr.13), ose e thënë në një monedhë të vetme, **10,473,572 euro¹⁶. Pra për periudhën 2014-2024, qeveria shqiptare ka shpenzuar për përfaqësim ligjor në tribunal **10,473,572 euro**, të ndarë këto ndërmjet institucioneve të ndryshme, përfshirë MF, MIE, APD, AI, MBZHR dhe AKUK.¹⁷**

Nga këto 7 vendime, janë njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë, vetëm 2 vendime, ku një vendim përket çështjes ICC Case No. 20564/EMT/GR, (iniciuar nga viti 2014), me Vendimin nr. 131 datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë (kërkesë MIE). Gjykata Ndërkombëtare e arbitrazhit ka vendosur që Pala Paditëse H. srl duhet t’i paguajë Penalitete për vonesat, RSH në shumën 1,693,157 Euro me interes të përbërë (interest on a compound basis), duke përdorur Libor 12-mujor në Euro + 2 % nga data 16 Korrik 2011 deri në pagesën e plotë;

- Detyrim i H. që t’i paguajë dëmshpërblim RSH në shumën 5,182,535 Euro me një interes të përbërë me bazë Libor 12-mujor në Euro +2% nga data 09.01.2018 deri në pagesën e plotë;

- Detyrim i H. që t’i rimbursojë RSH 325,000 USD sa i përket tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC.

Me shkresën nr. 3666/1 datë 18.07.2023, MIE i ka dërguar një kopje Avokaturës së Shtetit të vendimit të Gjykatës së Apelit të cilës i është dhënë fuqi juridike.

Nga MIE deri në 31.12.2023 nuk janë marrë masa për ekzekutimin e këtij vendimi, duke sjellë një paraqitje jo të drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që kanë palët e treta ndaj institucionit

¹⁶ Monedhat e huaja janë konvertuar me kursin zyrtar të BSH, të datës 24.04.2025.

¹⁷ Ndryshe nga vendimet e GJEDNJ, vendimet e Arbitrazhit Ndërkombëtar bëhen të zbatueshëm në Shqipëri pas njohjes së vendimit nga Gjykata Shqiptare e Apelit. Për vendimet e zbatueshme Avokatura e Shtetit disponon informacion i cili ka nevojë të përditësohet, lidhur me shumat e paguara nga institucionet respektive palë në gjykim, e si e tillë vlera e ekzekutuar dhe ajo për tu ekzekutuar nga buxheti i shtetit është gjithmonë në ndryshim çka në vlerësimin tonë paraqet nevojën për një qasje ndryshe të ASH si dhe rrit përgjegjësinë që kanë Institucionet përkatëse në rolin e palëve të paditura dhe detyrimin për të zbatuar dhe ndjekur vendimet e gjykatave të arbitrazhit për më tepër kur ato janë njohur nga gjykata e apelit.

dhe anasjelltas. Mosnjohja në pasqyrat financiare e të drejtave dhe detyrimeve sjell për pasojë mos arkëtimin e te drejtave të fituara dhe mospagimin e detyrimeve.

Vendimi i Tribunalit datë 20.03.2020, ka vendosur:

-se ka juridiksion për të marrë në shqyrtim pretendimet e palës paditëse;

-të rrëzojë secilën prej pretendimeve të ngritura nga pala paditëse dhe;

-se pala paditëse duhet t'i paguajë palës së paditur kostot dhe shpenzimet në vlerën totale prej €1,857,000, USD 427,488.72 dhe £106,755 brenda 28 ditëve nga momenti i shpalljes së këtij vendimi. Në rast vonese në pagesën e këtyre kostove, do të përlllogaritet një interes 2% i përbërë me bazë mujore (compound with monthly rests), deri në kryerjen e pagesës për këto kosto.

Vendimi i dytë i njohur nga Gjykata e Apelit i përket çështjes ICSID ARB/14/26, (iniciuar nga viti 2014) "A. A." sh.p.k., A. N., shoqëria "C." s.r.l, me nr. 969, datë 25.11.2024. Ky vendim është përcjellë nga MTM me shkresën nr. 3294 prot., datë 25.04.2025 (protokolluar në ASH me shkresën nr. 2726 prot., datë 28.04.2025). MTM i është drejtuar Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, duke vënë në dijeni ASH.

B. *Në lidhje me çështjet në gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar dhe vendimet e tyre ku shteti shqiptar është pala humbëse, deri në dhjetor 2024, rezultojnë 4 çështje, me efekte financiar në një vlerë totale 180,125, 882 euro, nga të cilat kosto të tribunalit dhe përfaqësimit janë 11,580,103.86 euro¹⁸, vlerë e cila gjithashtu do të paguhet nga qeveria shqiptare.*

Çështjet e humbura janë:

-H. dhe të tjerë kundër Shqipërisë, ku shteti shqiptar është i detyruar të paguajë shumën prej 108 mln euro ose sa 57% e detyrimit total që shtetit shqiptar ka në çështjet e arbitrazhit.

-C. A., çështje që lidhet me ndërtimin e autostradës Tiranë-Elbasan, me një faturë 39,462,217.43 euro.

-C. D., çështje e humbur me një detyrim 13,338,920.9 Euro + 350,000 USD

-G.C., çështje e humbur me një detyrim 11,317,183.7 euro.

Përsa i përket vendimeve të humbura nga RSH, vetëm një prej tyre është njohur nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, konkretisht: Çështja ICC Case no. 22676/GR me palë paditëse GBC, iniciuar prej 2017. Pala e Paditur (MIE&AKBN, Alb.)

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit vlerën 12,577,852.1 USD: si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencës Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit.

-Paditësi duhet të paguajë 60 % të Kostove Administrative dhe të Paditurit duhet të paguajnë 40 % të këtyre kostove.

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit 292,760 USD dhe 14,451.68 Euro, me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

Prej datës së njohjes deri në periudhën e auditimit (prill 2025) nuk është marrë asnjë masë nga MIE&AKBN, për njohjen e këtij detyrimi dhe planifikimin në buxhetin përkatës për shlyerjen e tij duke e vendosur shtetin shqiptar para një risku tjetër në dëm të buxhetit të shtetit atë të interesave për 4 vite, të cilat të përlllogaritura nga grupi i auditimit prej datës së vendimit 06.07.2020 deri në 31.12.2024, vlera e pritshme e interesave është: 65,871 \$ dhe 2,890.4 euro, ose e shprehur në një monedhë të vetme 60,776.15 euro, vlerë që përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit, pasi MIE rezulton të mos ketë njohur ende këtë detyrim në pasqyrat financiare të institucionit e si rrjedhojë nuk janë marrë masa për likuidimin e çështjeve të sipër përmendura, veprime në kundërshtim me *UMF nr. 8 datë 09.03.2018 i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.2.2022.*

¹⁸ Në shumën e kostove të përfaqësimit në gjykata, janë përfshirë edhe 2 çështje në të cilat pala shqiptare ka qenë fituese por ka pasur detyrim për të paguar vlerat 5,902,888 euro, paraqitur në tabelen 14, rreshti 5-6.

C. Përsa i përket çështjeve në proces apo të ndërprera, 4 (katër) çështje janë të përfunduara, 2 (dy) janë çështje të pezulluara pra pa zhvillime nga ana e palës paditëse dhe 2 (dy) janë në proces.

Efekti financiar i shpenzimeve gjyqësore, paguar nga buxhetit i shtetit si palë e paditur për këto çështje (të pezulluara, të përfunduara dhe në proces), është 1,949,063 euro.

Auditimi i efekteve financiare të ndjekjes dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të GJEDNJ, në buxhetin e shtetit:

Për efektet financiare, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

-Regjistri elektronik dhe fizik i vendimeve të formës së prerë dhe vendimeve në pritje për të dalë, pranë Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut;

-Korrespondenca e ASH me ministritë/institucionet e tjera që janë palë në gjykim;

-Çdo dokumentacion në funksion të auditimit.

-Mbikëqyrja mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë:

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ):

Shteti Shqiptar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, i ndryshuar, ka ratifikuar Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Në vijim të kësaj konvente janë ratifikuar dhe protokollat shtesë. Ndërkohë Ligji nr.10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, në nenin 9 të tij përcakton se Avokatura e Shtetit përfaqëson mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja dhe organizmave ndërkombëtarë, të cilat kryhen nëpërmjet Zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin. Detyrat e kësaj zyre, përcaktohen më hollësisht në rregulloren e brendshme të funksionimit të Avokaturës së Shtetit.

Me ndryshimet ligjore të miratuara në ligjin organik të ASH-së me ligjin nr. 86/2018, ky institucion është ngarkuar nga ligjvënësi të ndjekë dhe zbatimin e vendimeve të dhëna nga kjo gjykatë. Në nenin 19/1 të ligjit nr.10018, përcaktohet se: *Vendimet e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “GJEDNJ”), për çdo çështje ku Republika e Shqipërisë është palë, janë të detyrueshme për zbatim dhe ekzekutohen sipas procedurës së parashikuar. Konkretisht në nenet 19/1 deri 19/10 të tij përshkruhen veprimet të cilat ndërmerren nga Avokatura e Shtetit dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre vendimeve dhe afatet përkatëse.*

Me urdhrin nr.3 75 datë 20.10.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e formatit të regjistrat elektronik dhe fizik të çështjeve të arbitrazhit dhe përfaqësimit në gjykatat e huaja” ishte ngritur grupi i punës për hartimin e formateve përkatëse bazuar në nenin 9, pika 4, germa “g” dhe neni 17 i Rregullores.

Me Urdhrin nr.375/1 datë 21.10.2022 “Për miratimin e formatit të regjistrat të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrat të çështjeve në shqyrtim në GJEDNJ” kanë miratuar regjistrin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrat të çështjeve në shqyrtim në GJEDNJ.

Regjistrat elektronikë për ekzekutimin e detyrimeve të GJEDNJ, miratuar me urdhrin nr.375/1 datë 21.10.2022 nuk janë plotësuar sipas formatit të miratuar, duke mos përfshirë numrin e kërkesës së protokollit, si dhe datat përkatëse të nisjes së shkresave nga ASH për Ministrinë e Drejtësisë si dhe datat e shkresave përpara i përket dërgimit nga MD në ASH dhe MF.

Për vitin 2023, nga të dhënat e marra nga Raporti vjetor i ASH, Gjykata ka dalë me **47 vendime**, për 75 kërkesa. Në këto çështje, kërkuarit gjatë gjykimit, kanë kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerë financiare prej **2,010,199,582** (dy miliard e dhjetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e

nëntëmijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy) **Lekë**, ndërsa Gjykata ka pranuar në total një shpërblim dëmi në vlerën **29,089,814 Lekë** ose **279,170 Euro**.

Në formë tabelare çështjet pranë zyrës së përfaqësimit në GJEDNJ për vitin 2023 paraqiten si vijon:

Tabela 1

Nr.	CËSHTJET E TRAJTUARA	
1	Çështje të komunikuar nga GJEDNJ	17
2	Çështje të përfaqësuara dhe të mbrojtura	30
3	Vendime të dhënë nga GJEDNJ	47
4	Ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ	23

Burimi i të dhënave, ASH

-Gjatë vitit 2023, nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) i janë komunikuar ASH 47 kërkesa/çështje, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me shkelje të nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe të ndara sipas vendimeve të GJEDNJ, rezultojnë:

a) 26 vendime të papranuara nga këto 9 vendime të pranueshme por Gjykata nuk ka akorduar shpërblim dëmi. E thënë ndryshe këto vendime nuk kanë pasur efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit. (paraqitur në aneksin bashkëngjitur PRA).

b) Janë zgjidhur me deklaratë për zgjidhjen e çështjes me pajtim çështjet: “K. k. Shqipërisë”, datë 11.05.2023, “B. k. Shqipërisë”, datë 11.04.2023; “Rr.k. Shqipërisë, datë 21.09.2023, “Zh. k. Shqipërisë”, datë 5.10.2023, “N. C. dhe S. sh.p.k, datë 30.11.2023, C. dhe të tjerë k. Shqipërisë”, datë 5.10.2023”. Avokatura e Shtetit ka pranuar zgjidhjen me pajtim të ofruar nga GJEDNJ për zgjidhjen e çështjes me pajtim, bashkë me vlerat për shpërblimin e drejtë të propozuar po nga ajo. (paraqitur në Tabelën 1).

Zgjidhja e çështjes me pajtim, është pranuar duke konsideruar faktin se për këto çështje tashmë ka një praktikë të konsoliduar nga Gjykata, e cila e ka gjetur shtetin shqiptar në shkelje sa i takon tej zgjatjes së procedurave gjyqësore apo ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, referuar çështjeve “L. dhe të tjerë k. Shqipërisë”, kërkesa nr.64480/09, dhe “M. k. Shqipërisë”, kërkesa nr.18381/05. Gjithashtu, duke vlerësuar vlerat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile (neni 399/1 e vijues) për këto shkelje (50.000 – 100.000 lekë për çdo vit vonesë në ekzekutim) është vlerësuar pranimi i shumave të ofruara nga Gjykata.

Në tabelën 2 jepen të pasqyruara 12 Vendime të GJEDNJ, sipas numrit të kërkesës, datës së vendimit (viti 2023), pretendimit, dispozitivit me vlerat përkatëse si dhe datës së ekzekutimit.

Tabela 2: Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ, për vitin 2023 si dhe të ekzekutuara brenda vitit.

Nr.	Nr. aplikimit	Vendim	Pretendimi	Lloji	Data vendimit	Dispozitivi	Vlera/lekë	interesa	Data ekzekutimi
1	12957/15	K		civile	11.05.2023	Nxjerrë jashtë listës së çështjeve, bazuar në nenin 37/1(c) të Konventës, duke pranuar zgjidhjen e çështjes me deklaratë. Zgjidhur me marrëveshje miqësore 1,000 Euro.	104,200	0	19.07.2023
2	11167/09	B		civile	11.04.2023	Nxjerrë nga lista çështjeve në bazë të nenit 37/1, duke pranuar zgjidhjen e çështjes me deklaratë. Pranimi i	475,452		28.08.2023

						Deklaratës Unilaterale për dëmshpërblim në shumën 4,230 Euro.			
3	20702/18	S	Shpërblim i drejtë 2.317.443 Euro	civile	09.08.2023	Gjykata deklaroi të pranueshme; Konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës; sa i përket mundësisë së aksesit në Gjykatën Kushtetuese. Akordon:(i) 3,600 Euro në lidhje me dëmin jo pasuror;(ii) 2,000 Euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet	591,704	4,824	13.12.2023
4	29943/18	G DHE G	Shpërblim i drejtë 465.395 Euro	civile	04.07.2023	Pranon shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me pezullimin nga detyra të kërkesit të dytë. Akordon:(i) 4,500 Euro për dëmin jo material; (ii) 3,000 Euro për shpenzimet	820,500		22.09.2023
5	41047/19	TH	Kërkesi pretendoi 200.000 Euro për dëm jo pasuror.16.239 Euro për dëm pasuror.12.896 Euro për kosto dhe shpenzime.	civile	04.10.2023	Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6/1 të Konventës dhe akordoi 3.500 Euro si shpërblim të drejtë.	366,800		13.12.2023
6	52048/16	H.	Kërkesja pretendoi:- 13,626,777.7 lekë (116,658.49 EUR për dëmin pasuror dhe jo pasuror.- 5,500 EUR për kostot dhe shpenzimet e bëra përpara gjykatave vendase dhe GJEDNJ	penale	21.05.2023	Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 5§ 3 të Konventës. Akordoi: 4,500 Euro në lidhje me dëmin jo material; 3,500 Euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.	833,600		19.07.2023

7	63986/10	E. DHE 5 KËRKUES TË TJERË		civile	06.07.20 23	Gjykata konstaton shkelje të nenit 6/1 sa i takon tej zgjatjes së procedurave. Urdhëron ekzekutimin e vendimeve vendase dhe akordon shpërblimi dëm jo pasuror për të gjithë kërkuetit në shumën 23.800 Euro.	2,544,490	18,299	08.11.2023
8	72348/11	M.		civile	06.07.20 23	Deklaron të praneshme ankesën në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave sipas nenit 6 të Konventës. Akordon 1700 Euro Shuma akorduar për dëm jo pasuror dhe kostot dhe shpenzimet.	185,980		22.09.2023
9	48806/06	L	Shpërblim I drejtë 583.595 Euro	civile	20.06.20 23	Gjykata ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1. Akordoi 7200 EURO për të gjithë trashëgimtarët e kërkuetit për dëmin jo pasuror.	787,685		22.09.2023
10	70656/17	K	Shpërblim i drejtë 36,200 Euro	penal e	13.06.20 23	Konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës; Akordon: 3,000 Euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet.	328,206		22.09.2023
11	61445/12 dhe 53157/15	Z S	Kërkueti ka pretenduar: 195.000 EUR dëm pasuror dhe 100.000 EUR shpenzime shëndetësore. 87.000 EUR shpenzime gjyqësore.	civile	22.06.20 23	Konstaton shkelje të nenit 6/1 të Konventës dhe akordon 1.950 Euro si shpërblim dëmi jo pasuror për të dy kërkuetit.	213,330		22.09.2023
12	11254/11	H		civile	20.07.20 23	Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me zgjatjen e	64,140	409	17.11.2023

						tepërt të procesit civil dhe akordon 600 EURO për dëmin jo pasuror			
13	40662/19	S	Largimi nga detyra e prokurores dhe ndalimi i përjetshëm për të ushtruar profesionin e avokates, shkelte të drejtën e saj për respektimin e jetës private, sikurse parashikon Neni 8 i Konventës. Kërkesja pretendoi shumën 203,905 Euro si shpërblim dëmi jo pasuror dhe shpenzime gjyqësore.	Civile	13.12.2022	Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës, duke akorduar 24,600 Euro për dëmin jo pasuror dhe shpenzime gjyqësore	2,688,780	41,196	04.09.2023
14	40662/19	M	Kërkesa ka të bëjë me kohëzgjatjen dhe shkaqet për paraburgimin e kërkuarit sipas nenit 5 § 3 të Konventës. Kërkuari pretendoi shumën 169,000 euro për dëmin pasuror, jo pasuror dhe	Penale	11.07.2023	Gjykata konstatoi shkelje të nenit 5.3 të Konventës, duke akorduar 3,900 Euro për dëmin jo pasuror dhe shpenzime gjyqësore	416,910	3,427	17.11.2023
		Totali	10,485,108				10,416,942	68,166	

Burimi i të dhënave, ASH, përpunuar nga grupi i auditimit.

a) Nga përpunimi i të dhënave sipas regjistrave 2023, të ASH, rezulton se vendime të GJEDNJ, kundër Shqipërisë, të ekzekutuara për vitin 2023, rezultojnë 12, me shpërblim dëmi 10,485,108 lekë bashkë me kamatëvonesat për vonesat në likuidim. Sipas tabelës së mësipërme rezulton se 5 vendime janë në tejkalim të afatit 3 mujor, duke sjellë edhe pagesën prej **68,166 lekë interes**, në dëm të shtetit shqiptar, si dhe veprime në kundërshtim me Nenin 19/4 të Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse” ku përcakton se:

Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.

c) Në lidhje me vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë, të cilët kanë marrë formë të prerë në vitin 2023 dhe janë kryer pagesat në vitin 2024, (të pasqyruara në tabelën 5), rezultojnë të jenë 9, me një vlerë dëmshpërblimi 21,263,173 lekë nga të cilat 37,396 lekë janë interesa, për pagesa jashtë afatit 3 mujor.

Pra në total për vitin 2023, janë paguar jashtë afatit 3 mujor, 15 vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë në shkelje të nenit 19/4 të Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse”.

d) Në lidhje me vendime të hershme të GJEDNJ kundër Shqipërisë, të mbartura në vite, të paguara në vitin 2023, në një vlerë totale të dëmshpërblimit prej 4,018,746 lekë, të pasqyruara në tabelën 3, rezulton të jenë:

Tabela 3: Vendime të GJEDNJ, të ekzekutuara në vitin 2023, në tejkalim afati 2-5 vite

Nr.	Titulli	Data e vendimit përfundimtar	Data brenda së cilës duhet të paguhej detyrimi	Shpërblimi drejtë akorduar nga Gjykata në Euro	Shuma e Ekzekutuar në Lekë	Interesat në Lekë	Totali i paguar në Lekë	Data e pagesës/ Arsyja e mosekzekutimit
1	S	21.04.2021	21.07.2021	17,500	2,063,250	196,404	2,259,654	Likuiduar 26.01.2023
2	P	17.09.2019	17.12.2019	13,450	1,585,755	173,337	1.759.092	Likuiduar 26.01.2023
	Totali			30,950	3,649,005	369,741	4,018,746	

Punoi grupi i auditimit

Pra, janë 2 vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë, me një vlerë dëmshpërblimi 4,018,746 lekë, nga të cilat **369,741 lekë** janë interesa për pagesa të kryera jashtë afateve ligjore.

Gjatë vitit 2023, sipas regjistrave të ardhur nga Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe ato të Arbitrazhit ndërkombëtar, rezultoi se Gjykata ka dalë me 21 vendime, për të cilat janë ndërmarrë procedurat për ekzekutimin e tyre.

Korrespondenca e ASH me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave, për vendimet e paguara jashtë afatit 3-mujor:

1. Në lidhje me kërkesën nr. 34602/16 “S. k. Shqipërisë”:

- Me shkresën nr. 773/1, datë 10.04.2020 është njoftuar Ministria e Drejtësisë për mbajtjen në konsideratë të gjetjeve të Gjykatës për masat individuale dhe propozimin e Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ për ndjekjen e ekzekutimit të vendimit me procedurë të përshpejtuar.

- Me shkresën nr. 773/2, datë 22.04.2020 është dërguar Ministrisë së Drejtësisë për përkthim dhe publikim vendimi i GJEDNJ.

- Me shkresën nr. 773/3, datë 23.04.2020 është informuar Ministria e Drejtësisë mbi masat individuale që duhet të merren.

- Me shkresën nr. 1863/4 Prot., datë 28.05.2020 është dërguar pranë KM shkresa lidhur me ekzekutimin e masave individuale dhe ekzekutimin financiar të vendimit datë 20.01.2020 të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “S. k. Shqipërisë”, kërkesa nr.34602/16.

- Me shkresën nr. 773/5, datë 11.06.2020 është kërkuar informacion i detajuar në lidhje me masat individuale drejtuar Ministrisë së Drejtësisë mbi pyetjet e Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ.

-Me shkresën nr. 773/8, datë 03.07.2020 i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë pyetjet e Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ, lidhur me masat individuale për trajtimin e kërkuarit.

-Me shkresën nr. 18454/1, datë 09.10.2020 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka shprehur gatishmërinë për ekzekutimin e vendimit.

-Me shkresën nr. 773/16, datë 14.10.2020 drejtuar Kryeministrisë, Avokatura ka ri kërkuar marrjen e masave për miratimin e VKM për ekzekutimin e vendimit.

-Me shkresën nr. 773/19, datë 16.10.2020 Avokatura e Shtetit, në vijim të takimit me deputetët e Komisionit të Ligjeve, ka ri paraqitur pranë Kryeministrisë kërkesë për miratimin e VKM për ekzekutimin e vendimit.

2. Në lidhje me kërkesën nr. 29309/16 “P. k. Shqipërisë”.

- Me shkresën nr.3011/1, datë 29.10.2019 Avokatura e Shtetit ka përcjellë pranë KM Projekt vendimin e KM “Për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së P. k. Shqipërisë”.

- Me shkresën nr. 18454/1, datë 09.10.2020 Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka shprehur gatishmërinë për ekzekutimin e vendimit.

- Me shkresën nr.773/19, datë 16.10.2020 Avokatura e Shtetit, në vijim të takimit me deputetët e Komisionit të Ligjeve, ka riparuar pranë Kryeministritë kërkesën për miratimin e VKM për ekzekutimin e vendimit.

Përditësim për të dy vendimet e sipërcituara:

Me shkresën nr.3150 prot, datë 24.06.2022 Avokatura e Shtetit i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe ka kërkuar miratimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (1) kërkesa nr. 6858/11 “D.k. Shqipërisë”, (2) Kërkesa nr.29309/16 “P.k. Shqipërisë” dhe (3) kërkesa nr. 34602/16 “S.k. Shqipërisë”.

Në vijim, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM 172, datë 22.12.2022 për ekzekutimin e vendimit “S. k. Shqipërisë dhe VKM 860, datë 27.02.2022 për ekzekutimin e vendimit “P. k. Shqipërie”.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ekzekutuar këto dy vendime në datën 26.01.2023, në shumën totale prej 4,018,746 Lekë, nga të cilat 369,741 lekë janë interesa.

II. Për vitin 2024, sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe ato të Arbitrazhit ndërkombëtar, Gjykata ka dalë me 49 vendime, për 67 kërkesa. Në këto çështje, kërkuarit gjatë gjykimit, kanë kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerë financiare prej 5,601,036.064 (pesë miliard e gjashtëqind mijë milion e tridhjetëgjashtë mijë e gjashtëdhjetekatër) Euro¹⁹, ndërsa Gjykata ka pranuar në total një shpërblim dëmi në vlerën 212,600 Euro²⁰.

Nga Avokatura e Shtetit është arritur të shmangët një dëm financiar ndaj interesave pasurore të shtetit prej 5,600,823.009 (Pesë miliard e gjashtëqind milion e tetëqindnjëzetetë mijë) Euro.

Në formë tabelare çështjet pranë zyrës së përfaqësimit në GJEDNJ për vitin 2024 paraqiten si vijon:

Tabela 4: Tabela e çështjeve të trajtuara gjatë vitit 2024.

Nr.	ÇËSHJET E TRAJTUARA	
1	Çështje të komunikuar nga GJEDNJ	28
2	Çështje të përfaqësuara	46
3	Vendime të dhënë nga GJEDNJ (decisions and judgments)	49

Burimi: ASH përpunuar nga grupi i auditimit

Për periudhën nën auditim, (viti 2024) paraqiten 31 vendime gjyqësore të ekzekutuara si më poshtë²¹:

Tabela 5: Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ, të ekzekutuara gjatë vitit 2024.

Nr.	Vendimi	Data e vendimit	Data e ekzekutimit	Principali	Interesi	Total
1	Ekzekutim Vendimit të GJEDNJ dt. 05.10.2023, "Zh. kundër Shqipërisë", kërkesa Nr. 50783/12, 1450 euro	05.10.2023	12.01.2024	154,135	383	154,518
2	Ekzekutim i Vendimit të GJEDNJ dt. 10.10.2023, "N. kundër Shqipërisë" kërkesa 35703/17 7240 euro	10.10.2023	12.01.2024	769,612	319	769,931
3	Ekzekutim i Vendimit të GJEDNJ dt. 21.09.2023 "Rr. kundër Shqipërisë", kërkesa Nr. 52062/16, 4000 euro	21.09.2023	12.01.2024	425,200	2,010	427,210

¹⁹ Në terma konkretë, janë kërkuar gjithsej nga kërkuarit: 553.339.977 Euro; 260.488.700 Lekë; 5.122.715.430 USD dhe 180.901 Franga Zviceriane, të cilat janë konvertuar në Euro me kursin e datës 03.02.2025.

²⁰ Në këtë vlerë janë përfshirë dhe 2 vendimet më të fundit të gjykatës, që nuk janë bërë akoma përfundimtarë.

²¹ Vendimet e ekzekutuara, kanë marrë formë të prerë edhe gjatë vitit 2023, sqaruar hollësisht në tabelë.

4	Ekzekutim imuc Vendimit te GJEDNJ dt.17.11.2023, "P.V. No.2 SH. A kundër Shqipërisë", kërkesa Nr. 34649/14, 2000 euro	17.11.2023	01.02.2024	212,600	699	213,299
5	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 30.11.2023, "N. C. dhe S. shpk kundër Shqipërisë", kërkesa 18175/12 1450 euro	30.11.2023	21.02.2024	153,700	-	153,700
6	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 05.10.2023 "C. dhe te tjerë kundër Shqipërisë" kërkesa 13523/16, 7550 euro	05.10.2023	01.03.2024	801,810	7,699	809,509
7	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 30.11.2023, "A.a dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 63975/10, Nr.35321/11, Nr.6932/15 8450 euro	30.11.2023	04.03.2024	897,390	1,074	898,464
8	Ekzekutim Vendimit të GJEDNJ dt. 05.12.2023, "O. kundër Shqipërisë", kërkesa 8706/18, 4700 euro	05.12.2023	11.04.2024	488,330	3,813	492,143
9	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 07.11.2023, "D. dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 63543/09, 46714/13,12720/14 170,000 euro	07.11.2023	08.05.2024	17,323,000	21,399	17,344,399
10	Ekzekutim Vendimit te GJEDNJ dt.30.01.2024, "V.sh.p.k dhe D.E sh.p.k kundër Shqipërisë", kërkesa 18076/12, 6000 euro	30.01.2024	17.05.2024	609,600	2,510	612,110
11	Ekzekutim Vendimit te GJEDNJ dt.30.01.2024, "K. kundër Shqipërisë", kërkesa 22493/12, 2500 euro	30.01.2024	17.05.2024	254,000	1,016	255,016
12	Ekzekutim Vendimit te GJEDNJ dt.05.03.2024, "J. dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 7564/07, 5,000 euro	05.03.2024	27.05.2024	511,500	-	511,500
13	Ekzekutim Vendimit te GJEDNJ dt.22.02.2024, "V..sh.p.k kundër Shqipërisë", kërkesa 31018/09, 1,450 euro	22.02.2024	12.06.2024	149,495	722	150,217
14	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 06.06.2024, "Ç. dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 44307/21, 1200 euro	06.06.2024	02.09.2024	122,040	-	122,040
15	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 06.06.2024 "Ç.dhe te tjerë kundër Shqipërisë" kërkesa 37935/18, 3600 euro	06.06.2024	02.09.2024	366,120		366,120
16	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 06.06.2024, "P. kundër Shqipërisë", kërkesa 32893/16, 5600 euro	06.06.2024	04.09.2024	568,400		568,400
17	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 11.06.2024, "K. kundër Shqipërisë", kërkesa 59222/15, 2350 euro	11.06.2024	04.09.2024	238,424	-	238,424
18	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 04.07.2024, "K. dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 29264/16, 1000 euro	04.07.2024	17.09.2024	101,700		101,700
19	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 04.07.2024, "K. dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 37041/17, 3600 euro	04.07.2024	17.09.2024	366,120		366,120
20	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 04.07.2024, "K. dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 41365/21, 3600 euro	04.07.2024	01.10.2024	363,240		363,240
21	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 06.06.2024, "Ç. dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 1921/19, 3850 euro	06.06.2024	01.10.2024	388,465		388,465
22	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 11.06.2024, "K. kundër Shqipërisë", kërkesa 59222/15, 2350 euro	11.06.2024	01.10.2024	237,115		237,115
23	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 04.07.2024, "M. kundër Shqipërisë", kërkesa 21051/10, 2350 euro	04.07.2024	14.10.2024	236,645		236,645
24	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 04.07.2024, "M. kundër Shqipërisë", kërkesa 21051/10, 2350 euro	04.07.2024	22.10.2024	236,175		236,175
25	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 04.07.2024 "K. dhe te tjerë kundër Shqipërisë" kërkesa Nr.56999/16; Nr..37653/18 5,200 euro, Kursi këmbimi 1 euro x 99.9 leke.	04.07.2024	12.11.2024	519,480		519,480

26	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 04.07.2024, "K.. dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 42612/19, 2400 euro	04.07.2024	12.11.2024	239,760		239,760
27	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 04.07.2024, "T.kundër Shqipërisë", kërkesa 78957/11, 4700 euro	04.07.2024	12.11.2024	469,530		469,530
28	Ekzekutim i Vendimit te GJEDNJ dt. 18.07.2024, "S.dhe te tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa 79452/17, 6500 euro	18.07.2024	12.11.2024	649,350		649,350
29	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 18.07.2024, "P. kundër Shqipërisë", kërkesa 7568/08, 4700 euro	18.07.2024	12.11.2024	469,530		469,530
30	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt. 04.07.2024, "N. kundër Shqipërisë", kërkesa 52678/17, 3600 euro	04.07.2024	12.11.2024	359,640		359,640
31	Ekzekutim I Vendimit te GJEDNJ dt.07.08.2024, "B. kundër Shqipërisë", kërkesa Nr.. 24228/18, VKM Nr. 658 dt.23.10.2024. 16,700 euro	07.08.2024	26.11.2024	1,673,340	6,455	1,679,795
	Totali			30,355,446	48,099	30,403,545

Burimi: ASH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga tabela nr. 5, konstatojmë se për vitin 2024, janë ekzekutuar gjithsej 31 vendime, kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën **30,355,446 lekë dhe në vlerë totale 30,403,545 lekë nga të cilat 48,009 lekë** janë interes i paguar ndaj gjyqfituesve nga shteti shqiptar për vonesa në kryerjen e pagesës.

Referuar ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar, Neni 19/4 "Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse" përcakton se:

Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.

Gjithashtu pika 3 e nenit 19/5 përcakton se, "Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afateve kohore, të parashikuara në nenin 19/4, të këtij ligji, mbi masën e detyrimeve përkatëse financiare paguhet interesi, sipas përcaktimeve në vendimin e GJEDNJ-së".

Sipas tabelës së mësipërme rezulton se 12 vendime janë në tejkalim të afatit 3 mujor, duke sjellë edhe pagesën prej 48,009 lekë, interes, në dëm të shtetit shqiptar.

Sa i përket vendimeve gjyqësore të kësaj gjykate ende të pa ekzekutuara deri më 31.12.2024, sipas të dhënave të paraqitura nga Avokatura e Shtetit, situata paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela .6: Përmbledhje e vendimeve të pa ekzekutuara gjatë vitit 2024

Nr	Vendim	Pretendimi	Lloji	Data e vendimit	Dispozitivi	Vlera/euro	Data e ekzekutimit
1	I	Kërkuesi ka kërkuar shpërblim dëmi jo pasuror në shumën 100,000 Euro. Gjithashtu kërkuesi ka pretenduar 21,000 Euro si shpenzime gjyqësore.	Civile	05.03.2024	Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të kohëzgjatjes së procedurave; Gjykata akordoi:	10,800	Në proces ekzekutimi. Praktika është përcjellë pranë KM.
2	Z	Kërkuesi pretendoi: -Në lidhje me dëmshpërblimin jo pasuror kërkuesi pretendon 250,000 Euro.	Civile	11.06.2024	Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit 1 dhe ka akorduar:	60,000	Fletore zyrtare Nr.120 date 15.07.2024

3	M	Kërkuesit kanë kërkuar një shpërblim dëmi pasuror në vlerën e 13.058.547 Lekë, shpërblim dëmi jo pasuror në shumën 30,000 Euro dhe kosto dhe shpenzime gjyqësore në shumën 3,000 Euro.	Civile	12.12.2024	Gjykata ka konstatuar shkelje të Nenit 6 të KEDNJ për shkak të mosekzekutimit të vendimit. Gjykata ka akorduar 5.200 Euro, bashkërisht për aplikantët.	5,200	27.03.2025
4	N	Ankuesi pretendon shkelje të nenit 6/1 të Konventës. Kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë për shpërblim të drejtë	Civile	05.09.2024	Gjykata nxjerr çështjen nga lista duke pranuar deklaratën për zgjidhje me pajtim, në bazë të nenit 37/1/c.	3,600	21.01.2025
5	R	Kërkuesit kanë pretenduar shumën 1.970.000 Euro si shpërblim dëmi pasuror dhe 205.630 Euro si shpërblim dëmi jo pasuror dhe shpenzime gjyqësore.	Civile	10.12.2024	Gjykata ka konstatuar shkelje të Nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ. Gjykata ka akorduar 10.400 Euro, për kërkuesin. Për dëmin pasuror Gjykata do shprehet në një kohë të dytë, pasi vendimi të marrë formë të prerë.	10,400	Nuk është bërë ende përfundimtar. Është ankimuar në Dhomën e Madhe
6	G	Kërkuesit kanë pretenduar shumën 14,115 Euro si shpërblim dëmi jo pasuror dhe shpenzime gjyqësore.	Civile	17.12.2024	Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6/1 të Konventës, duke akorduar 7,100 Euro për dëmin jo pasuror dhe shpenzime gjyqësore	7,100	Në proces/ Është bërë përfundimtar 17.3.2025
	Totali					97,100 euro	

Burimi: ASH përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më sipër konstatojmë se kanë mbetur ende të pa ekzekutuar **3** vendime ku **2** prej tyre datojnë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, dhe **1** vendim është i datës 17.12.2024, ekzekutuar në 17.03.2025.

Pra **2** vendime të pa ekzekutuara ende, (me një dëmshpërblim prej 70,800 euro) janë jashtë afatit 3-mujor nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë, duke shtuar riskun në rritjen e efekteve negative që japin në pagesën e interesave, veprime në kundërshtim me pikën 3 e nenit 19/5 të ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, Ndërkohë janë ekzekutuar brenda tremujorit të parë 2025, **3** vendime, që kanë marrë formë të prerë në datat respektive 12.12.2024 & 05.09.2024 & 17.12.2024, kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën 15,900 euro, çështje të cilat janë zgjidhur me pajtim mes palëve. Dy prej tyre, janë vendime të ekzekutuara jashtë afatit 3-mujor, përkatësisht:

1. M. k. Shqipërisë, data e vendimit 12.12.2024, data e shlyerjes 27.03.2025, (data e shlyerjes është jashtë afatit 3-mujor, 12.03.2025, pra 15 ditë me vonesë.
2. N. Shpk k. Shqipërisë, data e vendimit 05.09.2024, data e shlyerjes 21.01.2025, (data e shlyerjes është jashtë afatit 3-mujor, 05.12.2024 pra 46 ditë me vonesë).

Sipas ASH, për këto vendime nuk ka pasur interesa në ekzekutim.

Gjatë vitit 2024, nga përpunimi i të dhënave, në regjistrat e ASH, rezulton të jenë marrë **6** vendime, për nxjerrjen e çështjeve nga lista e shqyrtimit, duke qenë se Gjykata ka pranuar

zgjdhjen me pajtim të nënshkruar nga palët ose deklaratën Unilaterale të Qeverisë. Konkretisht:

- “P. k. Shqipërisë”, datë 16.05.2024,
- “Ç. dhe të tjerë k. Shqipërisë”, datë 16.05.2024,
- “K. dhe të tjerët k. Shqipërisë, datë 13.06.2024,
- “K. dhe të tjerët k. Shqipërisë”, datë 13.06.2024,
- “N. dhe të tjerët k. Shqipërisë” datë 13.06.2024, “N.k. Shqipërisë”, datë 11.07.2024,
- “D. k. Shqipërisë”, datë 03.10.2024,
- “S. k. Shqipërisë” datë 03.10.2024.²²

Të gjitha çështjet, të cilat janë zgjidhur me pajtim kanë paraqitur problematika të ngjashme, që kanë të bëjë me tej zgjatjen e procedurave gjyqësore vendase, gjatë proceseve gjyqësore ose mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në shkëlqje të Nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

- Gjatë vitit 2024, Gjykata ka dalë me 23 vendime papranueshmërie/nxjerrje të çështjeve jashtë liste/ose vendime që nuk ka konstatuar shkelje, vendime të cilat kanë shmangur jo vetëm dëmin financiar, por kanë vendosur dhe një praktikë të re për problematika të caktuara.

III. Në lidhje me vendimet të GJEDNJ, të mbartura në vite (3 prej tyre prej periudhës 2015-2018) me një vlerë të konsiderueshme në buxhetin e shtetit , sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 7, rezultojnë:

Janë 6 vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë, të pa shlyera ende, në vlerë totale: 17,968,650 euro, ku korrespondenca shkresore ndërmjet ASH-MD-MF-KM paraqitet si më poshtë:

Tabela 7: Vendime të GJEDNJ, të mbartura ne vite dhe të pa ekzekutuara.

Nr.	Titulli	Data e vendimit përfundimtar	Data brenda së cilës duhet të paguhej detyrimi	Shpërblim i drejtë akorduar nga Gjykata në Euro	Shuma e Ekzekutuar në Lek	Interesat në Lek	Totali i paguar në Lek	Data e pagesës/ Arsyeja e mosekzekutimit
1.	D. k. Shqipërisë	14.09.2015	14.12.2015	15,600				Në proces për miratimin e VKM, dërguar praktika në KM.
2.	Dh. N. k. Shqipërisë (vendimi R.)	17.03.2016	17.06.2016	4,417,750				Ka dalë VKM për ekzekutim. Kërkuesit janë në proces gjyqësor vendas
3.	Sh. k. Shqipërisë	28.05.2018	28.05.2018	13,447,300				Mungesë fondesh në Buxhetin e Shtetit.
4.	I. srl K. Shqipërisë	05.03.2024	05.06.2024	10,800				Fletore Zyrtare Nr.57 date 04.04.2024
5.	Z. k. Shqipërisë	11.06.2024	11.09.2024	60,000				Fletore zyrtare, Nr.120 date 15.07.2024
6.	M. & S. F.Br. N. k. Shqipërisë	16.10.2024	16.01.2025	17,200				Fletore zyrtare, Nr.191 data e publikimit 12.11.2024
Totali				17,968,650				

Burimi i të dhënave, ASH, punoi grupi i auditimit

²² Shprehur në vlera në tabelën nr.2.

Sipas dokumentacionit të paraqitur nga ASH në lidhje me korrespondencën e ASH me MD dhe MF, pas marrjes së vendimit përfundimtar të GJEDNJ, në lidhje me subjektet e paraqitur në tabelën 7, si dhe në zbatim të nenit 19/2 Fillimi i procedurave të ekzekutimit, pika 1,2,3,4,5:

1. Me marrjen dijeni mbi vendimin e formës së prerë, Avokatura e Shtetit, brenda 10 ditëve pune, përcjell vendimin përkatës për përkthim dhe certifikim pranë Ministrisë së Drejtësisë.
2. Ministria e Drejtësisë, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 1, të këtij neni, dërgon vendimin e përkthyer dhe të certifikuar për publikim në Qendrën e Botimeve Zyrtare, si dhe pranë Avokaturës së Shtetit, me qëllim ndjekjen e procedurave të mëtejshme të ekzekutimit të vendimit të GJEDNJ-së.
3. Një kopje e vendimit origjinal dhe një kopje e përkthyer dhe e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë dërgohet nga Avokatura e Shtetit pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe pranë institucioneve të tjera, për efekt të zbatimit të njehsuar të praktikës gjyqësore.
4. Brenda 5 ditëve pune nga dërgimi i vendimit të përkthyer nga Ministria e Drejtësisë, sipas pikës 2, të këtij neni, Avokatura e Shtetit paraqet kërkesën pranë Kryeministrit për propozimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, e cila duhet të përmbajë: a) institucionet që ngarkohen me ekzekutimin e vendimit, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë; b) llojin e masës që buron nga vendimi i GJEDNJ-së, apo masa të tjera të përshtatshme që duhet të ndërmerren nga autoritetet vendase, në rastet kur vendimi i GJEDNJ-së nuk përcakton në mënyrë të shprehur masat konkrete që duhet të merren nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të shkeljeve të konstatuara; c) mënyrën dhe afatet e ekzekutimit të saj; ç) sanksionet në rast të mosekzekutimit.
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave miratohet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 4 të këtij neni, paraqitet kjo situatë dhe praktikë pune nga ASH:

1. Për kërkesën nr. 6858/11 “D. k. Shqipërisë”, vendimi përfundimtar mban datën 14.09.2015.

- Me shkresën Nr.192/13 prot., datë 18.09.2015, Avokatura e Shtetit ka dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë, kërkesën për përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, Relacionin dhe Projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për ekzekutimin e Vendimit të GJEDNJ-së “D. kundër Shqipërisë”, datë 14.09.2015.

-Me shkresën nr.773/19, datë 16.10.2020, Avokatura e Shtetit, në vijim të takimit me deputetët e Komisionit të Ligjeve, ka riparaqitur pranë Kryeministrit kërkesën për marrjen e masave për miratimin e VKM për ekzekutimin e vendimit.

-Me shkresën nr.3150 prot, datë 24.06.2022, Avokatura e Shtetit i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe ka kërkuar miratimin e Vendimeve të Këshillit të Ministrave për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (1) kërkesa nr. 6858/11 “D.k. Shqipërisë”, (2) Kërkesa nr.29309/16 “P. k. Shqipërisë” dhe (3) kërkesa nr. 34602/16 “S. k. Shqipërisë” dhe ende sot nuk ka një miratim të VKM-ve respektive në kundërshtim me nenin 19/2, pika 5, që citon se:

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave miratohet brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 4 të këtij neni.

Në këtë korrespondencë nuk rezulton asnjë shkresë e ardhur nga MD si dhe respektimi i afatit nga kjo e fundit në zbatim të nenit 19/2, pika 2.

2. Për kërkesën me nr. 10613/16 “Sh. dhe të tjerë k. Shqipërisë”, vendimi përfundimtar i GJEDNJ mban datën 28.05.2018 dhe pagesa duhet të kryhej brenda datës 28.08.2018.

-Me shkresën nr.151/3, datë 14.06.2018, ASH i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë, materialet lidhur me ekzekutimin e masave individuale, përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin financiar të vendimit.

- Me shkresën nr. 151/6, datë 31.08.2018, ASH i ka dërguar Ministrisë së Financave dokumentet e përfituesve dërguar nga përfaqësuesi i tyre me shkresën datë 01.08.2018.
- Me shkresën nr.6852/9, datë 26.10.2018, Ministria e Drejtësisë ka dërguar në ASH, bashkëlidhur komunikimin e Ministrisë së Financave lidhur me sugjerimin për të negociuar me përfituesit për pagesën me këste sipas mundësive të buxhetit.
- Me shkresën nr.151/12, datë 13.11.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Avokatura ka shprehur dakordësinë që të negociohet me përfituesin, duke propozuar që të bëhet me grup negocimi, me anëtarë nga MD, MFE dhe ASH.
- Me shkresën nr. 6852/11, datë 07.12.2018, Ministria e Drejtësisë, në përgjigje të shkresës nr.151/12, të ASH, është shprehur lidhur me negocimin.
- Me shkresën nr. 564, datë 10.05.2019, Avokatura ka paraqitur pranë Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, Planin e Veprimit mbi masat individuale dhe të përgjithshme.
- Me shkresën nr. 15671/1, datë 10.07.2019, ASH i ka dërguar Kryeministrisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, komunikimin e Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, lidhur me ankesën e paraqitur nga përfaqësuesi i kërkuesve, ku ndër të tjera nuk bien dakord me shlyerjen e pagesës me këste.
- Me shkresën nr. 15783/1, datë 27.09.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë vlerëson dhe sugjeron negocimin juridik me përfituesit, për shkak të vlerës së madhe të detyrimit.
- Vendim i Këshillit Konsultativ për çështjet e GJEDNJ nr. 9, datë 26.12.2019 - vendosi shtyrjen e diskutimit për marrjen e masave individuale për çështjen Sh., pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme.
- Me shkresën nr. 1795/1, datë 22.06.2020, ASH ka dërguar në Kryeministri dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, komunikimin e Departamentit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ, lidhur me një ankesë të paraqitur nga përfaqësuesi i kërkuesve pranë Komitetit të Ministrave të KIE.
- Me shkresën nr. 1795/7 prot., datë 05.02.2021, Avokatura e Shtetit i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shkresën e Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së, me të cilën vihet në vëmendje çështja e ekzekutimit të masave individuale për rastin “Sh. dhe të tjerë k. Shqipërisë”.
- Me shkresën 2554/1, datë 10.02.2021, Ministria e Financave informon se ka marrë të gjitha masat për ekzekutimin e vkm 1015/2013 të ndryshuar, si dhe thekson nevojën e skedulimit të shumës për ekzekutimin e vendimit “Sh.”, duke qenë se nuk mund të përballohet nga Buxheti i Shtetit.
- Me shkresën nr.655prot, datë 15.2.2022, Avokatura e Shtetit i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shkresën e Departamentit të Ekzekutimit të Vendimeve të GJEDNJ-së, me të cilën vihet në vëmendje çështja e ekzekutimit të masave individuale për rastin “Sh. dhe të tjerë k. Shqipërisë”.
- Me shkresën nr. 2978/2 datë 4.5.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të planifikimit buxhetor ka kërkuar listën e plotë (*duke iu referuar konkretisht vendimit Sh.*) të të gjitha vendimeve të GJEDNJ-së në pritje të ekzekutimit dhe shumat e tyre përkatëse të shpërblimit të drejtë. Në datën 6 maj 2022, Avokatura e Shtetit i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë listën e vendimeve dhe vlerën financiare përkatëse, duke përfshirë edhe vendimin Sh. kundër Shqipërisë.
- Me shkresën nr. 2978/2 datë 4.5.2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të planifikimit buxhetor ka kërkuar listën e plotë (*duke iu referuar konkretisht vendimit SH*) të të gjitha vendimeve të GJEDNJ-së në pritje të ekzekutimit dhe shumat e tyre përkatëse të shpërblimit të drejtë. Në datën 6 maj 2022, Avokatura e Shtetit i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë listën e vendimeve dhe vlerën financiare përkatëse, duke përfshirë edhe vendimin Sh. kundër Shqipërisë.

Me shkresën nr.2073 datë 14.4.2023, Avokatura e Shtetit i ka dërguar një relacion për ekzekutimin e vendimit “SH dhe të tjerë k. Shqipërisë” pranë Kryeministrisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Me shkresën 7106/1 datë 4.5.2023, Ministria e Financave informon ASH, se ka marrë të gjitha masat për ekzekutimin e VKM 015/2013 të ndryshuar, si dhe thekson faturën e madhe financiare që implikon ky vendim dhe nevojën e skedulimit të shumës për ekzekutimin e vendimit “SH”, duke qenë se nuk mund të përballohet nga Buxheti i Shtetit

-Me shkresën nr.6739 datë 29.12.2023, Avokatura e Shtetit i ka dërguar një relacion për ekzekutimin e vendimit “SH dhe të tjerë k. Shqipërisë” pranë Kryeministrisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

-Me shkresën nr.6757, datë 7.11.2024, Avokatura e Shtetit i ka dërguar një relacion për ekzekutimin e vendimit “SH dhe të tjerë k. Shqipërisë” pranë Kryeministrisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu edhe në zbatim të udhëzimeve “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023, 2024”, Avokatura e Shtetit ka përcjellë pranë Ministrisë së Financave regjistrin e përditësuar së bashku me vlerat financiare të vendimeve të GJEDNJ, ku përfshihen dhe vendimet e pa ekzekutuara, si SH dhe të tjerë kundër Shqipërisë, D. k. Shqipërisë. “DH.N k Shqipërisë.

Megjithëse kjo çështje është ndër më të rëndësishmet për Shqipërinë në Strasburg, me një detyrim financiar prej **13,3 mln euro**, duke e renditur të parën në listën e dëmshpërblimeve, ende s’ka marrë zgjidhje duke e ngarkuar shtetin shqiptar me kosto shtesë pra me kamatë vonesa mbi këtë vlerë.

3. Për kërkesën me nr. 48522/10 “Dh dhe N k. Shqipërisë”, pjesë e vendimit “R dhe të tjerë k. Shqipërisë”, përfundimtar në datën 17.03.2016 dhe afat për pagesën e dëmshpërblimit brenda datës 17.06.2016.

Me shkresën nr. 22882/1, datë 17.01.2019, dërguar në ASH, Ministria e Financave dhe Ekonomisë shprehet se vazhdimi i procedurave të ekzekutimit lidhur me aplikimin nr. 48522/10 “Dh dhe N a k. Shqipërisë”, do të bëhet pas qartësimit të situatës ligjore nga të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor vendas.

- Me shkresën nr. 384/1, datë 03.04.2019, Avokatura në përgjigje të shkresës nr. 22882/1 ka kërkuar nga MFE kopje të dokumentacionit të parashtruar, që ka pezulluar ekzekutimin.

- Me shkresën nr. 9249, datë 17.05.2019, MFE ka përcjellë informacion mbi vendimet gjyqësore vendase lidhur me aplikimin nr. 48522/10 “Dh . N k. Shqipërisë”.

- Me shkresën nr. 18539/4, datë 31.05.2019, MFE ka përcjellë vendimet gjyqësore.

- Me shkresën nr. 384/4, datë 25.06.2019 ka paraqitur kërkesë për informacion në ASH, z. A. Dh.

- Me shkresën nr. 384/6, datë 30.08.2019, Avokatura ka informuar MFE dhe për dijeni Kryeministrinë, në vijim të vendimeve të përcjella, ku sugjeron kalimin në llogari të bllokuar deri në përfundim të gjykimit të mosmarrëveshjes.

- Me shkresën nr.15783/1, datë 27.09.2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë shpreh gatishmërinë për zbatimin e vendimit, pas qartësimit të situatës ligjore nga të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor vendas.

Në datën **12 gusht 2021**, për shkak të zhvillimeve që kanë ndodhur në juridiksionin e brendshëm, në lidhje me çështjen “Dh. N k. Shqipërisë”, Avokatura e Shtetit ka paraqitur kërkesë për rishikimin e vendimit “DH. N k. Shqipërisë”.

Në datën **10.11.2022**, Avokatura e Shtetit ka paraqitur disa komente shtesë pranë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sa i takon kërkesës për rishikimin e këtij vendimi. Gjykata nuk ka dalë akoma me vendim.

Në lidhje me vendimet përfundimtare të GJEDNJ të dala gjatë vitit 2024 e të pa ekzekutuara ende, me vlera mbi 10,000 euro:

4. Për kërkesën me nr. 31011/09 “I. s.r.l k. Shqipërisë”, me vendim përfundimtar të GJEDNJ, datë 05.03.2024 dhe afat për pagesën e dëmshpërblimit brenda datës 05.06.2024.

ASH ka dërguar në MD shkresën me nr. Prot , datë Nr.1279/1, dt.12/03/2024, për materialet lidhur me ekzekutimin e masave individuale, përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin financiar të vendimit.

-Me shkresën nr. nr.1229/3, dt.02.04.2024, MD i ka dërguar materialet përkatëse lidhur me vendimin. Gjithashtu, ASH në vijim, duke qenë se shpërblimi i i drejtë i akorduar nga Gjykata, ka qenë mbi 10.000 Euro, me shkresën nr. 1279/4, datë **05.04.2024**, bazuar në nenin 19/2, të ligjit “Për Avokaturën e Shtetit” ka bërë kërkesë për ekzekutimin e këtij vendimi pranë Kryeministrisë, duke dërguar bashkëlidhur dhe projekt VKM “Për Ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 05.03.2024 për çështjen “I S.R.L kundër Shqipërisë”, kërkesa nr.31011/09” dhe Relacionin Përkatës.

Edhe pse ka kaluar një vit ende nuk është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave, në kundërshtim me nenin 19/2 i Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Fillimi i procedurave të ekzekutimit”, pika 5, ku citohet se:

*4. Brenda 5 ditëve pune nga dërgimi i vendimit të përkthyer nga Ministria e Drejtësisë, sipas pikës 2, të këtij neni, Avokatura e Shtetit **paraqet kërkesën pranë Kryeministrit për propozimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave, në lidhje me ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, e cila duhet të përmbajë: a) institucionet që ngarkohen me ekzekutimin e vendimit, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë; b) llojin e masës që buron nga vendimi i GJEDNJ-së, apo masa të tjera të përshtatshme që duhet të ndërmerren nga autoritetet vendase, në rastet kur vendimi i GJEDNJ-së nuk përcakton në mënyrë të shprehur masat konkrete që duhet të merren nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të shkeljeve të konstatuara; c) mënyrën dhe afatet e ekzekutimit të saj; ç) sanksionet në rast të mosekzekutimit.***

*5. Vendimi i Këshillit të Ministrave **miratohet brenda 30 ditëve** pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, sipas pikës 4 të këtij neni.*

5. Për kërkesën me nr. 33164/11 “Z. k. Shqipërisë”, me vendim përfundimtar të GJEDNJ, datë 11.06.2024 dhe afat për pagesën e shpërblimit të drejtë në vlerën 60.000 euro brenda datës 11.12.2024.

ASH ka dërguar në MD shkresën me nr. prot, datë nr.3014/2 dt.18.06.2024, për materialet lidhur me ekzekutimin e masave individuale, përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin financiar të vendimit.

Me shkresën nr. 3014/3, datë 11/07/2024, MD i ka dërguar materialet përkatëse lidhur me vendimin, si dhe me shkresën nr.3014/6, dt.20/09/2024, ASH ka dërguar kërkesën për ekzekutimin e këtij vendimi, së bashku me projekt VKM “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 11.06.2024, për çështjen “Z. kundër Shqipërisë” për kërkesën nr.33164/11” dhe Relacionin e projekt VKM duke kërkuar ekzekutimin e këtij vendimi në MF/KM.

Edhe pse kanë kaluar 6 muaj nga data e dërgimit të shkresës nga ASH në Kryeministri, për ekzekutimin e këtij vendimi, së bashku me projekt VKM “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 11.06.2024, për çështjen “Z. kundër Shqipërisë” për kërkesën nr.33164/11”, ende nuk është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave, në kundërshtim me nenin 19/2 i Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Fillimi i procedurave të ekzekutimit”, pika 5.

6. Për kërkesën me nr. 41373/21 dhe 48801/21 “M. dhe S. family B. N.V k. Shqipërisë”, vendim përfundimtar datë 16.10.2024 dhe afat për pagesën e dëmshpërblimit brenda datës 16.01.2025.

ASH ka dërguar në MD, shkresën me nr. 841/2 Prot.22/10/2024, për materialet lidhur me ekzekutimin e masave individuale, përkthimin, publikimin dhe ekzekutimin financiar të vendimit.

Me shkresën nr. 3841/5 prot., dt. 25.11.2024, duke qenë se vlera e shpërblimit të drejtë e akorduar nga Gjykata për këtë vendim është mbi 10.000 Euro, bazuar në nenin 19/2 të Ligjit për Avokaturën e Shtetit, është dërguar nga ASH pranë Kryeministrit kërkesa për ekzekutimin e këtij vendimi, së bashku me projekt VKM “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.07.2024 për çështjen “M.S.F.B.N.V. kundër Shqipërisë” dhe Relacionin përkatës për ekzekutimin e saj.

Edhe pse kanë kaluar 6 muaj nga data e dërgimit të shkresës nga ASH në Kryeministri, për ekzekutimin e këtij vendimi, së bashku me projekt VKM “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.07.2024 për çështjen “M.S.F.B.N.V. kundër Shqipërisë” dhe relacionin përkatës për ekzekutimin e saj”, ende nuk është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave, në kundërshtim me nenin 19/2 i Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Fillimi i procedurave të ekzekutimit”, pika 5.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti janë paraqitur observacionet me shkresën nr. 508/17 prot, datë 22.08.2025, administruar pranë KLSH me nr.164/5 prot, datë 25.08.2025, ku janë shprehur objeksionet në lidhje me rekomandimet e lëna, si më poshtë:

Në lidhje me Rekomandimin 1.1: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për ndjekjen e procedurave dhe njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të vendimeve të arbitrazhit (çështjet 1. ICC Case nr. 22676/GR dhe 2. ICC Case No. 20564/EMT/GR) në pasqyrat financiare dhe të iniciohen veprimet për ekzekutimin dhe arkëtimin e vlerave monetare në shumën 7,105,903 euro, duke bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit për të raportuar të dhënat në kohë reale në Ministrinë e Financave.

ASH pretendon:

1. Vendimi i Arbitrazhit – ICC Case Nr. 22676/GR – GBC MIE, AKBN dhe Alb

Edhe pse vendimi i mësipërm është njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 49, datë 04.05.2021, me kërkesë të degës së shoqërisë së huaj T. A. Ltd, pala paditëse nuk ka vijuar me procedurat e ekzekutimit në Shqipëri.

Ndërkohë, për ekzekutimin e këtij vendimi në Belgjikë, një palë e tretë – O. B. Limited ka iniciuar një proces gjyqësor duke pretenduar se G.B.C. i është nënshtruar një procesi likuidimi pranë gjykatës së Ishujve Cayman dhe se të gjitha të drejtat, interesat dhe përfitimet që burojnë nga vendimi i arbitrazhit i janë transferuar O.B. Limited.

Në këtë proces në Belgjikë, pala shqiptare ka paraqitur kundërshtime ndaj kërkesës për ekzekutim, duke sfiduar vlefshmërinë e marrëveshjes së transferimit dhe duke ngritur ndërkohë pretendimet e saj kundër O.B., mbi bazën e faktit që GBC Oil, nëpërmjet degës së saj T. A. Ltd, është debitore ndaj Al.sh.a. Këto detyrime burojnë nga marrëveshjet hidrokarbure dhe janë konfirmuar me urdhra ekzekutimi të gjykatave shqiptare në shumën: 18,786,507.616 USD dhe 94,245,125 ALL.

2. Vendimi i Arbitrazhit – ICC Case Nr. 20564/EMT/GR

Për këtë vendim, informacion më të detajuar mbi procedurat e ekzekutimit në Shqipëri mund të jepet nga MIE. Megjithatë, duke marrë parasysh që bëhet fjalë për një kompani të huaj që nuk ka asete të njohura në territorin e Shqipërisë, ekzekutimi në praktikë paraqet vështirësi të mëdha.

Sidoqoftë, pala shqiptare ka paraqitur në procesin gjyqësor të ekzekutimit të vendimit “H. 15/28” në Belgjikë kërkesën për ekzekutimin e vendimit ICC Case Nr. 20564/EMT/GR, në favor të palës shqiptare me kompensim pasi të dyja çështjet lidhen me të njëjtat palë.

Në lidhje me Rekomandimin 1.2: MTM/Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa për ndjekjen e procedurave dhe njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të vendimeve të arbitrazhit (ICSID ARB/14/26, (iniciuar nga viti 2014) “A.A.” sh.p.k., A. N., shoqëria “C.” s.r.l, me nr. 969, datë 25.11.2024) në pasqyrat financiare dhe të iniciohen veprimet për ekzekutimin dhe arkëtimin e vlerave monetare në shumën 3,269,938.71 euro, duke bashkëpunuar periodikisht me Avokaturën e Shtetit për të raportuar të dhënat në kohë reale në Ministrinë e Financave.

ASH, sqaron se: Sikur citohet dhe në draft raport, për çështjen ICSID ARB/14/26, (iniciuar nga viti 2014) “A. A.” sh.p.k., A. N., shoqëria “C.” s.r.l, vendimi rezultoi i njohur nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 969, datë 25.11.2024. Ky vendim është përcjellë nga MTM me shkresën nr. 3294 prot., datë 25.04.2025 (protokolluar në ASH me shkresën nr. 2726 prot., datë 28.04.2025). MTM i është drejtuar Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, duke vënë në dijeni ASH. Tashmë është detyrë e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror që të marrë masat për ekzekutimin duke njoftuar në vijim MTM për rezultatin/ekzekutimin.

Në lidhje me Rekomandimin 2.1: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të marrin masa për zbatimin e menjëhershëm të vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit të njohur nga Gjykata e Apelit me vendim nr. 49 datë 04.05.2021, në vlerën 12,577,852.1 USD, si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencës së Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit, me njohjen e këtij detyrimi në pasqyrat financiare të MIE. *Shih më sipër komentin për Rekomandimin në pikën 1.1*

Në lidhje me Rekomandimin 2.2: Avokatura e Shtetit për çështjet e humbura në arbitrazhin ndërkombëtar dhe gjykatat e huaja, të cilat kanë penalizuar taksapaguesit shqiptarë me një barrë të lartë financiare, të analizojë dosjet gjyqësore dhe të informojë Këshillin e Ministrave për të gjitha shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive, MIE, MTM, APD, ALB., AKBN, etj., të cilat duhen adresuar, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse dhe evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive në të ardhmen.

ASH thekson se: Avokatura e Shtetit në çdo rast pas daljes së vendimit të arbitrazhit i dërgon institucionit përkatës dhe Këshillit të Ministrave një kopje të vendimit dhe një analizë të vendimmarrjes nga ana e Tribunalit të Arbitrazhit. Megjithatë, të gjitha çështjet e arbitrazhit janë tejet komplekse me një ndërthurje të së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtës së brendshme. Në disa raste kanë të bëjnë me kontrata me një afat 35 vjeçar zbatimi i të cilave ka zgjatur në disa dekada dhe përfshin një sërë institucionesh qendrore dhe vendore. Ndërveprimi i gjatë ndërinstitutional e vështirëson individualizimin e përgjegjësive. Në rast se gjatë procesit të arbitrazhit apo dhe pas daljes së vendimit, do të evidentohet ndonjë shkelje e bërë nga persona përgjegjës, për Avokaturën e Shtetit është detyrë ligjore të komunikojë menjëherë me institucionin dhe Këshillin e Ministrave, e nëse është rasti të bëjë dhe kallëzimet përkatëse në Prokurori.

Në lidhje me Rekomandimin 2.3: Avokatura e Shtetit, të marrë masat e nevojshme duke informuar Këshillin e Ministrave, për të eliminuar kostot me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 60,776 euro të krijuara si pasojë e mos ekzekutimit të vendimit të formës prerë nr. 49 datë 04.05.2021, dhe në bashkëpunim me MIE të nxjerrë përgjegjësitë ligjore për çdo mosveprim të punonjësve.

Shih komentin në Rekomandimin 1.1.

Në lidhje me Rekomandimin 3.1: Avokatura e Shtetit të marrë masat e nevojshme për të njohur dhe reaguar në kohë në rastet kur gjyqëfituesit e vendimeve të gjykatave të huaja/arbitrazhit ndërkombëtar kërkojnë zbatimin e vendimit në vende ku Shteti Shqiptar gëzon të drejta, duke

analizuar në çdo rast përdorimin e mjetit ligjor më efektiv për mbrojtjen sa më të plotë dhe cilësor të interesit të vendit.

Avokatura e Shtetit në çdo rast kur palët gjyqëfituese iniciojnë një proces ekzekutimi në një juridiksion të huaj, njofton institucionet lidhur me procesin duke i kërkuar të verifikojnë nëse shteti shqiptar ka asete financiare në atë juridiksion. Avokatura e Shtetit merr masat për të siguruar përfaqësimin në këto procese gjyqësore. Ky është një proces që ndiqet në vazhdimësi nga Avokatura.

Në lidhje me Rekomandimin 4.1: Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të Buxhetit të Shtetit, në vlerën 893,053 lekë, interesa për pagesa të vendimeve të GJEDNJ, *jashtë afatit 3-mujor, për periudhën 2023-2024. Komentet e Avokaturës së Shtetit:* Lutemi që sipas komenteve tona të rishikohet shuma në total e kamatë pagesave.

Pas rakordimit me Ministrinë e Financave për vitin 2023 në total, penaliteti për ekzekutimin me vonesë, sikurse e kemi sqaruar edhe më lart është 68,868 lekë nga buxheti i vitit 2023 dhe 47,397 lekë nga buxheti i vitit 2024. Pra, në total penalitetet për këto dy vite arrijnë në shumën 116,265 lekë.

Sa i përket vendimeve të mbartura që ju citoni: Në çështjen “P. kundër Sh.”, penaliteti ka qenë 222,679 lekë dhe në çështjen “S. kundër Shqipërisë”, penaliteti ka qenë 249,286 lekë;

Të dyja këto vendime janë likuiduar në datë 26.01.2023, por me fondet e buxhetit të vitit 2022. Edhe duke i mbledhur të gjitha penalitetet së bashku (2022-2024), shuma nuk arrin në vlerën prej 845,044 lekë, jo më vetëm për vitin 2023.

Sa i përket rekomandimit për ngritjen e një grupi pune në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ, për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës për pagesat me vonesë të vendimeve të GJEDNJ-së, sqarojmë se përcaktimi i përgjegjësive për përdorimin joefikas të fondeve buxhetore nuk është pjesë e kompetencave të Këshillit Konsultativ. Ky i fundit, sic e kemi sqaruar dhe më lart ushtron vetëm rol këshillimor pranë Avokaturës së Shtetit, kryesisht për masa të përgjithshme ligjore dhe administrative, sipas nenit 19/7 të ligjit “Për Avokaturën e Shtetit”.

Sa i takon Avokaturës së Shtetit, ajo ka përmbushur detyrimet e saj ligjore sipas nenit 19 të ligjit “Për Avokaturën e Shtetit”, duke informuar institucionet përgjegjëse për afatet dhe pasojat e moszekutimit financiar të vendimeve të GJEDNJ-së.

Theksojmë gjithashtu se vonesat e konstatuara në pagesën e ekzekutimit shpesh nuk lidhen me neglizhencën e personave përgjegjës në institucionet e linjës, por kryesisht me problematika praktike si: vështirësitë në kontaktimin e përfituesve apo mosdorëzimi në kohë i dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e pagesës. Për të adresuar këto problematika, siç rezultoi edhe nga vlerësimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me Ministrinë e Financave ka ndërmarrë veprimet e nevojshme për respektimin e afateve procedurale të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, duke ndërmarrë edhe veprime proaktive, si kontaktimi i drejtpërdrejtë i kërkuarve dhe përcjellja e të dhënave të tyre pranë Ministrisë së Financave, me qëllim lehtësimin e kontaktimit dhe përshpejtimin e procedurës së pagesës – ndonëse, sipas procedurës, kontaktimi i tyre duhet të bëhet nga vetë kërkuarët.

Duke iu referuar të dhënave sipas Ministrisë së Financave për vitin 2023–2024 janë shmangur vonesat në pagesa, ndërsa shumata e kamatë-pagesave kanë qenë minimale. Avokatura e Shtetit do të përcjellë gjetjet e KLSH-së pranë të gjitha institucioneve të përfshira, duke kërkuar marrjen e masave të menjëhershme dhe të përshtatshme në kompetencat e tyre, në mënyrë që të garantohet respektimi i afateve ligjore dhe shmangia e çdo kostoje shtesë për buxhetin e shtetit.

5.1. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, për 3 çështjet kryesore “SH and others v. Albania”, “Dh. dhe N. vs. Albania” dhe “D. k. Shqipërisë” (17,880,650 euro), me vendime të formës përfundimtare të GJEDNJ-së për më shumë se 7 vite, të cilat kanë penalizuar taksapaguesit shqiptarë me një barrë mjaft të lartë financiare, (pa përfshirë këtu interesat për vonesa në likuidim) të ri analizojë dosjet gjyqësore dhe vendimet e GJEDNJ dhe të informojë Këshillin e Ministrave për të gjitha shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë përkatëse dhe evitimin e veprimeve të padrejta dhe/ose abuzive.

Komentet e Avokaturës së Shtetit. Në lidhje me procesin e ekzekutimit të këtyre tre vendimeve, na lejoni së pari, të ritheksojmë se, për të tre këto vendime Avokatura e Shtetit ka inicuar procesin e ekzekutimit të tyre.

- Për vendimin “R. kundër Shqipërisë”, kërkesa “DH.N kundër Shqipërisë”, është nxjerrë VKM-ja e ekzekutimit nr. 613, datë 31.08.2016. Ekzekutimi nuk është kryer për shkak të konflikteve midis kërkuarit dhe palëve të treta që pretendojnë 2/3 e shpërblimit të drejtë. Avokatura e Shtetit, me qëllim sigurimin e ekzekutimit të vendimit, i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me kërkesë për rishikim vendimi, duke qenë se këto fakte kanë rezultuar pas daljes së vendimit të GJEDNJ-së Kjo kërkesë është bërë sipas orientimeve të Departamentit të Ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së pranë Komitetit të Ministrave. Gjithashtu, sic dhe ju përmendni, për mosekzekutimin e këtij vendimi kanë qenë të vendosura masa sigurimi nga gjykatat vendase, të cilat urdhëronin Ministrinë e Financave të mos kalonte shumë e caktuar nga GJEDNJ në favor të kërkuarit A. Dh. Duke u bazuar sa më sipër, Avokatura ka ndërmarrë të gjitha masat në kompetencë të saj dhe nuk mund të ndërmarrë veprime të tjera pa një vendimmarrje të Gjykatës Evropiane.

- Për vendimet e mbartura në vite, Avokatura e Shtetit ka vepruar në përputhje me kompetencat ligjore: ka inicuar procesin e ekzekutimit për të gjithë këto vendime, duke bërë kërkesat për ekzekutimin e tyre, ka dhënë orientimet e nevojshme, ka informuar institucionet kompetente, duke përcaktuar afatet dhe pasojat e mosekzekutimit, si dhe i është drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose gjykatave vendase, me qëllimin e vetëm mbrojtjen e interesit pasuror të shtetit shqiptar.

6.2. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit bashkë me Këshillin Konsultativ për çështjet e GJEDNJ-së, për 3 çështjet “I srl k. Shqipërisë”, “Z. k. Shqipërisë” dhe “M. & S. F. B. NV k. Shqipërisë” (88,000 euro), me vendime të formës përfundimtare të GJEDNJ-së të dala gjatë vitit 2024, të marrë masa dhe t’i kërkojë Këshillit të Ministrave miratimin e VKM përkatëse, për ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së si dhe shmangien e penaliteteve në vonesa

Komentet e Avokaturës së Shtetit: Avokatura e Shtetit i ka iniciuar procedurat e ekzekutimit për të treja këto vendime dhe është e angazhuar të ndjekë procesin e ekzekutimit të tyre.

7.1. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit në rolin e njësisë përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ por dhe të përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për ekzekutimin e vendimeve, të ri informojë Këshillin e Ministrave për vendimet ende të paekzekutuara, si edhe vlerën e interesave financiarë të llogaritur për moszbatimin në afat të tyre, të cilat e ekspozojnë në vijimësi buxhetin e shtetit me vlera të konsiderueshme financiare.

Komentet e Avokaturës së Shtetit: Avokatura e Shtetit ka raportuar në lidhje me procesin e ekzekutimit të këtyre vendimeve në vijimësi të gjitha organet e angazhuara për zbatimin e tyre, duke përfshirë Këshillin e Ministrave. Në vecanti, cdo vit dërgohet një analizë e detajuar e procesit të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së si pranë Këshillit të Ministrave ashtu dhe në Komisionin e Ligjeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me objeksionet tuaja sipas rekomandimeve qëndrimi i grupit të auditimit mbetet i pandryshuar për argumente të spjegjuara nga ana jonë si

në procesin e auditimit në terren ashtu edhe në korespondencat e vazhdueshme shkresore midis nesh. Njëkohësisht funksioni i punës tonë është auditimi i menaxhimit të fondeve publike me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet nga institucionet përgjegjëse që në rastin konkret janë cituar (MIE, APD, MTM etj.) në PRA dhe rrjedhimisht edhe në raport por pa lënë mënjanë për çdo rast punën e kryer sipas dispozitave ligjore nga Avokatura e Shtetit.

Përsa i përket vlerës totale të kamatëvonesave për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ Observacioni juaj pranohet dhe është reflektuar edhe në material. E riparë sipas tabelave 2,3 dhe 5 në faqet respektive 47,50 kjo vlerë është $68,166+48,009+369,741=485,916$ lekë.

Konkluzion: Në lidhje me ndjekjen dhe ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga Zyra e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe ato të Arbitrazhit ndërkombëtar në ASH, për periudhën 2023-2024, rezultoi se:

*Gjatë **vitet 2023**, GJEDNJ shqyrtoi 47 çështje që lidhen me Shqipërinë, për 75 kërkesa. Në këto çështje, kërkuesit kërkuan shpërblime financiare prej rreth 2 miliard lekë, ndërsa Gjykata pranoi shpërblime në vlerën e 29 milion lekë, ose 279 mijë euro. Në 18 vendime u konstatuan shkelje nga ana e shtetit shqiptar, ndërsa në 16 vendime kërkesat u shpallën të papranueshme. ASH ka zhvendosur qasjen drejt zgjidhjes me pajtim të çështjeve që lidhen me tejzgjatjen e proceseve gjyqësore.

a) Nga përpunimi i të dhënave sipas regjistrave elektronikë, të ASH, rezulton se vendime të GJEDNJ, kundër Shqipërisë, të cilat kanë marrë formën përfundimtare gjatë viti 2023, janë 23, nga të cilët janë ekzekutuar 14 me një vlerë dëmshpërblimi *10,416,942 lekë dhe 68,166 lekë interesa për 5 vendime të likuiduara jashtë afatit 3-mujor*, në dëm të shtetit shqiptar, si dhe veprime në kundërshtim me Nenin 19/4 të Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse” ku përcakton se: *Vendimet e GJEDNJ-së që kanë vendosur kompensimin e drejtë, ekzekutohen nga institucionet përkatëse, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, brenda 3 muajve nga momenti kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.*

b) Në lidhje me vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë, të cilët kanë marrë formë të prerë në vitin 2023 dhe janë kryer pagesat në vitin 2024, rezultojnë të jenë 9, me një vlerë dëmshpërblimi *21,263,173 lekë nga të cilat 37,396 lekë janë interesa*, për pagesa jashtë afatit 3 mujor.

c) Në lidhje me 2 vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë, të cilët kanë marrë formë të prerë në periudhën 2019-2021, me një vlerë totale dëmshpërblimi 4,018,746 lekë, **369,741 lekë** janë interesa për pagesa të kryera jashtë afateve ligjore.

Pra në total për periudhën 2023-2024, janë paguar jashtë afatit 3 mujor, 19 vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë në shkelje të nenit 19/4 të Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse”, të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 485,916 lekë.

*Gjatë vitit 2024, GJEDNJ ka dalë me 49 vendime, për 67 kërkesa. Në këto çështje, kërkuesit gjatë gjykimit, kanë kërkuar shpërblimin e dëmit në vlerë financiare prej 5,601,036.064 (pesë miliard e gjashtëqind e një milion e tridhjetë e gjashtëmijë e gjashtëdhjetë e katër) Euro²³, ndërsa Gjykata ka pranuar në total një shpërblim dëmi në vlerën 212,600 Euro²⁴.

Shteti shqiptar për periudhën, janar- dhjetor 2024, ka ekzekutuar gjithsej 31 vendime, kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën 30,355,446 lekë dhe në vlerë totale 30,403,545 lekë nga të cilat 48,009 lekë, janë interes i paguar ndaj gjyqe fituesve, për vonesa në kryerjen e pagesës, veprime në kundërshtim me Neni 19/4 “Afatet e ekzekutimit nga

²³ Në terma konkretë, janë kërkuar gjithsej nga kërkuesit: 553.339.977 Euro; 260.488.700 Lekë; 5.122.715.430 USD dhe 180.901 Franga Zviceriane, të cilat janë konvertuar në Euro me kursin e datës 03.02.2025.

²⁴ Në këtë vlerë janë përfshirë dhe 2 vendimet më të fundit të gjykatës, që nuk janë bërë akoma përfundimtarë.

institucionet përgjegjëse” të ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar.

Nga 31 vendime të ekzekutuara, 9 prej tyre janë të mbartura nga viti 2023 (sqsaruar më sipër). Sa i përket vendimeve gjyqësore të GJEDNJ, të cilat kanë marrë formë të prerë gjatë vitit 2024, por ende të pa ekzekutuara deri më 31.12.2024, rezultojnë të jenë 6 me nje vlerë dëmshpërblimi 97,100 euro.

Sa më sipër konstatojmë se kanë mbetur ende të pa ekzekutuar 3 (tre) vendime, ku 2 prej tyre (I dhe Z. k. Shqipërisë-) datojnë në gjashtëmuorin e parë të vitit 2024, dhe 1 (një) vendim është i datës 17.12.2024, i cili rezulton i likuiduar gjatë tremujorit të parë 2025. (17.03.2023)

Ndërkohë janë ekzekutuar brenda tremujorit të parë 2025, 3 vendime që kanë marrë formë të prerë në datat respektive 12.12.2024 & 05.09.2024 & 17.12.2024, kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën 15,900 euro, çështje të cilat janë zgjidhur me pajtim mes palëve. Dy prej tyre, janë vendime të ekzekutuara jashtë afatit 3-mujor, përkatësisht:

-M. k. Shqipërisë, data e vendimit 12.12.2024, data e shlyerjes 27.03.2025, (data e shlyerjes është jashtë afatit 3-mujor, 12.03.2025, pra 15 ditë me vonesë.

-N. Shpk k. Shqipërisë, data e vendimit 05.09.2024, data e shlyerjes 21.01.2025, (data e shlyerjes është jashtë afatit 3-mujor, 05.12.2024 pra 46 ditë me vonesë).

-G. k. Shqipërisë, data e vendimit 17.12.2024, ekzekutimi i vendimit është kryer në afat 17.03.2024, por i përket vitit 2025 si kosto financiare.

Për këto vendime nuk ka pasur interesa në ekzekutim.

- Gjatë vitit 2024, Gjykata ka dalë me 23 vendime papranueshmërie/nxjerrje të çështjeve jashtë liste/ose vendime që nuk ka konstatuar shkëlje, vendime të cilat kanë shmangur jo vetëm dëmin financiar, por kanë vendosur dhe një praktikë të re për problematika të caktuara.

*ASH në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse (MD-MF-KM) nuk ka arritur ende të zgjidhë dhe të ekzekutojë vendimet e GJEDNJ në 6 çështje kundër Shqipërisë, të cilat kanë një vlerë dëmshpërblimi 17,968,650 euro, ku vetëm çështja SH përbën 75 % të këtij detyrimi (rreth 13.3 mln euro) me një vendim të datës 28.05.2018. Ndërkohë renditen edhe çështjet e tjera:

- ✓ Çështja D. k. Shqipërisë me vlerë 15,600 euro (dt. 14.09.2015/Vendimi).
- ✓ Çështja “Dh. dhe N. k. Shqipërisë”, me vlerë 4,417,750 euro (dt. 17.03.2016/Vendimi).
- ✓ Çështja I srl K. Shqipërisë me vlerë 10,800 euro, (dt. 05.03.2024/Vendimi).
- ✓ Çështja Z. k. Shqipërisë me vlerë 60,000 euro (dt. 11.06.2024/Vendimi).
- ✓ Çështja M. & S. F.. B.s NV k. Shqipërisë me vlerë 17,200 euro (dt.16.10.2024/Vendimi).

Tre nga këto çështje datojnë me një vendim përfundimtar të GJEDNJ për më shumë se 7 vite, (2015-2018) të pa ekzekutuara ende, çka sjell një efekt negativ të shtuar në buxhetin e shtetit lidhur me kamatëvonesat që do të aplikohen mbi këto vlera. Moszbatimi i Vendimeve të GJEDNJ, nga shteti shqiptar, bie ndesh me nenin 46 të KEDNJ (detyrimi për zbatim), ku përcaktohet se: *Palët kontraktuese angazhohen të respektojnë vendimet përfundimtare të gjykatës në çdo çështje në të cilën ato janë palë. Shqipëria si shtet palë, ka detyrimin ligjor ndërkombëtar kushtetues të ekzekutojë vendimet e GJEDNJ-së brenda një afati të arsyeshëm.*

Gjithashtu këto veprime janë në kundërshtim me nenin 122(2) të Kushtetutës së Shqipërisë ku: “Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara përbëjnë pjesë të sistemit juridik të brendshëm pas botimit në fletoren zyrtare të RSH”

Moszbatimi i vendimeve të GJEDNJ-së bie ndesh me këtë dispozitë, pasi vendimi konsiderohet i zbatueshëm dhe detyruar në mënyrë të drejtpërdrejtë në Shqipëri.

*Në lidhje me 3 vendimet e GJEDNJ, të cilat kanë marrë formë përfundimtare në vitin 2024 dhe konkretisht:

- i. Kërkesa me nr. 31011/09 “I. s.r.l k. Shqipërisë”, me vendim përfundimtar të GJEDNJ, datë 05.03.2024 dhe afat për pagesën e shpërblimit të drejtë brenda datës 05.06.2024;
- ii. Kërkesa nr. 33164/11 “Z. k. Shqipërisë”, me vendim përfundimtar të GJEDNJ, datë 11.06.2024 dhe afat për pagesën e shpërblimit të drejtë në vlerën 60.000 euro brenda datës 11.12.2024;
- iii. Kërkesa me nr. 41373/21 dhe 48801/21 “M.S.F.B.N.V k. Shqipërisë”, vendim përfundimtar datë 16.10.2024 dhe afat për pagesën e dëmshpërblimit brenda datës 16.01.2025.

Edhe pse ASH ka kryer praktikat sipas nenit 19/2 të Ligjit për Avokaturën e Shtetit, duke dërguar pranë Kryeministritë kërkesat për ekzekutimin e këtyre vendimeve, së bashku me projekt VKM përkatëse, *Vendimi i Këshillit të Ministrave që duhet të miratohej brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, nuk është miratuar duke dalë përtej afateve (përmbi 5 muaj) në kundërshtim me nenin 19/2 të Ligjit/10018, i ndryshuar për ASH, pika 5.*

U konstatua se Ministria e Financave në deklaratimet e saj si në raportet vjetorë 2023&2024, ashtu edhe në evidencat e borxhit, nuk paraqet dhe nuk ka llogaritur në asnjë moment, *vlerën e interesave mbi shumat e përcaktuara në vendimet e GJEDNJ-së apo të arbitrazhit ndërkombëtar kundër Shqipërisë edhe pse janë në tejkalim të afateve të përcaktuara e rrjedhimisht as Avokatura e Shtetit nuk e disponon këtë informacion.*

Grupi i auditimit nuk mund të dalë në një vlerë të saktë mbi vlerën e interesave të pritshëm për t’u paguar dhe që janë dëm në buxhetin e shtetit, veçanërisht për vendimet e GJEDNJ-së, ku afatet janë të mirë përcaktuara dhe ka ende vendime të cilat kanë më shumë se 5 vjet jashtë afateve për ekzekutim.

Këto interesa që do të llogariten mbi dëmshpërblimin 17,968,650 euro (vlerat e vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së, ende të pa ekzekutuara) do të gjenerojnë dëm në buxhetin e shtetit.

Mosveprimi ose veprimet me vonesë nga ana e institucioneve respektive (MF/KM) në këto çështje krijojnë risk të lartë për efekte të tjera shtesë në dëm të buxhetit të shtetit, çka kërkon vëmendje të shtuar në vijim nga ana e ASH-së si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre vendimeve por veçanërisht *nga MF/KM*, të cilët kanë vepruar në mospërputhje me qëndrimet ligjore të njëjstive të specializuara siç është Avokatura e Shtetit dhe Këshilli Konsultativ për çështjet e GJEDNJ pranë saj.

2.2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

-Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.

-Realizimi i planit të buxhetit.

Lidhur me zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit sipas ligjeve dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të viteve 2023 -2024, si edhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Rregullorja e brendshme e Avokaturës së Shtetit.

-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit.

- Dokumentacioni i PBA-ve, miratuar gjatë periudhës objekt auditimi.
- Buxheti i miratuar dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit
- Realizimi i shpenzimeve krahasuar me planifikimet.
- Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

A. Projekt Buxheti

-Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2023 - 2025**, në mbështetje të nr. Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, Avokatura e Shtetit ka dërguar në Ministrinë e Financave shkresën nr. 925/3 prot, datë 29.04.2022 me objekt “Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

-Kërkesa buxhetore sipas **PBA 2024 - 2026**, në mbështetje të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit 97/2023 “Për Buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, Avokatura e Shtetit ka dërguar në Ministrinë e Financave shkresën nr. 6672, datë 22.12.2023 me objekt “Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.
Planifikimi i fondeve sipas PBA 2024-2026 në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Kërkesa buxhetore sipas PBA:

(në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2023-2025	Kërkesa PBA 2024-2026
-Paga	171,000	280,000
-Sigurime shoqërore & shëndetësore	28,000	37,000
-Shërbime	19,400	19,000
Shp. Operative (A)	218,000	337,000
-Investime	39,000	8,000
Shpenzime kapitale (B)	39,000	8,000
II. Total shpenzime (A)+(B)	258,000	345,000
Numri punonjësve	107	107

Burimi: nga transferta e pakushtëzuar sektoriale

Parashikimi i shpenzimeve “**për mallra dhe shërbime**” është zë i rëndësishëm në funksionimin e këtij institucioni dhe përfshin:

-zërin “materiale dhe shërbime të përgjithshme” ku parashikohen shpenzime për kancelari, materiale pastrimi, blerje dokumentacioni, blerje detergjentë, etj. Shërbime speciale janë parashikuar blerje tonera materiale te ndryshme, hidraulike, vegla pune, e aksesorë. Po kështu përfshihen parashikimet për blerje uniforma.

-zërin “shërbime” për shërbimet që realizohen nga të tretët si energji elektrike, shpenzim për ngrohje, posta, telefon, etj.

-zërin “shpenzime transporti” janë parashikuar shpenzime për blerje karburanti për mjetet e transportit, pjesë këmbimi të mjeteve të transportit, siguracione të mjeteve të transportit

-zërin udhëtimi janë parashikuar shpenzimet për dieta brenda dhe jashtë vendit.

-zërin shërbime të sigurimit dhe ruajtjes janë parashikuar për ruajtjen me roje private të godinës së Avokaturës së Shtetit përkatësisht me 2 vendroje 16&24 orësh, kjo për të minimizuar riskun e sigurisë së godinës ku punohet 8 orë në 5 ditë të javës.

-zërin “shpenzime për mirëmbajtje janë parashikuar mirëmbajtjet e mjeteve të transportit, mirëmbajtje ndërtese, mirëmbajtje e pajisjeve teknologjike, pajisjeve të zyrave, etj.
-Zërin për “shpenzime detyrime dhe kompensime”, janë parashikuar shpenzime gjyqësore.
-Shpenzime “të tjera operative” janë parashikuar shpenzimet për pagesën e taksave vendore, honorare për bashkëpunëtor të jashtëm, (këshilltarë të jashtëm, ekspert të përkohshëm, etj)
-Zërin “të tjera materiale dhe shërbime” është vendosur për të parashikuar shpenzime të ndryshme maksiemergjence (përmbytje, tërmete, pandemi, etj)
Parashikimi i “*shpenzimeve kapitale*”, parashikon shpenzimet që do të kryhen për krijimin ose blerjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, të cilat parashikojnë realizimin për blerje orëndi zyre, blerje pajisje kompjuterike.

Burimi i të ardhurave për funksionimin e institucionit është buxheti i shtetit. Gjatë hartimit të projekt buxhetit kërkesa buxhetore në PBA 2023-2025 krahasuar me PBA 2024-2026, është rritur në shumën 87,000 mijë lekë.

-Për hartimin e kërkesave buxhetore nga institucioni duhen ndjekur disa hapa për të siguruar që fondet e kërkuara janë të justifikuar dhe të bazuara në nevojat reale të institucionit, si:

1. Analiza e situatës financiare, duke analizuar buxhetin aktual si edhe shpenzimet e realizuara deri tani si edhe identifikimin e fushave në të cilat ka mungesë fondesh/mbifinancime.
2. Vlerësimin e nevojave për vitin e ardhshëm, ku çdo sektor/departament paraqet nevojat për burime financiare, njerëzore dhe materiale si edhe projektet e reja/shërbimet që do të zbatohen.
3. Hartimi i planit të shpenzimeve në të cilin përfshihen pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet operative, mirëmbajtje, trajnime, etj, duke përcaktuar koston për secilën kategori.
4. Përgatitja e dokumentacionit zyrtar, i cili përmban objektivat e institucionit, argumentimin e kërkesave, parashikimin sipas zërave dhe tabela krahasuese me vitet e kaluara.
5. Dorëzimi kërkesës në Ministrinë e Financave referuar afateve kohore të përcaktuara
6. Ndjekja dhe ndryshimet e kërkesës buxhetore sipas udhëzimeve.

-Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2023-2025 dhe PBA 2024-2026, nuk janë diskutuar/trajtuar dhe analizuar në mbledhjet e ekipit të manaxhimit të programit si përgjegjës për realizimin e detyrave teknike si edhe përgatitjen e kërkesave buxhetore, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 2.5.

-Strukturat drejtuese dhe përgjegjëse të Avokaturës së Shtetit për hartimin e buxhetit nuk kanë analizuar rezultatet e vitit paraardhës si edhe analizën e shpenzimeve dhe përcaktimin e koston për secilën kategori.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar konkretisht nga zj. Sh. Sh.a, është paraqitur observacion me shkresën nr.508/17 prot, datë 22.08.2025, administruar pranë KLSH me nr.164/5 prot, datë 25.08.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Në lidhje me pikën 2.2 në Projektraport: Për përgatitjen e PBA-së 2023–2025 dhe 2024–2026, është konstatuar se kërkesat buxhetore nuk janë trajtuar në mbledhjet e ekipit të menaxhimit. Në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023–2025 dhe PBA 2024-2026, Avokatura e Shtetit ka ngritur grupe pune të posaçme dhe ka zhvilluar takime pune me drejtuesit e zyrave vendore për identifikimin dhe diskutimin e nevojave prioritare. Bashkëlidhur gjenden: Urdhri nr. 117, datë 31.03.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”; Urdhri nr. 185, datë 07.04.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura sqarojmë se, urdhrat nuk janë vënë në dispozicion gjatë periudhës së auditimit por observacioni merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në Raportin e Auditimit sa i takon urdhrave por jo analizës së buxhetit.

B. Zbatimi i kritereve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.

Viti 2023

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur në ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” UMF nr. 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”.

Buxheti i vitit 2023 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2023-2025

(në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2023-2025	Plani fillestar	Plani rishikuar	Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Plani Fillestar	Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Kërkesë Buxhetore
Shpenzime (A)+(B)	258,100	223,720	287,700	+63,980	+29,600
Paga	171,000	173,500	234,500	+61,000	+63,500
Sigurime	28,000	28,500	31,500	+3000	+3,500
Operative	19,400	18,920	18,920	-	(480)
Transferta	-	800	780	(20)	+780
Total Shp. Operative (A)	218,400	221,720	285,700	+ 63,980	+67,300
Investime	39,700	2,000	2,000		
Shpenzime kapitale Total (B)	39,700	2,000	2,000	-	(37,700)
Numri punonjësve total	107	107	107		
-Me kontratë të përhershme	101	101	101		
-Me kohë të pjesshme	6	6	6		

Me shkresën nr. 925/3, datë 29.04.2022 “Programi buxhetor afatmesëm 2023-2025”, Avokatura e Shtetit ka dërguar kërkesat për buxhetin e vitit 2023.

Pra, rezulton se alokimi i fondeve në planin vjetor në fillim të vitit 2023 është 258,100 mijë dhe plani në fund të vitit 2023 është 287,700 mijë lekë me një shtesë prej 29,600 mijë lekë.

Realizimi i buxhetit për Vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit rezulton si më poshtë:

Art .600 (Paga) 224,779 mijë lekë - realizuar në masën 96%

Art .601 (Sigurime shoqërore 30,017 mijë lekë - realizuar në masën 95%

Art. 602(Shpenzime operative) 16,349 mijë lekë - realizuar në masën 86%

Art. 606 (Transferta) 185 mijë lekë - realizuar në masën 24%

Art. 231 (Shpenzime kapitale) 1,901 mijë lekë - realizuar në masën 95%

Buxheti i akorduar nga Ministria e Financave për vitin 2023 në shumën 287,700 mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë. Plani në vlerën 287,700 mijë lekë dhe Fakti 273,230 mijë lekë, realizuar në masën 95%.

Viti 2024

Detajimi i limitit mujor të fondeve të njësisë shpenzuese është bërë mbështetur në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, UMF nr. 2,

datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, Ligjit 97/2023 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024” UMF nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”. Me shkresën nr. 2467 datë 10.05.2023 “Programi buxhetor afatmesëm 2024-2026, Faza Teknike”, Avokatura e Shtetit ka dërguar kërkesat për buxhetin e vitit 2024. Buxheti i vitit 2024 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2024-2026

(në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2024-2026	Plani fillestar 2024	Plani rishikuar 2024	Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Plani Fillestar	Ndryshimi (Plani Rishikuar/ Kërkesë Buxhetore
Shpenzime (A)+(B)	344,654	335,914	328,214	(7,700)	(16,440)
Paga	280,493	279,625	271,625	(8,000)	(8,868)
Sigurime	36,871	34,889	34,889	-	(1,982)
Operative	19,400	19,400	19,050	(350)	(350)
Transferta			650	650	
Total Shp. Operative (A)	336,764	333,914	326,214	(7,700)	(10,550)
Investime	7,890	2,000	2,000		
Shpenzime kapitale Total (B)	7,890	2,000	2,000		(5,890)
Numri punonjësve total	107	107	107		
-Me kontrate të përhershme	101	101	101		
-Me kohë të pjesshme	6	6	6		

Burimi: Avokatura e Shtetit

Buxheti i akorduar nga Ministria e Financave për vitin 2024 është në shumën 335,914 mijë lekë, me shtesat dhe pakësimet përgjatë vitit 2024 të përshkruara më sipër plani buxhetit është 328,214 mijë lekë e cila rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive të shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë, pra shpenzimet faktike 290,003 mijë lekë, plani realizuar në nivelin 88%.

Pra, rezulton se alokimi i fondeve në planin vjetor në fillim të vitit 2024 është 335,914 mijë lekë dhe plani në fund të vitit 2024 është 328, 214 me një ndryshim në shtesë prej 7,700 mijë lekë.

Ndërsa realizimi i buxhetit për Vitin 2024 i rakorduar me Degën e Thesarit rezulton si më poshtë:

Art. 600 (Paga) 243, 293 mijë lekë - realizuar në masën 90%

Art. 601 (Sigurime shoqërore 30,352 mijë lekë - realizuar në masën 87%

Art. 602(Shpenzime operative) 14,628 mijë lekë - realizuar në masën 77%

C. Realizimi i planit të buxhetit.

Viti 2023

Realizimi i buxhetit të Avokaturës së Shtetit për vitin 2023, krahasuar me kërkesat e vitit 2023, të përcjella nga institucioni sipas dokumentit të PBA 2023-2025, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2023

(në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2023-2025	Plani fillestar 2023	Plani rishikuar 2023	Realizmi 2023	Realizmi %	
Shpenzime (A)+(B)	258,100	334,462	241,695	232,995	96%	
Shp.Operative (A)	Paga	171,000	173,500	234,500	224,779	96%
	Sigurime	28,000	28,500	31,500	30,017	95%

	Shërbime	19,400	18,920	18,920	16,349	86%
	Transferta		780	780	185	24%
Total (A)		218,400	221,700	285,700	271,330	95%
Shpenzime kapitale (B)	Investime	39,700	2,000	2,000	1,900	95%
Total (B)		39,700	2,000	2,000	1,900	95%

Burimi: transferta e pakushtëzuar sektoriale

Në total për vitin 2023, ku sipas PBA 2023-2025, nga Avokatura e Shtetit janë kërkuar 258,100 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 334,462 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar 241,695 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve nga institucioni rezulton në vlerën 232,995 mijë lekë, ose realizuar në masën 96 %.

Shpenzimet operative janë kërkuar 19,400 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 18,920 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar realizuar 86 % në shumën 16,349 mijë lekë.

Për vitin 2023 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga 82%, e buxhetit të shpenzimeve operative, shpenzimet për sigurime shoqërore 11% dhe shpenzimet për shërbime zënë 7% të shpenzimeve operative të vitit buxhetor.

Buxheti i akorduar nga Ministria e Financave për vitin 2023 në shumën 241,695 mijë lekë rakordon me situacionet mujore/progresive të shpenzimeve dhe evidencën mujore/progresive shpenzimeve të firmosur nga Dega e Thesarit Tiranë Fakti 232,995 mijë lekë.

Viti 2024

Realizimi i buxhetit të Avokaturës së Shtetit për vitin 2024, krahasuar me kërkesat e vitit 2024, të përcjella nga institucioni, alokimit fillestar të buxhetit dhe atij të ndryshuar paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i buxhetit të vitit 2024

(në mijë lekë)

Emërtimi	Kërkesa PBA 2024-2026	Plani fillestar	Plani rishikuar Nëntor 2024	Realizmi 2024	Realizmi 2024(%)	
II Shpenzime (A)+(B)	344,654	335,914	328,214	290,003	88%	
Shp. Operative (A)	Paga	280,493	279,625	243,294	90%	
	Sigurime	36,871	34,889	30,352	87%	
	Shërbime	19,400	19,400	14,629	77%	
	Transferta			650	286	44%
Total (A)	336,764	333,914	326,214	288,560	88%	
Shpenzime kapitale (B)	Investime	7,890	2,000	2,000	1,443	72%
Total (B)		7,890	2,000	2,000	1,443	72%

Burimi: transferta e pakushtëzuar sektoriale

Sipas PBA 2024 - 2026 të Avokaturës së Shtetit, për vitin 2024 në total janë kërkuar 344,654 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 335,914 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar përfundimtar janë alokuar 328,214 mijë lekë. Realizimi shpenzimeve buxhetore në vlerën 290,003 mijë lekë, ose me një përqindje realizimi prej 88%.

Për **shpenzimet operative**, ku sipas PBA 2024-2026 janë kërkuar 19,400 mijë lekë, nga të cilat fillimisht janë alokuar 19,400 mijë lekë dhe sipas buxhetit të rishikuar 19,050 mijë lekë. Për vitin 2024 struktura e shpenzimeve përbëhet nga shpenzime për paga 82%, shpenzimet për sigurime shoqërore 11% dhe shpenzimet për shërbime që zënë 7% të shpenzimeve korrente të vitit buxhetor.

Zbatimi i buxhetit për shpenzimet:

Rakordimi shpenzimeve me Degën e Thesarit është bërë mujor dhe progresiv deri në dhjetor të vitit kalendarik.

Për vitet 2023 dhe 2024, bazuar në situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë llogaritë 600, 601, 602, 606 dhe 231 paraqiten:

Situacionet e shpenzimeve sipas artikujve buxhetore

(në mijë lekë)

Artikulli	Emërtimi	2023		2024		% Realizimi 2023	% Realizimi 2024
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
600	Shpenzime paga	234,500	224,779	271,625	243,294	96%	90%
601	Kont. sig. shoq dhe shend	31,500	30,017	34,889	30,352	95%	87%
602	Shpenzime operative	18,920	16,349	19,050	14,629	86%	77%
606	Transferta	780	185	650	286	24%	44%
231	Shpenzime kapitale	2,000	1,900	2,000	1,442	95%	72%
Total		287,700	273,300	328,214	290,003	95%	88%

Referuar realizimit të buxhetit për vitet 2023-2024, konstatohet mosrealizim i zërit “Shpenzime për paga” në masën 90% për vitin 2024 dhe 6% krahasuar me vitin 2023.

Zëri “Sigurime shoqërore shëndetësore” në masën 87 % për vitin 2024 dhe 8% krahasuar me vitin 2023.

Zëri “Shpenzime operative” në masën 77 % për vitin 2024 dhe 9 % krahasuar me vitin 2023.

Zëri “Shpenzime kapitale” në masën 72 % për vitin 2024 dhe 23 % krahasuar me vitin 2023.

Zëri “Transferta” në masën 44 % për vitin 2024 dhe 20 % krahasuar me vitin 2023.

Realizimi i buxhetit për vitin 2024 është në masën 88% ose 7% më i ulët se realizimi i vitit 2023.

Avokatura e Shtetit ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe realizimi prej 72 % i buxhetit të saj është si rezultat i planifikimit të paargumentuar të kërkesave.

Nuk janë kërkuar fonde për investime në sisteme kompjuterike financiare dhe për funksionin e punës që kryen Avokatura e Shtetit.

Monitorimi

Referuar udhëzimit nr.9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” përcaktohet se: “Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, nivelin e performancës gjatë realizimit të objektivave dhe trajtimin e risqeve të lidhura me to, të evidentuara gjatë takimeve periodike midis manaxherëve dhe raporteve të monitorimit, parashtrihen nga Nëpunësi Autorizues në mbledhjet periodike të GMS të kryesuar nga Titullari i njësisë së përgjithshme, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e masave konkrete për përmirësimin e procesit dhe minimizimin e risqeve duke përcaktuar edhe drejtuesin përgjegjës për menaxhimin e tyre”.

Raportet e monitorimit duhet të përfshijnë informacion mbi arritjet në terma sasiorë dhe në vlerë të produkteve të realizuara, të identifikojnë mosarritjet dhe të shpjegojnë shkaqet e tyre duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës.

Raport monitorimi për 4 - mujin e vitit 2023 dërguar Ministrisë së Financave me shkresën nr.2630, datë 19.05.2023.

Raport monitorimi për 8 - mujin e vitit 2023 dërguar Ministrisë së Financave me shkresën nr.474, datë 20.09.2023.

Raport monitorimi për vitin 2023 dërguar Ministrisë së Financave me shkresën nr. 1206, datë 04.03.2024.

Raport monitorimi për vitin 2024 dërguar Ministrisë së Financave me shkresën nr. 1049, datë 13.02.2025.

Raport monitorimi	4- mujor	8-mujor	12-mujor
Viti 2023	✓	✓	✓
Viti 2024	-	-	✓

-Nga Avokatura e Shtetit nuk janë dërguar 2 raportet e monitorimit për vitin 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”

Mungesa e raporteve të monitorimit, si dhe relacioneve shpjeguese çënojnë monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit të synuara dhe produkteve të parashikuara në buxhetin vjetor, si edhe mungesën e marrjes së masave korrigjuese për përmirësimin e situatës.

Si rezultat i mungesës së raporteve të monitorimit të buxhetit:

- Nuk bëhet e mundur ndjekja e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik;
- Nuk bëhet i mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve;
- Nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme;
- Nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.

Në raportet e monitorimit Avokatura e Shtetit ka përshkruar veprimtarinë e institucionit shprehur në terma sasiorë por nuk është kryer analizë mbi ndryshimet e zërave buxhetorë për periudhën raportuese, mosarritjet dhe shkaqet duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, veprime në kundërshtim me kërkesat e pikës 267 të UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” dhe ngarkojnë me përgjegjësi z. A. H. dhe zj.E. Gj.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar konkretisht nga zj. Sh. Sh, është paraqitur observacion me shkresën nr.508/17 prot, datë 22.08.2025, administruar pranë KLSH me nr.164/5 prot, datë 25.08.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën 2.2/1 në Projektraport, për realizimin e buxhetit prej 72% nga planifikimi i paargumentuar i kërkesave, Avokatura e Shtetit sqaron se shpenzimet për mallra dhe shërbime përsëriten çdo vit si elementë të domosdoshëm për funksionimin e institucionit, ndaj planifikimi është bërë në përputhje me nevojat e institucionit. Realizimi i procedurave të prokurimit gjatë viteve 2023 dhe 2024 lidhet drejtpërdrejt me kufizimin e buxhetit të miratuar, i cili për shpenzimet kapitale ka qenë vetëm 2.000 mijë lekë në vit. Për këtë arsye, prokurimet janë përqendruar vetëm tek shpenzimet bazike dhe të domosdoshme për funksionimin e institucionit, si blerje kancelarie, pajisje zyre dhe furnizime të tjera minimale. Të gjitha këto shpenzime janë të dokumentuara në urdhër-shpenzime dhe pasqyrojnë nevojat reale e të përsëritura të institucionit, pa krijuar devijime apo planifikim të paargumentuar të kërkesave buxhetore. Sipas Udhëzimit nr. 30 të Ministrisë së Financave, shpenzimet e realizuara për mallra dhe shërbime janë të natyrës operative dhe, si të tilla, janë të përsëritshme e të domosdoshme për vijimësinë e veprimtarisë së institucionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura sqarojmë se, grupi i auditimit nuk ka trajtuar se mungojnë dokumentet, por planifikimi i buxhetit nuk është i argumentuar, pretendimi nuk qëndron pasi në institucion nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton të kundërtën sa ka trajtuar grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me pikën 2.2/2 të Projektraportit, për mungesën e fondeve për investime në sisteme kompjuterike financiare, Avokatura e Shtetit sqaron se janë përfshirë fonde për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e programit buxhetor “Alpha” dhe të sistemit të menaxhimit të funksioneve të saj, i cili është funksional që prej vitit 2015 dhe është përditësuar në vitin 2025 në bashkëpunim me Këshillin e Europës. Sa i përket sistemit financiar, sqarojmë se gjatë vitit 2023 Avokatura e Shtetit ka punuar me programin Alpha Buxhetore, ndërsa për vitin 2024, për shkak të mungesës së specialistit të financës, përdorimi i këtij sistemi nuk është realizuar në mënyrë të plotë. Megjithatë, të dhënat financiare dhe statistikave të punës së institucionit janë përpunuar dhe raportuar rregullisht: çdo vit përmes raportit vjetor përmbledhës të dërguar pranë Kryeministrit, si dhe nëpërmjet treguesve të performancës të dorëzuar pranë Ministrisë së Financave në raportet e monitorimit. Këto dokumente përfaqësojnë burimin zyrtar të statistikave dhe provojnë vijimësinë e raportimit financiar dhe të performancës së institucionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit dhe situatës së sistemeve, sigurisë dhe dokumentacionin që përpunojnë sistemet edhe ai që përmendni i vitit 2015, sqarojmë se nuk kanë dhënë asnjë statistikë të vlefshme për punën e ASH, si edhe në sistemin financiar. Pretendimi nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Në kuadër të përgatitjes së dokumentacionit për Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023-2025 dhe PBA 2024-2026, në Avokaturën e Shtetit janë ndërmarrë veprime konkrete në përputhje me qëllimin e procesit. Janë ngritur grupe pune për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe janë zhvilluar takime fizike me kryetarët e zyrave vendore, gjatë të cilave janë diskutuar nevojat prioritare të secilës zyrë dhe janë mbledhur të dhëna mbi burimet njerëzore, financiare dhe materiale të nevojshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura sqarojmë se, pretendimi nuk qëndron pasi në institucion nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton të kundërtën sa ka trajtuar grupi i auditimit.

Pretendimi i subjekti: Avokatura e Shtetit ka zhvilluar procedurat e prokurimit dhe realizimi prej 72 % i buxhetit të saj është si rezultat i planifikimit të paargumentuar të kërkesave. Zërat buxhetorë për shpenzimet "për mallra dhe shërbime" janë të njëjtë dhe përsëriten çdo vit në regjistrin e parashikimeve, pasi përfaqësojnë elementë të domosdoshëm për funksionimin e vazhdueshëm të institucionit. Këto shpenzime lidhen ngushtësisht me sigurimin e kushteve minimale të punës dhe kryerjen efektive të funksioneve ligjore të Avokaturës së Shtetit. Siç theksohet edhe në akt-konstatim, ky zë përbën një komponent të rëndësishëm në mbështetje të mbarëvajtjes së veprimtarisë institucionale. Për rrjedhojë, planifikimi është bërë në përputhje me nevojat reale dhe të përsëritura të institucionit, duke pasur parasysh rëndësinë e vazhdueshme të këtyre shpenzimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura sqarojmë se, pretendimi nuk qëndron pasi në institucion nuk ka asnjë dokumentacion që vërteton të kundërtën sa ka trajtuar grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit: Referuar realizimit të buxhetit për vitet 2023-2024, konstatohet mosrealizim i zërit "Shpenzime për paga" në masën 90% për vitin 2024 dhe 6% krahasuar me vitin 2023. Mosrealizimi i plotë gjatë viteve 2023-2024 lidhet kryesisht me mungesën e stafit, ku pjesën më të madhe e zënë vendet vakante të avokatëve të shtetit. Rekrutimi i tyre nuk është realizuar për shkak të kufizimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, konkretisht në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të cilët përcaktojnë detyrimin për përfundimin e Shkollës së Magjistraturës si kusht për emërimin në

pozicionet e avokatëve të shtetit. Për rrjedhojë, këto pozicione kanë mbetur të paplotësuara, duke ndikuar drejtpërdrejt në mosrealizimin e zërit përkatës në buxhet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Konfirmoni sa është trajtuar nga grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit: Nuk janë kërkuar fonde për investime në sisteme kompjuterike financiare dhe për funksionin e punës që kryen Avokatura e Shtetit. Në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve janë përfshirë fonde për investime në sisteme kompjuterike, konkretisht për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e programit buxhetor “Alpha”, si dhe për sistemin e menaxhimit të funksioneve të Avokaturës së Shtetit. Ky sistem është funksional që prej vitit 2015 dhe mbështet ndjekjen dhe administrimin e çështjeve gjyqësore. Gjatë vitit 2025, ky sistem është përditësuar në bashkëpunim me Këshillin e Europës, duke reflektuar nevojat aktuale të institucionit dhe zhvillimet teknologjike, çka tregon angazhimin e institucionit në drejtim të modernizimit dhe përmirësimit të kapaciteteve teknologjike.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar dokumentacionit dhe situatës së sistemeve, sigurisë dhe dokumentacionin që përpunojnë sistemet edhe ai që përmendni i vitit 2015, sqarojmë se nuk kanë dhënë asnjë statistikë të vlefshme për punën e ASH, si edhe në sistemin financiar. Pretendimi nuk merret në konsideratë, pasi auditimi është kryer për vitet 2023-2024.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me raportet e monitorimit 4 dhe 8 mujore, nuk janë plotësuar për shkak të mungesës së stafit në Drejtorinë e Financës gjatë periudhës së vitit raportues. Kjo nuk ka krijuar pengesa në procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për raportimet e nevojshme, pasi në raportin përfundimtar të vitit 2024, Avokatura e Shtetit ka arritur të tejkalojë pritshmërinë për vitin 2024, duke realizuar objektivat e saj pavarësisht mungesave të fondeve dhe stafit. Ky rezultat tregon angazhimin dhe përpjekjet e stafit të Avokaturës së Shtetit për të realizuar detyrat dhe qëllimet e përcaktuara, duke përmbushur kërkesat e institucionit edhe në kushte sfiduese.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimi konfirmon sa është trajtuar nga grupi i auditimit.

2.3. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

-Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës

-Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit

-Inventarizimi i pronës shtetërore.

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin e vlerave materiale dhe monetare, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzimet.

- Veprimet e kryera nëpërmjet bankës

- Procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarëve

- Veprimet e kryera nëpërmjet arkës në valutë, etj.

- Pasqyrat financiare, etj.

a) Ligjshmëria dhe saktësia e kryerjes së veprimeve nëpërmjet arkës në valutë.

Për vitin 2023

Veprimet e arkës në valutë në institucion dokumentohen nëpërmjet mandat-arkëtimeve dhe mandat-pagesave të cilat nënshkruhen nga arkëtari, financieri dhe marrësi i paradhënies.

Regjistrimet e veprimeve të arkës janë kryer në llogari kontabile të arkës, nga Sektori i Financës dhe në librin e arkës nga ana e punonjësit të caktuar me përgjegjësinë e lëvizjes së vlerave monetare. Dokumentet e arkës janë shqyrtuar, kontrolluar dhe nënshkruar nga personat e

poshtëshënuar: mandatarkëtimet nënshkruhen rregullisht nga personi përgjegjës për vlerat monetare dhe nga Nëpunësi Zbatues; mandatpagesat nënshkruhen nga nëpunësi zbatues, nga zyrtari që ka nënshkruar mandatpagesën (marrësi) dhe nga personi përgjegjës për lëvizjen e vlerave monetare. Përgjithësisht nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të arkës në valutë konstatohet se, institucioni respekton përcaktimet e Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011, *“Për menaxhimin e aktiveve nënjësitë e sektorit publik”* i ndryshuar, dhe sa më sipër është mbajtur libër arke ku janë regjistruar rregullisht mandat arkëtimet e pagesat dhe janë bërë mbylljet e tij rregullisht çdo muaj, në zbatim të parashikimeve të paragrafit nr.67 dhe 68 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*.

Nga auditimi rezultoi se, regjistrimet kontabël në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë të rregullt, të kuadruara dhe duke u bazuar në dokumentacionin justifikues përkatës. Nëpërmjet arkës në valutë janë kryer pagesa për shërbime udhëtimi e dieta jashtë vendit. Në të gjitha rastet e audituara, paradhënia ka rezultuar të jetë sistemuar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, menjëherë pas paraqitjes së dokumenteve justifikuese, për shpenzimet e kryera, nga ana e nëpunësit udhëtues, e shoqëruar kjo sipas rastit me mandat pagesën ose mandatin e arkëtimet. Nga testimet e kryera nuk rezultoi të jetë akorduar paradhënie e dytë pa shlyer paradhënien e parë. Transaksionet financiare, në formën e paradhënies, për udhëtime e dieta, rezultojnë të kryera në zbatim të VKM nr. 870 datë 14.12.2011 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”*, i ndryshuar.

Çdo veprim në arkë është kryer vetëm me urdhër të titullarit të institucionit (Avokati i Përgjithshëm i Shtetit). Për vitin 2023 me autorizim të titullarit magazinieri ka mbuluar edhe funksionin e arkëtarit, veprime në mospërputhje me nenin 9, pika 4 shkronja f) të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar.

U shqyrtua libri i arkës në valutë për disa transaksione të përzgjedhura nga grupi i auditimit bazuar në vlerat më të larta. Në fund të vitit arka është mbyllur me gjendje zero.

Praktikat për likuidimet e kryera për shërbimet jashtë vendit janë hartuar nga personat udhëtues së bashku me dokumentacionin vërtetues përkatës.

Nga auditimi i praktikave të përzgjedhura rezultoi se bashkëlidhur praktikës është Urdhërshërbimi, autorizimi i titullarit të institucionit, dhe të gjithë dokumentet përkatëse që vërtetojnë shpenzimet e kryera për realizimin e shërbimit jashtë vendit, sipas përcaktimit të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 10.07.2013, *“Mbi zbatimin e Vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”*, pika 5.

Për vitin 2024

Veprimet e kryera nëpërmjet arkës në valutë janë pasqyruar në ditarin e arkës shoqëruar me dokumentacionin justifikues dhe urdhrat përkatës në zbatim të VKM nr.870, datë 14.11.2011 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”*. Vlera e shpenzuar për shërbimet jashtë vendit është 4850 euro, por avokatura e Shtetit nuk ka arkëtar dhe është autorizuar magazinieri për të kryer veprimet në valutë, veprime në kundërshtim me nenin 9, pika 4 shkronja f) të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar.

b) Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës

Për vitin 2023

Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Avokaturën e Shtetit rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të

Financave nr. 8, datë 09.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, i ndryshuar.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Kontabilizimet janë kryer rregullisht dhe të regjistruara në ditarët përkatës, sipas programit informatik të kontabilitetit “Alpha”.

Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, procesverbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*.

Në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik, për vitin 2023, me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor është ngritur komisioni i prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël si dhe komisioni i sistemit dinamik të blerjeve të transportit ajror ndërkombëtar. Konkretisht janë nxjerrë urdhrat për ngritjen e komisioneve si me poshtë:

-Urdhër nr.125, datë 09.01.2023 *“Për ngritjen e Komisionit të Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar në Avokaturën e Shtetit”* me përbërje: L.N., (Kryetar), A.T. dhe J. Z. (Anëtarë).

-Urdhër nr.124 prot, datë 09.01.2023 *“Për ngritjen e Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël në Avokaturën e Shtetit”* me përbërje: L. N., (Kryetar), A. T. dhe J. Z. (Anëtarë).

-Urdhër nr.257, datë 16.01.2023 *“Për ngritjen e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Punëve/Mallrave/Shërbimeve në Avokaturën e Shtetit”*, me përbërje: A. D. (Kryetar), R. H. dhe A. H. (Anëtarë).

-Urdhër nr.257/1, datë 18.7.2023 *“Për një ndryshim në Urdhërin Nr.257 prot, datë 16.01.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Marrjes në Dorëzim të Punëve/Mallrave/Shërbimeve në Avokaturën e Shtetit” më anë të së cilit zëvendësohet zj.A. H.me z.M. R.*

- Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin **2023** janë në vlerën totale 273,230,332 lekë;

Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditoi transaksionet sipas urdhër shpenzimeve të realizuara për periudhën **Shtator - Dhjetor** të vitit 2023.

Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”* veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.* Nga auditimi rezultoi se:

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit përgjithësisht është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si: faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

- Regjistrimi i dokumenteve në librat e kontabilitetit është kryer me vonesë dhe jo ditën e nesërme të paraqitjes së tyre, veprime në mospërputhje me pikën 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”*

Për vitin 2023, auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës u krye mbi bazë risku duke përzgjedhur si kampion transaksionet financiare me vlerën më të lartë/muaj.

1. Me Urdhër shpenzim nr.251, datë 25.9.2023, në vlerën 705,046 lekë është kryer shpenzimi **për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve** dhe ambienteve të Avokaturës së Shtetit në favor të shoqërisë *“I.G”* sh.a. Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit administrohet dokumentacioni vërtetues si vijon: Amendimi i kontratës me nr.2328/8 prot, dt.03.7.2023, Situacion shpenzimesh dt.13.9.2023 për periudhën korrik-gusht 2023 nga nëpunësi zbatues, Faturë tatimore nr.1873, datë 31.7.2023 të shoqërisë *“I.G.”* sh.a, Procesverbal (pa datë dhe nr....prot) për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve dhe ambienteve të Avokaturës së Shtetit për muajin korrik.

Faturë tatimore nr.2426, datë 31.8.2023 të shoqërisë “I.G.” sh.a, Procesverbal (pa datë dhe nr....prot) për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve dhe ambienteve të Avokaturës së Shtetit për muajin gusht.

2.Me USH nr.252 datë 25.9.2023 në vlerën 456,494 lekë është kryer shpenzimi **për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve dhe ambienteve** të Avokaturës së Shtetit në favor të shoqërisë “I.G.” sh.a. Bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimeve administrohet dokumentacioni vërtetues si: kontrata e shërbimit nr.2328/4 prot, dt.29.12.2022, Situacion shpenzimesh dt.13.09.2023 për periudhën maj-qershor 2023 nga nëpunësi zbatues, E. Gj., Faturë tatimore nr.1481, datë 01.5.2023 të shoqërisë “I.G.” sh.a; Procesverbal (pa datë dhe nr....prot) për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve dhe ambienteve të Avokaturës së Shtetit për muajin maj; Faturë tatimore nr.1783, datë 01.6.2023 të shoqërisë “I.G.” sh.a; Procesverbal (pa datë dhe nr....prot) për kryerjen e shërbimit për muajin qershor.

3. Me USH nr.255 datë 25.9.2023 në vlerën 515,016 lekë është kryer shpenzimi **për blerje orendie**. Në dokumentacionin vërtetues që i bashkëlidhet urdhër shpenzimit janë dokumentet si: Urdhër prokurim nr.382/1 prot, datë 22.8.2023, Ftesë për ofertë datë 22.8.2023, Procesverbali i vlerësimit të ofertave, Ekstrakt QKB i OE fitues, Procesverbal i marrjes në dorëzim të mallrave datë 4.9.2023 (i pa protokolluar) nga KBVV ngritur me Urdhër të titullarit nr.15, datë 16.01.2023.; Fletë hyrje nr.4, dt.04.9.2023 dhe Faturë tatimore nr.439, datë 04.9.2023.

4. Me USH nr.275 datë 16.10.2023 në vlerën 221,640 lekë është kryer shpenzimi **për blerje kancelarie**. Në dokumentacionin vërtetues që i bashkëlidhet urdhër shpenzimit janë dokumentet si: Urdhër prokurim nr.438 prot, datë 13.9.2023, Ftesë për ofertë datë 14.9.2023, Procesverbali i vlerësimit të ofertave dt.14.9.2023, Procesverbal njoftim fituesi 2, datë 15.9.2023; Fletë hyrje nr.10. datë 22.9.2023, Procesverbal i marrjes në dorëzim të mallrave datë 22.9.2023, Faturë tatimore nr.13384, datë 22.9.2023.

Për sa më sipër, procesverbalet e hartuara nga komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve nuk janë të protokolluara, veprime në mospërputhje me nenet 18 dhe 19 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohet se procesverbalet kanë të gjithë elementët e dokumenteve të brendshëm dhe duhet të protokollohen.

5. Me urdhër shpenzimet nr. 349, datë 26.12.2023, është kryer shpenzimi për **“Blerje toner”**, në vlerën 211,200 lekë.

Bashkëlidhur tij administrohet dokumentacioni vërtetues mbi realizimin e procedurës si vijon: Urdhër prokurimi nr.500, datë 09.11.2023, me objekt prokurimi: **“Blerje toner”**; ftesë për ofertë datë 13.11.2023; Njoftim fituesi APP, datë 20.11.2023; Procesverbali i marrjes në dorëzim datë 24.11.2023, (i pa protokolluar), nga KBVV ngritur me Urdhër të titullarit nr.15, datë 16.01.2023, faturë nr.16764, datë 24.11.2023.

Procesverbali i marrjes në dorëzim nuk përmban detaje dhe nuk evidentohet asnjë e dhënë mbi specifikimet teknike, duke e bërë të paqartë se me çfarë specifikimesh apo kriteresh bëhet krahasimi në momentin e marrjes në dorëzim të tyre, por deklarohet vetëm se shërbimi/malli është sipas specifikave të kërkuara. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me pikat 36, 42 dhe 47 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 **“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”** i ndryshuar ku specifikohet **“Titullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqëruar. Në çdo rast komisioni mban një procesverbal në të cilin detajon të dhënat e verifikuara dhe mospërputhjet....Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës,**

personat qe kane urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe te tjera te dhëna te nevojshme qe i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”.

➤ **Blerjet nën 100 mijë lekë**

Nga auditimi i urdhër shpenzimeve për vitin 2023 në lidhje për blerjet e realizuara nën 100,000 lekë rezultoi se bashkëlidhur praktikës së urdhër shpenzimit, administrohej dokumentacioni vërtetues mbi realizimin e procedurës nga testimi i tregut për përcaktimin e vlerës deri në fazën e përzgjedhjes së OE, me të cilin është realizuar transaksioni.

Lidhur me auditimin e dokumentacionit të dietave mbi të cilat është bërë rimbursimi i shpenzimeve *dieta brenda vendit* për punonjësit u konstatua se, përllogaritja e dietave kryhet sipas përcaktimeve të VKM-së nr.997, datë 10.12.2010 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit*”. Kryerja e pagesave për trajtim financiar me dieta është e shoqëruar me autorizim përkatës. Biletat kanë të përcaktuar itenerarin dhe datën e lëvizjes, dhe janë dorëzuar të plotësuara nga personi udhëtues.

Në 6 raste, rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore, për shkak të moslikuidimit në kohë të faturave tatimore, të cilat krijojnë premisa për lindjen e penalteteve, dhe rëndojnë mbi buxhetin e shtetit. Veprime në mospërputhje me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*” i ndryshuar, neni 52, ligjin nr.48/2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” neni 7, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, pika 184 “*Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik*”.

Konkretisht faturat e likuiduara me vonesë , por për të cilat nuk janë marrë penaltete, paraqiten si vijon:

- Fatura tatimore nr.30, lëshuar më datë 7.8.2023 me afat maturimi datë 04.09.2023 dhe pagesa është kryer me Urdhër Shpenzim nr.285, datë 16.10.2023, duke kaluar afatin 30 ditor.
- Fatura tatimore nr.1233 lëshuar më datë 31.8.2023 me afat maturimi datë 04.09.2023 dhe pagesa është kryer me USH nr.286, datë 16.10.2023.
- Fatura tatimore nr.1572 lëshuar më datë 28.7.2023 dhe pagesa është kryer me USH nr.297, datë 30.10.2023.
- Fatura tatimore nr.861 lëshuar më datë 22.08.2023 dhe pagesa është kryer me USH nr.324, datë 20.11.2023.
- Fatura tatimore nr.1130 lëshuar më datë 06.12.2023 dhe pagesa është kryer me USH nr.367, datë 22.01.2024.
- Faturat tatimore me nr.2308-213158-1, nr.2308-213157-1, nr.2308-213142-1, nr.2308-213155-1, datë 30.11.2003 dhe pagesa është kryer me USH nr.368, datë 22.01.2024.

Për vitin 2024

Nga auditimi mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj) të realizuara nga Dega e Financës së Avokaturës së Shtetit, rezultoi se, veprimet *nuk* janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar.

-Dokumentacioni i bankës nuk është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet jo në çdo rast janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Urdhër Shpenzimet u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik" veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

-Veprimet ekonomike që kryhen nga njësia si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrime ruajtje, pasqyrohen me dokumentet përkatëse *por jo menjëherë pasi kryhet veprimi.*

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit për vitin 2024 ka filluar në muajin mars të vitit 2025 gjatë kryerjes së auditimit në këtë institucion.

- Marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve sipas kontratave të lidhura për mallra/shërbime përgjithësisht janë të konfirmuara dhe dokumentuara rregullisht nga një komision i ngritur nga Titullari i Avokaturës së Shtetit, në përputhje konform pikës 42, 43, 44, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Nga auditimi i ditarit të bankës për vitin 2024, u konstatua:

Për periudhën janar-tetor janë kryer pagesat e pagave, sigurimeve shoqërore ujë-energji, ndërsa shpenzimet e kryera nga Avokatura e Shtetit për vitin 2024 si blerje materiale të ndryshme, shpenzime qiraje, dieta personeli, etj, janë kryer në muajin dhjetor megjithëse faturat e blerjeve dhe shërbimeve datojnë prej muajve shkurt-shtator, likuidimet janë kryer me vonesë edhe në muajin janar të vitit 2025.

Në mbi 30 raste, rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore, për shkak të moslikuidimit në kohë të faturave tatimore, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, neni 52, ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 7, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 184 "Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik", si edhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", pika 61 "Dokumentimi i vlerave monetare".

Konkretisht faturat e likuiduara me vonesë, paraqiten si vijon:

-USH nr.167, datë 16.12.2024 në shumën 81,200 lekë "Blerje adeziv" fatura datë 11.06.2024.
-USH nr.168, datë 16.12.2024 në shumën 248,026 lekë "Pagesë energjie" fatura Tetor-Nëntor.
-USH nr.169, datë 16.12.2024 në shumën 84,000 lekë "Mirëmbajtje pajisje elektronike" fatura datë 03.07.2024.

-USH nr.173, datë 18.12.2024 në shumën 175,055 lekë "Shpenzime postare" Mars-Nëntor.

-USH nr.175, datë 19.12.2024 në shumën 4,265 lekë "Shpenzime postare" Maj-Nëntor.

-USH nr.177, datë 19.12.2024 në shumën 33,430 lekë "Shpenzime postare" Maj-Nëntor.

-USH nr.178, datë 27.12.2024 në shumën 15,150 lekë "Shpenzime postare" Maj-Nëntor.

-USH nr.179, datë 19.12.2024 në shumën 11,350 lekë "Shpenzime postare" Maj-Nëntor.

-USH nr.180, datë 19.12.2024 në shumën 47,800 lekë "Shpenzime përkthim" fatura 25.04.2024.

- USH nr.181, datë 23.12.2024 në shumën 2,400 lekë “Shpenzim noterie” fatura datë 12.06.2024.
- USH nr.182, datë 19.12.2024 në shumën 211,868 lekë “Shpenzime telefonie” fatura datë 01.11.2024.
- USH nr.187, datë 24.12.2024 në shumën 6,000 lekë “Shpenzim noterie” fatura datë 13.09.2024.
- USH nr.194, datë 27.12.2024 në shumën 8,030 lekë “Shpenzime postare” Maj-Nëntor.
- USH nr.196, datë 30.12.2024 në shumën 17,400 lekë “Riparim automjeti” fatura datë 04.06.2024.
- USH nr.197, datë 07.01.2025 në shumën 33,513 lekë “Shpenzim transporti” taksa e automjeteve.
- Nga të cilat 14,220 TVMP e vitit 2024 + 3,114 gjobaTVMP + 16,179 të prapambetura.
- USH nr.200, datë 08.01.2025 në shumën 685,200 lekë “Blerje kancelari” fatura datë 29.03.2024.
- USH nr.201, datë 08.01.2025 në shumën 1,410,091lekë “Shërbimi i ruajtjes fizike” fatura datë 01.10.2024.
- USH nr.203, datë 08.01.2025 në shumën 473,300 lekë “Blerje kompjutera” fatura datë 27.09.2024.
- USH nr.204, datë 08.01.2025 në shumën 43,000 lekë “Blerje uniforma” fatura datë 12.11.2024.
- USH nr.209, datë 13.01.2025 në shumën 225,600 lekë “Shpenzime postare” fatura datë 21.11.2024.
- USH nr.211, datë 14.01.2025 në shumën 141,381 lekë “Shpenzime telefonike” fatura datë 02.02.2024.
- USH nr.213, datë 14.01.2025 në shumën 25,752 lekë “Shtypshkrime” fatura datë 07.11.2024.
- USH nr.218, datë 15.01.2025 në shumën 42,000 lekë “Shërbim larje automjeti” fatura Mars – qershor 2024.
- USH nr.219, datë 15.01.2025 në shumën 98,220 lekë “Shpenzime uji” fatura Maj -nëntor 2024.
- USH nr.220, datë 15.01.2025 në shumën 21,200 lekë “Shërbim noterie” fatura 24.09.2024.
- USH nr.221, datë 15.01.2025 në shumën 172,068 lekë “orendi zyrash” fatura 23.12.2024.
- USH nr.222, datë 15.01.2025 në shumën 678,000 lekë “Blerje tonera” fatura 17.10.2024.
- USH nr.231, datë 16.01.2025 në shumën 120,000 lekë “Blerje karburant” fatura 20.11.2024.

-Nëpërmjet bankës janë kryer pagesa për dieta brenda vendit në *shumën 66,000 lekë*, referuar urdhrin të titullarit nr.469, datë 18.12.2024 për të kryer pagesat për monitorimin e transferimit të dosjeve gjyqësore në disa Zyra Vendore të AV.Shtetit. Në urdhër nuk është përcaktuar data e nisjes dhe e kthimit të punonjësve.

- USH nr.170, datë 18.12.2024 në shumën 22,000 lekë “Shpenzime dieta” z. S. D.
- USH nr.171, datë 18.12.2024 në shumën 22,000 lekë “ Shpenzime dieta” zj. Xh. D.
- USH nr.172, datë 18.12.2024 në shumën 22,000 lekë “Shpenzime dieta” z. L. V.

Pagesat janë kryer pa dokumentacionin justifikues dhe vërtetues, pasi nga punonjësit nuk janë paraqitur faturat e hotelit si edhe nuk janë plotësuar urdhër shërbimet, veprime në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” Kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 34, 35 dhe 36.

- USH nr.198, datë 07.01.2025 në shumën *16,500 lekë* “Shpenzime dieta” referuar urdhrin të titullarit nr.482, datë 30.12.2024 për të kryer pagesat për shpenzimet e fjetjes z. Sh. S. për shërbimin e kryer në Vlorë në datat 13-16 qershor 2024.

Për këtë pagesë mungon dokumentacioni justifikues, sepse fatura tatimore nr.1648/2024 ora 15.45, e paraqitur nga hotel “R. group” daton më 13.12.2024, e cila nuk përputhet me datat e

përcaktuara në urdhërin e titullarit për kryerjen e shërbimit pasi shërbimi është kryer në muajin qershor ndërsa fatura e hotelit që vërteton kryerjen e tij është 6- muaj më vonë, mungon urdhër shërbimi si edhe nënshkrimi faturës së hotelit nga personi blerës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 54/b “Kryerja pagesave” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 34, 35 dhe 36.

Avokatura e Shtetit deri në datën 31.12.2024 është penalizuar me gjoba nga Drejtoria e Tatim Taksave Tiranë në shumën 391,550 lekë (shkaktuar nga dega e financës).

-Nëpërmjet bankës janë kryer pagesat e detyrimeve për gjobat në shumën 50, 630 lekë, ndërsa diferenca prej 340,920 lekë është në proces gjyqësor me nr. çështje 31155-02028-80-2025, datë 03.03.2025.

➤ *Proceset Gjyqësore.*

Për vitet 2023-2024 nga Avokatura e Shtetit janë larguar gjithsej 26 punonjës, nga të cilët 25 janë larguar me dorëheqje dhe 1 është shkarkuar nga detyra.

Gjatë vitit 2023 janë larguar 13 punonjës dhe është iniciuar 1 kërkesë padi me palë paditëse A. D. dhe të paditur Avokatura e Shtetit, ndërsa në vitin 2024 janë larguar 13 punonjës dhe nuk janë iniciuar kërkesë padi. Ndër vite në Avokaturën e Shtetit janë ngritur padi të ndryshme ku ndër to ende në proces janë 5 kërkesë padi.

Vendime të mbartura të cilat janë ekzekutuar pjesërisht apo plotësisht në periudhën objekt auditimi janë:

A. Gj. - larguar nga detyra në vitin 2021, më vendimin nr. 1747, datë 06.06.2022 gjykata ka vendosur rikthimin në detyrë dhe dhënien e pagës nga ndërprerja e marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit. Çështja është ankimuar nga Avokatura e Shtetit dhe ndodhet për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit rikthyer për rigjykim nga Gjykata e Lartë. Vlera e vendimit është ekzekutuar totalisht, dhe rikthimi në detyrë është bërë përkohësisht nga momenti i daljes së vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit deri në momentin e daljes së vendimit të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë ekzekutimi i vendimit nuk është bërë i plotë pasi pas rikthimit në detyrë Avokati i Shtetit ka hequr dorë nga ekzekutimi i vendimit për pjesën e mbetur të tij. Nga Vendimi ka lindur detyrimi prej 2,457,905 lekë ndaj Av. A.Gj. + Shpenzimet e përmbauesit, ndërkohë janë shlyer vetëm 1,698,813 lekë në total bashkë me shpenzimet e përmbauesit dhe është hequr dorë nga pjesa tjetër e mbetur e detyrimit.

A. P. - larguar nga detyra në vitin 2021, me vendimin nr. 2709, datë 18.10.2022 gjykata ka vendosur rikthimin në detyrë dhe dhënien e pagës nga ndërprerja e marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit. Çështja është ankimuar nga Avokatura e Shtetit dhe ndodhet për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Vlera e vendimit është e pashlyer plotësisht pasi është rikthyer në punë.

E. B. - larguar nga detyra në vitin 2018, me vendimin nr. 2082, datë 12.12.2019 gjykata ka vendosur dhënien e 18 pagave dëmshpërblim. Vendimi është ekzekutuar.

I. Th. - larguar nga detyra në 2021, me vendimin nr. 193(27), datë 26.01.2022 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë ka vendosur “Detyrimin e palës së paditur Avokatura e Shtetit të dëmshpërblejë paditësin Ildi Theodor në masën e 12 muajve punë...”. Vendimi është zbatuar.

L. Sh. - larguar nga detyra në vitin 2022, me vendimin nr. 843, datë 15.12.2022 të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Vlorë është vendosur dëmshpërblimi për 14 paga e 5 ditë. Vendimi është ankimuar dhe ndodhet në Gjykatën Administrative të Apelit dhe nuk është ekzekutuar, në pritje të vendimit të Gjykatës.

Nga 10 procese gjyqësore me objekt “Largim nga puna pa shkaqe të justifikuara” janë kryer

pagesat, si më poshtë:

Vendime të zbardhura dhe të ekzekutuara nga Avokatura e Shtetit.

Viti	Përshkrimi	Detyrimi	Vlera e likuiduar 2023	Vlera e likuiduar 2024	Vlera e përmbaresit	Total
2022	A. G.	2,599,700	1,582,204		116,609	1,698,813
2022	A. P.	5,145,516	354,623	-	-	354,623
2019	E. B.	1,418,160	-	1,418,160	93,598	1,511,758
2022	I. Th.	1,668,816	1,671,618	-	110,340	1,781,958
2022	L. Sh.	1,970,130	-	-	-	-
	Shuma	12,802,322	3,608,445	1,418,160	320,547	5,347,152

Deri në vitin 2023 janë likuiduar 3,608,445 lekë, ndërsa për vitin 2024 janë likuiduar 1,418,160 lekë shoqëruar me vlerën e përmbaresit (për 3 vendime) në shumën 320,547 lekë.

Pra, në total nga Avokatura e Shtetit detyrimi i paguar (për 4 vendime) deri në datën 31.12.2024 është 5, 347,152 lekë. Për 5 punonjës të tjerë vazhdojnë proceset gjyqësore nga shqyrtimi i dokumentacionit të urdhër-pagesave në lidhje me likuidimet e vendimeve gjyqësore u konstatua se për të gjitha këto vendime pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga Avokatura e Shtetit me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutiveve të lëshuara nga përmbaresit privat, duke paguar tarifa përmbaresore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë në shumën 320,547 lekë për buxhetin e Avokaturës së Shtetit. Nëse ekzekutimi i vendimit gjyqësor do të ishte kryer me ekzekutim vullnetar do të minimizoheshin kostot në buxhetin e institucionit.

c. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Për vitin 2023

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit u përqëndrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Pasqyrat financiare të vitit 2023 janë përpiluar dhe dërguar në afat në Degën e Thesarit Tiranë, me shkresën nr.1575 prot, datë 29.03.2024, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Pasqyra Financiare është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse është përpiluar Pasqyra e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së

Thesarit.

Situata e detyrimeve të prapambetura

Nga auditimi rezultoi se në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm”, vlera 11,053,138 lekë përfaqëson masa zhdëmtimi për dëme ekonomike të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit përmes Raportit Përfundimtar të Auditimit nr.114/5 prot, datë 16.05.2007. Vlera është kontabilizuar në librat e kontabilitetit, por nuk është arkëtuar ndër vite.

Vlera e debitorëve në fund të vitit është një vlerë e konsiderueshme për institucionin e cila nuk është klasifikuar në debitorë pa shpresë për arkëtim dhe debitorë të arkëtueshëm, ku për këta të fundit nuk janë marrë masa për ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre.

Për vitin 2024

-Nga auditimi mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj) **për vitin 2024** të realizuara në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të Avokaturës së Shtetit, rezultoi se, veprimet nuk janë kryer konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr.5, datë 21.02.2022 dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 12 “Përgjegjësia menaxheriale e nëpunësit zbatues”.

Dokumentacioni i bankës nuk është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit.

Dega e financës ka pasqyruar në programin “excel” vetëm shpenzimet e kryera.

- Urdhër Shpenzimet nuk janë të pasqyruara dhe kontabilizuara kronologjikisht.

-Në 22 raste konstatohen fatura të kthyera nga thesari për mangësi të ndryshme shkaktuar nga dega e financës, duke reflektuar veprime jo kronologjike në regjistrimin e urdhër shpenzimeve, në kundërshtim me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Nuk janë mbajtur dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.

-Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë për vitin ushtrimor 2024 me shkresë përcjellëse nr.prot.2059, datë 28.03.2025.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike nuk janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre nuk janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave, etj si edhe nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore, etj.

-Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik”, ku ndër të tjera theksohet se: “...- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet. - Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme*” Kreu III, pika

3.2 “Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme” në të cilën përcaktohet: *Mbyllja e llogarive vjetore nga ana e njësisve të qeverisjes së përgjithshme është një proces i domosdoshëm, i cili duhet të bëhet përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, duke ndjekur rradhën kronologjike si më poshtë vijon: Nën-pika 43. Fillimisht, njësitë e qeverisjes së përgjithshme (në varësi të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit) përgatisin dokumentin përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, gjatë periudhës ushtrimore vjetore. Nën-pika 44. Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”. Nën-pika 45. Pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, hartuesi i pasqyrave financiare duhet të realizojë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, për periudhën ushtrimore që raportohet.*

Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

d. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël.

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Avokatura e Shtetit ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhura”.

Për vitin 2023, është realizuar procesi i inventarizimit sipas përcaktimeve në paragrafin nr. 74, i Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

e. Inventarizimi fizik

Për vitin 2023 është ngritur komisioni i inventarizimit me urdhër nr. 6699 prot, datë 26.12.2023 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, “Për kryerjen e inventarizimit të aktive afatshkurtra dhe aktive afatgjata materiale”.

Gjatë procesit të inventarizimit është kryer edhe dorëzimi i detyrës nga magazinieria zj.S T. (për efekt të mbushjes së moshës së pensionit) te zj.B.Gj., bazuar në urdhërin e Avokatit të Përgjithshëm nr. 6630 prot, datë 26.12.2023 “Për marrjen në dorëzim të aktiveve afatshkurtër dhe afatgjatë gjendje në magazinë e avokaturës së shtetit”.

Nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbali datë 26.12.2023, ku është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljes midis përgjegjësit material S.T dhe komisionit të inventarizimit, (I.Q, L.N, M.R) ditën kur është mbyllur inventarizimi fizik i aktiveve sipas

përcaktimit të paragrafit 83, të UMFE²⁵ nr. 30/2011, i ndryshuar.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë, sipas përcaktimeve të paragrafit nr.26, të Udhëzimit të MFE me nr. 30/2011. Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Në fund të procesit të inventarizimit, nga komisioni është përgatitur raporti mbi inventarizimin e aktiveve, dërguar titullarit me memon nr. 6699/1 prot, datë 29.12.2023. komisioni është shprehur se nga rakordimi i të dhënave kontabël me ato fizike rezultoi se nuk ka mungesa në materiale dhe në aktivet afatgjata. Gjithashtu komisioni konstatoi se në magazinën e Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit ndodhen aktive afatgjatë materiale si pajisje elektronike kompjuter desktop, laptop, printer; mobile orendi zyre tavolina, karrige rrotulluese, poltrona, kondicioner etj, të kthyera nga punonjësit për mos funksionim ose për dëmtime të konsiderueshme, për të cilat janë lënë shënime/vërejte në “Fletë Inventari”. Komisioni ka evidentuar përmes një liste të veçantë zërat e aktiveve të cilat janë jashtë funksionit, në vlerën 3,465,781 lekë.

Nëpunësi Autorizues nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionin të vlerësimit, për vlerësimin e aktiveve të cilat relatohen nga komisioni i inventarizimit si jo funksionale, veprime në kundërshtim me Udhëzimin të MFE nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" paragrafi 96-99 dhe 102. Mos realizimi i vlerësimit të aktiveve nga institucioni ndikon në mos planifikimi efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.

-Mbi kryerjen e inventarëve për vitin 2024

Nga auditimi u konstatua se Avokatura e Shtetit ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të aktiveve në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “*Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistrë kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...*”

Regjistrimi i aktiveve është kryer konform Kreut III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Hyrja dhe dalja e aktiveve për çdo rast dokumentohet me fletë-hyrjen dhe fletë - daljen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Komisioni i ngritur me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 375, datë 25.10.2024 “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve afatshkurtra dhe aktiveve afatgjata materiale të vitit 2024” ka kryer brenda afateve të përcaktuara inventarizimin e aktiveve afat shkurtra dhe afatgjata materiale.

Nga auditimi u konstatua se, nga komisioni në momentin e fillimit të inventarit janë ndjekur kërkesat e UMF nr.30, datë 27.12.2011, është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit.

Në fund të procesit të inventarizimit nga komisioni është përpiluar një raport në lidhje me inventarizimin fizik të aktiveve, ku janë dhënë komentet në lidhje me gjendjen fizike aktuale të aktiveve (*nëse janë apo jo në përdorim*), dhe i është dorëzuar për veprime të mëtejshme titullarit të institucionit.

²⁵ “*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material*”.

-Për vitin 2024, komisioni i inventarizimit ka hartuar 2 procesverbale ku ka pasqyruar aktivet materiale në vlerën 1,053,103 lekë që i vlerëson për nxjerrje jashtë përdorimi duke llogaritur edhe amortizimin e tyre, veprim në kundërshtim me pikën 102, të UKM nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Nga komisioni nuk janë dhënë shpjegime se mbi bazën e cilit kriter janë vlerësuar aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, veprime në kundërshtim me pikën 103, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi pika 95 citon se: Është një proces që kryhet gjatë ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale.

-Nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të cilat janë vlerësuar nga komisioni inventarizimit si aktive për jashtë përdorimi, në kundërshtim me pikën 96, të UKM nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" dhe ngarkojnë me përgjegjësi z.A. H dhe zj.Sh.Sh.

Sa më sipër arrihet në konkluzion si vijon:

☞ Regjistrimi i dokumenteve në librat e kontabilitetit është kryer me vonesë dhe jo ditën e nesërme të paraqitjes së tyre, veprime në mospërputhje me pikën 60, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*";

☞ Në 6 raste, rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore, për shkak të moslikuidimit në kohë të faturave tatimore, të cilat krijojnë premisa për lindjen e penaliteteve, dhe rëndojnë mbi buxhetin e shtetit. Veprime në mospërputhje me nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor*" i ndryshuar, nenin 7 të ligjit nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*", si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", pika 184 "*Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik*".

☞ Në llogarinë 468 "*Debitor të ndryshëm*", vlera 11,053,138 lekë përfaqëson masa zhdëmtimi për dëme ekonomike të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit përmes Raportit Përfundimtar të Auditimit nr.114/5 prot, datë 16.5.2007. Vlera është kontabilizuar në librat e kontabilitetit, por nuk është arkëtuar ndër vite. Vlera e debitorëve në fund të vitit është një vlerë e konsiderueshme për institucionin, e cila nuk është klasifikuar në debitorë pa shpresë për arkëtim dhe debitorë të arkëtueshëm, ku për këta të fundit nuk janë marrë masa për ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre.

☞ Nëpunësi Autorizues nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve, të cilat relatohen nga komisioni i inventarizimit si jo funksionale, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" paragrafi 96-99 dhe 102. Mos realizimi i vlerësimit të aktiveve nga institucioni ndikon në mos planifikimin efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nga subjekti i audituar konkretisht nga zj. Sh. Sh është paraqitur observacion me shkresën nr.508/17 prot, datë 22.08.2025, administruar pranë KLSH me nr.164/5 prot, datë 28.08.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me vlerën prej 11,053,138 lekë të pasqyruar në llogarinë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", sqarojmë se ajo përfaqëson detyrime të konstatuara nga auditimet e

viteve 2003–2009 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Në atë kohë, institucioni ndërmoi masat e nevojshme duke njoftuar punonjësit dhe duke ndjekur procedurat gjyqësore për arkëtimin e vlerave të konstatuara si përfitime të padrejta. Megjithatë, sipas nenit 110 të Kodit Civil, afati i përgjithshëm i parashkrimit është 10 vjet dhe pas këtij afati detyrimi nuk mund të kërkohej më në rrugë gjyqësore. Pra, janë parashkruar që në vitin 2019. Duke qenë se kanë kaluar mbi 10 vite nga momenti i krijimit të këtyre detyrimeve dhe shumica e ish-punonjësve që i mbartnin nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin, ato duhet të klasifikohen si debitorë pa shpresë për arkëtim.

Institucioni mbetet i angazhuar që, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse, të ndërmarrë hapat e nevojshëm për pastrimin e pasqyrave financiare nga këto detyrime të parashkruara, në përputhje me legjislacionin financiar në fuqi, duke kërkuar bashkëpunim të plotë si me autoritetet përgjegjëse, ashtu edhe me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Shpjegimet e dhëna nga ana Juaj provojnë edhe një herë domosdoshmërinë për ndërmarrjen e masave për pasqyrimin e drejtë të vlerave të kontabilizuara në pasqyrat financiare dhe klasifikimin e drejtë të debitorëve.

Pretendimi i subjektit: Grupi i auditit ka konstatuar parregullsi mbi dokumentacionin e bankës nuk është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit:

Në lidhje me këtë konstatim sqarojmë se, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 19.01.2022, të gjitha urdhër-shpenzimet janë të shoqëruara me dokumentacionin përkatës justifikues. Urdhër-shpenzimet janë firmosur nga personi i autorizuar dhe nga Dega e Thesarit, ndaj janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk përbëjnë shkelje të disiplinës financiare. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike për vitin 2024 është kryer dhe dokumentuar. Bashkëlidhur, i është vënë në dispozicion audituesve edhe kontabilizimi i bankave, i ndarë sipas muajve. Dokumentacioni bankar i kërkuar është dorëzuar në mënyrë të plotë. Për shkak të volumit të lartë fizik, nuk është i bashkëngjitur me këtë përgjigje, por është bërë i disponueshëm gjatë procesit të auditimit dhe mund të vihet në dispozicion në çdo kohë nëse kërkohej sërish.

Regjistrimi i veprimeve ekonomike është kryer brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, ku përcaktohet se pasqyrat financiare vjetore duhet të përgatiten dhe dorëzohen brenda datës 31 mars të vitit pasardhës. Në momentin e auditimit, institucioni ndodhej në procesin përmbyllës të bilancit, ndaj veprimet ishin në përputhje me afatet zyrtare. Gjithashtu në mbështetje të udhëzimit të 13, datë 18.12.2024 pika 5, theksojmë se institucionet kanë të drejtë të vijnë me ekzekutimin e pagesave deri në fund të muajit janar të vitit pasardhës.....

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pretendimi nuk qëndron, pasi dokumentacioni i bankës, është plotësuar gjatë ditëve të auditimit dhe me kërkesën e vazhdueshme të anëtarëve të grupit të auditimit, ju kujtojmë edhe mangësitë në dokumentacion si fletë hoteli, urdhra të ndryshëm si edhe plotësime të gabuara lidhur me objektin e urdhër shpenzimeve ku pagesa kryhej për dieta dhe përshkrimi ishte blerje, etj, etj.

Grupi i auditimit nuk ka trajtuar vonesa në paraqitjen e pasqyra financiare pasi ato janë dërguar në afat por nuk janë plotësuar referuar dokumentacionit të kontabilizimeve sipas llogarive, etj, të trajtuara si edhe vonesat e pagesave pasi janë përcaktuar ligjërisht afatet për kryerjen e pagesave brenda 30 ditëve nga paraqitja e dokumentacionit.

Pretendimi i subjektit: Grupi i auditit ka konstatuar parregullsi mbi shpenzimet për blerje mallrash, qira, dieta personeli, etj., janë likuiduar me vonesë, ndonëse faturat përkatëse datojnë që prej muajve shkurt–shtator. Në mbi 30 raste është konstatuar shkelje e disiplinës buxhetore për shkak të mos likuidimit në kohë të faturave tatimore, në kundërshtim me ligjin nr. 9936/2008, ligjin nr. 48/2014 dhe udhëzimet përkatëse të MF-së. Vonesat e përkohshme në

likuidimin e disa faturave gjatë vitit 2024 janë shkaktuar nga mungesa e stafit të specializuar financiar në institucion. Megjithatë, dëshirojmë të sqarojmë se të gjitha detyrimet janë përmbushur brenda vitit dhe në përputhje me afatin e përcaktuar nga Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018, pa krijuar dëm ekonomik apo penaltite. Kjo tregon respektimin e parimeve të ligjit nr. 9936/2008 për menaxhimin buxhetor, dhe pagesat janë realizuar brenda vitit buxhetor 2024. Për shpenzimet postare, kemi kërkuar fatura përmbledhëse nga Posta, pasi faturat që ishin të regjistruara në sistemin e tatimeve "Selfcare" nuk ishin të detajuara. Në vijim të komunikimeve, janë kërkuar gjithashtu informacionet mbi numrat e llogarive bankare, të cilat nuk ishin specifikuar në faturat tatimore. Ja disa nga faturat për shpenzimet postare që janë likuiduar brenda vitit:

1. USH nr. 173, datë 18.12.2024, shuma 175,055 lekë, për "Shpenzime postare" Mars-Nëntor
2. USH nr. 175, datë 19.12.2024, shuma 4,265 lekë, për "Shpenzime postare" Maj-Nëntor
3. USH nr. 177, datë 19.12.2024, shuma 33,430 lekë, për "Shpenzime postare" Maj-Nëntor
4. USH nr. 178, datë 27.12.2024, shuma 15,150 lekë, për "Shpenzime postare" Maj-Nëntor
5. USH nr. 179, datë 19.12.2024, shuma 11,350 lekë, për "Shpenzime postare" Maj-Nëntor
6. USH nr. 194, datë 27.12.2024, shuma 8,030 lekë, për "Shpenzime postare" Maj-Nëntor

Për shpenzimet e ujit, në vijim të komunikimeve me UKT Vlorë, kemi kërkuar fatura përmbledhëse, pasi zyra vendore Vlorë është me qira nga individë dhe faturat paguhen në emër të individëve. Kemi kërkuar faturat përmbledhëse si më poshtë:

1. USH nr. 219, datë 15.01.2025, shuma 98,220 lekë, për "Shpenzime Uji", fatura për periudhën Maj-Nëntor 2024.

2. USH nr. 221, datë 15.01.2025, shuma 172,068 lekë, për "Orendi Zyrash", fatura datë 23.12.2024, e cila është likuiduar brenda afateve ligjore 30-ditore.

Të gjitha këto veprime janë ndërmarrë për të siguruar që detyrimet të paguhen brenda afateve dhe në përputhje me ligjin, duke shmangur ndonjë shkelje të disiplinës buxhetore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me pretendimet sqarojmë se konfirmoni mangësitë që ka trajtuar grupi i auditimit. Observacioni nuk ka mbështetje ligjore.

Pretendimi i subjektit: Grupi i auditit ka konstatuar parregullsi mbi, pagesat për dietat e kryera në shumën totale prej 66,000 lekësh janë realizuar pa dokumentacion të plotë justifikues, Përsa i përket pagesës së dietave (në lidhje me shumën 66,000 lekë) për Urdhrin nr. 459 datë 18.12.2024, sqarojmë se janë pagesa të prapambetura të shërbimeve mbi dietat ditore për gjithë vitin 2024. Pagesat janë kryer me vonesë për shkak të mungesës së specialistit të financës pozicion i cili u plotësua në datë 05.12.2024, duke kryer kështu të gjitha pagesat e prapambetura të punonjësve. Grupi i punës ka kryer shërbimin në varësi të ngarkesës së punës. Urdhëri përfshin dhe pagesën e hotelit në rast se punonjësit do të ishin të detyruar për të fjetur në shërbim në varësi të ngarkesës së shërbimit. Duke qenë se shërbimet janë kryer brenda ditës është paguar vetëm dieta prej 1,000 lekë, bazuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008. Sa i përket dietave të z. Sh.S, sqarojmë se ka ndodhur një lapsus në urdhrin e dietës, ndërkohë që datat e faturave të hotelit kanë qenë të sakta dhe në përputhje me qëndrimin real.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me pretendimet sqarojmë se në urdhrin e titullarit datat e shërbimit janë të mirëpërcaktuara (13-16 Qershor 2024) për shërbimin jashtë vendbanimit që trajtohet me dietë të plotë dhe pretendimi juaj nuk ka bazë ligjore, përveç kësaj në dokumentacion mungon edhe urdhër shërbimi, një *financier për më tepër i ASH nuk mund të*

mbaj këtë qëndrim dhe të justifikoj shkeljen e legjislacionit financiar në fuqi. Observacioni nuk ka mbështetje ligjore.

Pretendimi i subjektit: Grupi i auditit ka konstatuar parregullsi mbi, konstatimet për proceset gjyqësore dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nga Avokatura e Shtetit.

Vendimet gjyqësore të shkallës së parë janë dhënë me ekzekutim të përkohshëm bazuar në nenin 317 të K.Pr.Civile.

Avokatura e Shtetit ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të themelit dhe ankim të veçantë kundër vendimit për dhënien me ekzekutim të përkohshëm të vendimit gjyqësor, bazuar në nenin 318 të Kodit të Procedurës Civile, duke pretenduar se gjykata nuk duhej të shprehej për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, dhe ka qenë në pritje të shqyrtimit të ankimit nga gjykata e apelit.

Nga ana përmbauesit gjyqësor privat është kërkuar zbatimi i vendimit gjyqësor të dhënë me ekzekutim të përkohshëm. Për këtë Avokatura e Shtetit i ka kthyer përgjigje duke kundërshtuar veprimin përmbauesor.

Avokatura e Shtetit i ka kthyer përgjigje se kundër vendimit gjyqësor me ekzekutim të përkohshëm është ushtruar e drejta e ankimit të veçantë sipas nenit 318 të Kodit të Procedurës Civile, ankim i cili nuk ishte shqyrtuar ende në kohën e paraqitjes së kërkesës nga përmbauesi gjyqësor privat.

Sipas Avokaturës së Shtetit, duke qenë se kundër vendimit gjyqësor që përcakton dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, është e parashikuar një dispozitë e posaçme në K.Pr.Civile që njeh të drejtën e ankimit të veçantë, ligjvënësi ka parashikuar këtë të drejtë për të garantuar kontrollin gjyqësor të një gjykatë më të lartë përpara se vendimi të vendoset në ekzekutim. Paraqitja e ankimit të veçantë paraprin edhe një gjykim të shpejtë dhe në një kohë të shkurtër, çka prezumon që pala e cila kërkon ekzekutimin e vendimit nuk do të qëndrojë në pritje njësoj si të kërkohej ekzekutimi i një vendimi gjyqësor të shkallës së dytë.

Nga ana tjetër, në rast se do të zbatohej vendimi i dhënë me ekzekutim të përkohshëm, përpara se të shqyrtohej ankimi i veçantë i ushtruar nga Avokatura e Shtetit, do të gjendeshim në kundërshtim me dispozitën e nenit 318 të K.Pr.Civile, duke e bërë tërësisht jo efektiv mjetin e ankimit të veçantë kundër vendimit nëpërmjet të cilit pranohet kërkesa për ekzekutim të përkohshëm.

Për këto arsye, Avokatura e Shtetit i ka kërkuar përmbauesve gjyqësorë të mos kryejnë veprime përmbauesore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, për sa kohë nuk është shqyrtuar ankimi i veçantë i ushtruar nga Avokatura e Shtetit, pasi në të kundërt do të mohohet e drejta e kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më të lartë e vendimit gjyqësor për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

Për sa i përket vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për të cilat është kërkuar ekzekutimi nga ana e përmbauesve gjyqësor privatë, Avokatura e Shtetit nuk ka kryer ekzekutimet për shkak se përcaktimi i vlerës së detyrimit duhet të kryhej nga një ekspert ose nëpërmjet gjykatës kompetente, për shkak se vlera e pagës referuese ka ndryshuar nga koha e dhënies së vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë deri në marrjen e formës së prerë.

Ndodhur në situata të tilla faktike dhe juridike, Avokatura e Shtetit ka qenë në pamundësi objektive për të shmangur kërkesat e subjekteve nëpërmjet përmbauesit gjyqësor për vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore, pasi ka mbrojtur një interes më të madh që është shmangia e llogaritjes së gabuar të vlerës së pagave, çka do të prodhonte një dëm më të lartë ndaj institucionit se sa kostot e përmbauesit gjyqësor. Për këtë arsye, bazuar dhe në parimin e proporcionalitetit, ka qenë më e rëndësishme të unifikohet një praktikë e drejtë se sa të zbatohet menjëherë një vendim gjyqësor i përllogaritur gabim, në një vlerë më të madhe se çfarë i takon kreditorit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se grupi i auditimit ka trajtuar vlerën e përfituar nga përmbaruesit privat jo si shkelje ligjore (në procedurat e ndjekura për gjyqet) por në aspektin ekonomik pasi nëse ndiqen procedurat brenda afateve kohore për likuidim do të eliminohej pagesa shtesë për përmbaruesit.

Pretendimi i subjektit: Në lidhje me konstatimin e bërë nga grupi i auditimit, sqarojmë se pasqyrimi i shpenzimeve përmes programit Excel gjatë vitit 2024 është diktuar nga mungesa e një programi financiar të dedikuar si dhe nga mungesa e personelit në strukturën e Drejtorisë së Financës. Pavarësisht kësaj, të gjitha veprimet financiare janë mbështetur me dokumentacion të plotë justifikues dhe janë tërësisht të verifikueshme. Përdorimi i Excel-it si mjet ndihmës për përpunimin dhe pasqyrimin e të dhënave kontabël është në përputhje me pikën 2.2 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, sipas së cilës çdo bartës tjetër informacioni kontabël konsiderohet dokument kontabël. Institucioni mbetet i angazhuar të përmirësojë sistemin e administrimit financiar, duke synuar kalimin në një platformë të plotë elektronike në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se nuk pasqyrohen vetëm shpenzimet, por edhe të ardhurat. Konfirmoni problematikat të cilat ka trajtuar grupi i auditimit, pra mungesa e punonjësit dhe shefit të financës nuk ka mundësuar mbajtjen e dokumentacionit financiar dhe llogarive. Observacioni nuk qëndron.

Pretendimi i subjektit: Grupi i auditit ka konstatuar parregullsi mbi 22 raste konstatohen fatura të kthyer nga thesari për mangësi të ndryshme shkaktuar nga dega e financës. Kthimi i faturave nga Thesari për plotësime apo saktësime të mëtejshme është një praktikë e zakonshme administrative që ndodh në të gjitha institucionet publike dhe nuk përbën shkelje ligjore në vetvete. Ky proces është pjesë e kontrollit paraprak financiar dhe ndihmon në garantimin e saktësisë dhe përputhshmërisë së dokumentacionit me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Për pasojë, këto kthime nuk përfaqësojnë veprime në kundërshtim me ligjin, por janë pjesë e procedurës normale të qarkullimit të dokumentacionit financiar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Konfirmoni problematikat të cilat ka trajtuar grupi i auditimit, pra mungesa e punonjësit dhe shefit të financës nuk ka mundësuar plotësimin e saktë të dokumentacionit, si edhe paaftësi në sektorin e financës pasi i njëjti urdhër shpenzim nr.171, datë 18.12.2024, objektin e shpenzimit e ka “shpenzime kompensim naftë” dhe në rubrikën dokumentet e urdhër shpenzimit për kreditorin përfitues e ka “shpenzime udhëtim e dieta”. Observacioni nuk qëndron.

Pretendimi i subjektit: Grupi i auditit ka konstatuar parregullsi mbi, nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël te kryera. Në lidhje me konstatimin mbi mungesën e Librit të Madh, Librit Centralizator dhe Librit të Veprimeve të Ndryshme, sqarojmë se evidencimi i veprimeve kontabël është kryer në mënyrë kronologjike dhe sistematike, bazuar në dokumentacionin justifikues dhe mbi bazën e transaksioneve reale të kryera gjatë vitit ushtrimor 2024. Ndërkohë, pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e udhëzimeve në fuqi të Ministrisë së Financave, dhe të dhënat janë gjeneruar në mënyrë të përmbledhur nga ditarët e bankës, listë pagesat e pagave, veprimet e magazinës, si dhe kartelat përkatëse të shpenzimeve. Theksojmë se duke qenë se institucionet publike nuk janë të pajisura me sisteme të mirëfillta të programit kontabël, veprimet janë realizuar me mjetet në dispozicion, dhe informacioni është ruajtur dhe administruar sipas praktikave të ndjekura nga Drejtoria e Financës. Për më tepër, veprimet e mbylljes së vitit janë kryer sipas renditjes logjike të përcaktuar në nenin 3.2 të Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 të MFE.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se mbajtja e kontabilitetit nuk është vetëm ditari i bankës, mungojnë analizat e llogarive, ditari i magazinës, etj, të trajtuara në akt konstatime. Observacioni nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit: Grupi i auditit ka konstatuar parregullsi mbi, për vitin 2024, komisioni i inventarizimit ka hartuar 2 procesverbale ku ka pasqyruar aktivet materiale në vlerën 1,053,103 leke që i vlerëson për nxjerrje jashtë përdorimi duke llogaritur edhe amortizimin e tyre, veprim në kundërshtim me pikën 102, të UKM nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Avokatura e Shtetit pranon se komisioni i inventarizimit ka hartuar dy procesverbale për vitin 2024, ku janë pasqyruar aktive materiale në vlerën 1,053,103 lekë dhe është vlerësuar nxjerrja e këtyre aktiveve jashtë përdorimit, duke llogaritur edhe amortizimin përkatës. Megjithatë, duhet theksuar se procesi i vlerësimit është kryer duke u bazuar në gjendjen fizike të aktiveve dhe amortizimin e tyre, duke marrë parasysh rrethanat specifike të përdorimit të këtyre pasurive. Pavarësisht se komisioni nuk ka dhënë shpjegime të detajuara mbi kriteret e vlerësimit të përdorura për nxjerrjen jashtë përdorimi, Avokatura e Shtetit është e angazhuar për të përmirësuar këtë proces dhe për të ngritur komisionin përkatës të vlerësimit, në përputhje me kërkesat e pikës 103 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, dhe për të siguruar plotësimin e kërkesave ligjore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se konfirmoni të njëjtën mangësi që ka trajtuar grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit: Grupi i auditit ka konstatuar parregullsi mbi, komisionin e vlerësimit të aktiveve të cilat janë vlerësuar nga komisioni i inventarizimit si aktive për jashtë përdorimi, në kundërshtim me pikën 96, të UKM nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Prosesi i inventarizimit është realizuar në përputhje me legjislacionin dhe kërkesat e përcaktuara, duke u bazuar në gjendjen fizike dhe amortizimin e aktiveve. Pika 99 e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik" citon: *"Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se 3 persona të cilët janë menaxhere ose specialistë të financës si dhe specialiste të fushës përkatëse sipas natyrës së aktiveve që propozohen për dalje nga përdorimi. Kryetar i komisionit të vlerësimit është Nëpunësi Zbatues i njësisë. Nëpunësi/punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit", por jo në përbërje të komisionit.*" Ashtu siç është shpjeguar dhe gjatë periudhës së auditimit pozicioni i specialistit të financës gjatë vitit 2024 ka qenë vakant dhe është plotësuar nga Departamenti i Administratës Publike më 05.12.2024, ndërkohë pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka qenë vakant gjatë vitit 2024 dhe ende nuk është plotësuar nga Departamenti i Administratës Publike. Sa më sipër sqarojmë se, në bazë të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e Sektorit Publik", mungesa e Specialistit të fushës përkatëse (Financë) e bën të pamundur krijimin e komisionit të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sqarojmë se konfirmoni të njëjtën mangësi që ka trajtuar grupi i auditimit.

2.4. Prokurimet me fonde publike

-Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik,
-lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave/ punëve dhe shërbimeve.

Avokatura e Shtetit për periudhën objekt auditimi nuk ka zhvilluar procedura prokurimi mbi 1,000,000 lekë. Për periudhën 01.01.2023 deri në 31.12.2024, grupi i auditimit, për të

realizuar qëllimin dhe objektin e auditimit të përputhshmërisë mbi prokurimet publike, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore, si mëposhtë:

- Ligji nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,
- VKM nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”,
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe çdo akti juridik që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit.

Regjistrat e parashikimit dhe ato të realizimit të prokurimeve që i përkasin periudhës së auditimit, janë paraqitur brenda afateve sipas viteve buxhetore dhe janë dërguar on-line, pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP).

Viti	Procedura			Fondi		
	Parashikuar	Realizuar	% realizimit	Parashikuar	Realizuar	% realizimit
2023	24	19	79%	11,265,566	6,225,400	55%
2024	28	20	71%	11,366,514	5,529,143	48%

Burimi: Të dhënat e ASH, përpunuar nga grupi i auditimit:

Me shkresën nr. 302, datë 17.02.2023 miratuar nga titullari i institucionit i është dërguar degës së thesarit regjistri i parashikimit të 24 procedurave të prokurimit për vitin 2023.

Me shkresën nr. 565, datë 31.01.2024 miratuar nga titullari i institucionit i është dërguar degës së thesarit regjistri i parashikimit të 28 procedurave të prokurimit publik, nga ASH për vitin 2024.

Për vitin 2023, janë kryer gjithsej 19 procedura prokurimi “Blerje me vlerë të vogël” përfshirë edhe procedura nën vlerën 100,000 lekë pa TVSH.

Janë ngritur komisionet në fillim viti për “blerjet me vlera të vogla”, si më poshtë:

Me urdhrin nr, 124 datë 09.01.2023 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me objekt “*Krijimi i komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2023*”, i përbërë nga L. N. - Kryetar, A. T. dhe J. Z., anëtar.

Me urdhrin nr, 125 datë 09.01.2023 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me objekt “*Ngritjen e Komisionit të Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar për vitin 2023*”, i përbërë nga L. N. -Kryetar, A. T. dhe J. Z., anëtar.

Grupi i auditimit ka audituar të gjitha procedurat e prokurimit. Nga auditimi i procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) dhe dokumentacionit bashkëlidhur praktikave të likuidimit për vitin 2023, rezultoi si më poshtë:

-Urdhër prokurimi Nr. 37, datë 23.01.2023 “*Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Strasburg-Tiranë*” në vlerën 100,600 lekë, likuiduar me urdhër-shpenzimin nr. 53, datë 23.02.2023. OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13, të Udhëzimit Nr. 3, datë 18.06.2021, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

-Urdhër prokurimi Nr. 526 datë 01.12.2023, “*Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Strasbourg*” dhe kthimi Paris-Tiranë në vlerën 140,649 lekë likuiduar me urdhër-shpenzimin nr. 367, datë 22.01.2024. Konstatohet se kërkesa për dhënie miratimi për shërbim jashtë vendit drejtuar Kryeministrit, nga Avokatura e Shtetit është e datës 01.11.2023, ndërsa miratimi i kërkesës nga Departamenti i Mirëadministrimit pranë Kryeministrit është i datës 13.11.2023. OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

-Urdhër prokurimi Nr. 306 , datë 15.06.2023, “*Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Hagë-Tiranë*” në vlerën 121,500 lekë likuiduar me urdhër shpenzimin nr. 197, datë 07.07.2023. Konstatohet se nuk janë pjesë e dosjes deklarata mbi konfliktin e interesit si dhe deklarata mbi gjendjen gjyqësore të cilat duhen plotësuar nga operatori ekonomik. OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për Ofertë të AK. OE nuk kanë dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

-Urdhër prokurimi Nr. 274 datë 31.05.2023, “*Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Strasbourg-Tiranë*” në vlerën 107,500 lekë likuiduar me urdhër-shpenzimin nr. 165 datë 02.06.2023. OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për Ofertë të AK. OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

-Urdhër prokurimi Nr. 205 datë 20.04.2023, “*Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Bruksel-Tiranë*” në vlerën 52,785 lekë . OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar dokumentin (mungon) “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

-Urdhër prokurimi Nr. 194/1 datë 14.04.2023, “*Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Bruksel –Tiranë*” në vlerën 69,000 lekë likuiduar me urdhër –shpenzimin nr. 144 datë 17.05.2023 . OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA” por fotokopje , sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

-Urdhër prokurimi Nr. 155 datë 23.03.2023, “*Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Paris - Tiranë*” në vlerën 44,660 lekë . OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit por fotokopjen “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021

i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë. -Urdhër prokurimi Nr. 422 datë 30.08.2023, “Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Stamboll –Tiranë” në vlerën 63,500 lekë likuiduar me urdhër-shpenzimin nr. 286 datë 16.10.2023. OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit por fotokopje “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

-Urdhër prokurimi Nr. 513 datë 17.11.2023, “Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Paris–Tiranë” në vlerën 29,500 lekë likuiduar me urdhër-shpenzimin nr. 352 datë 26.12.2023. OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për ofertë të AK. OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021 i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

Për vitin 2024, janë kryer gjithsej 20 procedura prokurimi të cilat janë blerje me vlerë të vogël përfshirë edhe procedura nën vlerën 100,000 lekë pa TVSH.

Janë ngritur komisionet në fillim viti për “blerjet me vlera të vogla”, si më poshtë:

Me urdhrin nr.01, datë 04.01.2024 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me objekt “Krijimin e komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël për vitin 2024”, i përbërë nga L. N. Kryetar, A.T.dhe J.Z., anëtar.

Me urdhrin nr, 02 datë 05.01.2024 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me objekt “Ngritjen e Komisionit të Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar për vitin 2024” i përbërë nga J. Z.-Kryetar, A. T.dhe I. B., anëtar.

Grupi i auditimit ka audituar të gjitha procedurat e prokurimit. Nga auditimi i procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) dhe dokumentacionit bashkangjitur praktikave të likuidimit për vitin 2024, rezultoi si më poshtë vijon:

-Urdhër prokurimi Nr. 42, datë 01.03.2024, “Blerje 1 biletë avioni për itinerarin Tiranë-Mynih-Tiranë” në vlerën 53,000 lekë. OE i përzgjedhur fitues nuk ka dorëzuar origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentit por fotokopje “Certifikatë e akreditimit nga IATA/vërtetim nga IATA”, sipas kërkesave të përcaktuara në ftesën për Ofertë të AK. OE nuk ka dorëzuar dokumentacionin në zbatim të kërkesave të pikës 6 dhe 13 të Udhëzimit Nr. 3 datë 18.06.2021, i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4 datë 20.05.2022. Dorëzimi i dokumentacionit provues nga OE fitues duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK në ftesën për ofertë.

Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit “Blerje me vlera të vogla” u konstatuan problematikat e mëposhtme:

➤ Referuar regjistrin të parashikimit të procedurave të prokurimit si dhe regjistrin të realizimit për vitin 2023 janë planifikuar gjithsej 24 procedura prokurimi me fond limit 11,265,566 lekë dhe janë realizuar 19 prej tyre me vlerë 6,225,400. Realizimi i procedurave të prokurimit në numër paraqitet në nivelin 79% dhe në vlerë në nivelin 55%. Pra, referuar realizimit të blerjeve me vlera të vogla nga Autoriteti Kontraktor kërkesat për prokurime nuk janë bazuar në nevojat reale të institucionit me qëllim kryerjen e prokurimit me EEE, në respektim të kërkesave të nenit 2, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021”Për hartimin e regjistrin të parashikimeve të

procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”.

-Referuar regjistrit të parashikimit të procedurave të prokurimit si edhe regjistrit të realizimit për vitin 2024 janë planifikuar gjithsej 28 procedura prokurimi me fond limit 11,366,514 lekë dhe janë realizuar 20 prej tyre me vlerë 5,529,143 lekë. Realizimi i procedurave të prokurimit në numër paraqitet në nivelin 71% dhe në vlerë në nivelin 48%. Pra, referuar realizimit të blerjeve me vlera të vogla nga Autoriteti Kontraktor kërkesat për prokurime nuk janë bazuar në nevojat reale të institucionit me qëllim kryerjen e prokurimit me EEE, në respektim të kërkesave të nenit 2, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar edhe në kundërshtim me udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021”*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”.*

➤ **Blerjet nën 100,000 lekë**

Avokatura e Shtetit për vitin 2023, për blerjet nën 100,000 lekë, ka zhvilluar 7 procedura me fond limit 699,900 lekë, ndërsa për vitin 2024 ka zhvilluar 10 procedura me fond limit 999,918 lekë. Këto procedura janë kryesisht për blerje materiale elektrike, materiale hidraulike, larje automjetesh, sigurim automjetesh, goma dhe pjesë këmbimi, riparim dhe mirëmbajtje pajisjesh elektronike, shërbime të ndryshme, etj.

Konstatohet se në të gjitha procedurat e blerjeve nën 100,000 lekë, bazuar në regjistrat e parashikimit fondi limit i parashikuar është në të njëjtën vlerë 99,999 lekë për çdo procedurë. Pra vlera limit është përcaktuar sa e lejon limiti në legjislacionin e prokurimit publik. Veprime që tregojnë se nga AK nuk janë parashikuar fondet për blerjet sipas nevojave dhe llogaritje të fondit për çdo blerje/shërbim, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr. 4, datë 18.06.2021”*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”.*

2.5. Mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, funksionimi i strukturës së Auditit të Brendshëm.

Për vlerësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Rregullore e Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhërin nr. 68, datë 28.3. 2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, i ndryshuar.

-Urdhër i Kryeministrit nr.58, datë 25.3.2019 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetit*”.

-Urdhër i Kryeministrit nr.88, datë 29.5.2024 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetit*”.

-Urdhër i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr.351, datë 07.7.2023 “*Për miratimin e Kodit të Etikës në Avokaturën e Shtetit*”.

-Shkresat e përcaktimit të NA dhe NZ në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar;

-Deklarata për cilësinë dhe kushtet e kontrollit të brendshëm në ASH dhe raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnimet e tyre;

-Lista ose harta e proceseve të punës;

-Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe dërgimi i tij në Ministrinë e Financave.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit pranë Avokaturës së Shtetit u realizua bazuar në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar si dhe aktet e tjera nënligjore. Sipas përcaktimeve të këtij ligji, menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektivitet të shërbimeve publike. *Kontrolli i brendshëm* përbëhet nga pesë komponentë të ndërlidhur, të cilët ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si më poshtë:

- Mjedisi i kontrollit;
- Menaxhimi i riskut;
- Aktivitetet e kontrollit;
- Informimi dhe komunikimi;
- Monitorimi.

Lidhur me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi si më poshtë:

I. Mjedisi i Kontrollit

Ky komponent i kontrollit të brendshëm përshkruan kushtet bazë të nevojshme për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm kontrolli në një njësi të caktuar. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë, filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës, mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta, organizon e zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep niveli drejtues. Ky mjedis ndikohet më tej nga struktura organizative e njësisë dhe marrëdhëniet e llogaridhënies.

Avokatura e Shtetit është person juridik publik, në varësi të Kryeministrit që ka për mision eskuzivitetin e dhënies së asistencës juridike, i cili përfshin shërbimin këshillimor dhe të përfaqësimit për personat juridik shtetëror. Fusha e zbatimit të veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit konsiston në ofrimin e asistencës juridike, për personat juridikë të mëposhtëm: a) institucionet shtetërore; b) entet publike; c) shoqëritë e krijuara ose që veprojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku aksioneri shtetëror ka të drejtë të emërojë shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë ose zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve apo kuotave.

Avokatura e Shtetit është institucion i centralizuar i cili drejtohet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe organizohet në dy nivele: a) Avokatura e Shtetit në nivel qendror dhe b) Avokatura e Shtetit në nivel vendor. *Avokatura e Shtetit në nivel qendror përbëhet nga:*

- a) zyra e përfaqësimit ligjor në gjykatat kombëtare;
- b) zyra e këshillimit dhe koordinimit ndërministror;
- c) zyra e përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar;
- ç) zyra e inspektimit;
- d) Kolegji i Avokaturës së Shtetit.

Avokatura e Shtetit në nivel vendor përbëhet nga:

- a) zyrat vendore;
- b) avokatët e shtetit ose zyrat e Avokaturës së Shtetit pranë ministrive.

Avokatura e Shtetit ka në përbërjen e saj edhe administratën.

1.1 “Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike”.

Në referencë të ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe

të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar, kap. III, pika 3.1, kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje.

Institucioni i Avokaturës së shtetit ka hartuar dhe miratuar Kodin e etikës me Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr.351, datë 07.07.2023, i cili parashikon rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale të punonjësve të ASH në nivel qendror dhe vendor. Në zbatim të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "*Për Avokaturën e Shtetit*", i ndryshuar, të Rregullores së Brendshme të institucionit dhe Kodit të Etikës, përmes zyrës së inspektimit (*si struktura në nivel qendror, përgjegjëse për kryerjen e kontrollit në të dyja nivelet e organizimit*) ushtrohen kontrole periodike sipas planit vjetor²⁶ në të gjitha zyrat vendore të ASH, kryhen kontrole tematike në varësi të problematikës së konstatuar si dhe shqyrton çdo ankesë të qytetarëve apo të institucioneve që avokatët e shtetit përfaqësojnë lidhur me shkelje të rregullave të etikës. Për çdo rast zyra e inspektimit përgatit raportin e inspektimit me gjetjet e konstatuara, rekomandimet për përmirësimin e punës, si dhe propozimet për masat disiplinore, nëse ka konstatuar shkelje të etikës.

Për periudhën 2023-2024 institucioni ka funksionuar sipas rregullores së brendshme të miratuar me Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr.68 prot, datë 28.03.2019, i ndryshuar me Urdhërin nr.348, datë 06.07.2023. Aktet ligjore dhe nënligjore me të cilat rregullohet veprimtaria e Avokaturës së Shtetit janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

1.2 "Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje".

Në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "*Për Avokaturën e Shtetit*", i ndryshuar, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit drejton, organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e institucionit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij, si dhe planifikon e administron buxhetin vjetor të Avokaturës së Shtetit.

Mbikëqyrja e performancës operationale në funksion të realizimit të objektivit kryesor të institucionit, përfaqësimit dhe këshillimit të çdo rasti të parashikuar me akte ligjore dhe nënligjore, realizohet nga drejtuesit e zyrave në nivel qendror dhe vendor, të cilët organizojnë punën, ndjekin dhe mbikëqyrin realizimin e detyrës nga punonjësit e zyrës që ata drejtojnë. Në bazë të informacionit të dhënë nga çdo drejtues zyre në nivel qendror dhe vendor, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit realizon mbikëqyrjen e punës së institucionit. Gjithashtu nga drejtuesit e zyrave çdo muaj raportohet një statistikë e hollësishme, lidhur me çështjet e reja gjyqësore të ardhura dhe me çështjet gjyqësore të përfunduara gjatë muajit. Çdo vit realizohet analiza vjetore e punës²⁷ së institucionit dhe në veçanti analiza e punës për çdo zyrë vendore të Avokaturës së Shtetit.

Sa i përket delegimit të kompetencave, në rregulloren e brendshme përcaktohen pjesërisht rregullat që trajtojnë delegimin e detyrave. Përgjegjësitë menaxheriale janë të mirë përcaktuara nga vetë organizimi i punës së Avokaturës së Shtetit në dy nivele: qendror dhe vendor. Delegimi i kompetencave bëhet në raste të mungesave të menaxherëve (kryetarëve të Zyrave ose Drejtorisë) me miratim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Për vitin 2023 nuk ka raste

²⁶- Me urdhërin nr. 27, datë 20.01.2023 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është miratuar plani i inspektimit për vitin 2023. - Me urdhërin nr. 5, datë 08.01.2024 "*Për miratimin e planit vjetor të Zyrës së Inspektimit në Avokaturën e Shtetit*" është miratuar plani i inspektimit për vitin 2024.

²⁷ Raport vjetor i Avokaturës së Shtetit për vitin 2023, nr.540 prot, datë 31.1.2024
Raport vjetor i Avokaturës së Shtetit për vitin 2024, nr.696 prot, datë 31.1.2025


të delegimit të kompetencave. Ndërsa për vitin 2024 evidentohet se me urdhërin nr.2093, datë 29.04.2024 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit "Për delegim kompetencash", nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit i janë deleguar kryetarit të zyrës vendore Lushnje, kompetencat për kryerjen e detyrave të nëpunësit zbatues, lidhur me detyrat financiare të Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

- Lidhur me detyrimet ligjore që burojnë nga ligji nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" si dhe VKM-së nr.816, datë.16.11.2016, "Për strukturën, kriteret e për zgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike", konstatohet se: Inspektimi i rasteve të denoncuarra për çdo ankesë kryhet nga një grup pune i ngritur me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, i cili përbëhet nga Avokat Shteti pranë Zyrës së Inspektimit, të cilët në përfundim të hetimit, nëpërmjet raportit informojnë Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit me gjetjet e konstatuara gjatë kontrollit. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit e kalon këtë praktikë për shqyrtim disiplinor nga Komisioni i Disiplinës,²⁸ sipas nenit 32 dhe 32/1 të ligjit nr. 10018/2008 të ndryshuar. Me Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm i Shtetit nr.269, datë 22.07.2022 është ngritur njesia përgjegjëse për kryerjen e procedurave në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve". Për periudhën objekt auditimi nuk janë raportuar raste mashtrimi apo abuzimi.

1.3 Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Për periudhën objekt auditimi, Avokatura e Shtetit ka funksionuar sipas kufirit organik të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 88, datë 29.5.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokatura e Shtetit" dhe ka një numër të përgjithshëm prej 107 punonjësish. Pas miratimit të VKM-së nr. 65, datë 14.02.2024 "Për organizimin e zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit", me Urdhërin nr. 88, datë 29.05.2024 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Avokaturës së Shtetit" u miratua edhe numri aktual i avokatëve të shtetit në nivel vendor dhe qendror, me qëllim përshtatjen sipas ngarkesës së punës dhe ndryshimeve në organizimin dhe shpërndarjen e gjykatave²⁹. Organizimi i Avokaturës së Shtetit dhe strukturës së zyrave vendore u krye në përputhje me ri-organizimin e rretheve gjyqësore, duke mbajtur në konsideratë edhe kapacitetet e tyre për shqyrtimin e çështjeve sipas numrit të bashkive në kompetencën territoriale përkatëse. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe ka përbërjen sipas paraqitjes skematike si më poshtë:

STRUKTURA E AVOKATURËS SË SHETIT



Burimi: Avokatura e Shtetit

²⁸ Urdhër nr.5286 prot, datë 17.10.2023 "Për një ndryshim të urdhrit të avokatit të përgjithshëm të shtetit nr.278, datë 28.7 2022 "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e komisionit të disiplinës pranë avokaturës së Shtetit"

²⁹ VKM nr. 495/2022, "Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave".

Nga auditimi u konstatua se gjatë periudhës 2023-2024, ASH ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur vende vakante, kjo në mospërputhje me strukturën organike të miratuar me Urdhër të Kryeministrit. Konkretisht për vitin **2023**, pozicionet vakante kanë qenë si vijon:

- Avokat shteti në zyrën vendore Korçë	1
- Jurist në Strasburg	1
- Juristë	3
- Specialist i burimeve njerëzore	1
- Specialist protokoll/arkivi	1
Totali	7

Gjatë vitit **2024**, Avokatura e Shtetit ka pasur 16 vende vakante, konkretisht pozicionet vakante janë si vijon:

- Avokat shteti pranë ministrive	5
- Specialistë pranë zyrës së përfaqësimit ligjor në gjykata kombëtare, (<i>pozicione pjesë e strukturës si nëpunësve civile</i>)	3
- Jurist në Strasburg	1
- Specialist përkthyes pranë zyrës së përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, (<i>pozicione pjesë e strukturës si nëpunësve civile</i>)	2
- Avokat shteti në zyrën vendore Lushnjë	2
- Drejtor i financës dhe shërbimeve mbështetëse	1
- Specialist protokoll/arkivi	1
- Specialist prokurimesh	1
Totali	16

Për **vitin 2023** janë dërguar vakancat pranë DAP përmes shkresës nr.1063, datë 24.02.2023, për shpallje të vendeve vakante në shërbimin civil për 3 specialist jurist dhe 1 specialist të burimeve njerëzore, ndërsa për 2 pozicionet e tjera nuk dokumentohet kryerja e njoftimeve.

Ndërsa për **vitin 2024** sipas komunikimeve elektronike të datës 04.09.2024 për pozicionin specialist prokurimi, dhe email datë 30.12.2024 për 7 pozicione specialist.

Rezulton se, Drejtoria e financës dhe shërbimeve si struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore nuk ka përgatit planin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil referuar parashikimeve në VKM nr.108, datë 26.2.2014 “*Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil*” pika³⁰ 5, shkronja “b”, si dhe rregullores së brendshme miratuar me Urdhërin nr. 68, datë 28.03. 2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, neni 21.

Avokati i Përgjithshëm i Shtetit z. O. M është emëruar me Vendimin nr.27, datë 19.01.2022 të Këshillit të Ministrave, me propozim të Kryeministrit. Roli i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit është kryesisht garantues e menaxherial, dhe mban përgjegjësi përpara Kryeministrit në lidhje me veprimet zbatuese dhe rezultatet e administratës së tij.

Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të MFK, në të gjitha njësitë, strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset e drejuara prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar

³⁰ *Institucionet në varësi të Kryeministrit apo të ministrave, jo më vonë se muaji tetor i çdo viti kalendarik, e paraqesin planin e nevojave për rekrutim, përkatësisht te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave apo te ministri përkatës deri në fund të muajit tetor.*

dhe transparencës. Për vitin 2023 vijon emërimi i Nëpunësit Zbatues³¹ (NZ) sipas Urdhrit nr.132, datë 27.8.2020, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit në përputhje me ligjin, të përshtatur me pozicionin si drejtor e drejtorisë së financës dhe shërbimeve mbështetëse. Drejtoria e financës përbëhet nga drejtori dhe specialisti i financës.

Me Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 6207 prot, datë 30.11.2023 është ndërprerë marrëdhënia e punës për zj. E.Gj. në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së financës dhe shërbimeve mbështetëse. Prej datës 30.11.2023 dhe në vijim pozicioni i drejtorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse ka mbetur vakant. Specialistja e financës ka kryer edhe detyrat e nëpunësit zbatues nga data 06.12.2023-12.04.2024. Për periudhën 29.04.2024 dhe në vijim, detyrat e Nëpunësit Zbatues janë kryer nga një nëpunës i deleguar me urdhër të titullarit/ Avokatit të Përgjithshëm. Gjithashtu, pozicioni i specialistes së financës ka qenë vakant nga data 12.04.2024 -05.12.2024.

Lidhur me veprimet nëpërmjet arkës në valutë për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në aktivitete jashtë vendit të punonjësve, për vitin 2023 me autorizim të titullarit magazinieri ka mbuluar funksionin e arkëtarit, veprime në mospërputhje me nenin 9, pika 4 shkronja f) të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar.

Konstatim: Mungesat në staf në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse kanë ndikuar në drejtim të funksionimit të kësaj strukture duke mos garantuar ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, bazuar në nenin 22, pika 3, shkronja b) të ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.

Me urdhrin nr. 32, datë 22.02.2024 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit "*Për ngritjen e grupit të punës për draftimin e projekt akteve të Avokaturës së Shtetit*" është ngritur grupi i punës për përgatitjen e ndryshimeve në rregulloren e brendshme dhe aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Avokaturës së Shtetit, në zbatim dhe në përputhje me ndryshimet që pësoi ligji "*Për Avokaturën e Shtetit*", nëpërmjet ligjit nr. 91/2023. Aktualisht rregullorja e re është drejt përfundimit, duke qenë se gjatë fundit të vitit 2024 u miratua dhe Rregullorja "*Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe norma të posaçme procedurale*", nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 20.11.2024. Duke qenë se një pjesë e ndryshimeve që janë kryer nëpërmjet këtij vendimi, duhen reflektuar edhe në Rregulloren e Brendshme të Avokaturës së Shtetit, kjo e fundit nuk është miratuar me qëllim përfshirjen e të gjitha ndryshimeve, për të mos u bërë sërish objekt ndryshimesh në një të ardhme të afërt.

1.4 "Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave".

Politikat e burimeve njerëzore dhe praktikat e ngjashme lidhen me rekrutimin, emërimin, trajnimin, vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë dhe veprimet disiplinore, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kontrollit të brendshëm. Burimet njerëzore, referuar strukturës së miratuar menaxhohen nga Drejtoria e financës dhe shërbimeve mbështetëse.

³¹ Për periudhën dhjetor 2023 - prill 2024 detyrat e Nëpunësit Zbatues janë kryer nga zj.M.Sh. bazuar në Urdhrin nr.530, datë 15.12.2023 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit "*Për delegim kompetencash të drejtorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse*";

Për periudhën prill 2024 – në vijim, detyrat e Nëpunësit Zbatues janë kryer nga z.A.H. bazuar në Urdhrin nr.111, datë 29.4.2024 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit "*Për delegim kompetencash të Drejtorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse*", njoftuar Dega e Thesarit me shkresën nr.2093/1 prot, dt. 02.5.2024.

Marrëdhëniet e punës për Avokatët e Shtetit rregullohen sipas ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit" i ndryshuar, vlerësimi periodik i punonjësve bëhet në bazë të nenit 25 dhe 34 të ligjit si dhe nenit 9 të Rregullores së Brendshme, miratuar me Urdhërin nr. 68, datë 28.3. 2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit", sipas të cilit vlerësimi i Avokatëve të Shtetit kryhet një herë në vit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve. Vlerësimi i performancës inkurajon zhvillimin profesional të punonjësve dhe ofron mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt. Bazuar në nenin 9, pika 4, shkronja dh) të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"(i ndryshuar), përcaktohet se: "Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore:-mbikëqyrjen dhe menaxhimin efektiv të punonjësve të njësisë dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional për menaxhimin financiar dhe kontrollin."

Procedurat e ndjekura për rekrutimin e Avokatëve të Shtetit bazohen në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar dhe në Rregulloren e Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit", miratuar me Urdhërin nr. 68, datë 28.3. 2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. Për nëpunësit civil rekrutimi bëhet sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësit civil". Përshkrimi i punës është pjesë përbërëse e Rregullores së Brendshme.

Referuar nenit 34 të ligjit nr. 10 018/2008, i ndryshuar, rekrutimi i Avokatëve të Shtetit për vitin 2024 e në vazhdim bëhet nëpërmjet Shkollës së Magjistraturës. Kandidatët për avokat shteti konkurrojnë pranë Shkollës së Magjistraturës pasi Avokatura e Shtetit, në fillim të çdo viti kalendarik përcakton numrin maksimal të kandidatëve që do të pranohen për vitin e ri akademik në Programin e Formimit Fillestar për pozicionet e lira në Avokaturën e Shtetit.

Për vitin 2024 ka pasur problematika lidhur me rekrutimin e avokatëve të shtetit. Konkretisht gjatë këtij viti rekrutimi i Avokatëve të Shtetit do të kryhej nëpërmjet konkurrimit në Shkollën e Magjistraturës dhe kryerjes së programit të formimit fillestar. Duke qenë se gjatë fillim vitit 2024 në Avokaturën e Shtetit nuk ka pasur vende vakante, nuk është dërguar kërkesë pranë Shkollës së Magjistraturës për shpalljen e vendeve vakante. Në vijim, gjatë të njëjtit vit, janë krijuar gjithsej 7 (shtatë) vende vakante për avokatë shteti, për të cilat gjatë vitit 2025 është kërkuar shpallja nga Shkolla e Magjistraturës e konkurrimit për profilin avokat shteti.

Për të realizuar trajnimin e vazhdueshëm të Avokatëve të Shtetit me qëllim ngritjen profesionale të tyre, institucioni i Avokaturës së Shtetit ka lidhur marrëveshje me Shkollën e Magjistraturës, bazuar në nenin 20 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit". Çdo fillim viti Shkolla e Magjistraturës dërgon programin e trajnimeve të formimit vazhdues që zhvillohen në të drejtën civile, administrative dhe penale, në të cilat marrin pjesë magjistratë gjyqtarë/prokurorë, këshilltarë, ndihmës ligjorë dhe avokatët e shtetit në të dyja nivelet e Avokaturës së Shtetit, qendror dhe vendor. Programi i dërgohet avokatëve të shtetit për të bërë përzgjedhjet e temave që kanë interes për të marrë pjesë në trajnime, të cilat përgjithësisht kanë një kufi përzgjedhje deri në 30 trajnime. Pasi bëhet përzgjedhjet e temave nga avokatët e shtetit, listat përkatëse i dërgohen Shkollës së Magjistraturës nëpërmjet e-mail dhe në vijim për çdo trajnim që zhvillohet, kjo e fundit njofton individualisht avokatët e shtetit. **Konstatohet se** për periudhën objekt auditimi nuk ka të dhëna mbi trajnimet e kryera nga avokatët e shtetit. Për sa i përket trajnimeve për nëpunësit civil nuk ka një planifikim dhe evidentim të nevojave për trajnim.

Lidhur me procedurat e largimeve nga puna, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2024, në ASH janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 25 punonjës (me motiv dorëheqje), 2 raste zgjidhje kontrate dhe një rast (ndërrim jete).

II. “Menaxhimi i Riskut”

2.1 “Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.”

Objektivi kryesor i avokatëve të shtetit është përfaqësimi dhe këshillimi i çdo rasti të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Mbi bazën e misionit dhe objektivit, hartohet dokumenti i PBA për shpenzimet koherente dhe për investimet. Objektivat institucional përcaktohen në raportet periodike “*Për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm*” si dhe raportet vjetore të institucionit. Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, për periudhën **2023-2024** u konstatua se:

-Institucioni nuk ka krijuar mekanizmat e vlerësimit të riskut pasi, nga titullari nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, organ i cili luan një rol të rëndësishëm në drejtim të integritetit të informacionit financiar, sistemin e saj të kontrollit të brendshëm si dhe kujdeset për performancën e njësisë publike; GMS duhet të sigurojë që komponentët e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimi efektiv i risqeve janë të pranishëm dhe funksionojnë siç duhet në njësinë publike.

Veprime në kundërshtim me nenin 8, pika 8, shkronja b), e ligjit nr.10296, datë 08.007.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” (i ndryshuar).

-Titullari nuk ka miratuar Strategjinë e Menaxhimit të Riskut ose planin e menaxhimit për trajtimin e risqeve, dokument i cili përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut, veprime në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, të ndryshuar.

Plani i menaxhimit për trajtimin e risqeve përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

2.2. “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

Nga strukturat përgjegjëse nuk kryhet identifikimi, vlerësimi, kontrolli dhe monitorimi i risqeve në të gjitha nivelet e saj me qëllim arritjen e objektivave dhe si rrjedhojë nuk është dokumentuar procesi i menaxhimit të riskut në një regjistër. Veprime në kundërshtim me nenin 11, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” (i ndryshuar), si dhe Udhëzimin nr.16, dt.20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”.

2.3. “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

Titullarët e njësive kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr.3588/1, datë 22.7.2022 është ngritur njësia përgjegjëse në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”. Institucioni nuk ka hartuar

rregullore mbi sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe nuk ka evidenca të vlerësimit dhe monitorimit të riskut të mashtrimit/planit të veprimit.

2.4. “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Nga subjekti nuk janë analizuar apo marrë në konsideratë ndikimet e mundshme ekzistuese në sistemin e kontrollit të brendshëm.

III “Aktivitetet e Kontrollit”

3.1 “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

Aktivitetet e kontrollit janë rregulla, procedura dhe veprime që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar përcaktohet se “Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi”.

-Avokatura e Shtetit nuk ka të hartuar gjurmën e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të institucionit dhe që sigurojnë se të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, sipas përcaktimit në nenin 16, pikat 2 dhe 3, nenin 22 dhe nenin 23 pika 5 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar), si dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga (NZ). Hartimi dhe regjistrimi i pagesës kryhet nga specialisti i financës, ndërsa autorizimi i pagesës nga NA.

-Në kuadër të detyrimeve ligjore për menaxhimin e aktiveve konstatohet se, nga nëpunësi autorizues nuk janë marrë masa për ngritjen e komisionin të vlerësimit të aktiveve të cilat janë relatuar nga komisioni i inventarizimit si jo funksionale, si dhe ndjekien e mëtejshme të procedurave të asgjësimit apo dhënies në përdorim/tjetërsim të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit.Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" paragrafët 96-99, 102 dhe 109. Mos realizimi i vlerësimit të aktiveve nga institucioni ndikon në mos planifikimi efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, qe janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.

IV. “Informimi dhe Komunikimi”

Komunikimi luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe kontrollin e aktiviteteve të njësisë. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet raportimit mujor periodik nga Kryetarët e Zyrave Vendore dhe nga Avokatët e Shtetit pranë Ministrive, me evidenca shkresore dhe elektronike.

Avokatura e Shtetit disponon faqen e saj zyrtare në internet si mjet informimi të publikut si dhe ka krijuar postë elektronike si mjet komunikimi zyrtar të brendshëm me qëllim transmetimin e informacionit. Të gjithë punonjësit e Avokaturës së Shtetit janë të pajisur me adresë zyrtare e-mail.

Nga subjekti nuk garantohet përditësimi i informacionit në faqen zyrtare lidhur me buxhetin e miratuar; raportet periodike të zbatimit të buxhetit, pasqyrat vjetore financiare; statistika mbi prokurimet; kontratat e lidhura; raporte të auditimit të jashtëm për njësinë mbi pasqyrat financiare dhe aktivitetin e vitit paraardhës, etj.

V. “Monitorimi dhe Raportimi”

Komponenti i pestë i kontrollit të brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të MFK-së bëhet nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Vetëvlerësimi

Neni 18 i ligjit nr. 10296, datë 10.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, përcakton se NA i njësisë publike depoziton te titullari i njësisë raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt i vitit aktual. NPA, më tej, përgatit dhe depoziton te Ministri i Financave raportin vjetor të konsoliduar jo më vonë se fundi i muajit prill.

Nga auditimi u konstatua se, Avokatura e Shtetit ka dërguar pranë Ministrin përgjegjës për financat deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raportin vjetor së bashku me planin e veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si më poshtë:

- Për vitin 2023, nëpërmjet shkresës nr. 1006/1 prot, datë 28.3.2024.
- Për vitin 2024, nëpërmjet shkresës nr. 1137 prot., datë 19.02.2025.

Auditimi i brendshëm

Përveç monitorimeve të vazhdueshme, titullari i njësisë mund të përdorë AB për efekt të vlerësimit të kontrollit të brendshëm që ekziston në njësinë publike. Vlerësimi i sistemeve të MFK-së që kryhet nga audituesit e brendshëm, i ofron informacion titullarit të njësisë, lidhur me efikasitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të MFK-së. Kështu, veprimtaria e AB mbështet titullarin e njësisë në monitorimin e sistemeve të MFK-së.

Konstatim: Përgjatë periudhës **2023-2024**, dobësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk janë analizuar dhe adresuar përmes auditit të brendshëm apo të jashtëm. Avokatura e Shtetit nuk ka siguruar shërbim të auditimit të brendshëm, çka do të ofronte siguri të arsyeshme, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion, në kundërshtim me nenin 12, pika 1, të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar. Referuar nenit 10, pika 1, i këtij ligji, parashikohet se: “*Të gjitha njësitë publike, të përfshira në nenin 3, të këtij ligji, sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas njërës prej formave të përcaktuara në vijim: a) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e auditimit të brendshëm, kur ka një të tillë të parashikuar në strukturën organizative të njësisë publike; b) Kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm nga njësia e Auditimit të Brendshëm e institucionit epror ose nga njësia e Auditimit të Brendshëm e një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet titullarëve të njësisë publike përkatëse. Marrëveshja miratohet paraprakisht nga ministri përgjegjës për financat. ç) kryerja e shërbimit të auditimit të brendshëm me kontraktim, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.*

Aktiviteti i Zyrës së Inspektimit

Bazuar në neni 10 të ligjit "Për Avokaturën e Shtetit" i ndryshuar, Zyra e Inspektimit është struktura që ushtron kontroll vetëm në kuadër të veprimtarisë së avokatëve të shtetit në të dyja nivelet e organizimit, si dhe për kryerjen e funksioneve mbështetëse, në rastet kur vihen re pamjaftueshmëri në burime, materiale dhe njerëzore, për ushtrimin me efektivitet të funksioneve të institucionit.

Në këtë kuadër, çdo vit hartohet plani i inspektimit të kësaj zyre. Konkretisht plani i punës së zyrës së inspektimit për vitin 2023, është i miratuar me Urdhërin nr.27, datë 20.01.2023 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, i ndryshuar me Urdhërin nr.487, datë 17.10.2023, ndërsa për vitin 2024 përmes Urdhrit nr. 5, datë 08.01.2024 "Për miratimin e planit vjetor të Zyrës së Inspektimit në Avokaturën e Shtetit". Për vitin 2023 janë planifikuar 4 inspektime të përgjithshme sipas tabelës si vijon:

Tabelë nr. 1 : *Plani i inspektimit për vitin 2023.*

Nr	SUBJEKTE TË PLANIFIKUARA PËR INSPEKTIM	LLOJET E INSPEKTIMIT	KOHA E PLANIFIKUAR
1	Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Gjirokastrë	Inspektim i përgjithshëm	25.01.2023-31.03.2023
2	Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Durrës	Inspektim i përgjithshëm	10.04.2023-30.06.2023
3	Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Tiranë	Inspektim i përgjithshëm	01.07.2023-02.10.2023
4	Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit Korçë	Inspektim i përgjithshëm	15.09.2023-15.12.2023

Burimi: Avokatura e Shtetit

Në ndryshim nga plani i miratuar i inspektimeve, përgjatë vitit 2023 nuk janë kryer inspektimet e planifikuara, por janë kryer 7 inspektime tematike dhe 1 inspektim i përgjithshëm deri në datë 16.10.2023.

Në muajin tetor (datë 16.10.2023) me urdhër të titullarit është ndryshuar përmbajtja e planit të inspektimit, ndryshimi i cili është justifikuar për shkak të inspektimeve tematike të zhvilluara bazuar në indicet e përfituara mbi veprimtarinë e avokatëve të shtetit, ndryshimeve të planifikuara të organizimit territorial të zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit, dhe rritjes së kërkesave për përditësimin e të dhënave nga avokatët e shtetit në regjistrin elektronik të çështjeve të Avokaturës së Shtetit, në kuadër të implementimit të sistemit të ri digjital si dhe në funksion të zbatimit të programit të digjitalizimit dhe modernizimit të infrastrukturës së institucionit.

Ndryshimi i planit të inspektimit në fakt është miratim i inspektimeve të kryera gjatë periudhës janar- shtator 2023. Si rezultat i inspektimeve të kryera gjatë vitit 2023, janë përfunduar Raportet e Inspektimit për 61 avokatë shteti të cilët ushtrojnë funksionin e tyre pranë zyrave vendore dhe ministrive si dhe 1 avokat shteti në nivel qendror. Në përfundim janë dhënë gjithsej 23 (njëzetë e tre) masa disiplinore, nga të cilat 21 (njëzetë e një) masa disiplinore "vërejtje me shkrim", 1 (një) masë disiplinore "vërejtje me paralajmërim", 1 (një) masë disiplinore "shkarkim nga detyra".

Për periudhën Janar - Dhjetor 2024 janë planifikuar dhe kryer vetëm inspektime tematike.

Tabelë nr.2: *Plani i inspektimit për vitin 2024.*

Nr	SUBJEKTE TË PLANIFIKUARA PËR INSPEKTIM	LLOJET E INSPEKTIMIT	KOHA E PLANIFIKUAR
1	Avokatët e shtetit pranë ministrive dhe zyra vendore të Avokaturës së Shtetit	Monitorim/mbikëqyrje/inspektim tematik	01.01.2024-30.6.2024
2	Avokatët e shtetit pranë ministrive dhe zyra vendore të Avokaturës së Shtetit	Monitorim/mbikëqyrje/inspektim tematik	01.07.2024-30.9.2024
3	Avokatët e shtetit pranë ministrive dhe zyra vendore të Avokaturës së Shtetit	Monitorim/mbikëqyrje/inspektim tematik	01.10.2024-30.11.2024

4	Avokatët e shtetit pranë ministrive dhe zyra vendore të Avokaturës së Shtetit	Monitorim/mbikëqyrje/inspektim tematik	01.12.2024-31.12.2024
---	---	--	-----------------------

Burimi: Avokatura e Shtetit

Zyra e Inspektimit ka kryer mbikëqyrjen e pjesëmarrjes së avokatëve të shtetit në procese gjyqësore, kryesisht të avokatëve të shtetit pranë ministrive dhe avokatëve të shtetit pranë Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit Tiranë, gjithsej 34 (tridhjetë e katër) avokatë shteti. Në përfundim të këtij inspektimi, grupi i punës ka përgatitur relacionin me nr. 3291/1 prot, datë 04.10.2024. Duke qenë se gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes nuk janë identifikuar rrethana që të motivojnë fillimin e inspektimeve tematike ndaj avokatëve të shtetit, nuk është konkluduar me propozime konkrete.

Për sa më sipër, për periudhën 2023-2024 nga Zyra e Inspektimit nuk janë kryer inspektime të përgjithshme dhe inspektime performance, sipas përcaktimeve në nenin 19 të Rregullores së brendshme të Avokaturës së Shtetit. Në procedurën e miratuar me Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm nr. 80, datë 08.4.2019 “Për miratimin e metodologjisë procedurale dhe materiale të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga zyra e inspektimit” konstatohet se nuk ka një parashikim apo rregullim të detajuar mbi fazën e planifikimit të inspektimit, mbi mënyrën e përzgjedhjes së subjekteve të inspektimit, duke pamundësuar krahasimin vjetor plan-fakt si dhe për të vlerësuar performancën e subjekteve të inspektuara. Planet vjetore të Zyrës së Inspektimit në Avokaturën e Shtetit duhet të konsistojnë në planifikime të bazuara në analiza risku të aktivitetit inspektues.

Sa më sipër, lidhur me komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit arrihet në konkluzion se ka mangësi në disa drejtime si më poshtë:

I. “Mjedisi i kontrollit”

☒ Mungesat në staf në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse kanë ndikuar në drejtim të funksionimit të kësaj strukture duke mos garantuar ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, bazuar në nenin 22, pika 3, shkronja b) të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

☒ Për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve, veprime në kundërshtim me nenin 9, pika 4, shkronja dh) të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar) si dhe nenit 9, pika 5/t) të Rregullores së brendshme të Avokaturës së Shtetit. ku përcaktohet se: “Avokati i Përgjithshëm i Shtetit kryen vlerësimet vjetore të punës për avokatët e shtetit sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore”.

II. “Menaxhimi i Riskut”

☒ Për periudhën **2023-2024** institucioni nuk ka krijuar mekanizmat e vlerësimit të riskut pasi, nga ana e titullarit nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, veprime në kundërshtim me nenin 8, pika 8, shkronja b), të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”(i ndryshuar).

☒ Institucioni nuk ka hartuar *Strategjinë e Menaxhimit të Riskut/ Plani i menaxhimit për trajtimin e risqeve*, dokumenti cili përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut, veprime jo në përputhje me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

☞ Nga strukturat përgjegjëse nuk kryhet identifikimi, vlerësimi, kontrolli dhe monitorimi i risqeve në të gjitha nivelet e saj me qëllim arritjen e objektivave dhe si rrjedhojë nuk është dokumentuar procesi i menaxhimit të riskut në një regjistër. Nuk ka evidenca të vlerësimit dhe monitorimit të riskut të mashtrimit nga niveli i lartë si dhe planit të veprimit. Veprime jo në përputhje me nenin 11, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”(i ndryshuar), si dhe Udhëzimin nr. 16, dt.20.07.2016 “*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*”.

III “Aktivitetet e Kontrollit”

Avokatura e Shtetit nuk ka të hartuar gjurmën e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të institucionit dhe që sigurojnë se të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, sipas përcaktimit në nenin 16, pikat 2 dhe 3, nenin 22 dhe nenin 23 pika 5 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” (i ndryshuar) si dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

Në kuadër të detyrimeve ligjore për menaxhimin e aktiveve konstatohet se, nga nëpunësi autorizues nuk janë marrë masa për ngritjen e komisionin të vlerësimit të aktiveve të cilat janë relatuar nga komisioni i inventarizimit si jo funksionale, si dhe ndjekien e mëtejshme të procedurave të asgjësimit apo dhënies në përdorim/tjetërsim të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*” paragrafët 96-99, 102 dhe 109. Mos realizimi i vlerësimit të aktiveve nga institucioni ndikon në mosplanifikim efektiv financiar afatmesëm të nevojave të institucionit për zëvendësimin e këtyre aktiveve, që janë në përfundim të ciklit të tyre të funksionimit.

IV.“Informimi dhe Komunikimi”

Në faqen zyrtare në internet të institucionit nuk garantohet dhënia e informacioneve të përditësuara, lidhur me të dhëna mbi buxhetin e miratuar, planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit, statistika mbi prokurimet; kontratat e lidhura; raporte të auditimit të jashtëm, bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “*Për të Drejtën e Informimit*” i ndryshuar.

Për vitin 2024, nuk janë hartuar raportet e monitorimit 4 mujor dhe 8 mujor të zbatimit të buxhetit, veprime në kundërshtim me nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, dhe Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore*”, kreu II dhe kreu III, i ndryshuar.

V. “Monitorimi dhe Raportimi”

Përgjatë periudhës objekt auditimi, Avokatura e Shtetit nuk ka siguruar shërbim të auditimit të brendshëm, çka do të ofronte siguri të arsyeshme, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion, në kundërshtim me nenin 12, pika 1, të ligjit nr. 114/2015 “*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*”, i ndryshuar.

Në procedurën e miratuar me Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm nr. 80, datë 08.4.2019 “*Për miratimin e metodologjisë procedurale dhe materiale të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga zyra e inspektimit*” konstatohet se nuk ka një parashikim apo rregullim të detajuar mbi fazën e planifikimit të inspektimit, mbi mënyrën e përzgjedhjes së subjekteve të

inspektimit, duke pamundësuar krahasimin vjetor plan-fakt si dhe për të vlerësuar performancën e subjekteve të inspektuara. Planet vjetore të Zyrës së Inspektimit në Avokaturën e Shtetit duhet të konsistojnë në planifikime të bazuara në analiza risku të aktivitetit inspektues. Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi z.A. H. dhe zj.M.Sh.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr.508/17 prot, datë 22.08.2025, administruar pranë KLSH me nr.164/5 prot, datë 28.08.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Bashkëlidhur ju përcillet Urdhri nr. 283, datë 13.05.2025 i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik. Gjithashtu, nga viti 2025 Avokatura e Shtetit po punon me programin financiar Alpha, duke siguruar administrim më të plotë dhe në kohë të veprimeve kontabël. Institucioni mbetet i angazhuar për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Shkresa e dërguar nga ana juaj lidhur me ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik do të merret në konsideratë. Përsa i përket masave që do të ndërmerren nga ana juaj në vijim, ato do të jenë objekt verifikimi në auditimet e ardhshme që do të kryhen për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit: 1. Në lidhje me konstatimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për mungesat në staf në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse theksojmë se nga ana e Avokaturës së Shtetit janë ndërmarrë veprime të vazhdueshme dhe të përsëritura për kërkimin e shtesës së stafit, duke i adresuar nevojat strukturore në mënyrë të vazhduar dhe në kohë, në përputhje me dinamikën e ngarkesës së punës dhe përgjegjësive funksionale. Vakanca e pozicionit të Drejtorit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse e ka bërë të pamundur vlerësimin e nëpunësve civil. Për sa i përket vlerësimit të performancës së avokatëve të shtetit, duke qenë se formati aktual i vlerësimit të performancës nuk reflekton në mënyrë të plotë veçoritë e veprimtarisë profesionale të Avokatëve të Shtetit, si dhe volumin real të punës që ata përballojnë, në raport me kompleksitetin e çështjeve që trajtojnë. Avokatura e Shtetit ka në plan të hartojë dhe të miratojë një format të ri vlerësimi të performancës për avokatët e shtetit, duke u bazuar në praktikat më të mira dhe në bashkëpunim me institucionet përkatëse të administratës publike.

2. Nga ana e Avokaturës së Shtetit janë marrë masa në vijim për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik, (*Urdhër i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr.283, datë 13.05.2025*), i cili është ngarkuar edhe me përgjegjësinë për hartimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut,

3. Lidhur me nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve, titullari ka ngritur një grup të posaçëm për vlerësimin dhe trajtimin e tyre. Ky grup ka filluar procesin e shqyrtimit të aktiveve që janë raportuar si jo funksionale, dhe është duke ndjekur procedurat e vlerësimit dhe dokumentimit të nevojshëm.

4. Përsa i përket informacioneve në faqen zyrtare të institucionit mbi buxhetin e miratuar, planin e shpenzimeve, raportet vjetore dhe statistikat për prokurimet jemi në proces përditësimi dhe do të publikohen së shpejti, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 119/2014 'Për të Drejtën e Informimit'.

5. Mungesa e shërbimit të auditimit të brendshëm ka ndodhur për shkak të disa kufizimeve të brendshme, përfshirë mungesën e burimeve të nevojshme dhe nevojën për të ristrukturuar disa procese të brendshme, megjithatë, jemi duke punuar për të krijuar mundësitë për angazhimin e një shërbimi auditimi të brendshëm të pavarur.

6. Në lidhje me raportet e monitorimit 4 dhe 8 mujore, nuk janë plotësuar për shkak të mungesës së stafit në Drejtorinë e Financës gjatë periudhës së vitit raportues. Kjo nuk ka krijuar pengesa në procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për raportimet e nevojshme, pasi në raportin përfundimtar të vitit 2024, Avokatura e Shtetit ka arritur të tejkalojë pritshmërinë për vitin 2024, duke realizuar objektivat e saj pavarësisht mungesave të fondeve dhe stafit.

7. Përsa i përket veprimtarisë së Zyrës së Inspektimit për periudhën 2023-2024 ju sqarojmë se për zyrën e inspektimit ka qenë objektivisht e pamundur të realizohej plani i inspektimit për inspektimin e përgjithshëm të zyrave vendore të Avokaturës së Shtetit, duke marrë parasysh edhe funksionet dhe detyrat e tjera të caktuara avokatëve të shtetit pranë Zyrës së Inspektimit, si funksione mbështetëse dhe të monitorimit të akteve procedurale të avokatëve të shtetit pranë 6 (gjashtë) zyrave vendore, sipas urdhrin nr.127 datë 08.04.2022 "*Për Hartimin dhe Depozitimin e Akteve Procedurale në Gjykatë, Cilësinë e Mbrojtjes dhe Unifikimin e qëndrimit të Veprimtarisë së Avokatëve të Shtetit*". Fokus kryesor i Zyrës së Inspektimit për 2023-2024, ka qenë "Përditësimi i dosjeve në sistemin elektronik", në zyrat vendore dhe ato të avokatëve të shtetit pranë Ministrive. (rreth 92 inspektime për 2023), Gjithashtu përveç përgatitjes së raporteve përfundimtare të inspektimit për 53 avokatë shteti, përfaqësimi i çështjeve gjyqësore në gjykatë përbën një impenjim tjetër për avokatët e shtetit pranë Zyrës së Inspektimit që kërkon kohën dhe angazhimin e duhur. Së fundi, Zyra e Inspektimit është angazhuar në mënyrë aktive në përgatitjen e një sërë projekt aktesh ligjore, etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimet e paraqitura sqarojmë se, nga **I-6**. Në kuadër të mangësive të konstatuara në komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, masat që janë ndërmarra nga ana juaj menjëherë pas përfundimit të fazës së auditimit në terren do të merren në konsideratë pasi të jenë shoqëruar edhe me dokumentacion justifikues. Përsa i përket masave që do të ndërmerren nga ana juaj në vijim, ato do të jenë objekt verifikimi në auditimet e ardhshme që do të kryhen për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupi i auditimit.

7. Rrethanat e parashtruara nga ana juaj mbi realizimin e planeve të inspektimit do të merren në konsideratë, ndërsa për sa i përket metodologjisë procedurale dhe materiale të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga zyra e inspektimit, është e domosdoshme që të rishikohet procedura me qëllim plotësimin me elementë të tjerë që lidhen me fazën e planifikimit të inspektimit, mbi mënyrën e përzgjedhjes së subjekteve të inspektimit, vlerësimin e riskut, etj.

2.6. Të tjera çështje që mund të dalin gjatë auditimit

2.6.1. Mbi kontraktimin e studiove/avokat vendase ose të huaja për ndjekjen e proceseve të arbitrazhit.

Në lidhje me procedurat e ndjekura për kontraktimin e studiove/avokat vendase ose të huaja për ndjekjen e proceseve të arbitrazhit, u shqyrtua dokumentacioni i procedurave si vijon:

- Praktika e procedurës së ndjekur deri në lidhjen e kontratës mbi kontraktimin e studios ligjore "C. Ch", për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar *PCA Case No. 2023043 Ph.P vs Albania*.

- Praktika e procedurës së ndjekur deri në lidhjen e kontratës mbi kontraktimin e studios ligjore "A & O" për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar "M. N" kundër Republikës së Shqipërisë.

- Praktika e procedurës së ndjekur deri në lidhjen e kontratës mbi kontraktimin e studios ligjore "Wh & C" për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar "E & T" kundër Republikës së Shqipërisë".

Baza ligjore:

- VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”.

-VKM nr. 711, datë 20.11.2024, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe personave juridikë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe norma të posaçme procedurale”.

Sipas të dhënave të paraqitura nga Avokatura e Shtetit, **për periudhën 2023-2024 janë zhvilluar 3 procedura kontraktimi të studiove ligjore** dhe konkretisht:

- I. Kontraktimi i studios ligjore “C. Ch” për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, në çështjen e arbitrazhit “Ph. P” kundër Republikës së Shqipërisë.
- II. Kontraktimi i studios ligjore “Wh & C” për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar “E & T” kundër Republikës së Shqipërisë”.
- III. Kontraktimi i studios ligjore “A & O” për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë, në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar “M. N” kundër RSH mbi shkeljen e marrëveshjes së ndërsjelltë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Bullgarisë dhe Qeverisë së RSH, për nxitjen dhe mbrojtjen e përbashkët të investimeve.

Të dhëna të detajuara mbi procedurat e mësipërme paraqiten në tabelën si vijon:

Studio ligjore	Vlera e kontratës	Totali i paguar	Statusi i Kontratës
“C. Ch”	1,790,000 Euro	156,867.52 Euro	Kontrata është e përfunduar dhe nuk ka pagesa të mëtejshme duke qenë se procedura e arbitrazhit u ndërpre për shkak të tërheqjes së paditësit. Vendimi i Tribunalit për përfundimin e procedurave u lëshua më datë 11.12.2023.
“Wh & C”	1,999,998 Euro	1,050,000 Euro	Kontrata konsiderohet e përfunduar dhe nuk ka pagesa të mëtejshme duke qenë se procedura e arbitrazhit u ndërpre për shkak të tërheqjes së paditësit. Në datën 13.08.2024, nga ana e Tribunalit është dërguar Urdhri për ndërprerjen e procedurës.
“A & O”	675,000 Euro	130,000 Euro	Çështja është ende në proces.

Burimi: Avokatura e Shtetit

I. Procedura e ndjekur deri në lidhjen e kontratës lidhur me kontraktimin e studios ligjore “C. Ch” për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar “Ph. P.” kundër RSH.

Me shkresë nr. 1345/2, datë 06.03.2023, shoqëria "A" Sha, ka informuar Avokaturën e Shtetit mbi njoftimin për arbitrazh të shoqërisë "Ph. P" Sh.a, lidhur me marrëveshjen e hidrokarbureve "Për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin Amonicë" datë 26.08.2013, miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 699, datë 16.08.2013.

Përmes Memos nr.1362/5, datë 27.03.2023, Drejtuesja e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar në Avokaturën e Shtetit zj.M.I ka informuar titullarin mbi nevojën e kontraktimit të avokatëve/studios së avokatisë për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në këtë çështje, bazuar në kreun III, të VKM-së nr.893, datë 18.11.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrrave të avokatisë vendase ose të huaja".

Me shkresë nr. 1362/7 prot, datë 29.03.2023, Avokatura e Shtetit ka informuar shoqërinë "A" mbi nevojën e kontraktimit të një avokati/studio avokatie për përfaqësimin e interesave të saj në çështjen e arbitrazhit "Ph. P." Sha kundër shoqërisë "A" si dhe miratimin e mbulimit të kostove të avokatit /studios së avokatisë që do të angazhohet në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të saj në këtë proces arbitrazhi.

Me shkresë nr. 1362/9 prot, datë 06.4.2023, shoqëria "A" ka shprehur dakortësinë për mbulimin e kostove të studios së avokatisë që do të angazhohet në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të saj në këtë proces arbitrazhi.

Përmes Urdhrit të Avokatit të Përgjithshëm nr. 289, datë 05.6.2023 "Për fillimin e procedurës së konkurrimit për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studios së avokatisë vendase ose të huaj për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit unicitral case "Ph. P". kundër A Sh.a" është ngritur Komisioni për zhvillimin e procedurës së kontraktimit dhe të përzgjedhjes së studios së avokatisë me përbërje si vijon: M. M.- kryetar, D. S.-anëtar dhe D. Sh.-anëtar.

Në kuadër të procesit të konkurrimit, gjatë fazave të shqyrtimit dhe vlerësimit të subjekteve ofertuese nga komisioni janë mbajtur procesverbalet si më poshtë:

-Procesverbal nr. 1, datë 05.06.2023, komisioni ka nisur procedurën për hartimin e ftesës për ofertë, si dhe identifikimin e subjekteve të cilët janë renditur në udhërrëfyes ndërkombëtar të njohur në fushën objekt procedure.

-Procesverbal nr. 2, datë 05.06.2023, komisioni ka miratuar formën dhe përmbajtjen e Ftesës për Ofertë në gjuhën shqipe dhe angleze, si dhe procedoi me dërgimin në mënyrë elektronike të ftesës për ofertë 13 studiove të avokatisë. Komisioni i është referuar udhërrëfyesve ndërkombëtar në të cilën rankohen zyrrat e avokatisë në nivel botëror në fushat më të larta të renditjes si Band 1, Band 2, Band 3.

-Në Ftesën për ofertë nr. 1362/33 prot, datë 05.6.2023, përcaktohet se ofertat duhet të paraqiten pranë ASH deri në datën 13.06.2023 ora 12:30, CET, si dhe kriteret e kualifikimit, kriteret e vlerësimit, procedura e përzgjedhjes, ankimimit etj.

-Procesverbal nr. 3 datë 08.06.2023, komisioni ka konstatuar se në adresën e e-mailit të përcaktuar si pikë kontakti janë paraqitur e-maile për vënien në dispozicion të ftesës për ofertë dhe disa kërkesa për sqarim, nga disa studio të huaja. Për çdo kërkesë të subjekteve që kanë shprehur interes, Komisioni ka dhënë sqarimet përkatëse në rrugë elektronike, të cilat janë pjesë e dosjes.

-Procesverbal nr. 4 datë 13.06.2023, Zyra e protokoll arkivës i dorëzon komisionit 28 zarfet e depozituara pranë saj për procedurën e kontraktimit.

-Procesverbal nr.5 datë 13.06.2023, komisioni ka hapur ofertat e dorëzuara nga 28 subjektet si vijon: 1.F.F., 2.A. I., 3.SCH., 4. S & S., 5. AL., 6. A & M., 7. OM., 8. P. M., 9. V.D., 10. CR., 11. Ë. & I., 12. DF., 13. RO., 14. S. P. B., 15. S. Ë.- C., 16.CU., 17. B.E., 18. B. M., 19. H. L., 20. M. B., 21. B. S. F., 22. F. H. / D. P., 23. Ë. F., 24. C. CH., 25. B. C., 26. MI., 27. H. S. F., 28. LI.

Komisioni ka evidentuar në procesverbal vlerën e ofertës së ofruar nga secili subjekt dhe ka vijuar me procesin e shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur prej tyre. Komisioni ka vendosur për kualifikimin e 27 subjekteve dhe s'kualifikimin e subjektit "SCH." për shkak të mungesave në dokumentacion. Konkretisht subjektit i mungonin dokumentet si vijon:

-Vetëdeklarata se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit;

-Vetëdeklarata se ekziston rregullisht sipas ligjeve në fuqi dhe se nuk ka ndonjë procedurë likuidimi, falimentimi, disiplinore apo tjetër kundër tyre që mund të cenojë ofrimin e shërbimeve;

-Vetëdeklarata të licensimit të tij për ofrimin e shërbimit objekt procedure kontraktimi.

Procesverbalin nr. 6 datë 16.06.2023, komisioni ka kërkuar sqarime prej disa ofertuesve pjesëmarrës në procedurë lidhur me vlerën variable të ofertës ekonomike të paraqitur nga ana e tyre. Komisioni ka konstatuar se studiot ligjore "S.W-C" dhe "B.S.F", nuk kanë konfirmuar shumën totale të përgjithshme pa supozim për të gjithë shërbimin. Ndërsa studio ligjore "B. E", ka ndryshuar ofertën nga 1,050,000€ në 1,092,000€, duke sjellë s'kualifikimin e saj në bazë të përcaktimeve të VKM-së nr. 893/2020 dhe ftesës për ofertë, kapitulli IV ku parashikohet se: "Oferta ekonomike (shuma dhe vlera) do të përbëj çmimin total dhe të pandryshuar për shërbimin e ofruar nga ofertuesi së bashku me vlerën e çdo takse të zbatueshme". Për të kryer një vlerësim proporcional të ofertave ekonomike të paraqitura, sipas përcaktimit të pikës 4 a), Seksioni B, kreu III, i VKM nr. 893/2020, duhet të paraqiten në një monedhë të vetme, e cila do të jetë në euro.

-Procesverbal nr. 7, datë 26.06.2023, komisioni ka kryer vlerësimin e 24 subjekteve të kualifikuara sipas kriterëve dhe sistemit të pikëzimit, bazuar në pikën 3 dhe 5 të seksionit B, kreu III, të VKM-së nr.893, datë 18.11.2020. Referuar rezultateve të vlerësimit komisioni ka përzgjedhur si fitues studion ligjore "C. CH", me vlerë të ofertës 1,790,000 euro. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave dhe të afateve të ankimimit, nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim ose në mënyrë elektronike.

-Në përfundim të procedurës së kontraktimit, komisioni i ka paraqitur për miratim Avokatit të Përgjithshëm raportin përmbledhës nr.1362/67, datë 03.7.2023, në të cilin paraqiten në mënyrë kronologjike të gjitha hapat e ndjekura të procedurës deri në njoftimin e fituesit.

-Shkresë nr.1362/84 prot, datë 09.10.2023, Zyra e Avokatit të Përgjithshëm i drejtohet shoqërisë A, "Mbi marrjen e masave për parashikimet buxhetore në kuadër të ekzekutimit të kontratës së nënshkruar me studion ligjore "C. CH" për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë në procesin e arbitrazhit ndërkombëtar PCA Case No. 2023043 Ph.P vs Albania.

-Lidhur me zbatimin e kontratës rezulton se: Totali i likuiduar është në vlerën 156,867.52 Euro. Nga Avokatura e Shtetit janë dërguar tek shoqëria "A" faturat me datë 09.02.2024 dhe 17.04.2024, me vlerë 100 000 Euro dhe 56,867.52 Euro. Fatura prej 56,867.52 Euro është dërguar në një vlerë më të vogël se kësti përkatës prej 100,000 Euro, për shkak të ndërprerjes së hershme të procesit të arbitrazhit, duke likuiduar shërbimin e realizuar deri në momentin e ndërprerjes. Kontrata është përfunduar për shkak të tërheqjes së paditësit dhe nuk ka pagesa të mëtejshme. Vendimi i Tribunalit për përfundimin e procedurave është dhënë më datë 11.12.2023.

Nga auditimi i procedurës si më sipër konstatohet se:

1. Procedura e ndjekur nga komisioni në kuadër të kontraktimit të studiove ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar bazohet në VKM nr.893, datë 18.11.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja". Në kushtet e mungesës së akteve të tjera nënligjore për këtë lloj procedure, nga Avokatura e Shtetit nuk është hartuar ndonjë rregullore e brendshme që të

përcaktojë rregulla të detajuara që lidhen me funksionimin e komisionit, detyrat e anëtarëve të komisionit, procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, vendimmarrjen, rregullat mbi dokumentimin e plotë, të saktë dhe në kohën e duhur të procesit që nga nisja e tij deri në arkivimin e praktikës, si edhe rregulla të tjera që lidhen me konfidencialitetin e ruajtjes së të dhënave apo deklarimin e konfliktit të interesit.

2. Nisur nga fakti se VKM nr. 890/2020, nuk i ka të përcaktuara qartë rregullat që ndiqen gjatë procesit të pikëzimit e të renditjes së subjekteve ofertuese lidhur me kritere si: *“përvoja profesionale e ofertuesit, eksperiencia të ngjashme të stafit kryesor të ofertuesit dhe raste të suksesit të ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit”*, komisioni i ngritur në ASH ka aplikuar një formulë të ngjashme me atë të vlerësimit të ofertës ekonomike sipas pikës 4, shkronja a) të kësaj VKM-je. Kjo metodologji e përdorur nga komisioni është e pa miratuar me një akt të brendshëm. Për sa më sipër është e nevojshme që procedura të pasqyrohet në një akt nënligjor me efekt rregullator si Udhëzim apo Urdhër të titullarit të ASH dhe në rast ankimimi të procedurës së vlerësimit nga subjektet ofertuese të kualifikuara, Zyra e Avokaturës së Shtetit do të mund të garantojë ofertuesit me informacion të mjaftueshëm për mënyrën e vlerësimit, bazuar në procedura të miratuara dhe transparente. Mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 16, pikat 2 dhe 3, nenin 22 dhe nenin 23, pika 5, e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, si dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Referuar pikës 3.3 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin përcaktohet se, njësitë publike duhet të mbështeten në akte ligjore dhe nënligjore specifike për procese dhe procedura përkatëse, duke filluar nga zbatimi i ligjeve, e duke vijuar me miratimin e rregulloreve të tyre të brendshme (udhëzime, direktiva) për të evidentuar më hollësisht procedurat, përcaktimin e autoritetit dhe përgjegjësisë, si dhe procedurat e kontrollit.

3. Nga anëtarët e komisionit nuk është kryer verifikimi i mungesës së konfliktit të interesit në momentin e hapjes së ofertave sipas nenit 4, pika 1, shkronjës “c”, dhe pika 2 shkronjat “b” ,“c”, si dhe neni 7, pika 1 në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar.

4. Në procesverbalin e vlerësimit të subjekteve, lidhur me kriteret si: *“përvojë profesionale/eksperiencia të ngjashme të stafit kryesor dhe raste të suksesit”*, komisioni nuk ka dhënë shpjegime të hollësishme mbi mënyrën e vlerësimit të numrit të rasteve të ngjashme për secilin kriter.

5. Kontrata nr.1362 prot, datë 15.09.2023 midis studios ligjore “C.CH” dhe Zyrës së Avokatit të Shtetit si përfaqësuese e shoqërisë “A” është nënshkruar vetëm në gjuhën angleze.

6. Procesverbalet e mbajtura nga komisioni për të gjitha fazat e ndjekura të procedurës nuk janë të protokolluara, në mospërputhje me nenin 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Dokumentacioni i praktikës është i pa arkivuar, në mospërputhje me nenin 24 të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, *“Për arkivat”*, dhe nenin 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr.508/17 prot, datë 22.08.2025, administruar pranë KLSH me nr.164/5 prot, datë 28.08.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: 1. Në lidhje me konstatimin e KLSH-së për mungesën e një rregulloreje të brendshme që të përcaktojë funksionimin e komisionit dhe mënyrën e vlerësimit të ofertave, sqarojmë se procedurat dhe kriteret për kontraktimin e avokatëve/studiove, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse si dhe mënyra e pagesës përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 18.11.2020, i cili është akt nënligjor i posaçëm, që nuk

parashikon nxjerrjen e ndonjë akti tjetër zbatues (si udhëzim, urdhër apo rregullore) për zbatimin e saj. Në këto kushte, kërkesa për miratimin e një rregulloreje të brendshme shtesë nuk ka mbështetje në ligj dhe do të përbënte tejkalim kompetencash nga organi zbatues. Komisioni i ngritur ka vepruar në përputhje me dispozitat e VKM-së, e cila përcakton qartë përbërjen, funksionimin, procedurat e kontraktimit dhe kriteret e vlerësimit.

2. Komisioni vlerëson se VKM nr. 893/2020, megjithëse përcakton kriteret bazë për përzgjedhjen e studiove ligjore, nuk përmban metoda të detajuara për mënyrën e pikëzimit dhe renditjes së ofertuesve lidhur me kriteret cilësore, si përvoja profesionale, eksperiencat e ngjashme të stafit dhe rastet e suksesit në çështje të ngjashme. Në këtë kuadër, komisioni ka aplikuar një metodologji të ndërtuar mbi parimet e barazisë dhe logjikës së pikëzimit të ofertës ekonomike, sipas formulës së përcaktuar në pikën 4, shkronja “a” të VKM-së. Kjo metodologji është përdorur nga Komisioni në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë ofertuesit dhe është dokumentuar në tabelën përkatëse të vlerësimit. Pra theksojmë se kjo metodologji është përdorur nga Komisioni për të siguruar një vlerësim të drejtë, të barabartë dhe objektiv të ofertuesve, duke kryer një përlllogaritje të secilit kriter, në mënyrë matematikore.

3. Komisioni sqaron se verifikimi i mungesës së konfliktit të interesit nuk është formalizuar në momentin e hapjes së ofertave, për shkak se VKM nr. 893/2020, si akti i vetëm rregullues për këtë procedurë specifike, nuk përmban një kërkesë të shprehur për këtë veprim në këtë fazë të procedurës. Deri në përfundim të procedurës, nuk ka rezultuar asnjë situatë konkrete të konfliktit të interesit, dhe komisioni nuk është vënë në dijeni të ndonjë rrethane që do të kërkonte vetëdeklarim ose përjashtim.

4. Duke qenë se procesi i kontraktimit është zhvilluar në kuadër të një arbitrazhi ndërkombëtar, komunikimet janë realizuar në mënyrë elektronike, përfshirë edhe njoftimet individuale ndaj secilit subjekt pjesëmarrës. Këto njoftime janë dërguar në adresat zyrtare të e-mailit të ofertuesve dhe janë të dokumentuara në postën elektronike të institucionit, të administruar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit. *Bashkëlidhur kopjet e njoftimeve elektronike të dërguara përkatësisht për secilin subjekt pjesëmarrës në procedurë.*

5. Lidhur me konstatimin për mungesën e shpjegimeve në procesverbal mbi mënyrën e vlerësimit të rasteve të ngjashme me objektin e procedurës, sqarojmë se vlerësimi i kriterëve si përvoja profesionale, eksperiencat e ngjashme të stafit kryesor dhe rastet e suksesit, është kryer mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet ofertuese, në përputhje me pikën 1, shkronja “ç”, të seksionit B, kreu III të VKM nr. 893/2020, ku kërkohet informacion mbi “*raste të suksesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurimit*”.

Komisioni ka konsideruar të mjaftueshëm dokumentimin përmes përmbledhjes numerike dhe sistemit të pikëzimit të aplikuar, pasi kjo qasje siguron objektivitet dhe trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit.

6. Kontratat e lidhura nga Avokatura e Shtetit parashikojnë hartimin në gjuhën angleze.

Një parashikim i tillë, është në koherencë edhe me kompetencat e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar e cila sipas nenit 9 të ligjit organik të saj, ka për kompetencë përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja ndërkombëtare, arbitrazhit ndërkombëtar, dhe organizmave ndërkombëtare, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës. Gjithashtu duhet të evidentohet se gjuha e arbitrazhit, në të gjitha çështjet ku RSH është palë, është gjuha angleze. Çdo parashtrim, komunikim zyrtar në këto procedura është gjuha angleze. Është Avokatura e Shtetit, ajo që ndjek zbatimin e Kontratës. Megjithatë ASH, i ka vënë në dispozicion, një version në gjuhën shqipe të secilës kontratë, institucioneve të cilat realizojnë pagesat e parashikuara në kontratë.

7. Komisioni ka konsideruar se raporti përfundimtar përbën dokumentin zyrtar dhe përmbledhës të gjithë praktikës, dhe për rrjedhojë, dokumentet përbërëse brenda tij (p.sh. procesverbalet ndërmjetëse) nuk janë protokolluar në mënyrë të veçantë, pasi nuk kanë

funksion të veçantë të pavarur nga raporti. Gjithsesi, të gjitha dokumentet janë të ruajtura në dosje dhe të aksesueshme, sipas praktikës së ndjekur nga institucioni në përputhje me rregullat e brendshme të administrimit të dokumentacionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: 1. Çdo institucion publik është i detyruar të hartojë akte të brendshme për rregullimin e procedurave dhe funksionimit të tij. Çdo akt administrativ i nxjerrë nga organi publik duhet të bazohet në procedura të qarta dhe të përcaktuara, duke përfshirë edhe miratimin e rregulloreve të brendshme nga institucionet publike. Referuar **ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”**, 186 shkronja b) parashikohet se *Organet publike miratojnë rregullat e brendshme të punës në zbatim të dispozitave të këtij Kodi*. Për më tepër, bazuar në nenin 16, pikat 2 dhe 3, nenin 22 pika 1 dhe nenin 23, pika 5, e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, si dhe pikës 3.3.2 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, parashikohet se njësitë publike, për realizimin e objektivave dhe përdorimin e fondeve buxhetore në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe eficiente duhet të organizojnë veprimtarinë, jo vetëm bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, por edhe në procedura të brendshme të shkruara dhe miratuara nga titullarët e tyre.

Për të vijuar me Rregulloren e brendshme të Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68, datë 28.3. 2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, i ndryshuar në nenin 55 të saj parashikohet si vijon: 1. Llojet e akteve administrativë në veprimtarinë ekzekutive dhe urdhërdhënëse të ASH-s, që përdoren për përmbushjen e funksioneve të saj, janë:

a) **“Urdhri”**, është akti nënligjor i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me karakter të brendshëm, që vendos rregulla sjellje të përgjithshme ose rregullon një marrëdhënie konkrete. Urdhëri del në bazë dhe në zbatim të Ligjit.

b) **“Udhëzimi”**, është akt nënligjor i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me karakter shpjegues, që shtjellon të gjitha urdhërimet e Ligjit ose Vendimit të Këshillit të Ministrave.

c) **“Rregullorja”**, është akt nënligjor i miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, që shtjellon rregullat dhe procedurat që do të përdoren në kryerjen e një veprimtarie konkrete.

Nisur nga kuadri ligjor si më sipër, i cili parashikon mundësinë e rregullimit të situatave të pa trajtuara në mënyrë shteruese në një akt ligjor apo nënligjor si dhe mangësitë e konstatuara në përmbajtjen e praktikave të shqyrtuara nga grupi i auditimit arrihet në konkluzion se: Ngritja e komisionit në Avokaturën e Shtetit për zhvillimin e procedurës së kontraktimit e të përzgjedhjes së ofertuesit/studios së avokatisë në pajtim me funksionet e ngarkuara sipas VKM nr. 893/2020, shoqërohet edhe me detyrimin ligjor të ekzistencës së rregullave të brendshme, të cilat në mënyrë të qartë e të detajuar përcaktojnë ndarjen e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisë të anëtarëve të komisionit, procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, vendimmarrjen, rregullat mbi dokumentimin e plotë, të saktë dhe në kohën e duhur të procesit që nga nisja e tij deri në arkivimin e praktikës, si edhe rregulla të tjera që lidhen me konfidencialitetin e ruajtjes së të dhënave apo deklarimin e konfliktit të interesit.

2. Për më tepër, nisur nga fakti se VKM nr. 890/2020, nuk i ka të përcaktuara qartë rregullat që ndiqen gjatë procesit të pikëzimit e të renditjes së subjekteve ofertuese lidhur me kritere si: *“përvoja profesionale e ofertuesit, eksperiencë të ngjashme të stafit kryesor të ofertuesit dhe rastet e suksesit të ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit”*, si dhe metodologjia e përdorur nga komisioni është e pa miratuar me një akt të brendshëm është e nevojshme që procedura të pasqyrohet në një akt nënligjor me efekt rregullator si Udhëzim/Urdhër/Rregullore të titullarit të institucionit. Në rast ankimi të procedurës së vlerësimit nga subjektet ofertuese të kualifikuara, Zyra e Avokaturës së Shtetit do të mund të garantojë ofertuesit me informacion të mjaftueshëm për mënyrën e vlerësimit, bazuar në procedura transparente dhe të miratuara.

Për sa më sipër, observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

3. Ndonëse verifikimi i mungesës së konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit përbën një situatë të pa parashikuar nga VKM nr. 893/2020, si akti i vetëm rregullues për këtë procedurë specifike, ky detyrim ligjor buron nga ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar si dhe neni 30 i ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”. Pavarësisht qëndrimit tuaj mbi mos pasje të situatave të konfliktit të interesit në procedurat e zhvilluara, në kuadër të parimit të paanësisë dhe objektivitetit, në vijimësi anëtarët duhet të shprehen në procesverbalin e mbajtur prej tyre, mbi kryerjen e verifikimit të mungesës së situatave të konfliktit të interesit dhe në rast të konstatimit të ekzistencës së tij nga anëtari i komisionit plotësohet një deklaratë tip për gjendjen e konfliktit të interesit.

*Për sa më sipër, **observacioni juaj do të merret pjesërisht në konsideratë.***

4. Njoftimet elektronike të dërguara përkatësisht për secilin subjekt pjesëmarrës në procedurë duhet të ishin pjesë përbërëse e dokumentacionit të dosjes së kësaj procedure. Në mungesë të përcaktimit të rregullave të detajuara nga ASH mbi përgjegjësinë e komisionit për administrimin, sistemin, inventarizimin e dokumentacionit të praktikës dhe arkivimin e saj, është e domosdoshme të theksohet se çdo akt i mbajtur nga komisioni si procesverbale, korrespondenca me subjektet ofertuese si dhe dokumentacion i dorëzuar nga subjektet ofertuese, në formë elektronike apo shkresore duhet të administrohen si pjesë e dosjes përkatëse. Në përfundimin të procedurës komisioni inventarizon dosjen dhe e dorëzon në zyrën e arkivës bazuar në nenin 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Megjithatë, ***kopjet e njoftimeve elektronike të dërguara nga ana juaj do të merren në konsideratë.***

5. Pavarësisht se numri i rasteve të vlerësuara për çdo subjekt nga komisioni është i bazuar në dokumentet e paraqitura prej tyre, pasqyrimi në procesverbal vetëm i numrit të rasteve që janë marrë në konsideratë si raste të ngjashme **me objektin e procedurës së konkurrimit**, në mungesë të një analize të hollësishme nga anëtarët e komisionit nuk garanton përmbushjen e standardit të arsyetimit të aktit administrativ. Në vijimësi komisioni duhet të kryej dhe të pasqyrojë në procesverbal një analizë e vlerësimit më të detajuar mbi numrin total të praktikave të ngjashme të paraqitura nga subjektet ofertuese, çfarë përfaqësojnë ato në kuptim të kriterit që duhet të përmbushin, me qëllim garantimin e një transparence më të lartë të procedurës për palët e interesuara. *Për sa më sipër, **observacioni juaj nuk do të merret në konsideratë.***

6. Procedura e ndjekur dhe kriteret e vendosura për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyra të avokatisë të huaja është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Kontrata e lidhur midis ASH dhe subjektit ndërkombëtar fitues është një veprim juridik, i cili duhet të përmbush kriteret e formës edhe sipas ligjit të shtetit shqiptar, në të cilin është kryer veprimi juridik. Për sa më sipër, kontrata duhet të përkthehet saktë nga një përkthyes i çertifikuar, në mënyrë që personi juridik/institucioni që do të marrë masat për zbatimin e saj, të disponojë kopjen e kontratës në gjuhën shqipe si një dokument zyrtar me të gjithë elementët e duhur për vlefshmërinë e saj. *Për sa më sipër, **observacioni juaj nuk do të merret në konsideratë.***

7. Në kushtet kur procedura nuk zhvillohet në formë elektronike, hapat e ndjekura nga komisioni duhet të dokumentohen përmes hartimit të procesverbalit në kohën e duhur dhe të protokollohen në përputhje me nenin 18 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Bazuar në pikën 7 të VKM nr. 893/2020 parashikohet se: “*Komisioni mban një procesverbal të hollësishëm për procedurën e ndjekur sipas kreut III, të këtij vendimi, përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Pra, përtej detyrimit të hartimit të një raporti përmbledhës sipas pikës D të VKM-së ku përcaktohet se: “*Komisioni, brenda 2 (dy) ditëve punë nga momenti i përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave dhe të afateve të ankimit, përgatit një raport**

*përmbledhës për gjithë procesin e kontraktimit dhe ia dërgon për miratim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit”, komisioni ka detyrimin ligjor të hartojë procesverbal për procedurën e ndjekur. Për sa më sipër, dokumentimi i veprimeve të komisionit në formën e kërkuar ligjore dhe në kohën e duhur për çdo fazë të procedurës së ndjekur prej tij paraqet rëndësi në kuadër të zhvillimi të një procedure transparente dhe ligjore. Për sa më sipër, **observacioni juaj nuk do të merret në konsideratë.***

II. Procedura e ndjekur nga komisioni deri në lidhjen e kontratës lidhur me kontraktimin e studios ligjore “A & O. LLP & O. B. s.r.o” për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar Ad Hoc “M.N” kundër RSH.

Përmes Memos nr.190/3 prot, datë 10.02.2023, Drejtuesja e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar në Avokaturën e Shtetit, zj.M.I. ka rekomanduar titullarin për miratimin e inicimit të procedurës së kontraktimit të avokatëve/studios së avokatisë për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në këtë çështje, si dhe dërgimin e kërkesës pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për dhënien e miratimit për mbulimin e shpenzimeve bazuar në kreun III, të VKM-së nr.893, datë 18.11.2020 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja*”.

Me shkresë nr. 190/3 prot, datë 13.02.2023, Avokatura e Shtetit ka informuar MFE mbi nevojën e kontraktimit të një avokati/studio avokatie për përfaqësimin e interesave të saj në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar “M.N” kundër RSH si dhe mbulimin e kostove të studios së avokatisë avokatisë që do të angazhohet në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të saj në këtë proces arbitrazhi.

Me shkresë nr. 190/4 prot, datë 04.4.2023, Ministria e Financave ka shprehur dakortësinë për mbulimin e kostove të studios së avokatisë që do të angazhohet në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar në këtë proces arbitrazhi ndërkombëtar.

Përmes Urdhrit të Avokatit të Përgjithshëm nr. 178, datë 05.4.2023 “*Për fillimin e procedurës së konkurrimit për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studios së avokatisë vendase ose të huaj për përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit AD Hoc “M.N” kundër Republikës së Shqipërisë*” është ngritur Komisioni për zhvillimin e procedurës së kontraktimit dhe të përzgjedhjes së studios së avokatisë me përbërje si vijon: D. S. - kryetar, E. M. -anëtar dhe S. P.-anëtar.

Në kuadër të procesit të konkurrimit, gjatë fazave të shqyrtimit dhe vlerësimit të subjekteve ofertuese nga komisioni janë mbajtur procesverbalet si më poshtë:

-Procesverbal nr. 1, datë 05.04.2023, komisioni ka nisur procedurën për hartimin e ftesës për ofertë, si dhe identifikimin e subjekteve të cilët janë renditur në udhërrëfyes ndërkombëtar të njohur në fushën objekte procedure.

-Procesverbal nr. 2, datë 11.04.2023, komisioni ka miratuar formën dhe përmbajtjen e Ftesës për Ofertë në gjuhën shqipe dhe angleze, si dhe ka proceduar me dërgimin në mënyrë elektronike të ftesës për ofertë 13 studiove të avokatisë. Komisioni i është referuar udhërrëfyesve ndërkombëtar në të cilën rankohen zyrat e avokatisë në nivel botëror në fushat më të larta të renditjes si Band 1, Band 2, Band 3. Për shkak të problematikës të aksesit në ëb-in e Avokaturës së Shtetit www.avokaturashitetit.gov.al të njoftuar nga IT e institucionit, nga komisioni nuk mund të procedohej me publikimin online në faqe të njoftimit për arbitrazh adhoc dhe si rrjedhojë nuk mund të kryhej asnjë veprim tjetër. (*Memo Bashkëlidhur këtij Procesverbali*). Në vijim më datë 11 prill 2023, pas miratimit të formës dhe përmbajtjes së Ftesës për Ofertë, komisioni në mbështetje të parashikimeve të pikës 3, dhe 4 të kreut III,

Seksioni A), të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, ka dërguar në mënyrë elektronike nëpërmjet faqes së komisionit arbitrazhadhoc@avokaturashtetit.gov.al, të ftesës për ofertë, dhe ka publikuar në faqen zyrtare elektronike të Avokaturës së Shtetit ëëë.avokaturashtetit.gov.al njoftimin për nevojën e kontraktimit të subjekteve të përcaktuara në pikën 1, të kreut 1, të VKM-së nr. 893, datë 18.11.2020.

Në ftesën për ofertë nr. 190/10 prot, datë 11.4.2023, përcaktohet se ofertat duhet të paraqiten pranë ASH deri në datën 19.04.2023 ora 12:30, CET, si dhe kriteret e kualifikimit, kriteret e vlerësimit, procedura e përzgjedhjes, ankimimit etj.

-Procesverbal nr. 3, datë 18.04.2023, komisioni ka konstatuar se në adresën e e-mailit të përcaktuar si pikë kontakti janë paraqitur e-maile për vënien në dispozicion të ftesës për ofertë dhe disa kërkesa për sqarim, nga disa studio të huaja. Për çdo kërkesë të subjekteve që kanë shprehur interes, Komisioni ka dhënë sqarimet përkatëse në rrugë elektronike (*bashkëlidhur kërkesat për sqarim në gjuhën angleze*).

-Procesverbal nr. 4, datë 19.04.2023, Zyra e protokoll arkivës i ka dorëzuar komisionit 37 zarfet e depozituara pranë saj për procedurën e kontraktimit.

-Procesverbal nr. 5, datë 19.04.2023, komisioni ka hapur ofertat e dorëzuara nga **37** subjektet si vijon: 1. P. M., 2. N. R. F., 3. H. S. F., 4. GST, 5. CMS, 6. L. L., 7. LA., 8. B. C. L. P., 9. D. B. B. Ë., 10. K. L., 11. A. U., 12. O. S., 13. V. F., 14. BSF, 15. F. F, 16. AR., 17. E. S., 18. A. & P., 19. CU., 20. Ë. F. & G., 21. AG., 22. M.D. C.G., 23. A.E O., 24. M.B., 25. MS D. Ë. E., 26. C. E. C., 27. D. & 3BV., 28. D. M., 29. GU., 30. CA. R., 31. F. AV., 32. H. & L., 33. F. H. & D.P., 34. S. P. B..

Në vijim komisioni, në zbatim të pikës 9, seksioni A, kreut III të VKM-së nr. 893 datë 18.11.2020, si edhe në përputhje me parashikimet në pikën 2, seksioni V, të ftesës për ofertë, vendosi të procedojë me hapjen e 37 (tridhjetë e shtatë) zarfeve, duke evidentuar në procesverbal për secilin subjekt, vlerën e ofertës së ofruar, numrin e fletëve që ndodhen në zarf, si edhe dokumentacionin bashkëlidhur. Komisioni ka konstatuar se **3** (tre) subjekte, përkatësisht subjekti "W. F. & GA."; "AR." dhe subjekti "B. C. L. P." kanë dërguar 2 (dy) kopje zarfe, të cilat kishin të njëjtën përmbajtje të paraqitur respektivisht prej tyre duke rezultuar në total **34** ofertues.

Komisioni ka vijuar me procesin e shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur prej tyre dhe ka vendosur të kualifikojë për në fazën e mëtejshme **31** subjekte si dhe të s’kualifikojë 3 subjekte për arsyet si vijon:

1. Subjekti "N. R. F.", ka paraqitur ofertën ekonomike të llogaritur për orë. Gjithashtu ky subjekt gjendet në kushtet e konfliktit të interesit pasi gjatë kësaj faze ka mbrojtur një çështje arbitrazhi kundër Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti "CU." nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet sipas kriterëve të Ftesës për Ofertë.

3. Subjekti "GU." me ofertë ekonomike 1,425,000 \$; 2,725,000\$; 1,925,000 \$, ka parashikuar ofertën ekonomike në dollarë, jo në euro sipas kriterit të parashikuar në ftesën për ofertë.

-Procesverbal nr. 6, datë 25.04.2023, komisioni ka kërkuar sqarime prej disa ofertuesve pjesëmarrës në procedurë lidhur me vlerën variable të ofertës ekonomike të paraqitur nga ana e tyre. Komisioni ka konstatuar se studio ligjore "H. S. F.", ka ndryshuar ofertën nga 3,900,000 euro në vlerën 2,900,000 euro. Në përmbajtjen e procesverbalit përcaktohet se: “komisioni insistoi edhe një herë për të shmangur çdo gabim të mundshëm nga ana e studios ligjore për të deklaruar edhe një herë shumën totale, por studio solli një ofertë tjetër ekonomike duke sjellë s’kualifikimin e saj në bazë të përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.893, datë 18.11.2020, "Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve për kontraktimin dhe pagesën e

avokatëve/zyrave ligjore, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyrës së pagesës" dhe ftesës për ofertë: kapitulli IV, ku përcaktohet se: "Oferta ekonomike (shuma dhe vlera) do të përbëjë çmimin total dhe të pandryshuar për shërbimin e ofruar nga ofertuesi së bashku me vlerën e çdo takse të zbatueshme."

-Procesverbal nr. 7, datë 04.05.2023, komisioni ka vijuar me vlerësimin e 30 subjekteve të kualifikuara sipas kriterëve dhe sistemit të pikëzimit, bazuar në pikën 3 dhe 5 të seksionit B, kreu III, të VKM-së nr.893, datë 18.11.2020. Referuar rezultateve të vlerësimit komisioni ka përzgjedhur si ofertues fitues "A. & O.", me vlerë të ofertës 1,790,000 euro. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave dhe të afateve të ankimimit, nuk është paraqitur asnjë ankesë me shkrim ose në mënyrë elektronike.

-Në përfundim të procedurës së kontraktimit, komisioni i ka paraqitur për miratim Avokatit të Përgjithshëm raportin përmbledhës nr.190/13, datë 10.5.2023, në të cilin paraqiten në mënyrë kronologjike hapat e ndjekur të procedurës deri në njoftimin e fituesit.

-Shkresë nr.190/18 prot, datë 23.06.2023, Zyra e Avokatit të Përgjithshëm i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Mbi marrjen e masave për parashikimet buxhetore në kuadër të ekzekutimit të kontratës së nënshkruar me studion ligjore "A. & O. LLP & A. & O. B.s.r.o" në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar ". M. N. kundër Republikës së Shqipërisë".

-Lidhur me zbatimin e kontratës rezultoi se çështja është ende në proces dhe totali i likuiduar është në vlerën 130,000 Euro.

Nga auditimi i procedurës si më sipër konstatohet se:

- Nga anëtarët e komisionit nuk është kryer verifikimi i mungesës së konfliktit të interesit në momentin e hapjes së ofertave sipas nenit 4, pika 1, shkronjës "c", dhe pika 2 shkronjat "b" , "c", si dhe neni 7, pika 1 në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
- Procesverbalet e mbajtura nga komisioni për të gjitha fazat e ndjekura të procedurës nuk janë protokolluar, veprime në kundërshtim me nenin 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
- Dokumentacioni i praktikës është i pa arkivuar, në mospërputhje me nenin 24 të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat", dhe nenin 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.
- Në procesverbalin e vlerësimit të subjekteve, lidhur me kriteret si: "përvojë profesionale/eksperienca të ngjashme të stafit kryesor dhe raste të suksesit", komisioni nuk ka dhënë shpjegime të hollësishme mbi mënyrën e vlerësimit të numrit të rasteve të ngjashme për secilin kriter.
- Kontrata nr.190/14, datë 08.6.2023 mes studios ligjore dhe Avokaturës së Shtetit si përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë është nënshkruar vetëm në gjuhën angleze.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, nga subjekti i audituar shtë paraqitur observacion me shkresën nr.508/17 prot, datë 22.08.2025, administruar pranë KLSH me nr.164/5 prot, datë 28.08.2025, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: 1.Në lidhje me konstatimin e KLSH-së për mungesën e një rregulloreje të brendshme që të përcaktojë funksionimin e komisionit dhe mënyrën e vlerësimit të ofertave, sqarojmë se procedurat dhe kriteret për kontraktimin e avokatëve/studiove, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse si dhe mënyra e pagesës përcaktohen me Vendim

të Këshillit të Ministrave nr. 893, datë 18.11.2020, i cili është akt nënligjor i posaçëm, që nuk parashikon nxjerrjen e ndonjë akti tjetër zbatues (si udhëzim, urdhër apo rregullore) për zbatimin e saj. Në këto kushte, kërkesa për miratimin e një rregulloreje të brendshme shtesë nuk ka mbështetje në ligj dhe do të përbënte tejkalim kompetencash nga organi zbatues. Komisioni i ngritur ka vepruar në përputhje me dispozitat e VKM-së, e cila përcakton qartë përbërjen, funksionimin, procedurat e kontraktimit dhe kriteret e vlerësimit.

2. Komisioni vlerëson se VKM nr. 893/2020, megjithëse përcakton kriteret bazë për përzgjedhjen e studiove ligjore, nuk përmban metoda të detajuara për mënyrën e pikëzimit dhe renditjes së ofertuesve lidhur me kriteret cilësore, si përvoja profesionale, eksperiencat e ngjashme të stafit dhe rastet e suksesit në çështje të ngjashme. Në këtë kuadër, komisioni ka aplikuar një metodologji të ndërtuar mbi parimet e barazisë dhe logjikës së pikëzimit të ofertës ekonomike, sipas formulës së përcaktuar në pikën 4, shkronja “a” të VKM-së. Kjo metodologji është përdorur nga Komisioni në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë ofertuesit dhe është dokumentuar në tabelën përkatëse të vlerësimit. Pra theksojmë se kjo metodologji është përdorur nga Komisioni për të siguruar një vlerësim të drejtë, të barabartë dhe objektiv të ofertuesve, duke kryer një përlllogaritje të secilit kriter, në mënyrë matematikore.

3. Komisioni sqaron se verifikimi i mungesës së konfliktit të interesit nuk është formalizuar në momentin e hapjes së ofertave, për shkak se VKM nr. 893/2020, si akti i vetëm rregullues për këtë procedurë specifike, nuk përmban një kërkesë të shprehur për këtë veprim në këtë fazë të procedurës. Deri në përfundim të procedurës, nuk ka rezultuar asnjë situatë konkrete të konfliktit të interesit, dhe komisioni nuk është vënë në dijeni të ndonjë rrethane që do të kërkonte vetëdeklarim ose përjashtim.

4. Lidhur me konstatimin për mungesën e shpjegimeve në procesverbal mbi mënyrën e vlerësimit të rasteve të ngjashme me objektin e procedurës, sqarojmë se vlerësimi i kriterëve si përvoja profesionale, eksperiencat e ngjashme të stafit kryesor dhe rastet e suksesit, është kryer mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga subjektet ofertuese, në përputhje me pikën 1, shkronja “ç”, të seksionit B, kreu III të VKM nr. 893/2020, ku kërkohet informacion mbi *“raste të suksesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurrimit”*.

Rastet janë trajtuar si pjesë përbërëse e vlerësimit, dhe për secilin operator është përlllogaritur numri përkatës i tyre, duke u reflektuar në totalin përfundimtar të pikëve në tabelën përkatëse të procesverbalit. Komisioni ka konsideruar të mjaftueshëm dokumentimin përmes përmbledhjes numerike dhe sistemit të pikëzimit të aplikuar, pasi kjo qasje siguron objektivitet dhe trajtim të barabartë për të gjithë ofertuesit.

5. Kontratat e lidhura nga Avokatura e Shtetit parashikojnë hartimin në gjuhën angleze.

Një parashikim i tillë, është në koherencë edhe me kompetencat e Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja, Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar e cila sipas nenit 9 të ligjit organik të saj, ka për kompetencë përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit shqiptar pranë gjykatave të huaja ndërkombëtare, arbitrazhit ndërkombëtar, dhe organizmave ndërkombëtare, me karakter gjyqësor apo mbikëqyrës. Gjithashtu duhet të evidentohet se gjuha e arbitrazhit, në të gjitha çështjet ku RSH është palë, është gjuha angleze. Çdo parashtrim, komunikim zyrtar në këto procedura është gjuha angleze. Është Avokatura e Shtetit, ajo që ndjek zbatimin e Kontratës. Megjithatë ASH, i ka vënë në dispozicion, një version në gjuhën shqipe të secilës kontratë, institucioneve të cilat realizojnë pagesat e parashikuara në kontratë.

6. Komisioni ka konsideruar se raporti përfundimtar përbën dokumentin zyrtar dhe përmbledhës të gjithë praktikës, dhe për rrjedhojë, dokumentet përbërëse brenda tij (p.sh. procesverbalet ndërmjetëse) nuk janë protokolluar në mënyrë të veçantë, pasi nuk kanë funksion të veçantë të pavarur nga raporti. Gjithsesi, të gjitha dokumentet janë të ruajtura në dosje dhe të aksesueshme, sipas praktikës së ndjekur nga institucioni në përputhje me rregullat e brendshme të administrimit të dokumentacionit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit pasi analizoi me vëmendje parashtrimin tuaj, i cili është i njëjtë me atë që u përcoll në fazën e projekt-raportit, arsyeton se ***argumentet tuaja nuk paraqesin fakte të reja, arsye për të cilën observacioni nuk pranohet.*** Argumentet ligjor janë dhënë nga grupi i auditimit në akt-konstatimin nr.10, datë 07.05.2025 dhe në Projekt Raport, argumente të cilat po i citojmë edhe njëherë si vijon:

1. Çdo institucion publik është i detyruar të hartojë akte të brendshme për rregullimin e procedurave dhe funksionimit të tij. Çdo akt administrativ i nxjerrë nga organi publik duhet të bazohet në procedura të qarta dhe të përcaktuara, duke përfshirë edhe miratimin e rregulloreve të brendshme nga institucionet publike. Referuar ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, 186 shkronja b) parashikohet se *Organet publike miratojnë rregullat e brendshme të punës në zbatim të dispozitave të këtij Kodi.* Për më tepër, bazuar në nenin 16, pikat 2 dhe 3, nenin 22 pika 1 dhe nenin 23, pika 5, e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe pikës 3.3.2 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, parashikohet se njësitë publike, për realizimin e objektivave dhe përdorimin e fondeve buxhetore në mënyrë të ligjshme, ekonomike, efektive dhe eficiente duhet të organizojnë veprimtarinë, jo vetëm bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, por edhe në procedura të brendshme të shkruara dhe miratuara nga titullarët e tyre.

Për të vijuar me Rregulloren e brendshme të Avokaturës së Shtetit, miratuar me Urdhrin nr. 68, datë 28.3.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, i ndryshuar në nenin 55 të saj parashikohet si vijon: 1. Llojet e akteve administrative në veprimtarinë ekzekutive dhe urdhërdhënëse të ASH-s, që përdoren për përmbushjen e funksioneve të saj, janë:

a) **“Urdhri”**, është akti nënligjor i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me karakter të brendshëm, që vendos rregulla sjellje të përgjithshme ose rregullon një marrëdhënie konkrete. Urdhëri del në bazë dhe në zbatim të Ligjit.

b) **“Udhëzimi”**, është akt nënligjor i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit me karakter shpjegues, që shtjellon të gjitha urdhërimet e Ligjit ose Vendimit të Këshillit të Ministrave.

c) **“Rregullorja”**, është akt nënligjor i miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, që shtjellon rregullat dhe procedurat që do të përdoren në kryerjen e një veprimtarie konkrete.

Nisur nga kuadri ligjor si më sipër, i cili parashikon mundësinë e rregullimit të situatave të pa trajtuara në mënyrë shteruese në një akt ligjor apo nënligjor si dhe mangësitë e konstatuara në përmbajtjen e praktikave të shqyrtuara nga grupi i auditimit arrihet në konkluzion se: Ngritja e komisionit në Avokaturën e Shtetit për zhvillimin e procedurës së kontraktimit e të përzgjedhjes së ofertuesit/studios së avokatisë në pajtim me funksionet e ngarkuara sipas VKM nr. 893/2020, shoqërohet edhe me detyrimin ligjor të ekzistencës së rregullave të brendshme, të cilat në mënyrë të qartë e të detajuar përcaktojnë ndarjen e të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësisive të anëtarëve të komisionit, procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, vendimmarrjen, rregullat mbi dokumentimin e plotë, të saktë dhe në kohën e duhur të procesit që nga nisja e tij deri në arkivimin e praktikës, si edhe rregulla të tjera që lidhen me konfidencialitetin e ruajtjes së të dhënave apo deklarimin e konfliktit të interesit.

Pretendimi juaj se kërkesa për miratimin e një rregulloreje të brendshme shtesë apo udhëzim do të përbënte tejkalim kompetencash nga organi zbatues nuk qëndron, për sa kohë që ky udhëzim nuk do të krijoj rregulla të reja që tejkalojnë kompetencat e dhëna nga VKM-ja apo ligji, por ndihmon në zbatimin e VKM-së në mënyrë më efektive.

2. Për më tepër, nisur nga fakti se VKM nr. 890/2020, nuk i ka të përcaktuara qartë rregullat që ndiqen gjatë procesit të pikëzimit e të renditjes së subjekteve ofertuese lidhur me kritere si: *“përvoja profesionale e ofertuesit, eksperiencia të ngjashme të stafit kryesor të ofertuesit dhe raste të suksesit të ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit”*, si dhe metodologjia e përdorur nga komisioni është e pa miratuar me një akt të

brendshëm është e nevojshme që procedura të pasqyrohet në një akt nënligjor me efekt rregullator si Udhëzim/Urdhër/Rregullore të titullarit të institucionit. Në rast ankimimi të procedurës së vlerësimit nga subjektet ofertuese të kualifikuara, Zyra e Avokaturës së Shtetit do të mund të garantojë ofertuesit me informacion të mjaftueshëm për mënyrën e vlerësimit, bazuar në procedura transparente dhe të miratuara.

3. Ndonëse verifikimi i mungesës së konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit përbën një situatë të pa parashikuar nga VKM nr. 893/2020, si akti i vetëm rregullues për këtë procedurë specifike, ky detyrim ligjor buron nga ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar si dhe neni 30 i ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”. Pavarësisht qëndrimit tuaj mbi mos pasje të situatave të konfliktit të interesit në procedurat e zhvilluara, në kuadër të parimit të paanësisë dhe objektivitetit, në vijimësi anëtarët duhet të shprehen në procesverbalin e mbajtur prej tyre, mbi kryerjen e verifikimit të mungesës së situatave të konfliktit të interesit dhe në rast të konstatimit të ekzistencës së tij nga anëtari i komisionit plotësohet një deklaratë tip për gjendjen e konfliktit të interesit.

4. Pavarësisht se numri i rasteve të vlerësuara për çdo subjekt nga komisioni është i bazuar në dokumentet e paraqitura prej tyre, pasqyrimi në procesverbal vetëm i numrit të rasteve që janë marrë në konsideratë si raste të ngjashme *me objektin e procedurës së konkurrimit*, në mungesë të një analize të hollësishme nga anëtarët e komisionit nuk garanton përmbushjen e standardit të arsyetimit të aktit administrativ. Në vijimësi komisioni duhet të kryej dhe të pasqyrojë në procesverbal një analizë e vlerësimit më të detajuar mbi numrin total të praktikave të ngjashme të paraqitura nga subjektet ofertuese, çfarë përfaqësojnë ato në kuptim të kriterit që duhet të përmbushin, me qëllim garantimin e një transparence më të lartë të procedurës për palët e interesuara.

5. Procedura e ndjekur dhe kriteret e vendosura për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyra të avokatisë të huaja është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Kontrata e lidhur midis ASH dhe subjektit ndërkombëtar fitues është një veprim juridik, i cili duhet të përmbush kriteret e formës edhe sipas ligjit të shtetit shqiptar, në të cilin është kryer veprimi juridik. Për sa më sipër, kontrata duhet të përkthehet saktë nga një përkthyes i çertifikuar, në mënyrë që personi juridik/institucioni që do të marrë masat për zbatimin e saj, të disponojë kopjen e kontratës në gjuhën shqipe si një dokument zyrtar me të gjithë elementët e duhur për vlefshmërinë e saj.

6. Në kushtet kur procedura nuk zhvillohet në formë elektronike, hapat e ndjekura nga komisioni duhet të dokumentohen përmes hartimit të procesverbalit në kohën e duhur dhe të protokollohen në përputhje me nenin 18 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Bazuar në pikën 7 të VKM nr. 893/2020 parashikohet se: “*Komisioni mban një procesverbal të hollësishëm për procedurën e ndjekur sipas kreut III, të këtij vendimi, përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Pra, përtej detyrimit të hartimit të një raporti përmbledhës sipas pikës D të VKM-së ku përcaktohet se: “Komisioni, brenda 2 (dy) ditëve punë nga momenti i përfundimit të procesit të vlerësimit të ofertave dhe të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës për gjithë procesin e kontraktimit dhe i’a dërgon për miratim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit”, komisioni ka detyrimin ligjor të hartojë procesverbal për procedurën e ndjekur. Për sa më sipër, dokumentimi i veprimeve të komisionit në formën e kërkuar ligjore dhe në kohën e duhur për çdo fazë të procedurës së ndjekur prej tij, paraqet rëndësi në kuadër të zhvillimit të një procedure transparente dhe ligjore.*

Në mungesë të përcaktimit të rregullave të detajuara nga ASH mbi përgjegjësinë e komisionit për administrimin, sistemimin, inventarizimin e dokumentacionit të praktikës dhe arkivimin e saj, është e domosdoshme të theksohet se çdo akt i mbajtur nga komisioni si procesverbale, korrespondenca me subjektet ofertuese si dhe dokumentacion i dorëzuar nga subjektet

ofertuese në formë elektronike apo shkresore duhet të administrohet si pjesë e dosjes përkatëse. Në përfundimin të procedurës komisioni inventarizon dosjen dhe e dorëzon në zyrën e arkivës bazuar në nenin 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

III. Procedura e kontraktimit për përfaqësimin e RSH-së në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar EMS & Trading GmbH kundër Republikës së Shqipërisë .

-Me shkresën nr. 1736/17 prot, datë 05.06.2023 Avokatura e Shtetit ka vënë në dijeni Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë se me anë të komunikimit elektronik me ICSID(Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve), është njoftuar mbi kërkesën për arbitrazh të regjistruar kundër RSH-së prej shoqërisë tregtare “EMS & Trading GmbH”. Bazuar në pikën 6, Kreun III, të VKM-së nr. 893, datë 18.11.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, Avokatura e Shtetit ka konstatuar nevojën për kontraktimin e një avokati/studio avokatie, me qëllim angazhimin e tij/saj për përfaqësimin e RSH-së në këtë proces arbitrazhi.

-Me shkresën nr.1736/30, datë 12.07.2023 ka ardhur përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit ku shprehen se janë dakort me vijimin e procedurave për sigurimin e asistencës sipas kuadrit ligjor në fuqi.

-Me shkresën nr. 1736/38 , datë 12.10.2023 është vënë në dijeni Avokati i Përgjithshëm i Shtetit për nevojën e kontraktimit të një studioje ligjore që do të realizojë mbrojtjen dhe përfaqësimin e RSH-së.

-Me shkresën nr.1736/39, datë 17.10.2023, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit me Urdhërin nr. 485, datë 17.10.2023 ka vendosur “Për fillimin e procedurës së konkurimit për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studios së avokatisë për përfaqësimin e RSH-së në çështjen e arbitrazhit ICSID CASE NO. ARB/23/9 EMS SHIPPING&TRADING GMBH kundër RSH-së”. Për zbatimin e procedurës së kontraktimit të avokatëve/studios së avokatisë është ngritur Komisioni me përbërje: D. S.(Kryetare) si dhe S. P dhe B. H. (anëtar).

-Me procesverbalin nr. 1, datë 17.10.2023 komisioni ka vendosur të hartojë Ftesën për Ofertë në gjuhën shqipe dhe angleze, si edhe ka filluar procesin e identifikimit të subjekteve të përcaktuara (studiove të arbitrazhit) në pikën 1, të Kreut I, të VKM-së nr. 893, datë 18.11.2020 të cilët janë renditur në udhërrëfyes ndërkombëtarë të njohur, në fushën objekt procedure.

-Me procesverbalin nr. 2, datë 18.10.2023, komisioni diskutoi përmbajtjen e ftesës për ofertë në shqip dhe anglisht dhe vendosi për hartimin e saj. Komisioni në mbështetje të parashikimeve të pikës 1, të Kreut I dhe të pikës 6 të Kreut III, të VKM-së nr. 893, datë 18.11.2020 procedoi me diskutimin mbi identifikimin e avokatëve/zyrave të avokatisë të cilët janë renditur në udhërrëfyes ndërkombëtarë të njohur në fushën objekt procedure. Për këtë Komisioni është konsultuar me udhërrëfyes të njohur ndërkombëtarë si “G. R, Who’s Who L, L. 500 dhe G.Ch.” ku janë renditur studiot ligjore me më shumë eksperiencë. Komisioni duke krahasuar renditjen e tyre në të gjithë Udhërrëfyesit e përmendur identifikoi dhe u dërgoi Ftesën për Ofertë 11(njëmbëdhjetë) studiove të avokatisë. Komisioni publikoi në faqen zyrtare elektronike të ASH www.avokaturaeshtetit.gov.al njoftimin për nevojën e kontraktimit të subjekteve të përcaktuara në pikën 1, të Kreut I, të VKM-së nr. 893, datë 18.11.2020.

-Me shkresën nr.1736/40, datë 19.10.2023, komisioni ka hartuar Ftesën për Ofertë. Në ftesën për ofertë në seksionin I është parashikuar objekti i kontratës “ Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të RSH, në çështjen e arbitrazhit ICSID Case No. ARB/23/9 EMS & Trading GmbH kundër RSH, për mosëmarrveshjet që burojnë nga shkeljet e pretenduara mbi “Marrëveshjen

ndërmjet Qeverisë së Republikës Gjermane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen e përbashkët të investimeve”.

Në seksionin II të ftesës për ofertë janë parashikuar detyrat e avokatit/studios së avokatisë vendase ose të huaja ku parashikohet:

- Të studiojë në tërësi çdo dokument që ka lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi mosëmarrëveshjet e ngritura;
- Të hartojë, përgatisë dhe depozitojë brenda afatit përkatës deklaratën e mbrojtjes dhe kundërpadinë për llogari të RSH-së;
- Të bëjë vlerësimin e situatës juridike ekzistuese midis palëve, të përgatisë strategjinë për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të RSH-së;
- Të bashkëpunojë me ekspertin/ekspertët e përzgjedhur për vlerësimet e ndryshme teknike, financiare etj;
- Të paraqesë parashtrimet për çdo fazë procedurale, si dhe të paraqesë sipas rastit kundërpadi, komunikime apo çdo dokument tjetër Tribunalit, brenda afateve të caktuara, të marrë pjesë në seancat dëgjimore si dhe të përgatisë dëshmitarët, ekspertët dhe të kryejë çdo veprim tjetër procedural dhe material me qëllim realizimin e një përfaqësimi sa më të suksesshëm dhe profesional;
- Të bëjë vlerësimin e legjislacionit shqiptar lidhur me të gjitha hapësirat e zbatimit të tij mbi mosmarrëveshjet e pretenduar, objekt i këtij arbitrazhi;
- Të bëjë vlerësimin e BiT mbi juridiksionin e mosmarrëveshjes së pretenduar;
- Të asistojë palën e paditur/Avokaturën e Shtetit në rast negociatash;
- Të kërkojë pajisjen me të gjitha autorizimet apo akt/përfaqësimet e nevojshme për realizimin e shërbimeve;
- Të raportojë me shkrim mbi veprimet dhe procedurat e ndërmarra sa herë ti kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Avokatura e Shtetit;
- Të kryejë çdo veprim dhe të ofrojë çdo shërbim tjetër të arsyeshëm me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen sa më profesionale dhe të suksesshme të interesave të palës shqiptare në këtë proces arbitrazhi.

Në seksionin III janë përcaktuar kriteret për përzgjedhjen dhe vlerësimin e avokatit/studios së avokatisë vendase ose të huaj. Lista e dokumenteve që duhet të paraqesin ofertuesit është:

- Oferta ekonomike;
- Përvoja profesionale e ofertuesit;
- Eksperienca të ngjashme të stafit kryesor të propozuar , me natyrën e mosmarrëveshjes dhe/ose shërbimit të kërkuar;
- Raste të suksesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së konkurimit;
- Besueshmëria dhe reputacioni;
- Vërtetim/vetëdeklaratë i/e licencimit të avokatit/studios së avokatisë vendase ose të huaj për ofrimin e shërbimit objekt procedure kontraktimi;
- Vërtetim/vetëdeklaratë se avokati/studio e avokatisë vendase apo e huaj ekzistojnë rregullisht sipas ligjeve në fuqi dhe se nuk kanë ndonjë procedurë likuidimi, falimentimi, disiplinore apo tjetër kundër saj e cila mund të çënojë ofrimin e shërbimit objekt procedure kontraktimi;
- Deklaratë se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit.

Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas sistemit të pikëzimit të përcaktuar në VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyrat e pagesës”.

Në seksionin IV jepet informacion mbi dokumentacionin që duhet të paraqitet nga ofertuesit ku përcaktohet se:

- Oferta ekonomike (monedha dhe vlera) do të përbëjë çmimin total e të pandryshueshëm së bashku me vlerën e çdo takse të aplikueshme.
- Lidhur me përvojën profesionale, ofertuesit duhet të paraqesin dokument që pasqyron numrin e çështjeve të arbitrazhit të ndjekura nga ofertuesi. Çështjet e arbitrazhit duhet të paraqiten të listuara, me të dhënat përkatëse mbi nr. e çështjeve në ICSID, objektin, palët dhe rezultatin e saj. Ofertuesi duhet të paraqesë vetëm çështjet e përfunduara të arbitrazhit.
- Lidhur me eksperiencat e ngjashme, ofertuesit duhet të paraqesin dokumente që pasqyrojnë numrin e çështjeve të arbitrazhit të ndjekura nga stafi kryesor i propozuar nga ofertuesi, të cilat janë me natyrë të ngjashme me objektin e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në ftesën për ofertë.
- Lidhur me rastet e suksesit, ofertuesit duhet të paraqesin dokument që pasqyron numrin e çështjeve të arbitrazhit të fituara, të cilat kanë patur objekt mosmarrëveshje që rrjedhin nga zbatimi i BiT, të përfaqësuara në forumin e ICSID, të cilat duhet të paraqiten të listuara, me të dhënat përkatëse, mbi numrin e çështjeve, objektin, palët dhe rezultatin e saj. Ofertuesi duhet të paraqesë vetëm çështjet e përfunduara të arbitrazhit.
- Lidhur me besueshmërinë dhe reputacionin, ofertuesit duhet të paraqesin dokument që pasqyron besueshmërinë dhe reputacionin që gëzon ofertuesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në fushën e arbitrazhit ndërkombëtar, një përshkrim të shkurtër të metodologjisë, veprimeve dhe afateve që ndiqen nga ofertuesi për ofrimin e këtyre shërbimeve;
- Dokumentet do të paraqiten në gjuhën angleze.

Në seksionin nr. V, pika 3 të ftesës për ofertë përcaktohet procesi i përzgjedhjes dhe ankimit ku citohet:

- Komisioni për zhvillimin e procedurës së kontraktimit e të përzgjedhjes së ofertuesit brenda 10(dhjetë) ditëve pune nga hapja e ofertave, kualifikon për fazën e mëtejshme të vlerësimit vetëm ato oferta që plotësojnë kriteret për përzgjedhjen e vlerësimit, të përcaktuara në pikën 1 ,të seksionit B, të Kreut III të VKM-së nr. 893, datë 18.11.2020.

Në seksionin nr. VI të ftesës për ofertë përcaktohet:

- Ofertat e dorëzuara pas afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë nuk shqyrtohen nga komisioni dhe i kthehet e pahapur ofertuesit;
- Oferta nuk duhet të dërgohet me e-mail pasi bëhet e pavlefshme;
- Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të numerizohen. Të gjitha fletët e ofertës duhet të pajisen me iniciale ose të nënshkruhen nga personi i autorizuar nga ofertuesi;
- Ofertuesi nuk mund të tërhiqet nga oferta e tij pas paraqitjes së saj. Nëse pas paraqitjes së ofertës së tij, ofertuesi ka arsye për të dyshuar se duhet të tërhiqet nga procedura e konkurrimit, sic mund të jetë evidentimi i një rasti të mundshëm konflikti interesi, ai do të procedojë duke e njoftuar Komisionin në adresën zyrtare, i cili do të vlerësojë sipas rastit për skualifikimin e tij nga procedura e konkurrimit;
- Oferta ekonomike nuk ndryshohet për asnjë arsye përgjatë procedurës së vlerësimit dhe /ose pas momentit të lidhjes së kontratës;
- Oferta ekonomike nuk duhet të jetë me orë pune;
- Oferta ekonomike nuk duhet të përmbajë tarifë suksesi;
- Monedha e përdorur për ofertën ekonomike do të jetë Euro;
- Oferta ekonomike do të përbëjë çmimin total të pandryshueshëm , i cili në asnjë rast nuk duhet të jetë i bazuar në supozime;
- Oferta ekonomike duhet të përfshijë pagesat dhe shpenzimet në lidhje me shërbimet përkatëse të konsulencës dhe përfaqësimit për të gjitha fazat e procesit deri në përfundimin e tij *si dhe kostot e printimeve, përkthimeve, udhëtimeve dhe transportit;*
- Oferta ekonomike nuk përfshin kostot administrative që paguhen në forum dhe çdo kosto tjetër arbitrazhi e cila kërkohet prej gjykatës, koston(nëse ka) për përdorimin e

ambientit për seancën dëgjimore, kostot e transkriptuesve dhe përkthyesve për çdo seancë dëgjimore si dhe kostot për ekspertët dhe dëshmitarët;

- Ofertuesit përballojnë kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij/tyre. ASH nuk është përgjegjëse për këto kosto;
- Ofertuesi mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës. Në rast verifikimi të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, apo të vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton e vërtetë, ASH ka të drejtë të refuzojë ofertën dhe të skualifikojë ofertuesin;
- Ofertuesi mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës si dhe për çdo mospërputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në ftesën për ofertë, të cilat mund të ndikojnë deri në vlerësimin e tij të ulët ose skualifikimin e tij si ofertues nga procedura e konkurrimit;
- Në rast se në momentin e hapjes së ofertave evidentohet se një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për vlerësimin e ofertave ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej ofertuesve dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti, atëherë duhet të zëvendësohet zyrtari/zyrtarët në fjalë dhe më pas të vazhdojë procesi i konkurrimit;
- ASH ka të drejtë të ndërpresë këtë procedurë në çdo moment dhe asnjë dëmshpërblim nuk mund të kërkohet për një vendim të tillë të ASH;
- Midis ASH dhe ofertuesve nuk krijohet asnjë marrëdhënie juridike kontraktore ose jashtë kontraktore deri në nënshkrimin e një kontrate në formë të shkruar.

-Me Procesverbalin nr.3, datë 24.10.2023 Komisioni ka konstatuar se në adresën e e-mailit, të përcaktuar si pikë kontakti kanë dërguar e-maile për vënien në dispozicion të ftesës për ofertë 5(pesë) studio ligjore. Në zbatim të pikës 7, Seksioni A, Kreu III, të VKM-së nr. 893, datë 18.11.2020 Komisioni ka dhënë sqarimet përkatëse për çdo kërkesë(në gjuhën angleze).

-Me procesverbalin nr. 4 , datë 27.10.2023 Komisioni ka marrë në dorëzim nga Zyra e Protokoll Arkivës 30 (tridhjetë) zarfe të depozituara pranë ASH.

-Me procesverbalin nr. 5 datë 27.10.2023 komisioni në zbatim të pikës 9, Seksioni A, Kreu III, të VKM-së nr. 893, datë 18.11.2020 ka proceduar me hapjen e 30(tridhjetë) zarfeve duke evidentuar për secilin subjekt vlerën e ofertës, numrin e fletëve si dhe dokumentacionin bashkëlidhur. Ofertuesit bazuar në procesverbal janë si më poshtë:

1. PL 400,000 €
2. ALL&OV 1,275,000 €
3. OM 710,000 €
4. ËH&C 1,999,998 €
5. B P1,100,000 €
6. P A 1,200,000 €
7. H L 1,490,000 €
8. FH/ D A. P1,199,000 €
9. CUA 1,350,000 €
10. MIL 200,000 €
11. HU H&R 2,750,000 €
12. C&CO 785,000 €
13. FR 2,100,000 €
14. AG IN 500,000 €
15. H S FR 2,800,000 €
16. Ë&P 1,800,000 €
17. Ë F& Ë 945,000 €
18. A B 1,138,500 €
19. AU CO 749,000 €

20. L B K M PLLC 1,450,000 €
21. AR& P 3,600,000 €
22. S A 749,000 €
23. Ę&S 840,000 €
24. D M 2,000,000 €
25. EV SU 700,000 €
26. G INT A 2,500,000 €
27. HAN-H-P 2,200,000 €
28. CU 1,650,000 €
29. LIN 1,450,000 €

Në procesverbal është shkruar se janë dorëzuar 30 zarfe ndërkohë që nga leximi i emrave të subjekteve rezulton se janë 29 oferta. Nuk ka shpjegime nga Komisioni në procesverbal për zarfin e 30-të. Gjithashtu me numër rendor oferta nr. 10 paraqitet si oferta e njëmbëdhjetë e kështu me radhë duke vazhduar tek oferta nr. 29 e cila paraqitet si oferta e tridhjetë.

-Me procesverbalin nr. 6 ,datë 01.11.2023 Komisioni në zbatim të pikës 11, Kreu III, Seksioni A, të VKM-së nr. 893 datë 18.11.2020 ka konstatuar se është e nevojshme të kërkohen sqarime nga disa prej ofertuesve pjesëmarrës lidhur me mënyrën e paqartë dhe variabël të shumës totale të prezantimit të ofertës së tyre ekonomike. Komisioni ka kërkuar konfirmimin se cila është shumata totale e përgjithshme për studiot ligjore si më poshtë:

1. MIL;
2. HU H&R;
3. W&P;
4. C&CO;
5. A&B;
6. PL;
7. P A;
8. B P;
9. CUA;
10. D M;
11. W&S;
12. CU;

Komisioni ka konstatuar se ofertat ekonomike të studiove ligjore përkonin me ofertën që ata kishin sjellë në rrugë shkresore. Ndërsa për studiot “MIL” dhe “A&B”, komisioni ka konstatuar se kanë ndryshuar vlerat përkatësisht, studio “M” nga **200,000 € në 1,000,000 €** dhe A. nga 1,138,500 € në 1,233,500 €. Të dyja studiot ligjore janë skualifikuar bazuar në VKM nr. 893, datë 18.11.2020, Kapitulli IV dhe Ftesës për Ofertë ku parshikohet se: “Oferta ekonomike do të përbëj çmimin total të pandryshueshëm për shërbimin e ofruar nga ofertuesi së bashku me vlerën e çdo takse të zbatueshme. Në dosje nuk gjendeshin të administruara kopjet e e-mail-ve përkatëse me studiot, por ato u vendosën në dispozicion nëpërmjet observacioneve të datës 19.05.2025.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga M rezulton se oferta ekonomike e paraqitur nga firma është si më poshtë:

M. ka nderin ti përgjigjet ftesës për ofertë të lëshuar nga Komisioni në lidhje me përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë në çështjen e arbitrazhit No. ARB/23/9 me EMS & Trading GmbH. MIL propozon kryerjen e arbitrazhit për një tarifë ligjore të kufizuar në 1,000,000 € për punën e përshkruar në Seksionin II të Ftesës për Ofertë dhe një kufi për shpenzimet e printimit, përkthimit dhe udhëtimit në total prej 200,000 €. Propozimi është në përputhje me kërkesat e Ftesës për Ofertë, përkatësisht:

- *Oferta ekonomike nuk është paraqitur me orë pune;*
- *Oferta ekonomike nuk përmban tarifë suksesi;*

- *Oferta ekonomike është në Euro;*
- *Oferta ekonomike përbën çmimin total të pandryshueshëm, i cili nuk është i bazuar në supozime.*

M. propozon të dorëzojë fatura për shpenzimet e bëra “në kosto” pa asnjë rritje. M. vlerëson se shpenzimet e printimit, përkthimit dhe udhëtimit do të jenë më pak se 200,000 €. Oferta ekonomike nuk përfshin:

- *Kostot e arbitrazhit të kërkuara nga gjykata;*
- *Kostot e seancës dëgjimore;*
- *Kostot e ekspertëve dhe dëshmitarëve.*

Sa më sipër konstatohet se: Oferta ekonomike e paraqitur nga studio “M” është 1,200,000 € në total, ndërkohë që në procesverbalin Nr. 5, datë 27.10.2023 të hartuar nga komisioni pasqyrohet se oferta ekonomike e studios “M” është 200,000 €.

Me procesverbalin Nr. 6, datë 01.11.2023 komisioni ka kërkuar nga 12 ofertues përfshirë edhe studion “M” konfirmimin e shumës totale pasi është e paqartë, në këtë procesverbal studio “M” është skualifikuar me arsyetimin se ka ndryshuar ofertën ekonomike nga 200,000 € në 1,000,000 €. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, Kreu III, Seksioni A, Pika 10 ku citohetse: “Komisioni, brenda 10(dhjetë) ditëve punë nga hapja e ofertave, kualifikon për fazën e mëtejshme të vlerësimit vetëm ato oferta që plotësojnë kriteret për përzgjedhjen e vlerësimit, të përcaktuara në pikën 1, të seksioni B, të këtij kreu. Procesi i përzgjedhjes dhe i vlerësimit vijon nëse pranë Avokaturës së Shtetit është paraqitur të paktën 1(një) ofertë” dhe pikën 11, ku citohet se: “Për shqyrtimin e vlerësimit sa më të drejtë të këtyre ofertave, komisioni, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime me shkrim ose në mënyrë elektronike për ofertat e tyre. Në çdo rast, nuk duhet të kërkohej apo të lejohet asnjë ndryshim thelbësor në përmbajtjen e ofertës”.

-Me procesverbalin nr. 7, mbajtur në datën 06.11.2023 komisioni është mbledhur për të vijuar me procesin e vlerësimit të 28 subjekteve të kualifikuara. Bashkëlidhur procesverbalit është edhe tabela me pikët totale të vlerësimit të studiove. Komisioni në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave ka përzgjedhur fituese studion “WH &C” me vlerën 1,999,998 €, ofertues i cili ka marrë më shumë pikë sipas kriterëve të përzgjedhjes dhe vlerësimit sipas sistemit të pikëzimit.

-Konstatohet se nuk është pjesë e dosjes procesverbali i hollësishëm për vlerësimin e ofertave i parashikuar në VKM nr. 893, datë 18.11.2020 Kreu III, Seksioni B, pika 7, ku citohet se: “Komisioni mban një procesverbal të hollësishëm për procedurën e ndjekur sipas kreut III, të këtij vendimi, përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave”. Përlllogaritja e pikëve më qëllim vlerësimin e ofertuesve është mbajtur në një tabelë exceli, e printuar në kohën kur u kërkuar nga audituesi.

- Kontrata e nënshkruar në dt. 11.12.2023, midis Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe studios fituese “WH &C” në vlerën 1,999,998 €, është në dy kopje në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

Në lidhje me likuidimin e studios “Wh & C”, ASH ka përcjellë 4 fatura, dt. 29.12.2023 me vlerë 150,000€; dt. 23.05.2024 në vlerën 50 000 €, dt. 23.05.2024 në vlerën 500,000 € si edhe dt. 29.07.2024 me vlerë 350,000 €. Pra në total ka paguar 1,050,000 €. Kontrata konsiderohet e përfunduar dhe nuk ka pagesa të mëtejshme duke qenë se procedura e arbitrazhit u ndërpre për shkak se paditësi “EMS” ka tërhequr në mënyrë të pakthyeshme (pa mundur të ngrrejë më të njejtat pretendime) të gjitha pretendimet e saj kundër Republikës së Shqipërisë.

Në datën 13 Gusht 2024, nga Tribunali është dërguar Urdhri për Ndërprerjen e Procedurës Nga auditimi i procedurës së kontraktimit të studiove/avokatëve vendase/të huaja u konstatua se dokumentacioni i dosjes është i paprotokolluar në kundërshtim me ligjin Nr.9154, datë

06.11.2003 “Për arkivat”, i ndryshuar dhe nenin 12 e 13 të normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Nga auditimi i procedurës si më sipër konstatohet se:

1. Me procesverbalin nr. 5 datë 27.10.2023 është shkruar se janë dorëzuar 30 zarfe ndërkohë që nga leximi i emrave të subjekteve rezulton se janë 29 oferta. Nuk ka shpjegime nga Komisioni në procesverbal për zarfin e 30-të. Gjithashtu me numër rendor oferta nr. 10 paraqitet si oferta e njëmbëdhjetë e kështu me radhë duke vazhduar tek oferta nr. 29 e cila paraqitet si oferta e tridhjetë.

2. Me procesverbalin nr. 6, datë 01.11.2023 Komisioni në zbatim të pikës 11, Kreu III, Seksioni A, të VKM-së nr. 893 datë 18.11.2020 ka konstatuar se është e nevojshme të kërkohen sqarime nga disa prej ofertuesve pjesëmarrës lidhur me mënyrën e paqartë dhe variabël të shumës totale të prezantimit të ofertës së tyre ekonomike. Konstatohet se nuk janë pjesë e dosjes e-maillet nëpërmjet të cilave u është kërkuar sqarimi me shkrim firmave të mësipërme. Komisioni ka konstatuar se ofertat ekonomike të studiove ligjore përkonin me ofertën që ata kishin sjellë në rrugë shkresore. Ndërsa për studiot “M” dhe “A&B”, komisioni ka konstatuar se kanë ndryshuar vlerat përkatësisht, studio “M” nga 200,000 € në 1,000,000 € dhe A&B nga 1,138,500 € në 1,233,500 €. Të dyja studiot ligjore janë skualifikuar bazuar në VKM nr. 893, datë 18.11.2020, Kapitulli IV dhe Ftesës për Ofertë ku parshikohet se: “Oferta ekonomike do të përbëjë çmimin total të pandryshueshëm për shërbimin e ofruar nga ofertuesi së bashku me vlerën e çdo takse të zbatueshme. Në dosje nuk gjendeshin të administruara kopjet e e-mail-ve përkatëse me studiot, ato u vendosën në dispozicion pasi u kërkuan nga grupi i auditimit.

3. Oferta ekonomike e paraqitur nga studio “M” është 1,200,000 € në total, ndërkohë që në procesverbalin Nr. 5, datë 27.10.2023 të hartuar nga komisioni pasqyrohet se oferta ekonomike e studios “M” është 200,000 €. Studio “M” është skualifikuar me arsyetimin se ka ndryshuar ofertën ekonomike nga 200,000 € në 1,000,000 €. Komisioni ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, Kreu III, Seksioni A, Pika 10

4. Nuk është pjesë e dosjes procesverbali i hollësishëm për vlerësimin e ofertave i parashikuar në VKM nr. 893, datë 18.11.2020 Kreu III, Seksioni B, pika 7, ku citohet se: “Komisioni mban një procesverbal të hollësishëm për procedurën e ndjekur sipas kreut III, të këtij vendimi, përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave”. Përlllogaritja e pikëve më qëllim vlerësimin e ofertuesve është mbajtur në një tabelë exceli, e printuar në kohën kur u kërkua nga audituesi.

5. Procesverbalet e mbajtura nga komisioni për të gjitha fazat e ndjekura të procedurës nuk janë të protokolluara, në mospërputhje me nenin 19 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave. Dokumentacioni i praktikës është i pa arkivuar, në mospërputhje me nenin 24 të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”, dhe nenin 21 të Normave Tekniko-Profesionale të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

2.6.2. Mbi funksionimin e Këshillit Konsultativ

Për funksionimin e Këshillit Konsultativ, u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- Urdhrat e Avokatit të Shtetit për ngritjen dhe përbërjen e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit;
- Urdhrat e KM për përbërjen e Këshillit Konsultativ;
- Proces verbalet e mbajtura sipas mbledhjeve të kryera, për periudhën 01.01.2023-31.12.2024;
- Çdo dokumentacion në funksion të auditimit.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

-Ligji Nr.10018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit” i ndryshuar;

-Rregullore e brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e Avokaturës së Shtetit” miratuar me Urdhrin Nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit i ndryshuar; Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve në ligjin organik nr. 10018 datë 13.11.2018 të ASH sipas ligjit nr. 86/2018, pranë Avokaturës së Shtetit është përcaktuar edhe *ngritja dhe funksionimi i një këshilli të posaçëm për orientimin dhe konsultimin e ASH mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ*, realizimin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në mënyrë të plotë nga institucionet e ngarkuara për kryerjen e tyre si dhe përcaktimit të një plani pune/veprimi me afate konkrete për realizimin e detyrave konkrete, në kuadër të ekzekutimit të një vendimi.

Këshilli Konsultativ përbëhet nga 5 anëtarë të cilët emërohen nga Kryeministri, me propozim të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

Me urdhrin nr.34, datë 04.02.2019, të Kryeministrit “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ për Çështjet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut” (i ndryshuar) janë emëruar anëtarë të Këshillit Konsultativ:

1. Znj. A. V. - Këshilltare në Gjykatën Kushtetuese
2. Z. A. H. -Dekan i Fakultetit Juridik/ish anëtar i Gjykatës së Lartë
3. Z. K. T. -Ish anëtar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
4. Z. S. S. -Drejtore i Shkollës së Magjistraturës/ish anëtar i GJK
5. Z. P. P. - Ish anëtar i Gjykatës Kushtetuese

Në vijim Titullari i ASH me Urdhrin nr.33 datë 08.02.2019 ka miratuar Sekretariatit Teknik të Këshillit, i përbërë dhe ky nga 5 anëtarë punonjës të institucionit.

Për shkak të dorëheqjeve të disa anëtarëve të Këshillit për shkak të emërimit të tyre në institucione, në të cilat qëndrimi si anëtarë do të konsiderohej në konflikt interesi apo do të sillte ngarkesë të tepërt për ta, si dhe për shkak të mbarimit të afatit 2 vjeçar të mandatit si anëtarë Këshilli, pas vitit 2020, Këshilli Konsultativ ka mbetur jo funksional.

Në datën 04.06.2024, me Urdhrin 91 të Kryeministrit janë përzgjedhur anëtarët e rinj të Këshillit Konsultativ (KK).

1. Znj. E. A.
2. Z. A. R.
3. Z. S. B.
4. Z. I. R.
5. Z. H.L.

Me Urdhrin nr. 350, datë 27.09.2024, Avokati i Përgjithshëm ka urdhëruar krijimin dhe përbërjen e Sekretariatit Teknik të përhershëm të KK, i përbërë nga 4 anëtarë:

1. Znj.E. D.
2. Znj.A. Gj.
3. Znj.M. L.
4. Z.M. R.

Ky Këshill gjatë vitit 2024, ka zhvilluar 2 mbledhje, konkretisht në muajin tetor (datë 23.10.2024) dhe muajin nëntor (datë 13.11.2024).

Mbledhjet e Këshillit janë kryer si vijon:

1. Mbledhje e datës 23.10.2024, diskutimi mbi rregullat e funksionimit të Këshillit Konsultativ për çështjet e GJEDNJ si dhe miratimin e agjendës për mbledhjen e ardhshme.

2. Mbledhje e datës 13.11.2024, me rend dite: *Gjetjen e zgjidhjeve efektive për zgjidhjen e çështjeve në gjykim përpara GJEDNJ-së, me objekt “Mungesë aksesit në Gjykatën Kushtetuese” për shkak të mënyrës së llogaritjes së afatit të paraqitjes së kërkesës pranë kësaj*

gjykate si dhe çështjeve me të njëjtin objekt, që nuk i janë komunikuar qeverisë për gjykim, por mund të jene në shqyrtim të GJEDNJ-së(çështja S. k. Shqipërisë, Ç. k. Shqipërisë).

Në fund të diskutimeve u rekomandua nga ky Këshill:

Hartimi dhe dërgimi i një shkrese pranë GJK, në të cilën të evidentohet problematika e konstatuar nga GJEDNJ në vendimet k. Shqipërisë, duke u rekomanduar edhe mundësia e zgjidhjes së këtyre çështjeve me pajtim.

Lidhur me veprimtarinë e Këshillit Konsultativ konstatohet se:

-Procesverbalet e mbledhjeve nuk rezultojnë të firmosura nga pjesëmarrësit por vetëm nga një anëtare e Sekretariatit Teknik dhe Titullari i institucionit. Mungesa e konfirmimeve bie në kundërshtim me “Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13, ku përcaktohet se: “*Dokumentet e brendshme, si: vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e jo shtetëror, studimet, planet e programet e punës, raportet, relacionet, informacionet, bilancet etj., kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin, me përjashtim të adresës së korrespondentit e të formulës “në përgjigje” ose “në vijim të shkresës”.*

Dokumentet e brendshme, kur i dërgohen një organi tjetër, shoqërohen me shkresë përcjellëse. Dokumentet e brendshme i paraqiten titullarit për firmë apo njohje vetëm pasi janë protokolluar”.

Për periudhën në auditim, evidentohen vetëm 2 mbledhje nga 12 të tilla minimalisht të detyrueshme, për një vit. Pra rezulton që ky Këshill **nuk ka qenë funksional** duke mos i shërbyer qëllimit për të cilin është krijuar në orientimin dhe konsultimin e ASH mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së KEDNJ, realizimin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në mënyrë të plotë nga institucionet e ngarkuara për kryerjen e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 10018 për ASH, i ndryshuar, neni 19/7 Llojet e masave të përgjithshme;

*1. Avokatura e Shtetit ka të drejtën të sugjerojë masa të përgjithshme parandaluese, në lidhje me ndryshimet e nevojshme të legjislacionit apo praktikave, të cilat mund të shkaktojnë **dëm financiar për shtetin**, si rezultat i shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e në vijim të kësaj në kundërshtim me nenin 19/8 Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, pika 1:*

*1. Avokatura e Shtetit, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve, **sipas nenit 19/7, të këtij ligji, konsultohet me Këshillin Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së.***

Në këtë kontekst nisur nga analizimi e efekteve financiare në lidhje me monitorimin dhe ndjekjen nga ASH për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, rezultoi se deri në dhjetor 2024, janë ende pa u ekzekutuar 6 vendime me një barrë financiare të konsiderueshme për shtetin shqiptar në vlerën **17,968,650 euro**, pa përfshirë këtu interesat që do të llogariten në momentin e ekzekutimit të tyre.

Kolegji i Avokaturës së Shtetit përbëhet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, i cili kryeson Kolegjin, si dhe nga gjashtë avokatë shteti, të zgjedhur për dy vjet nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

Për periudhën në auditim, Kolegji i Avokaturës së Shtetit është krijuar me urdhrin nr. 378, datë 20.10.2022 “Për ngritjen dhe përbërjen e Kolegjit”, i ndryshuar (me urdhrin nr. 49, datë 30.01.2023 si dhe ndryshuar me urdhrin nr. 284, datë 02.08.2024).

Përbërja e tij është:

1. znj.V. L.
2. z. B. H.
3. znj.M. M.

4. znj.S. T.
5. znj.E. D.
6. znj.J. Ç.

Sekretariati teknik përbëhet nga 2 anëtarë: znj. Xh. D., z.M. R.

Për periudhën e auditimit 2023-2024, Kolegji i Avokaturës së Shtetit është mbledhur gjithsej dy herë pasqyruar në procesverbalin nr. 3, datë 30.01.2023, dhe procesverbali nr. 4, datë 08.02.2023. Rendi i ditës në të dy mbledhjet ka qenë:

1. Diskutim mbi propozimin për hartimin e një Urdhri të vetëm për delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetit tek organi i administratës publike apo enti publik i interesuar, lidhur me kategori të caktuara çështjesh gjyqësore.

2. Vendimarrja e mbledhjes së datës 30.01.2023, rezulton në Vendimin e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit nr. 2, datë 08.02.2023 “Për propozimin për delegimin e së drejtës së përfaqësimit dhe mbrojtjes” dhe urdhrin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit nr. 123, datë 03.03.2023.

-Procesverbalet e mbledhjeve të datës 30.01.2023 dhe 08.02.2023 nuk rezultojnë të firmosura nga pjesëmarrësit por vetëm nga anëtarët e sekretariatit teknik. Mungesa e konfirmimeve bie në kundërshtim me Ligjin nr.8480 datë 27.05.1999, ”Për funksionimin e organeve kolegjiale”, neni 16 i tij.

-Në procesverbal nuk rezultojnë të pasqyruara votimi pro ose kundër i anëtarëve, çka cenon besueshmërinë e vendimmarrjeve.

Kolegji i ASH, nuk i ka shërbyer qëllimit për të cilin ai është i krijuar dhe përcaktuar në ligj pasi për periudhën 2023-2024 është mbledhur vetëm **2 herë** kur të paktën duhet të ishte mbledhur **24 herë**, në kundërshtim me nenin 20, pika 3 e Rregullores së brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit” miratuar me Urdhrin Nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, ku përcaktohet se: “**Mbledhjet e Kolegjit të Avokaturës së Shtetit zhvillohen periodikisht një herë në muaj por me kërkesë të Kryetarit apo njërit prej anëtarëve ato mund të thirren edhe më shpesh. Ato do të konsiderohen të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve, me përjashtim të rasteve kur Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, për shkak të rëndësisë së çështjes, kërkon që në mbledhje të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët e kolegjit. Një nga anëtarët e Kolegjit zgjidhet relator për çështjen. Në mbledhjet e Kolegjit mund të thirret për të dhënë shpjegime avokati i shtetit i ngarkuar me çështjen që do të shqyrtohet**”

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Funksionimi i dy organeve kolegjiale (KK dhe Kolegji i ASH) përgjatë periudhës 2023-2024 paraqitet me mangësi, në përmbushjen e qëllimit të parashikuar nga ligjvënësi pasi pothuajse kanë qenë jo funksionale si në drejtim të aspekteve procedurale por edhe në numrin shumë të vogël të mbledhjeve të kryera për zgjidhjen dhe këshillimin në shumë çështje gjyqësore kundër Shqipërisë duke mos dhënë besueshmëri për rolin të cilin ata kanë sipas përcaktimeve ligjore. Kjo edhe për faktin e konstatimeve të kryera nga grupi i auditimit ku shumë çështje sipas vendimeve të GJEDNJ, nuk kanë zhvillim për më shumë se 7 vite, ka mangësi në proceset e ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit të brendshëm, mungesën e mbulimit të plotë me veprimtari inspektimi të zyrave vendore të ASH, zvarritjen e procesit të regjistrimit të dosjeve në regjistrin elektronik të disponuar nga ASH, të çështjeve të zhvilluara në gjykatat e huaja, mos garantimin e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) brenda afateve përkatëse dhe në vlerën e përcaktuar të tyre, ku vetëm për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ, rezultoi se deri në dhjetor 2024, janë ende pa u ekzekutuar 6 vendime me një barrë financiare të konsiderueshme për shtetin shqiptar në vlerën **17,968,650 euro**, pa përfshirë këtu interesat që do të llogariten në momentin e ekzekutimit të tyre.

2.6.3. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH

Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, nr. 853/15 Prot, datë 27.01.2025
- Korrespondenca shkresore e ndjekur ndërmjet Avokaturës së Shtetit dhe KLSH-së.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur nga institucioni për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

- *Avokatura e Shtetit, ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

Realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar pasqyrohet si më poshtë vijon:

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së”.

Nga auditimi i ushtruar në Avokaturën e Shtetit, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “Mbi auditimin e përputhshmërisë për ecurinë e detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të GJEDNJ dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 19, datë 23.01.2025, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 853/15 Prot, datë 27.01.2025, verifikohet se:

-Avokatura e Shtetit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka nxjerrë plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe me shkresën nr. 3316/7, datë 14.02.2025 “Plan veprimi, për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH” ka dërguar kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë 7 masa organizative gjithsej. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga 7 masa organizative të rekomanduara gjithsej, nga të cilat 3 janë zbatuar plotësisht, 2 janë në proces zbatimi dhe 2 nuk janë zbatuar.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar rezulton se:

- për 2 vendime arbitrazhi (*ICC Case 22919/GR dhe ICSID ARB/14/26*) ku Tribunali është shprehur për detyrimet që kanë paditësit ndaj RSH, ka vonesa nga mosveprimi në kohë i palëve të interesit/të paditurve (*RSH/MIE,MTM*) në procedurat e njohjes të vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile (K.Pr.C), neni 393 dhe 398, duke

sjellë për pasojë mos arkëtimin në buxhetin e shtetit të vlerës prej **10,013,972 Euro, 1,162,125.71 USD dhe 108,550.6 GBP.**

- për 4 vendime arbitrazhi (*ICSID Case ARB/15/28, ICC Case 22676/GR GBC, ICC Case 23998/MMH dhe ICC Case 20564*) ku Tribunali është shprehur për detyrimet që ka RSH ndaj paditësve, ka vonesa në ushtrimin e kërkesës për njohjen e vendimeve të arbitrazhit nga Gjykata e Apelit në zbatim të nenit 398 të Kodit të Procedurës Civile, nga mosveprimi në kohë i paditësve, që ka sjellë për pasojë mos ekzekutimin e detyrimit që ka RSH-së ndaj tyre, në vlerën **108,439,747.08 Euro dhe 59,479,735.64 USD.** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Avokatura e Shtetit/Zyra e Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, për këmbimin në kohë të informacionit dhe bashkëpunimin me palët e interesit/ministritë përgjegjëse, në lidhje me procedurat e ndjekura prej tyre për ecurinë e procesit të njohjes së vendimeve nga Gjykata e Apelit, për rastet kur vendimet e arbitrazhit janë shprehur në favor të RSH-së.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Avokatura e Shtetit në përfundim të procedurave të arbitrazhit për vendimet në favor të RSH-së, ka bashkëpunuar dhe do të vijojë bashkëpunojë me institucionet e përfshira në proces, sa i përket procesit të njohjes së vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar nga Gjykata e Apelit më konkretisht:

Me daljen e një vendimi arbitrazhi në favor të RSH-së, Avokatura e Shtetit u njofton institucioneve të përfshira vendimin, duke i sjellë në vëmendje se vendimi për t'u bërë i ekzekutueshëm në Shqipëri, duhet të njihet në Gjykatën e Apelit. Në këtë kuadër Avokatura i ofron institucioneve asistencë në përgatitjen e dosjes së plotë për t'u paraqitur në Gjykatën e Apelit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është në proces.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi hedhjen e të dhënave në regjistrin e posaçëm fizik dhe elektronik të çështjeve të trajtuara apo në trajtim të gjykatave të huaja, ndërkombëtare dhe arbitrazhit ndërkombëtar, rezulton se Regjistri nuk është plotësuar sipas rubrikave të formatit të miratuar, pasi nuk përmban të dhëna mbi datën dhe numrin e regjistrimit të çështjes/vendimit për arbitrazh në protokoll, për çështje të iniciuara para vitit 2022 (*kohë në të cilën ka dalë urdhri për miratimin e formatit të Regjistrit*) për aq sa mund të lejohet nga parimi i konfidencialitetit, si dhe për ekzekutimin e detyrimeve të GJEDNJ si dhe nuk përfshin numrin e kërkesës, në kundërshtim me nenin 17 pika 3, germa “c” dhe nenin 18, pika 1.2, germa “r” të Rregullores dhe formatit të Regjistrit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 27-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

2.1. Rekomandimi: Të merren masa nga ASH/Zyra e Përfaqësimit në gjykatat e huaja, ndërkombëtare dhe në arbitrazhin ndërkombëtar, që hedhja e të dhënave në regjistrin e çështjeve të bëhet konform kërkesave të formatit të miratuar, duke u bërë përditësimi i tij në kohë reale, me qëllim që të dhënat e regjistruara të shërbejnë për raportimin në MFE - së të detyrimeve që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Do të vijojë hedhja dhe përditësimi i të dhënave në regjistrin e çështjeve të arbitrazhit dhe GJEDNJ sipas formatit të miratuar me urdhrin nr. 375/2 prot, datë 16.11.2022 i Avokatit të Përgjithshëm.

Do të vijojë raportimi i çështjeve të arbitrazhit në Ministrinë e Financave sipas formatit të kërkuar në zbatim të udhëzimit UMF nr. 9 datë 20.03.2021 dhe nr. 2, datë 19.01.2023.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurën e përkthimit dhe certifikimit të vendimeve GJEDNJ nga Ministria e Drejtësisë, ka rezultuar se për 3 (tre) çështje (“P.V nr.2 SHA kundër Shqipërisë”, “N. kundër Shqipërisë” dhe “L. C. kundër Shqipërisë” dhe 4 kërkesa të tjera”) nuk është respektuar afati ligjor brenda 15 ditëve, e cila nuk është në përputhje me nenin 19/2 të Ligjit Nr.10018/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 27-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Të merren masa nga ASH në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë për koordinimin e veprimeve për përkthimin dhe certifikimin në kohë të vendimeve të GJEDNJ, me qëllim respektimin e afateve procedurale të ekzekutimit final të tyre, duke shmangur lindjen e interesave për vonesë në ekzekutimin e tyre.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: Do vijojë ndjekja dhe koordinimi me Ministrinë e Drejtësisë për përkthimin dhe certifikimin në kohë të vendimeve të GJEDNJ, me qëllim respektimin e afateve procedurale të ekzekutimit final të tyre, duke shmangur lindjen e interesave për vonesë në ekzekutimin e tyre. Krahas kësaj, në kërkesat për përkthimin e vendimeve të GJEDNJ-së, do të specifikohet në mënyrë të veçantë afati 15 ditor për përkthimin e këtyre vendimeve.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve GJEDNJ, rezultoi se:
- Avokatura e Shtetit ka iniciuar procedurat për 21 vendime të dala në vitin 2023, duke përfshirë dhe vendimin ”D. kundër Shqipërisë”, i cili është bërë përfundimtar në vitin 2024, dhe në 6 procedura të vitit 2023 ekzekutimi është bërë jashtë afatit përkatës ligjor.

-Për 3(tre) vendime (*D. kundër Shqipërisë*-vendimi përfundimtar nga GJEDNJ 14.09.2015, *DH.N kundër Shqipërisë*-vendimi përfundimtar nga GJEDNJ 17.03.2016 dhe *SH kundër Shqipërisë*, vendimi përfundimtar nga GJEDNJ 28.05.2018) detyrimi i vendosur nga GJEDNJ vijon të jetë i pa ekzekutuar, duke shkaktuar rritjen e interesave për mos likuidimin në kohë.

- Gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar me vonesë 3(tre) vendime të GJEDNJ-së, të mbartura (“S. kundër Shqipërisë-komunikuar datë 21.01.2020, vendimi përfundimtar datë 21.05.2020”, “P. kundër Shqipërisë- komunikuar datë 11.06.2019, vendimi përfundimtar datë 11.09.2019” dhe “S. kundër Shqipërisë-komunikuar datë 13.12.2022, vendimi përfundimtar datë 13.03.2023”), të cilat kanë sjellë efekt financiar dhe konkretisht interesa në vlerën 410,937 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 27-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Të merren masa nga ASH në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të kryhen veprimet me qëllim respektimin e afateve procedurale të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ brenda afatit ligjor, me qëllim që të shmangen kostot shtesë për buxhetin.

Në vijimësi

Përgjigjja e institucionit: ASH në vijim, krahas kërkesës për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, do të dërgojë pranë Ministrisë së Financave edhe të dhënat e kërkuarve, që dërgohen nga Gjykata, me qëllim komunikimin drejtpërdrejt të MF me ta, për të shmangur tejkëmbimet në ekzekutim.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportimin në MFE, në rrugë zyrtare shkresore dhe elektronike për sa i përket regjistrin të përditësuar së bashku me vlerat financiare të vendimeve të arbitrazhit dhe vendimeve të GJEDNJ, ku përfshihen ato të formës së prerë, ato në proces

shqyrtimi dhe ato në pritje për shqyrtim (in queue), në zbatim të UMF Nr.9 datë 20.03.20218 dhe Nr.2, datë 19.01.2023, rezulton se nga ASH është tejkaluar afati, si dhe nuk është respektuar forma e kërkuar për dhënien e informacionit/raportimit, në kundërshtim me këtë akt nënligjor. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 24-26, 35-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Të merren masa nga ASH që në bashkëpunim me MF të bëjë rakordimin e vlerave financiare, që rrjedhin nga vendimet e arbitrazhit dhe GJEDNJ, me qëllim raportimin sa më të saktë në realizimin e buxhetit faktik të vitit, për sa i përket detyrimeve financiare që burojnë nga këto vendime të periudhës përkatëse raportuese.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit: ASH do të mbajë komunikim të vazhdueshëm me MF, duke plotësuar regjistrin e detyrimeve të vendimeve të arbitrazhit dhe ato të GJEDNJ-së, sipas udhëzimeve të MF 2/2023.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe është në proces.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ nuk ka funksionuar në vitin 2023, sipas parashikimeve në nenin 19/8 të Ligjit Nr.10018/2008, i ndryshuar, pasi ka përfunduar mandati i anëtarëve të tij. Emërimi i anëtarit të ri është bërë në vitin 2024, bazuar në Urdhrin nr.91, datë 04.06.2024 të Kryeministrit “Për një ndryshim në urdhrin nr.34 datë 04.02.2019 të Kryeministrit “Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Konsultativ për çështjet e Gjykatës Evropiane të të drejtave të Njeriut” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, përbërja e të cilit është plotësuar në vitin 2024 në zbatim të Urdhrit nr.91, datë 04.06.2024 të Kryeministrit, të marrë masa për hartimin e planeve të punës dhe plan veprimet në kuadër të ekzekutimit të vendimeve nën drejtimin dhe bashkërendimin e Avokaturës së Shtetit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: ASH ka mbledhur dy herë për vitin 2024 Këshillin Konsultativ dhe do të vijojë mbledhjen e tij, në kuadër të gjetjes së zgjidhjeve për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ dhe sipas rastit, të çështjeve në shqyrtim pranë kësaj Gjykate.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në Regjistrin e çështjeve që administron ASH për çështjet më poshtë, si dhe nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023 në lidhje me kontabilizimin dhe likuidimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendime të arbitrazhit ndërkombëtar, në subjektet MIE, MTM, AKBN dhe A SHA Patos rezulton se:

- Në pasqyrat financiare viti 2023 të MIE, në seksionin e të drejtave dhe të detyrimeve, nuk janë të kontabilizuara vendimet e gjykatave të arbitrazhit ndërkombëtar. Ndërkohë, nga auditimi i të dhënave raportuar nga Avokatura e Shtetit rezultojnë dy çështje në arbitrazhin ndërkombëtar me palë të paditur MIE:

- ICC Case nr. 22676/GR GBC Oil v. MIE, AKBN & A.

- ICC Case No. 20564/EMT/GR H. srl k. RSH/MIE.

a. Për çështjen ICC Case 22676/GR G.C kundër MIE, AKBN & A datë 06.07.2020 detyrimi i RSH (MIE/AKBN) ndaj paditësit është **12,870,612.1 USD, 14,451.68 Euro+interesa**, i cili përbëhet nga:

- 12,577,852.1 USD si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencë Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit;

- Paditësi duhet të paguajë 60 % të kostove administrative dhe të paditurit duhet të paguajnë

40 % të këtyre kostove,

-292,760 USD dhe 14,451.68 Euro, me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, ka njohur dhe ka dhëni fuqi ligjore për zbatim në RSH të Vendimit nr. 22676/GR. Avokatura e Shtetit ka ushtruar rekursin për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit, pushimin e gjykimit të çështjes, si dhe pezullimin e ekzekutimit. Pezullimi i ekzekutimit nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë. Aktualisht çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë.

Totali i detyrimeve deri në datën 31.12.2023 i përlllogaritur rezulton të jetë **12,921,664.63 USD dhe 16,971.82 Euro**.

Mosnjohja e vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 49, datë 04.05.2021 në pasqyrat financiare, ka sjellë një paraqitje jo të drejtë të detyrimeve që ka institucioni ndaj palëve të treta si dhe interesa të cilat shtohen me normë 5% deri në shlyerje, duke sjellë rritje të risqeve financiare për buxhetin e institucionit.

Interesat e përlllogaritura deri me datë 31.12.2023 janë 2,520.14 € dhe 51,052.53 USD.

b. Për çështjen ICC Case No. 20564/EMT/GR Hydro srl kundër RSH/MIE, tribunali arbitrazhit shprehet:

- T'i paguhen RSH, penalitetet për vonesa në shumën 1,693,157 Euro me interes të përbërë duke përdorur Libor 12-mujor në Euro + 2 % nga data 16 Korrik 2011 deri në pagesën e plotë.
- Dëmshtëpërblim RSH në shumën 5,182,535 Euro me një interes të përbërë me bazë Libor 12-mujor në Euro +2% nga data 9.1.2018 deri në pagesën e plotë.
- Rimbursim të RSH 325,000 USD sa i përket tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC.

- Detyrim i RSH për t'i rimbursuar Padihtësit kostot ligjore për fazën e dytë të procedurave në shumën 142,975.78 Euro.

Gjykata e Apelit me vendimin nr. 131, datë 03.05.2023 ka njohur çështjen ICC Case No. 20564/EMT/GR Hydro srl kundër RSH/MIE duke i dhënë fuqi ligjore. Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nuk është bërë njohja e këtij vendimi në pasqyrat financiare, duke sjellë një paraqitje jo të drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që kanë palët e treta ndaj institucionit dhe anasjelltas. Mosnjohja në pasqyrat financiare të të drejtave dhe detyrimeve sjell për pasoje mos arkëtimin e të drejtave të fituara dhe mospagimin e detyrimeve.

- Në pasqyrat financiare viti 2023 të MTM, në seksionin e të drejtave dhe të detyrimeve, tepricat e llogarive rezultojnë me vlerë 0 (zero) lekë. Ndërkohë, nga auditimi i të dhënave raportuar nga Avokatura e Shtetit për çështjen ICSID ARB/14/26 "A.A." SHPK, M. A. N., shoqëria "C." s.r.l kundër RSH/Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, tribunali Arbitrazhit shprehet për detyrimet e palës paditëse:

- 427,488.72 USD, kosto dhe shpenzime të procesit të arbitrazhit, dhe

- 1,857,000 Euro shpenzime gjyqësore (shpenzimet për studion ligjore të kontraktuar, ekspertin)

- 106,755 GBP shpenzime administrative.

Pala paditëse "A. A." SHPK, M. A. N., shoqëria "C" s.r.l ka iniciuar procesin e anulimit, për të cilin tribunali i arbitrazhit ka dalë me vendim datë 18.04.2022, njoftuar palëve me 6 Maj 2022:

Detyrime të palës paditëse në favor të RSH/MTM janë:

- 409,636.99 USD dhe 550,000 Euro.

Nga përlllogaritja e grupit të auditimit deri me datë 31.12.2023 totali i vlerave të arkëtueshme në favor të Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit janë në shumat 5,418,883.31 Euro, 1,472,635.27 USD dhe 265,458.19 GBP.

Nga shpallja e vendimit deri ne datën 31 dhjetor 2023 nga ana e MTM, nuk është marrë asnjë mase për njohjen e vendimit të arbitrazhit në Gjykatën e Apelit për dhënien fuqi ligjore në mënyrë që të bëhet kontabilizimi dhe më pas ndjekja për ekzekutimin e tij.

- Në pasqyrat financiare për vitin 2023, në **AKBN**, në seksionin e të drejtave dhe të detyrimeve është kontabilizuar një vendim arbitrazhi ndërkombëtar. Nga auditimi i të dhënave raportuar nga Avokatura e Shtetit rezulton një çështje ICC Case 21349/GR B. P. kundër MIE dhe AKBN e përfunduar, me palë të paditur AKBN, që është e njëjtë me vendimin e kontabilizuar në pasqyrat financiare. Tribunali Arbitrazhit ka dalë me vendim të ndërmjetëm datë 01.02.2018 sipas të cilit:

- AKBN detyrohet t'i paguajnë Bankersit vlerën 1,161,309.37 USD, kostot e përballuara nga Bankers deri në këtë fazë të procedurave në lidhje me ankimimin.

Deri më datë 31.12.2023 nga ana e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore nuk është marrë asnjë masë lidhur me likuidimin apo planifikimin për likuidim të këtij detyrimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 36-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Të merren masa nga institucionet palë në proces arbitrazhi (MTM, MIE, AKBN) në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit, të rakordojnë veprimet duke filluar që nga ndjekja e procedurave ligjore në Gjykatën e Apelit për dhënie fuqi ligjore vendimit të arbitrazhit, me qëllim njohjen e të drejtave dhe detyrime në pasqyrat e tyre financiare, për ekzekutimin dhe arkëtimin e vlerave monetare, me qëllim likuidimin e detyrimeve dhe marrjen e masave për ekzekutimin e vendimeve në funksion të raportimit që Avokatura e Shtetit bën pranë Ministrisë së Financave për hartimin e Raportit Vjetor për zbatimin e buxhetit faktit.

Menjëherë

Përgjigjja e institucionit: Në vijim të shkresave të Avokaturës së Shtetit drejtuar MTM dhe MIE ku është përcjellë vendimi i arbitrazhit së bashku me vlerat financiare dhe rekomandimi mbi fillimin e procesit të njohjes së vendimeve nga gjykata e Apelit.

Avokatura e Shtetit mbetet e gatshme në dhënien e informacionit apo çdo kërkesë të ardhur nga MTM, MIE, AKBN brenda një kohë të shkurtër, lidhur me proceset e arbitrazhit dhe raportimit që Avokatura e Shtetit ka kryer në Ministrinë e Financave me qëllim rakordimin e tyre për zbatimin e buxhetit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **nuk është zbatuar**.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces
Masa Organizative	7	3	2	2
Total	7	3	2	2

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bazuar në raportet vjetore të Avokaturës së Shtetit dhe nga verifikimet e kryera për periudhën nën auditim, 2023-2024, Zyra e Inspektimit dhe Këshillimit, e cila është përgjegjëse për kryerjen e kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit, në të dyja nivelet e organizimit, për ushtrimin me efektivitet të funksioneve të institucionit, ka kryer vetëm

inspektive tematike dhe të fokusuar mbi veprimtarinë e avokatëve të shtetit individualisht dhe jo mbi veprimtarinë e zyrave në tërësi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008 Për Avokaturën e Shtetit (ndryshuar me Ligjin Nr. 86/2018), Rregulloren e Brendshme të Avokaturës së Shtetit “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Avokaturës së Shtetit” miratuar me Urdhrin Nr.68, datë 28.03.2019, e ndryshuar, neni 19, pika 4/a.

Mungon informacioni dhe analiza lidhur me çështjet dhe pasojat të cilat mund/kanë sjellë dëm në interesat e shtetit Shqiptar, nga veprimet apo mos veprimet e avokatëve të shtetit. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe 15-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të marrë masat e nevojshme për hartimin e planeve vjetore të inspektimit, programeve të plota të inspektimit, hartimin e raporteve me informacionet përkatëse të çështjeve në të cilat mbrojtja e interesave të shtetit nuk është kryer në përputhje me përcaktimet ligjore, për të vlerësuar përmbushjen e detyrave funksionale nga avokatët e shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Fokusi kryesor i Zyrës së Inspektimit për periudhën 2023-2024, ka qenë “Përditësimi i dosjeve në sistemin elektronik”, në zyrat vendore dhe ato të avokatëve të shtetit pranë Ministrive. Megjithëse është kryer një numër i konsiderueshëm inspektimesh për këtë problematikë (rreth 92 inspektive vetëm për 2023), nuk ka një konkluzion mbi përqindjen e dosjeve të regjistruara në sistemin elektronik, e rrjedhimisht asnjë datë fikse se kur ky proces duhet të përfundojë.

Avokatura e Shtetit i regjistron çështjet e gjykatave kombëtare në regjistrin fizik dhe në sistemin elektronik të çështjeve për zyrat vendore, për të cilin rezultoi se nuk ka gjurmë auditimi ku të specifikohet data e implementimit të këtij sistemi përveçse një dokumenti në gjuhën angleze i datës 25.02.2019, i cili ka të bëjë me specifikimet teknike të sistemit. Sistemi aktual elektronik nuk përpunon informacione statistikore për çështjet gjyqësore në vite çfarë do të sillte rritje të transparencës e llogaridhënies si dhe saktësim në përpunimin e informacioneve për të bërë një analizë mbi shkaqet dhe kostot që rrjedhin prej tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 4/Pika 19. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe 15-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të marrë masa konkrete për:

-Finalizimin dhe standardizimin e hedhjes së të gjitha dosjeve për çështjet e gjykatave Kombëtare në sistemin elektronik duke përcaktuar një afat kohor për përfundimin e këtij procesi.

-Krijimin e gjurmueshmërisë së plotë të të dhënave në sistem përfshirë:

- Regjistrimin automatik të datave të hedhjes dhe përditësimeve të çështjeve.
- Vendosjen e “audit trails” për çdo veprim të bërë në sistem.
- Integrimin e moduleve analitike dhe statistikore në sistemin elektronik për të gjeneruar raporte mbi ecurinë e çështjeve gjyqësore dhe për të mbështetur analizat e brendshme.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, ende në vitin 2025, të dhënat për vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatave të Arbitrazhit nuk janë të digjitalizuara, pasi nuk ka një sistem elektronik për sa i përket regjistrimit të vendimeve të GJEDNJ dhe Gjykatave të Huaja dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe çdo lloj korrespondence tjetër pjesë e procesit deri në publikimin e vendimit përfundimtar. Veprime në kundërshtim me Urdhrat e Titullarit të ASH, nr. 375, datë 20.10.2022 dhe nr. 375/1, datë 21.10.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e formatit të regjistrimit elektronik dhe fizik të çështjeve të Arbitrazhit dhe përfaqësimit në gjykatat e huaja”

-Mungesa e digjitalizimit ka sjellë:

Mungesë transparence dhe llogaridhënie, pasi rrit riskun e mos mbajtjes saktë dhe në kohë të çdo të dhëne të nevojshme për monitorimin e të gjithë korrespondencës shkresore apo e-maileve zyrtare si me institucionet brenda vendit ashtu dhe me ato ndërkombëtare;

Përgatitjen e dosjeve dhe çështjeve të reja apo atyre të mbartura në vite duke u bazuar në të dhëna të plota dhe të verifikuara si dhe kursyer kohë dhe burime njerëzore;

Gjurmimin dhe verifikimin e veprimeve, duke ulur mundësinë e ndërhyrjeve apo mosparaqitjes së plotë të fakteve si dhe mbrojtjen më të mirë të interesave të shtetit Shqiptar. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe 15-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të marrë masa konkrete dhe të ngrejë një grup pune me avokatët e shtetit dhe specialistë IT, për digjitalizimin e procesit të dosjeve dhe vendimeve të GJEDNJ dhe Gjykatave të Huaja dhe Arbitrazhit Ndërkombëtar ku të përcaktohen saktë çdo e dhënë për to, prej inicimit të këtyre çështjeve e deri në daljen e vendimit përfundimtar si dhe në monitorimin e korrespondencës me institucionet palë në këtë proces.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Funksionimi i dy organeve kolegjiale të Avokaturës së Shtetit: Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së dhe Kolegji i Avokaturës së Shtetit, përgjatë periudhës 2023-2024 paraqet mangësi në përmbushjen e qëllimit të parashikuar nga ligjvënësi pasi këto organe pothuajse kanë qenë jo funksionalë, si në drejtim të aspekteve procedurale, por edhe në numrin shumë të vogël të mbledhjeve të kryera (4 gjithsej për periudhën 2023-2024) për zgjidhjen dhe këshillimin në shumë çështje gjyqësore kundër Shqipërisë, duke mos dhënë besueshmëri për rolin të cilin ata kanë sipas përcaktimeve ligjore.

-Këshilli Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së gjatë vitit 2024, ka zhvilluar 2 mbledhje, konkretisht në datë 23.10.2024 dhe datë 13.11.2024. Procesverbalet e mbledhjeve nuk rezultojnë të firmosura nga pjesëmarrësit, por vetëm nga një anëtare e Sekretariatit Teknik dhe Titullari i Institucionit. Mungesa e konfirmimeve bie në kundërshtim me “Normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Ky Këshill nuk ka qenë funksional duke mos i shërbyer qëllimit për të cilin është krijuar në orientimin dhe konsultimin e Avokaturës së Shtetit, mbi masat parandaluese të cilat mund të shkaktojnë dëm financiar për shtetin si rezultat i shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, realizimin e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, ku deri në dhjetor 2024, janë ende pa u ekzekutuar 6 vendime të GJEDNJ-së me një barrë financiare të konsiderueshme për shtetin shqiptar në vlerën 17,968,650 euro, pa përfshirë këtu interesat që do të llogariten në momentin e ekzekutimit të tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin 10018 për ASH, i ndryshuar, nenin 19/7.

Për 2023-2024, ky kolegji është mbledhur gjithsej dy herë dhe nuk i ka shërbyer qëllimit për të cilin ai është i krijuar dhe përcaktuar në ligj pasi, kur të paktën duhet të ishte mbledhur 24 herë, në kundërshtim me nenin 20, pika 3 e Rregullores së brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Avokaturës së Shtetit” miratuar me Urdhrin Nr.68, datë 28.03.2019 të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 6, faqe 107-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Këshilli Konsultativ për Çështjet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të marrë masa për hartimin e planeve konkrete të punës dhe plan veprimet në kuadër të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2. Rekomandimi: Avokati i Përgjithshëm të marrë masa dhe të thërrasë në mënyrë periodike Kolegjin e Avokaturës së Shtetit për të përmbushur rolin për të cilin ai është krijuar në këshillimin për çështje të një rëndësie të veçantë për interesat e shtetit, dhënien e udhëzimeve të

përgjithshme për bashkërendimin dhe trajtimin e çështjeve, ndërmjet avokatëve që ushtrojnë funksione drejtuese dhe atyre të ngarkuar me ndjekjen e çështjeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Strukturat drejtuese dhe përgjegjëse të Avokaturës së Shtetit për hartimin e buxhetit nuk kanë ngritur strukturën për hartimin e kërkesave buxhetore dhe buxhetit vjetor, mungon gjurma e kërkesave dhe nevojave nga degët, mungon analiza e bazuar në rezultatet e vitit paraardhës si edhe analiza e shpenzimeve dhe përcaktimi i kostos për secilën kategori. Për hartimin e kërkesave buxhetore nga institucioni nuk janë ndjekur disa hapa për të siguruar që fondet e kërkuara janë të justifikuara dhe të bazuara në nevojat reale të institucionit, si: 1. Analiza e situatës financiare, duke analizuar buxhetin aktual dhe shpenzimet e realizuara si edhe identifikimin e fushave në të cilat ka mungesë fondesh/mbifinancime; 2. Vlerësimin e nevojave për vitin e ardhshëm, ku çdo sektor/departament paraqet nevojat për burime financiare, njerëzore dhe materiale si edhe projektet e reja/shërbimet që do të zbatohen; 3. Hartimi i planit të shpenzimeve në të cilin përfshihen pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet operative, mirëmbajtje, trajnime, etj, duke përcaktuar koston për secilën kategori.

Kërkesat buxhetore në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2023-2025 dhe PBA 2024-2026, nuk janë diskutuar/trajtuar dhe analizuar në mbledhjet e ekipit të manaxhimit të programit si përgjegjës për realizimin e detyrave teknike si edhe përgatitjen e kërkesave buxhetore, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” pika 2.5. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqe 64-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik i Avokaturës së Shtetit dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa që strukturat që do të merren me programimin e Planifikimin Buxhetor Afatmesëm, të kryejnë analiza të hollësishme të treguesve të buxhetit, të marrë në konsideratë kërkesat reale buxhetore sipas Drejtorive/sectorëve për hartimin e treguesve buxhetor afatmesëm PBA, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Avokatura e Shtetit nuk ka dërguar në Ministrinë e Financës, 2 raportet e monitorimit për vitin 2024, në kundërshtim me Udhëzimin nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”. Në raportet e monitorimit Avokatura e Shtetit nuk është kryer analizë mbi ndryshimet e zërave buxhetorë për periudhën raportuese, mosrealizimet e zërave buxhetorë dhe shkaqet, për të propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit, veprime në kundërshtim me kërkesat e pikës 267, të UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 2, faqe 64-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të ndjekin zbatimin e treguesve buxhetorë dhe të hartojnë raportet periodike të monitorimit të tyre shoqëruar me relacionet shpjeguese dhe analizë mbi ndryshimet e zërave buxhetorë për periudhën raportuese, mosrealizimet dhe shkaqet, duke propozuar në të njëjtën kohë masa për përmirësimin e situatës apo mangësitë në lidhje me procesin e zbatimit të buxhetit.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara nga Dega e Financës së Avokaturës së Shtetit, rezultoi se, veprimet nuk janë kryer

konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar dhe Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12.

Për vitin 2023, rezultoi se:

- Regjistrimi i dokumenteve në librat e kontabilitetit është kryer me vonesë dhe jo ditën e nesërme të paraqitjes së tyre, veprime në mospërputhje me pikën 60 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”;

- Në 6 raste, rezultoi shkelje e disiplinës buxhetore, për shkak të moslikujdimit në kohë të faturave tatimore, të cilat krijojnë premisa për lindjen e penaliteteve, veprime në mospërputhje me nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, nenin 7 të ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, si dhe UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184.

Për vitin 2024, rezultoi se:

-Dokumentacioni i bankës nuk është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit, si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet jo në çdo rast janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

Për periudhën janar-tetor të vitit 2024, shpenzimet e kryera nga Avokatura e Shtetit si blerje materiale të ndryshme, shpenzime qiraje, dieta personeli, etj., janë kryer në muajin dhjetor megjithëse faturat e blerjeve dhe shërbimeve datojnë prej muajve shkurt-shtator, likujdimet në mbi 30 raste, janë kryer me vonesë deri në muajin janar të vitit 2025.

Dega e financës ka pasqyruar në programin “Excel” vetëm shpenzimet e kryera, dhe jo me “Bartës informatikë”, të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë.

-Në 22 raste konstatohen fatura të kthyera nga thesari për mangësi të ndryshme, duke reflektuar veprime jo kronologjike në regjistrimin e urdhër shpenzimeve, në kundërshtim me Kreu III “pika 34,35 dhe 36 i UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

- Nuk janë mbajtur dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike nuk janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre nuk janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave, etj. si edhe nuk janë mbajtur regjistra analitik për llogaritë kreditorë e debitorë, libri i veprimeve të ndryshme etj.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II “pika 2.2. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqe 72-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

- Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit për vitin 2024 ka filluar në muajin mars të vitit 2025 gjatë kryerjes së auditimit në këtë institucion në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” i ndryshuar, neni 52, ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184, si edhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në

Njësitate e Sektorit Publik" pika 60 dhe 61 "Dokumentimi i vlerave monetare". (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqe 72-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për evidentimin më të saktë të veprimeve në kontabilitet, nëpërmjet dixhitalizimit të të dhënave me qëllim përmirësimin e mbajtjes së skedave të kontabilitetit, për të rritur sigurinë, cilësinë e regjistrimit, përpunimit dhe hartimit të pasqyrave financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për regjistrimin e veprimeve financiare në librat e kontabilitetit dhe kryerjen e pagesave të faturave brenda afateve ligjore të përcaktuara, me qëllim shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.3. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat për saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm, duke evidentuar veprimet në llogaritë përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Avokatura e Shtetit deri në datën 31.12.2024 është penalizuar me gjoba nga Drejtoria e Tatim Taksave Tiranë për vonesa në deklarime të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në shumën 391,550 lekë. Nëpërmjet bankës janë kryer pagesat e detyrimeve për gjobat në shumën 50,630 lekë, ndërsa diferenca prej 340,920 lekë është në proces gjyqësor me nr. çështje 31155-02028-80-2025 datë 03.03.2025. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqe 72-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për raportimin në afat të deklarimeve periodike në sistemin C@TS, me qëllim shmangien e penaliteteve nga Drejtoria e Tatimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2023, në kuadër të procesit të inventarizimit të aktiveve, nga komisioni i inventarizimit është përgatitur raporti mbi inventarizimin e aktiveve duke evidentuar një listë të veçantë të zërave të aktiveve, të cilat janë jashtë funksionit me vlerë 3,465,781 lekë. Në vijim, nëpunësi autorizues nuk ka marrë masa për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve, të cilat relatohen nga komisioni i inventarizimit si jo funksionale, si edhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave të asgjësimit apo dhënies në përdorim/tjetërsim të aktiveve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" paragrafët 96-99, 102 dhe 109.

Për vitin 2024, komisioni i inventarizimit ka hartuar 2 procesverbale ku janë pasqyruar aktivet materiale në vlerën 1,053,103 lekë që i vlerëson për nxjerrje jashtë përdorimi duke llogaritur edhe amortizimin e tyre, veprim në kundërshtim me pikën 102, të UKM nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Nga komisioni nuk janë dhënë shpjegime se mbi bazën e cilit kriter janë vlerësuar aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, veprime në kundërshtim me pikën 103, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

-Nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të cilat janë vlerësuar nga komisioni inventarizimit si aktive për jashtë përdorimi, në kundërshtim me UKM nr.30, datë

27.12.2011" *Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", pika 96. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqe 72-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të ndjekë hapat e mëtejshme për procesin e vlerësimit/asgjësimit të aktiveve të propozuara për nxjerrjen nga përdorimi, me qëllim identifikimin e aktiveve në gjendje/funksionale që disponon institucioni.

Deri në 30.06.2026

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se, në llogarinë 468 "Debitor të ndryshëm", vlera prej 11,053,138 lekë, përfaqëson masa zhdëmtimi për dëme ekonomike të konstatuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit përmes Raportit Përfundimtar të Auditimit nr.114/5 prot, datë 16.5.2007. Vlera është kontabilizuar, por nuk është arkëtuar ndër vite dhe nuk janë marrë masa për ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre. Veprime në kundërshtim me shkronjat "g" dhe "gj", të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqe 72-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të analizojë mundësitë për arkëtimin ose jo të detyrimeve të prapambetura, me qëllim pasqyrimin e drejtë të vlerave të kontabilizuara në pasqyrat financiare dhe klasifikimin e drejtë të debitorëve.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nuk është zbatuar Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", konkretisht:

Për periudhën 2023-2024, nga Avokatura e Shtetit nuk janë përcaktuar strukturat dhe mekanizmat që garantojnë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë, pasi nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik.

-Nuk është hartuar *Strategjia e Menaxhimit të Riskut/Plani i menaxhimit për trajtimin e risqeve*, dokumenti që përcakton mënyrën se si sillen institucioni ndaj risqeve dhe kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

-Nuk kryhet identifikimi, vlerësimi, kontrolli dhe monitorimi i risqeve në të gjitha nivelet me qëllim arritjen e objektivave dhe si rrjedhojë nuk është dokumentuar procesi i menaxhimit të riskut në një regjistër. Veprime në kundërshtim me nenin 8, pika 8, shkronja b), nenin 11, pikat 2 dhe 3, nenin 21, pika 2 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"(i ndryshuar), si dhe Udhëzimin nr. 16, dt.20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".

-Mungesat në staf në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse kanë ndikuar në drejtim të funksionimit të kësaj strukture duke mos garantuar ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, bazuar në nenin 22, pika 3, shkronja b) të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar. Gjatë vitit 2023, në strukturën e Avokaturës së Shtetit janë evidentuar gjithsej 7 vende të lira, ndërsa në vitin 2024 ky numër është rritur në 16 vende vakante.

-Për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve, veprime në kundërshtim me nenin 9, pika 4, shkronja dh) të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"(i ndryshuar) si dhe nenit 9, pika 5/t) të Rregullores së brendshme të Avokaturës së Shtetit. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 5, faqe 93-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Avokati i Përgjithshëm i Shtetit të marrë masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik, hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet

identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Të parashikohet mundësia e realizimit të investimeve në programe kompjuterike të licencuara, në funksion të përmirësimit të shërbimeve të njësisë, si dhe të merren masa për garantimin e sigurisë së të dhënave ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga përgjegjësit e strukturave për realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti.

Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.2. Rekomandimi: Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e vendeve vakantë në strukturën organizative, me qëllim përmbushjen me efikasitet të objektivave të institucionit si edhe të kryej vlerësimin vjetor të performancës në punë të punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.Gjetje nga auditimi: Avokatura e Shtetit nuk ka siguruar shërbim të auditimit të brendshëm, çka do të ofronte siguri të arsyeshme, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në institucion, në kundërshtim me nenin 12, pika 1, të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 5, faqe 93-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Avokati i Përgjithshëm i Shtetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Harmonizimit në Ministrinë e Financës, të marrë masa për vlerësimin e formës më të përshtatshme nga mundësitë e parashikuara në ligj, me qëllim sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm për institucionin.

Në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Procedura e miratuar me Urdhër të Avokatit të Përgjithshëm nr. 80, datë 08.04.2019 “Për miratimin e metodologjisë procedurale dhe materiale të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga zyra e inspektimit” nuk ka një parashikim apo rregullim të detajuar lidhur me fazën e planifikimit të inspektimit, mbi mënyrën e përzgjedhjes së subjekteve të inspektimit si dhe vlerësimin e riskut duke pamundësuar krahasimin vjetor plan-fakt si dhe për të vlerësuar performancën e subjekteve të inspektuara. Planet vjetore të Zyrës së Inspektimit në Avokaturën e Shtetit duhet të konsistojnë në planifikime të bazuara në analiza risku të aktivitetit inspektues, në kundërshtim me neni 21 i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, si dhe pikën 3.2 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 5, faqe 93-107, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Avokati i Përgjithshëm i Shtetit të marrë masa për rishikimin e Urdhrit nr. 80, datë 08.04.2019 “Për miratimin e metodologjisë procedurale dhe materiale të kontrollit të veprimtarisë së avokatëve të shtetit nga zyra e inspektimit” lidhur me hartimin e planeve të përgjithshme të inspektimit me qëllim plotësimin e tij me elementë që rregullojnë fazën e planifikimit të inspektimit, mënyrën e përzgjedhjes së subjekteve të inspektimit si dhe vlerësimin të mirëfilltë të riskut.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga komisioni i ngritur në kuadër të kontraktimit të studiove ligjore për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë në çështjet e arbitrazhit ndërkombëtar, bazuar në VKM nr.893, datë 18.11.2020 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja*”, rezultoi mungesë e akteve të tjera nënligjore për këtë lloj procedure. Avokatura e Shtetit nuk ka hartuar ndonjë akt si: Udhëzim/rregullore e brendshme që të përcaktojë rregulla më të detajuara lidhur me funksionimin e komisionit, detyrat e anëtarëve të komisionit, vendimmarrjen, rregullat mbi dokumentimin e plotë, të saktë dhe në kohën e duhur të procesit që nga nisja e tij deri në arkivimin e praktikës, si edhe rregulla të tjera që lidhen me konfidencialitetin e ruajtjes së të dhënave apo deklarinimit të interesit. Nisur nga fakti se VKM nr.893, datë 18.11.2020 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja*”, nuk i ka të përcaktuara qartë rregullat që ndiqen gjatë procesit të pikëzimit e të renditjes së subjekteve ofertuese lidhur me kritere si: “*përvoja profesionale e ofertuesit, eksperiencia të ngjashme të stafit kryesor të ofertuesit dhe raste të suksesit të ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit*”, komisioni i ngritur në ASH ka aplikuar një formulë të ngjashme me atë të vlerësimit të ofertës ekonomike sipas pikës 4, shkronja a) të kësaj VKM-je.

Kjo metodologji e përdorur nga komisioni është e pa miratuar me një akt të brendshëm. Mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 16, pikat 2 dhe 3, nenin 22 dhe nenin 23, pika 5, e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, si dhe pikën 3.3 të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

2. Anëtarët e komisionit nuk janë shprehur për mungesën e konfliktit të interesit në momentin e hapjes së ofertave sipas nenit 4, pika 1, shkronjës “c”, dhe pika 2 shkronjat “b”, “c”, si dhe neni 7, pika 1 në ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar.

3.Në procesverbalin e vlerësimit të subjekteve, lidhur me kriteret si: “*përvojë profesionale/eksperiencia të ngjashme të stafit kryesor dhe raste të suksesit*”, komisioni nuk ka dhënë shpjegime të hollësishme mbi mënyrën e vlerësimit të numrit të rasteve të ngjashme për secilin kriter.

4. Procedura e ndjekur dhe kriteret e vendosura për përzgjedhjen, kontraktimin dhe pagesën e avokatëve ose zyrave të avokatisë të huaja është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Kontrata e lidhur midis ASH dhe subjektit ndërkombëtar fitues është hartuar vetëm në gjuhën angleze si dhe nuk përkthehet nga një përkthyes i certifikuar, Ky veprim juridik duhet të përmbush kriteret e formës edhe sipas ligjit të shtetit shqiptar, në të cilin është kryer veprimi juridik, në kundërshtim me neni 14 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 20 i Kodit të Procedurës Administrative dhe neni 663 të Kodit Civil. (*Më hollësisht trajtuar në drejtimin 6, faqe 107-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1. Rekomandimi: Avokati i Përgjithshëm i Shtetit të marrë masa për hartimin e një akti nënligjor me karakter shpjegues mbi përcaktimin e rregullave më të qarta që duhet të ndiqen nga komisionet e ngritura për kontraktimin e studiove ligjore lidhur me: (i) dokumentimin e plotë, të saktë dhe në kohën e duhur të procesit që nga nisja e tij deri në arkivimin e praktikës si dhe përcaktimin e listës së akteve që duhet të përmbajë dosja e procedurës së kontraktimit; (ii) rregulla që lidhen me konfidencialitetin e ruajtjes së të dhënave dhe verifikimin e mungesës së konfliktit të interesit; (iii) detyrat e detajuara të anëtarëve të komisionit; (iv) procesin e pikëzimit e të renditjes së subjekteve ofertuese lidhur me kritere si: “*përvoja profesionale e ofertuesit, eksperiencia të ngjashme të stafit kryesor të ofertuesit dhe raste të suksesit të*

ofertuesit në procedime të ngjashme me objektin e procedurës së kontraktimit”, (v) arsyetimin e vendimmarrjes nga ana e komisionit si dhe (vi) hartimin e kontratës edhe në gjuhën shqipe.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Ministria e Financave në deklaratimet e saj si në raportet vjetore 2023 dhe 2024, ashtu edhe në evidencat e borxhit, nuk paraqet dhe nuk ka llogaritur në asnjë moment, vlerën e interesave mbi shumat e përcaktuara në vendimet e GJEDNJ-së apo të arbitrazhit ndërkombëtar kundër Shqipërisë edhe pse janë në tejkalim të afateve të përcaktuara e rrjedhimisht as Avokatura e Shtetit nuk e disponon këtë informacion.

Këto interesa që do të llogariten mbi dëmshpërblimin 17,968,650 euro (vlerat e vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së, ende të pa ekzekutuara) do gjenerojnë dëm në buxhetin e shtetit.

Mosveprimi ose veprimet me vonesë nga institucionet respektive (Ministria e Financave/Këshilli i Ministrave) në këto çështje krijojnë risk të lartë për efekte të tjera shtesë në dëm të buxhetit të shtetit, çka kërkon vëmendje të shtuar në vijim nga ana e Avokaturës së Shtetit si institucion përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre vendimeve por veçanërisht nga Ministria e Financave/Këshilli i Ministrave) të cilët vijnë me qëndrim të veçantë në mospërputhje me qëndrimet ligjore të njësive të specializuara siç është Avokatura e Shtetit dhe Këshilli Konsultativ për çështjet e GJEDNJ pranë saj. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe 15-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit në rolin e njësive përgjegjëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së por dhe të përfaqësuesit përpara Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ti ri kërkojë Këshillit të Ministrave përsheptimin e miratimit për shlyerjen e tyre si për vendimet e GJEDNJ-së dhe ato të Arbitrazhit, ende të pa ekzekutuara, për shmangien e kamatëvonesave.

-Avokatura e Shtetit të vlerësojë dhe të bashkëpunojë me Ministrinë së Financave për zbardhjen e vlerës së interesave financiarë të pa llogaritura për moszbatimin në afat të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat e ekspozojnë në vijimësi buxhetin e shtetit me një barrë të konsiderueshme financiare.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, nga Titullari i Njesisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohej në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën 82,500 lekë, sipas gjetjeve dhe rekomandimit të trajtuar.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ligjshmërisë dhe saktësisë së veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës rezultoi se nëpërmjet bankës janë kryer pagesa për dieta brenda vendit në shumën 66,000 lekë, referuar urdhrin të titullarit nr.469, datë 18.12.2024 për të kryer pagesat për monitorimin e transferimit të dosjeve gjyqësore në disa Zyra Vendore të AV.Shtetit. Në urdhër nuk është përcaktuar data e nisjes dhe e kthimit të punonjësve.

-USH nr.170, datë 18.12.2024 në shumën 22,000 lekë “Shpenzime dieta” z. S. D.

-USH nr.171, datë 18.12.2024 në shumën 22,000 lekë “ Shpenzime dieta” zj. Xh. D.

-USH nr.172, datë 18.12.2024 në shumën 22,000 lekë “Shpenzime dieta” z. L.V.

Pagesat janë kryer pa dokumentacionin justifikues dhe vërtetues, pasi nga punonjësit nuk janë paraqitur faturat e hotelit si edhe nuk janë plotësuar urdhër shërbimet, veprime në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 34, 35 dhe 36.

-USH nr.198, datë 07.01.2025 në shumën 16,500 lekë “Shpenzime dieta” referuar urdhrin të titullarit nr.482, datë 30.12.2024 për të kryer pagesat për shpenzimet e fjetjes z. Sh. S. për shërbimin e kryer në Vlorë në datat 13-16 qershor 2024.

Për këtë pagesë mungon dokumentacioni justifikues, sepse fatura tatimore nr.1648/2024 ora 15.45, e paraqitur nga hotel “Regina group” daton më 13.12.2024, e cila nuk përputhet me datat e përcaktuara në urdhrin e titullarit për kryerjen e shërbimit sepse shërbimi është kryer në muajin qershor ndërsa fatura e hotelit që vërteton kryerjen e tij është 6- muaj më vonë, mungon urdhër shërbimi si edhe nënshkrimi faturës së hotelit nga personi blerës, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 54/b “Kryerja pagesave” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 34, 35 dhe 36. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqe 72-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 1.1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masa duke ndjekur procedurat e nevojshme administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në shumën 82,500 lekë, përfituar pa dokumentacionin justifikues nga punonjësit, sipas gjetjes të trajtuar.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICËNCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE E TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ecursionit të detyrimeve shtetërore për vendimet e formës së prerë të Arbitrazhit Ndërkombëtar si dhe vlera e ekspozimit të Buxhetit të Shtetit nga çështjet në proces gjykim, u konstatuan:

-Në lidhje me vendimet e arbitrazhit të fituara nga RSH, rezulton se janë 7 vendime, nga të cilat 4 vendime janë të fituara gjatë vitit 2024.

Nga këto 7 vendime, janë njohur nga Gjykata e Apelit Tiranë, *vetëm 2 vendime:*

a. Çështja ICC Case No. 20564/EMT/GR, (iniciuar nga viti 2014), me *Vendimin nr. 131 datë 03.05.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë (kërkues MIE)*, ku Gjykata Ndërkombëtare e arbitrazhit ka vendosur që Pala Paditëse H. srl duhet t’i paguajë Penalitete për vonesat, RSH në shumën 1,693,157 Euro plus interesat, nga data 16 Korrik 2011 deri në pagesën e plotë;

- Detyrim i H që t’i paguajë dëmshpërblim RSH në shumën 5,182,535 Euro së bashku me interesat, nga data 09.01.2018 deri në pagesën e plotë;

- Detyrim i H që t’i rimbursojë RSH 325,000 USD sa i përket tarifave dhe shpenzimeve të arbitrave dhe shpenzimet administrative të ICC.

Nga MIE deri në 31.12.2023 nuk janë marrë masa për ekzekutimin e këtij vendimi, duke sjellë një paraqitje jo të drejtë të të drejtave dhe detyrimeve që kanë palët e treta ndaj institucionit

dhe anasjelltas. Mosnjohja në pasqyrat financiare sjell mos pasqyrim të saktë të të drejtave dhe detyrimeve.

b.Vendimi i dytë i njohur nga Gjykata e Apelit i përket çështjes ICSID ARB/14/26, (iniciuar nga viti 2014) “A.A” sh.p.k., A. N, shoqëria “C” s.r.l, me nr. 969, datë 25.11.2024.

Vendimi i Tribunalit datë 06.05.2022, ka vendosur: -se pala paditëse duhet t’i paguajë palës së paditur kostot dhe shpenzimet në vlerën totale prej €2,407,000, USD 837,128.71 dhe £106,755, brenda 28 ditëve nga momenti i shpalljes së këtij vendimi ose e thënë ndryshe në total 3,269,938.71 euro. (*pala e paditur, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*).

MTM i është drejtuar Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror, duke vënë në dijeni ASH.

Mos rimbursimi i vlerave të vendosura nga Vendimet e Gjykatave të Arbitrazhit në favor të Republikës së Shqipërisë, në buxhetin e shtetit, në dy çështjet të cilat janë njohur edhe nga Gjykata e Apelit, konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën totale **10,091,648.7 euro dhe 325,000 USD**, veprime në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile (K.Pr.C), neni 510. (*Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe 15-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë/Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për ndjekjen e procedurave dhe njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të vendimeve të arbitrazhit (*çështjet 1. ICC Case nr. 22676/GR dhe 2. ICC Case No. 20564/EMT/GR*) në pasqyrat financiare dhe të iniciohen veprimet për ekzekutimin dhe arkëtimin e vlerave monetare në shumën 7,105,903 euro, duke bashkëpunuar me Avokaturën e Shtetit për të raportuar të dhënat në kohë reale në Ministrinë e Financave.

Brenda datës 30.03.2026

1.2. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit t’i kërkojë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit/Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, të marrë masa për ndjekjen e procedurave dhe njohjen e të drejtave dhe detyrimeve të vendimeve të arbitrazhit (ICSID ARB/14/26, (iniciuar nga viti 2014) “A.A.” ShPK., A. N, shoqëria “C ” s.r.l, me nr. 969, datë 25.11.2024) në pasqyrat financiare dhe të iniciohen veprimet për ekzekutimin dhe arkëtimin e vlerave monetare në shumën 3,269,938.71 **euro**, duke bashkëpunuar periodikisht me Avokaturën e Shtetit për të raportuar të dhënat në kohë reale në Ministrinë e Financave.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me çështjet në gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar dhe vendimet e tyre ku shteti shqiptar është pala humbëse, deri në dhjetor 2024, rezultojnë 4 çështje, me efekte financiar në një vlerë totale *180,125,882 euro*, nga të cilat kosto të Gjyqësorit, dhe përfaqësimit janë 11,580,103.86 euro³², vlerë e cila gjithashtu do të paguhet nga qeveria shqiptare.

Përsa i përket vendimeve të humbura nga RSH, vetëm 1 (një) prej tyre është njohur nga Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 49 datë 04.05.2021, konkretisht: Çështja ICC Case no. 22676/GR me palë paditëse G.C, iniciuar prej 2017.

³² Në shumën e kostove të përfaqësimit në gjykata, janë përfshirë edhe 2 çështje në të cilat pala shqiptare ka qenë fituese por ka pasur detyrim për të paguar vlerat 5,902,888 euro, paraqitur në tabelën 14, rreshti 5-6.

Pala e Paditur (MIE dhe AKBN) detyrohen t'i paguajnë paditësit vlerën **12,577,852 USD**: si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencës së Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit.

MIE dhe AKBN detyrohen t'i paguajnë paditësit 292,760 USD dhe 14,452 Euro, me interes me normë 5% e cila llogaritet nga data e Vendimit deri në kryerjen e plotë të pagesës.

Prej datës së njohjes deri në periudhën e auditimit (prill 2025) nuk është marrë asnjë masë nga MIE dhe AKBN, për njohjen e këtij detyrimi dhe planifikimin në buxhetin përkatës për shlyerjen e tij duke e vendosur shtetin shqiptar para një risku tjetër në dëm të buxhetit të shtetit atë të interesave për 4 vite, të cilat të përlllogaritura nga grupi i auditimit prej datës së vendimit 06.07.2020 deri në 31.12.2024, vlera e pritshme e interesave është: 65,871 \$ dhe 2,890.4 euro, ose e shprehur në një monedhë të vetme **60,776 euro**, vlerë që përbën efekt negativ në buxhetin e shtetit, pasi MIE rezultoi të mos ketë njohur ende këtë detyrim në pasqyrat financiare të institucionit e si rrjedhojë nuk janë marrë masa për likuidimin e çështjeve të sipër përmendura, veprime në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 09.03.2018 i ndryshuar me UMF nr. 5, datë 21.2.2022 si dhe me nenin 46 të KEDNJ. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe 15-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore të marrin masa për zbatimin e menjëhershëm të vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit të njohur nga Gjykata e Apelit me vendim nr. 49 datë 04.05.2021, në vlerën 12,577,852 USD, si dëmshpërblim monetar për shkelje të detyrimeve të Licencës së Marrëveshjes të Cakran, Gorishtit dhe Ballshit, si dhe njohjen e këtij detyrimi në pasqyrat financiare të MIE.

Menjëherë

2.2. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit, të marrë masat e nevojshme duke informuar Këshillin e Ministrave, për të eliminuar kostot me efekt negativ financiar në buxhetin e shtetit në vlerën 60,776 euro të krijuara si pasojë e mos ekzekutimit të vendimit të formës prerë nr. 49 datë 04.05.2021, dhe në bashkëpunim me MIE të nxjerrë përgjegjësitë ligjore për çdo mosveprim të punonjësve.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me çështjet në proces apo të ndërprera, në gjykatat e arbitrazhit ndërkombëtar, 4 (katër) çështje janë të përfunduara, 2 (dy) janë çështje të pezulluara pra pa zhvillime nga ana e palës paditëse dhe 2 (dy) janë në proces.

Efekti negativ financiar i shpenzimeve gjyqësore, për t'u paguar nga buxheti i shtetit si palë e paditur për këto çështje (të pezulluara, të përfunduara dhe në proces) është 1,949,063 euro. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe 15-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit të marrë masat e nevojshme për të njohur dhe reaguuar në kohë në rastet kur gjyq fituesit e vendimeve të gjykatave të huaja/arbitrazhit ndërkombëtar kërkojnë zbatimin e vendimit në vende ku Shteti Shqiptar gëzon të drejta, duke analizuar në çdo rast përdorimin e mjetit ligjor më efektiv për mbrojtjen sa më të plotë dhe cilësore të interesit të vendit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Avokaturën e Shtetit, për vitin 2023, rezultoi se: janë shqyrtuar 47 çështje që lidhen me Shqipërinë, për 75 kërkesa. Në këto çështje, kërkuesit kanë kërkuar shpërblime financiare

prej rreth 2 miliardë lekë, ndërsa Gjykata pranoi shpërblime në vlerën e 29 milionë lekë, ose 279 mijë euro. Në 18 vendime u konstatuan shkelje nga ana e shtetit shqiptar, ndërsa në 16 vendime kërkesat janë shpallur të papranueshme. ASH ka zhvendosur qasjen drejt zgjidhjes me pajtim të çështjeve që lidhen me tej zgjatjen e proceseve gjyqësore.

a) Nga përpunimi i të dhënave sipas regjistrave manualë dhe Excel, të Avokaturës së Shtetit, rezulton se vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë, të cilat kanë marrë formën përfundimtare gjatë vitit 2023, janë 23, nga të cilët të ekzekutuar brenda vitit 2023, janë 14 me një vlerë dëmshpërblimi 10,416,942 lekë dhe 68,166 lekë interesa për 5 vendime të likuiduara jashtë afatit 3-mujor, në dëm të shtetit shqiptar, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10018 datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, nenin 19/4 “Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse” .

b) Në lidhje me vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë, të cilët kanë marrë formë të prerë në vitin 2023 dhe janë kryer pagesat në vitin 2024, rezultojnë të jenë 9, me një vlerë dëmshpërblimi 21,263,173 lekë nga të cilat 37,396 lekë janë interesa, për pagesa jashtë afatit 3 mujor.

c) Për vendime të GJEDNJ-së, të cilat kanë marrë formë përfundimtare në periudhën 2019-2021, por të ekzekutuara gjatë vitit 2023, rezultojnë të jenë 2 vendime (datë 26.01.2023) me një vlerë dëmshpërblimi 4,018,746 lekë, nga të cilat 369,741 lekë janë interesa për pagesa të kryera jashtë afateve ligjore, konkretisht Vendimi i datës 21.04.2021/Strazimiri. k. Shqipërisë dhe Vendimi i GJEDNJ i datës 17.09.2019/Prizreni k. Shqipërisë.

Shteti shqiptar për periudhën, janar- dhjetor 2024, ka ekzekutuar gjithsej 31 vendime, kundër Shqipërisë duke akorduar shpërblim dëmi në vlerën 30,355,446 lekë dhe në vlerë totale 30,403,545 lekë nga të cilat 48,009 lekë janë interes i paguar ndaj gjyqe fituesve, për vonesa në kryerjen e pagesës, veprime në kundërshtim me Neni 19/4 “Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse” të ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar. Nga 31 vendime të ekzekutuara, 9 prej tyre janë të mbartura nga viti 2023.

Pra, në total për periudhën, 2023-2024, janë paguar jashtë afatit 3 mujor, 19 vendime të GJEDNJ kundër Shqipërisë në shkelje të nenit 19/4 të Ligjit nr. 10018 datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar, “Afatet e ekzekutimit nga institucionet përgjegjëse”, të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën 485,916 lekë. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe 15-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të Buxhetit të Shtetit, në vlerën 485,916 lekë, kamatë vonesa për pagesa të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, jashtë afatit 3-mujor, për periudhën 2023-2024.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse (Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financës dhe Këshilli i Ministrave) nuk ka arritur ende të zgjidhë dhe të ekzekutojë vendimet e GJEDNJ në 6 çështje kundër Shqipërisë, të cilat kanë një vlerë dëmshpërblimi 17,968,650 euro, ku vetëm çështja SH përbën 75 % të këtij detyrimi (rreth 13.3 milion euro) me një vendim të datës 28.05.2018. Ndërkohë renditen edhe çështjet e tjera:

- Çështja “D. k. Shqipërisë” me vlerë 15,600 euro (datë 14.09.2015/Vendimi).
- Çështja “Dh. dhe N. k. Shqipërisë”, me vlerë 4,417,750 euro (datë 17.03.2016/Vendimi).
- Çështja “I srl k. Shqipërisë” me vlerë 10,800 euro, (datë 05.03.2024/Vendimi).

- Çështja “Z. k. Shqipërisë”, me vlerë 60,000 euro (datë, 11.06.2024/Vendimi).
- Çështja “M. & S. F. B. NV k. Shqipërisë”, me vlerë 17,200 euro (datë 16.10.2024/Vendimi).

Tre nga këto çështje datojnë me një vendim përfundimtar të GJEDNJ për më shumë se 7 vite, (2015-2018) të pa ekzekutuara ende, çka sjell një efekt negativ të shtuar në buxhetin e shtetit lidhur me kamatëvonesat që do të aplikohen mbi këto vlera. Moszbatimi i Vendimeve të GJEDNJ, nga shteti Shqiptar janë veprime në kundërshtim me nenin 46 të KEDNJ (detyrimi për zbatim), ku përcaktohet qartë se *palët kontraktuese angazhohen të respektojnë vendimet përfundimtare të gjykatës në çdo çështje në të cilën ato janë palë*. Shqipëria si shtet palë, ka detyrimin ligjor ndërkombëtar kushtetues të ekzekutojë vendimet e GJEDNJ-së brenda një afati të arsyeshëm.

Gjithashtu këto veprime janë në kundërshtim me nenin 122(2) të Kushtetutës së Shqipërisë. Në lidhje me 3 vendimet e GJEDNJ, të cilat kanë marrë formë përfundimtare në vitin 2024 dhe konkretisht:

-Kërkesa me nr. 31011/09 “I s.r.l k. Shqipërisë”, me vendim përfundimtar të GJEDNJ, datë 05.03.2024 dhe afat për pagesën e shpërblimit të drejtë brenda datës 05.06.2024;

-Kërkesa nr. 33164/11 “Z. k. Shqipërisë”, me vendim përfundimtar të GJEDNJ, datë 11.06.2024 dhe afat për pagesën e shpërblimit të drejtë në vlerën 60.000 euro brenda datës 11.12.2024;

-Kërkesa me nr. 41373/21 dhe 48801/21 “M. dhe S. F. B. N.V k. Shqipërisë”, vendim përfundimtar datë 16.10.2024 dhe afat për pagesën e dëmshpërblimit brenda datës 16.01.2025. Edhe pse ASH ka kryer praktikat sipas nenit 19/2 të Ligjit për Avokaturën e Shtetit, duke dërguar pranë Kryeministrit kërkesat për ekzekutimin e këtyre vendimeve, së bashku me projekt VKM përkatëse, Vendimi i Këshillit të Ministrave që duhet të miratohej brenda 30 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës së Avokaturës së Shtetit, nuk është miratuar duke dalë përtej afateve (përmbi 5 muaj) në kundërshtim me nenin 19/2 të Ligjit/10018, i ndryshuar për ASH, pika 5 si dhe me nenin 122 të Kushtetutës së RSH. (Më hollësisht trajtuar në drejtimin 1, faqe 15-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit në bashkëpunim me Këshillin Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, për 3 çështjet kryesore “SH and others v. A.”, “Dh. dhe N. vs. A.” dhe “D.k. Sh.” me vlerë 17,880,650 euro, me vendime të formës përfundimtare të GJEDNJ-së për më shumë se 7 vite, (pa përfshirë këtu interesat për vonesa në likuidim) të ri analizojë dosjet gjyqësore dhe vendimet e GJEDNJ dhe të informojë Këshillin e Ministrave për të gjitha shkeljet dhe mosveprimet e institucioneve respektive vendase, të cilat duhen adresuar, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse

Brenda datës 30.03.2026

5.2. Rekomandimi: Avokatura e Shtetit bashkë me Këshillin Konsultativ për Çështjet e GJEDNJ-së, për 3 çështjet “I srl K. Sh.”, “Z. k. Sh.” dhe “M & S F. B.NV k. Sh ” me vlerë 88,000 euro, me vendime të formës përfundimtare të GJEDNJ-së të dala gjatë vitit 2024, të marrë masa dhe ti kërkojë Këshillit të Ministrave miratimin e VKM përkatëse, për ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së si dhe shmangien e penaliteteve në vonesa për likuidim.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të urdhër-pagesave në lidhje me likuidimet e vendimeve gjyqësore si pasojë e largimit padrejtësisht të punonjësve, nga Avokatura e Shtetit deri në vitin 2023 janë likuiduar 3,608,445 lekë, ndërsa për vitin 2024 janë likuiduar 1,418,160 lekë shoqëruar me vlerën e përmbarimit (për 3 vendime) në shumën 320,547 lekë.

Pra, në total nga Avokatura e Shtetit detyrimi i paguar (për 4 vendime) deri në datën 31.12.2024 është 5,347,152 lekë dhe për 5 punonjës të tjerë vazhdojnë proceset gjyqësore.

Për këto vendime pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga Avokatura e Shtetit me marrjen e njoftimit të vendimit të formës së prerë dhe kthimit të tij në titull ekzekutiv, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbauesit privat, duke paguar tarifa përmbaimore, veprime të cilat kanë sjellë kosto shtesë për buxhetin e Avokaturës së Shtetit në shumën 320,547 lekë. Nëse ekzekutimi i vendimit gjyqësor do të ishte kryer me ekzekutim vullnetar do të minimizoheshin kostot në buxhetin e institucionit. *(Më hollësisht trajtuar në drejtimin 3, faqe 72-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masa për kryerjen në kohë të pagesave nga vendimet gjyqësore, me qëllim eliminimin e kostove shtesë nga tarifat përmbaimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.